

AVOKATI I POPULLIT

RAPORT I VEÇANTË

***“ANALIZË E EFIÇENCËS SË DREJTËSISË PËR FËMIJËT,
NË FUSHËN E MBROJTJES SË FËMIJËVE DHE ÇËSHTJEVE FAMILJARE”***

Tiranë, Nëntor 2024

Ky raport u mbështet financiarisht dhe teknikisht nga Zyra e UNICEF-it në Shqipëri. Gjithashtu, përpilimi i këtij raporti është bërë në bashkëpunim dhe me asistencën teknike të institucionit të Avokatit të Popullit.

Përgatiti: Arjana Fullani, Eksperte Ligjore Kombëtare

Qershor, 2024

Në përgatitjen e këtij dokumenti kontribuan në vijim:

Erinda Ballanca – Avokate e Popullit

Olta Aliaj - Komisionere e Avokatit të Popullit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve

Anila Nepravishta – Ndhmës Komisionere

Donald Fetah – Ndhmës Komisioner

Matilda Tyli – – Ndhmës Komisionere

PËRMBAJTJA

I. Shkurtime dhe akronime

II. Përkufizime

III. Objektivat

IV. Metodologjia

V. Kuadri ligjor ndërkombëtar, me fokus efencën e drejtësisë për fëmijët

V.1 Akte ndërkombëtare me karakter universal në kuadër të OKB-së

V.2 Akte ndërkombëtare me karakter rajonal

VI. Kuadri ligjor vendas, me fokus efencën e drejtësisë për fëmijët

VI.1 Kuadri ligjor përpara hartës së re gjyqësore

VI.2 Kuadri ligjor pas hartës së re gjyqësore

VII. Situata faktike e çështjeve gjyqësore civile, të mbrojtjes së fëmijëve dhe çështjeve familjare që prekin fëmijët, para dhe pas hartës së re gjyqësore (2020-2023)

VII.1 Situata e përgjithshme për gjykimin në shkallë të parë, përpara dhe pas hartës së re gjyqësore (2020-2023)

***VII.1.a)** Çështjet e mbrojtjes së fëmijës, para dhe pas hartës së re gjyqësore (2020 - 2023) në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë*

***VII.1.b)** Çështjet familjare që prekin fëmijët, para dhe pas hartës së re gjyqësore (2020 - 2023) në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë*

VII.2 Situata e përgjithshme për gjykimin në apel, përpara dhe pas hartës së re gjyqësore (2020 – 2023)

***VII.2.a)** Çështjet e mbrojtjes së fëmijës, para dhe pas hartës së re gjyqësore (2020 - 2023) në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë*

***VII.2.b)** Çështjet familjare që prekin fëmijët, para dhe pas hartës së re gjyqësore (2020 - 2023) në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë*

VII.3 Përmbledhje e gjetjeve/ rezultateve, në lidhje me situatën faktike të drejtësisë për fëmijët, para dhe pas hartës së re gjyqësore

VII.4. Kohëzgjatja e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore

VII.5 Ndihma Jurdike Falas

VII.6 Trajnimet

VII. Rekomandime

IX. Anekse

Aneks 1. Statistika 2020-2023

Aneks 2. Referenca të burimeve

I. SHKURTIME DHE AKRONIME

AP	Avokati i Popullit
BE	Bashkimi Evropian
CEPEJ	Komisioni Evropian për Eficiencën në Drejtësi
GJ.A.J.P.T	Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë
GJ.SH.P.J.P.T	Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë
GJ.L	Gjykata e Lartë
GJ.K	Gjykata Kushtetuese
GJEDNJ	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
INSTAT	Instituti i Statistikave
KDF	Konventa për të Drejtat e Fëmijëve
KEDNJ	Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut
K.F	Kodi i Familjes
KLGI	Këshilli i Lartë Gjyqësor
KKGJE/CCJE	Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropian
K.Pr.C	Kodi i Procedurës Civile
LMDF	Ligji për Mbrojtjen dhe të Drejtat e Fëmijëve
MD	Ministria e Drejtësisë
NJMF	Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve
OKB	Kombet e Bashkuara
PMF	Punonjës për mbrojtjen e fëmijëve
ToR	Termet e Referencës së Projektit “National consultant to support the People’s Advocate in analyzing the efficiency or the delay of justice for children in child protection and family laë areas.
UNCRC	Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (United Nations Children's Fund)
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

II. PËRKUFIZIME

“**Afati i arsyeshëm**¹” ka kuptimin e dhënë në nenin 399/2 të K.Pr.C dhe për qëllime të kësaj analize referenca do të jetë: - *“Afate të arsyeshme të përfundimit të hetimit, gjykimit apo ekzekutimit të një vendimi të formës së prerë, për qëllimet e përcaktuara në nenin 399/1, do të konsiderohen: b) në gjykimin civil në shkallë të parë përfundimi i procesit të gjykimit brenda dy viteve, në gjykim civil në apel brenda dy vjetëve; dhe gjykimin civil në Gjykatën e Lartë, brenda dy vjetëve; c) në procedurën e ekzekutimit të një vendimi civil apo administrativ, me përjashtim të detyrimeve periodike ose të përcaktuara në kohë, afati njëvjeçar fillon nga dita e paraqitjes së kërkesës për vënie në ekzekutim. 2. Palët në proces mund të kërkojnë konstatimin e tejzgjatjes së procedurave, sipas nenit 399/6, pika 1, edhe pa kaluar afatet e mësipërme, duke pasur parasysh kompleksitetin e çështjes, objektin e mosmarrëveshjes, të procedimit ose të gjykimit, sjelljen e organit që po kryen procedurat, si dhe të çdo personi tjetër të lidhur me çështjen, kur pretendojnë zvarritje të hetimit, gjykimit ose ekzekutimit të vendimit. 3. Në kohëzgjatjen e gjykimit ose të procedimit, nuk llogaritet koha kur çështja është pezulluar për shkaqe ligjore, kur është shtyrë për shkak të kërkesave të palës kërkuese, sipas këtij kreu, ose kur shfaqen rrethana të pamundësisë objektive për procedim.”*

“**Birësim**”² është procedura administrative dhe gjyqësore, nëpërmjet së cilës fëmijës, që i është privuar ose jo mjedisi familjar, i sigurohet një familje alternative, me të drejta dhe detyrime të njëjta me prindërit biologjikë.

“**Backlog**” ka kuptimin e çështjeve gjyqësore të akumuluar, të prapambetura, të cilat kanë nevojë të zgjidhen³.

“**Drejtësia miqësore**”⁴ për fëmijët, përfshin të drejtën për një proces të rregullt ligjor, të drejtën për pjesëmarrje dhe për të kuptuar procedurat, të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare, si dhe të integritetit dhe dinjitetit.

“**Fëmijë**”⁵ është çdo person nën moshën 18 vjeç. Në rastin kur mosha e personit është e pamundur të përcaktohet saktë, por ka arsye të besohet se personi është fëmijë, ai konsiderohet fëmijë, derisa mosha e tij të përcaktohet sipas legjislacionit në fuqi.

Fëmija përkufizohet në nenin 1 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës, si *“çdo qenie njerëzore nën moshën 18 vjeç, përveç rasteve kur sipas ligjit të zbatueshëm për fëmijën, mosha e madhe arrihet më herët”*.

“**Interesi më i lartë i fëmijës**”⁶ ka kuptimin e dhënë në nenin 2 të KF, ku parashikohet se prindërit, organet kompetente dhe gjykatat, në vendimet dhe veprimtarinë e tyre, duhet të kenë si konsideratë parësore interesin më të lartë të fëmijës.

¹ K.Pr.Civile, neni 399/2

² Ligji nr.9695, datë 19.3.2007 “Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit” i ndryshuar, neni 3, pika 1.

³ <https://dictionary.cambridge.org/dictionary/english/backlog>

⁴ VKM Nr. 892, datë 27.12.2022 “Për miratimin e strategjisë ndërsëktoriale të drejtësisë për të mitur 2022–2026, planit të veprimit dhe të pasaportës së indikatorëve”

⁵ Ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, neni 3, pika 4.

⁶ Kodi i Familjes, neni 2.

Ky parim nënkupton që në të gjitha veprimet në lidhje me fëmijët, qofshin të ndërmarrë nga institucionet publike ose private të mirëqenies sociale, gjykatat, autoritetet administrative ose organet legjislative, interesi më i lartë i fëmijës do të jetë një **konsideratë parësore**.⁷

Komiteti për të Drejtat e Fëmijës e ka interpretuar parimin si qëllim për të garantuar gëzimin e plotë dhe efektiv të të gjitha të drejtave të njohura në Konventë, si dhe e ka konsideruar atë në kuptim holistik, që përfshin gjendjen fizike, mendore, shpirtërore të fëmijës, zhvillimin moral, psikologjik dhe social”.⁸ Ky parim përfshin tre koncepte: (a) *Një e drejtë thelbësore*: E drejta e fëmijës që interesat e tij/saj më të mira të vlerësohen dhe të merren si konsideratë parësore kur merren parasysh interesa të ndryshme për të marrë një vendim për çështjen në fjalë, dhe garancia që kjo e drejtë do të zbatohet sa herë që do të merret një vendim në lidhje me një fëmijë, një grup fëmijësh të identifikuar ose të paidentifikuar ose fëmijët në përgjithësi. (b) *Një parim ligjor themelor me qëllim interpretues*: Nëse një dispozitë ligjore është e hapur për më shumë se një interpretim, duhet zgjedhur interpretimi që i shërben në mënyrë më efektive interesave më të mira të fëmijës. (c) *Rregull procedural*: Sa herë që do të merret një vendim që prek një fëmijë, një grup të identifikuar fëmijësh ose fëmijët në përgjithësi, procesi i vendimmarrjes duhet të përfshijë një vlerësim të ndikimit të mundshëm (pozitiv ose negativ) të vendimit për fëmijën ose fëmijët në fjalë. Vlerësimi dhe përcaktimi i interesit më të mirë të fëmijës kërkon garanci procedurale.⁹

Parimi sipas të cilit në të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijët, qofshin të ndërmarrë nga autoritetet publike apo institucionet private, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë një konsideratë parësore¹⁰.

“Juridiksioni”¹¹ ka kuptimin e dhënë në nenin 36 të K.Pr.C: *“Në juridiksionin e gjykatave hyjnë të gjitha mosmarrëveshjet civile dhe mosmarrëveshjet e tjera të parashikuara në këtë Kod e në ligje të veçanta. Juridiksioni gjyqësor civil ushtrohet sipas dispozitave të këtij Kodi dhe ligjeve të tjera. Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata. Është e pavlefshme çdo marrëveshje që lidhet në kundërshtim me këtë dispozitë. Juridiksioni përcaktohet në momentin e paraqitjes së padisë në gjykatë, pavarësisht ndryshimeve të mëpasshme të faktit apo të ligjit”*.

“Mbrojtje e fëmijës”¹² është parandalimi dhe përgjigjja ndaj dhunës, keqtrajtimit, shfrytëzimit dhe neglizhimit të fëmijës, përfshirë rrëmbimin, shfrytëzimin seksual, trafikimin dhe punën e fëmijës.

“Shkelja e afatit të arsyeshëm” ka kuptimin e dhënë në nenin 6/1, të Konventës Europiane “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore”. Në përcaktimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, gjykata vlerëson kompleksitetin e çështjes, objektin e mosmarrëveshjes, të procedimit ose të gjykimit, sjelljen e palëve dhe të trupit gjykues gjatë gjykimit, ose të përmbaruesit, si dhe të çdo personi tjetër të lidhur me çështjen¹³.

⁷ Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve, neni 3.

⁸ Konventa për të Drejtat e Fëmijës, Komiteti për të Drejtat e Fëmijëve, Për të Drejtën e Fëmijës për të marrë interesat e tij më të mira si konsideratë parësore, neni 3, para. 1, [Microsoft Word - 2013044186_142042.DOC \(ohchr.org\)](#).

⁹ Id.

¹⁰ Karta e të Drejtave Themelore të BE-së, neni 24.

¹¹ K.Pr.Civile, neni 36.

¹² Ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, neni 3, pika 8.

¹³ K.Pr.Civile, neni 399/9.

III. OBJEKTIVAT

Qëllimi i analizës së kryer nga institucioni i Avokatit të Popullit (Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve) është monitorimi dhe eksplorimi i efikasitetit (ose mungesës së tij) në drejtim të menaxhimit të çështjeve gjyqësore, pas implementimit të reformës në drejtësi dhe hartës së re gjyqësore, veçanërisht në fushën e mbrojtjes së fëmijëve dhe çështjeve familjare që prekin ata, nga e cila mund të rezultojë ose jo një drejtësi e vonuar për fëmijët. Analiza ka në fokus kryesor ndikimin e vonesave në gjykimin e çështjeve gjyqësore familjare tek të drejtat e fëmijëve (interesi më të lartë të fëmijës).

Në aspektin gjeografik, analiza është kryer vetëm për çështjet gjyqësore në kompetencë të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Në aspektin kohor, analiza ka përfshirë periudhën nga viti 2020 deri në vitin 2023.

Në fokus të kësaj analize nuk është legjislacioni penal, pra çështjet penale ku fëmijët/ të miturit janë palë në proces si të hetuar, të akuzuar, të pandehur, të dënuar, etj.

Në fokusin e kësaj analize janë përfshirë çështjet gjyqësore që lidhen me mbrojtjen e fëmijëve të parashikuara nga Ligji nr.18/2017 “Për mbrojtjen dhe të drejtat e fëmijëve”, si dhe disa çështje gjyqësore familjare të parashikuara nga Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë dhe Ligji nr.9695, datë 19.3.2007 “Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit” i ndryshuar. Më konkretisht, në analizë janë marrë çështje specifike të cilat janë përfshirë në këtë Raport Monitorimi të Avokatit të Popullit, si vijon:

Grupi i parë i çështjeve gjyqësore që prekin fëmijët, me objekt:

1) vleftësimin e masave të menjëhershme të mbrojtjes së fëmijëve, të përcaktuara në LMDF.

Grupi i dytë i çështjeve gjyqësore që prekin fëmijët, me objekt¹⁴:

1) zgjidhjen e martesës (neni 125 e në vijim të KF)

2) kërkimin e detyrimit të bashkëshortit tjetër për të përballuar shpenzimet për detyrimin për ushqim, edukimin dhe arsimimin e fëmijëve, si dhe shpenzimet për jetesë të bashkëshortit nevojtar, heqjen, pakësimin ose shtimin e detyrimit për ushqim të caktuar nga gjykata (neni 192 e në vijim i KF);

¹⁴ Disa nga çështjet gjyqësore që prekin fëmijët sipas Kodit të Familjes.

- 3) kërkimin për marrjen e masave të përkohshme për detyrimin për ushqim, edukimin dhe arsimimin e fëmijëve të mitur, për detyrimin për ushqim të bashkëshortit, kur shihet e arsyeshme, për sigurimin e banimit, si dhe administrimin dhe përdorimin e pasurisë së vënë gjatë martesës, derisa të jepet vendimi përfundimtar (neni 139 i KF).
- 4) kërkimin e derdhjes ose ndryshimit të kontributit kompensues nga njëri bashkëshort për llogari të tjetrit, për të kompensuar pabarazinë që mund të shkaktojë në jetën e tjetrit ndarja e pasurisë në zgjidhjen e martesës, përveç detyrimit për ushqim (neni 147 e në vijim i KF);
- 5) kërkimin e të drejtës së përdorimit të banesës së ish-bashkëshortit (neni 153 i KF);
- 6) kërkimin e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, të drejtës së vizitës ose të besuarit të fëmijës nga njëri ish-bashkëshort, heqjen ose ndryshimin e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore (neni 155 e në vijim i KF);
- 7) kthimin e fëmijës së mitur, kur nuk jeton pranë prindërve dhe mbahet pa të drejtë nga persona të tjerë (neni 218 i KF);
- 8) ushtrimin, heqjen, kthimin ose humbjen e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore (neni 220 e në vijim i KF);
- 9) përfaqësimin dhe administrimin e pasurisë së fëmijës (neni 231 e në vijim i KF);
- 10) birësimin e fëmijës (neni 240 e në vijim i KF);
- 11) deklarimin e braktisjes së fëmijës (neni 250 i KF);
- 12) vendosjen e kujdestarisë mbi fëmijën, heqjen dhe zëvendësimin e kujdestarit (neni 250 e në vijim, neni 300 i KF);
- 13) caktimin e kujdestarit të posacëm të fëmijës, mbarimin e kujdestarisë së posacme (neni 275 dhe neni 280 i KF);
- 14) vendosjen e kujdestarit të përkohshëm ose të marjes së masave të tjera urgjente që janë të nevojshme për mbrojtjen e të miturit ose për të ruajtur dhe administruar pasurinë e tij (neni 281 i KF);
- 15) Çdo çështje tjetër e së drejtës familjare që ka në fokus ose ndikon fëmijët.

IV. METODOLOGJIA

Për realizimin e këtij Raporti Monitorimi, gjatë analizës u përdorën disa metoda të aplikuara në një qasje të integruar, në funksion të objektivave të analizës të bazuar në Termat e Referencës, si dhe burimet parësore të informacionit të natyrës sasimore dhe cilësore.

1. Desk Study

1.a Shqyrtimi i dokumentave ligjorë të Reformës në Drejtësi dhe të Hartës së Re Gjyqësore, me fokus eficientë e drejtësisë për fëmijët

Reforma në gjyqësor metoi të adresojë problemet e evidentuara, përmes ndërhyrjeve të nevojshme kushtetuese dhe legislative, ku një ndër objektivat kryesorë ishte rritja e aksesit dhe efektivitetit në sistemin gjyqësor, nëpërmjet riorganizimit të gjykatave në përputhje me standardet evropiane. Realizimi i një shtrirjeje kapilare të shërbimit gjyqësor në të gjithë territorin e banuar të vendit, u krye nëpërmjet riorganizimit territorial të tij, në mënyrë që të garantohet aksesit i qytetarëve në këtë shërbim, efektiviteti i shërbimit gjyqësor, rritja e shpejtësisë së gjykimit, kontrolli i efektshëm i shkeljeve ligjore dhe faktike të gjykatave më të ulëta nga ato më të larta, si dhe shpërndarja proporcionale e ngarkesës mesatare të çështjeve për gjykatë dhe gjyqtar.

Për rrjedhim, metodologjia përfshin eksplorimin e:

- i. **kuadrit ligjor ndërkombëtar**, me fokus eficientë e drejtësisë për fëmijët, akteve ndërkombëtare me karakter universal në kuadër të OKB-së dhe akteve ndërkombëtare me karakter rajonal (si instrumentet në kuadër të Këshillit të Evropës, Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe standardet e GJEDNJ-së në lidhje me praktikën shqiptare, duke sjellë edhe raste specifike nga praktika e GJEDNJ-së për ta konkretizuar) si dhe instrumentet në kuadër të Bashkimit Evropian;
- ii. **kuadrit ligjor vendas**, me fokus eficientë e drejtësisë për fëmijët, përpara dhe pas hartës së re gjyqësore, të bazës ligjore si ndryshimet kushtetuese, ndryshimet e kodeve dhe ligjeve të posacme apo miratimi i ligjeve të reja, nxjerrja e vendimeve, urdhërave apo akteve të tjera nga organet vendimmarrëse të pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor, në kuadër të reformës në drejtësi dhe të hartës së re gjyqësore, të strategjive, analizave, studimeve, raporteve të cilat lidhen me zbatimin e reformës në drejtësi dhe eficientë në sistemin e drejtësisë, duke përfshirë drejtësinë për fëmijët në aspektin e mbrojtjes së fëmijëve dhe çështjeve familjare që i prekin ata.

Shqyrtimi i dokumentave të sipërpërmendur të kuadrit ligjor vendas, përfshin periudhën para dhe pas zbatimit të hartës së re gjyqësore, sipas referencave burimore në aneksin bashkëngjitur.

1.b Situata faktike e çështjeve gjyqësore civile, të mbrojtjes së fëmijëve dhe çështjeve familjare që prekin fëmijët, para dhe pas hartës së re gjyqësore (2020-2023)

Përvec shqyrtimit të dokumentave të kuadrit ligjor, për periudhën përpara dhe pas hartës së re gjyqësore, kjo analizë përfshin edhe vlerësimin e:

- **situatës faktike përpara dhe pas implementimit të hartës së re gjyqësore**, duke sjellë të dhëna specifike për efincencën dhe efikasitetin e gjykimit të çështjeve fokus analize në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për ta konkretizuar dhe për t'i bërë më të kuptueshme gjetjet dhe rekomandimet, në drejtim të evidentimit të mungesës ose jo të efincencës së sistemit të ri gjyqësor, për sa i përket çështjeve gjyqësore në fokus të kësaj analize.

Shqyrtimi i situatës faktike u realizua në bazë të të dhënave statistikore dhe cilësore, të cilat i referohen:

- i. dokumentave zyrtare të publikuara;
- ii. përgjigjeve dhe të dhënave të marra nga interlokutorët nëpërmjet pyetësorëve;
- iii. intervistave gjysëm të strukturuar me interlokutorët.

Mjetet e monitorimit që u përdorën gjatë kësaj analize përfshijnë:

- Listën e interlokutorëve
- Pyetësin
- Formularin e dhënies së pëlqimit nga të intervistuarit.

Lista e interlokutorëve (institucioneve dhe personave të kontaktit) u hartua duke mbajtur parasysh institucionet që mbajnë të dhëna statistikore dhe cilësore mbi çështjet gjyqësore me objekt mbrojtjen e fëmijës dhe çështjet familjare që prekin fëmijët. Në listën e interlokutorëve u përfshinë 7 (shtatë) institucione që dispononin të dhëna sasiore dhe cilësore, në lidhje me evidentimin e kohëzgjatjes së gjykimit për çështjet gjyqësore në fokus të kësaj analize, e më konkretisht:

- 1) Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë
- 2) Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë
- 3) Këshilli i Lartë Gjyqësor
- 4) Ministria e Drejtësisë
- 5) Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas
- 6) Shkolla e Magjistraturës
- 7) Dhoma Kombëtare e Avokatisë.

Nëpërmjet Pyetësorit u bënë përpjekje për të marrë të gjithë informacionin e nevojshëm për të vlerësuar nëse ndryshimet kushtetuese e ligjore, që kanë të bëjnë me organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor dhe hartën e re gjyqësore, kanë përmbushur synimin e rritjes së efincencës së

drejtësisë për fëmijët, për çështjet gjyqësore objekt i kësaj analize. Pyetësi me 14 pyetje kryesore dhe nënpyetjet përkatëse, u përdor gjatë zhvillimit të intervistave gjysëm të strukturuar me interlokutorët, nga Komisioneri për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve i Avokatit të Popullit dhe konsulentja e kontraktuar nga UNICEF Albania.

Formulari i dhënies së pëlqimit u vlerësua i nevojshëm nga Komisioneri për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve i Avokatit të Popullit dhe UNICEF, zyra Tiranë, duke u plotësuar dhe nënshkruar nga disa prej përfaqësuesve të interlokutorëve përpara zhvillimit të intervistës.

Marrja e informacionit nëpërmjet pyetësorit dhe intervistave, kishte për qëllim evidentimin dhe analizimin më tej të situatës faktike, në drejtim të:

- 1) *Si e zbaton gjykata vendimin nr.78, datë 30.05.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ) “Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në Gjykatën e Apelit” sipas të cilit çështjet gjyqësore që kanë për objekt të drejtat e fëmijëve apo që kanë ndikim tek një fëmijë i mitur janë çështje që shqyrtohen me prioritet? Si bëhet konkretisht prioritizimi i këtyre çështjeve nga ana e gjykatave në zbatim të vendimit 78/2019 të KLGJ-së? A ka ndonjë sistem/udhëzim/praktikë të brendshme të gjykatës për çështjet e mbrojtjes së fëmijëve dhe çështje të tjera familjare që prekin ata?*
- 2) *A ka gjykata një punonjës të caktuar që merret me njoftimet dhe trajtimin e dosjeve për çështjet e mbrojtjes së fëmijëve dhe çështje të tjera familjare që prekin ata? A është sistemi i menaxhimit të çështjeve i kompjuterizuar? Si bëhet njoftimi i palëve pas vendimit? A është eficient sistemi i njoftimit? A koordinohen sekretarët gjyqësorë të shkallës së parë dhe të apelit për transferimin në kohë dhe pa zvarritje të dosjeve të çështjeve gjyqësore? A ka aplikuar gjykata gjopa për rastet e zvarritjeve të çështjeve nga ana e palëve pjesëmarrëse në proces (psh. zvarritjet nga ana e avokatëve ose ndonjë institucioni palë në proces)?*
- 3) *Sa është backlog-u i dosjeve që kanë si objekt çështje që i përkasin mbrojtjes dhe të drejtave të fëmijëve apo që kanë ndikim tek fëmijët? Sa është numri i çështjeve që përfshijnë fëmijë vajza dhe sa djem? Sa është numri i përgjithshëm/ mesatar i çështjeve të mbrojtjes së fëmijëve dhe çështjeve të tjera familjare që prekin ata, që janë regjistruar në gjykatë (për secilin vit)? Cfarë masash janë marrë për evadimin e backlog-ut?*
- 4) *A e respekton gjykata të drejtën e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm ligjor si një ndër të drejtat themelore kushtetuese dhe si janë statistikat në këtë drejtim? A respektohen afatet procedurale të parashikuara nga K.P.C (neni 399/2) për gjykimin e çështjeve dhe si janë statistikat në këtë drejtim? A respektohen standardet e vendosura nga GJEDNJ për gjykimin e çështjeve gjyqësore që prekin fëmijët (standardet në çështjen Bara dhe Kola kundër Shqipërisë)?*
- 5) *Cilat janë shkaqet që cojnë në zgjatjen përtej afateve ligjore dhe përtej afatit të gjykimit të arsyeshëm të çështjeve të mbrojtjes së fëmijëve dhe çështjeve të tjera familjare që prekin ata? A kanë patur ndikim vonesat në gjykimin e çështjeve familjare tek të drejtat e fëmijëve (interesi më i mirë i fëmijës)?*

- 6) *Në lidhje me ndihmën juridike parësore, a ka raste kur fëmijët kanë marrë ndihmë juridike? Nëse po, në cilat raste/ çështje ka ndodhur që është kërkuar dhe/ose dhënë ndihmë juridike? Në sa raste është marrë ndihmë juridike falas? A janë të mjaftueshme burimet financiare dhe njerëzore për të ofruar dhe dhënë këtë lloj ndihme juridike? A është mospasja e ndihmës juridike një nga shkaqet e zvarritjes së çështjeve të mbrojtjes së fëmijëve dhe çështjeve të tjera familjare që prekin ata?*
- 7) *A kanë kryer gjyqtarët, prokurorët, administrata gjyqësore dhe avokatët, trajnime për të drejtat e fëmijëve dhe procedurat miqësore të drejtësisë për fëmijë? Nëse po, sa trajnime janë zhvilluar dhe sa profesionistë nga secila fushë janë trajnuar?*
- 8) *A ka gjykata statistika/ të dhëna se sa zgjasin proceset gjyqësore të fëmijëve dhe çështjeve të tjera familjare që prekin ata deri në dhënien e vendimit përfundimtar? Po statistika/ të dhëna në lidhje me kohëzgjatjen e ekzekutimit të këtyre vendimeve gjyqësore? Nëse po, si rezultojnë këto të dhëna? A ndahen ato me institucione të tjera të sistemit të drejtësisë dhe të sistemit të ekzekutivit që mbulon mirëqenien sociale?*
- 9) *Kohëzgjatja e gjykimit të çështjeve objekt analize dhe kohëzgjatja e ekzekutimit të vendimeve të gjykatës, është ulur apo është rritur krahasimisht me periudhën përpara zbatimit të hartës së re gjyqësore?*
- 10) *A ka gjykata një seksion të posacëm për çështjet familjare? Sa është numri i gjyqtarëve në këto seksione dhe a është i mjaftueshëm për të përballuar ngarkesën e çështjeve? A ka një shpërndarje proporcionale të ngarkesës mesatare të çështjeve për gjykatë dhe gjyqtar? Si është raporti i gjyqtarëve për numër banorësh në krahasim me normën europiane 22.2 gjyqtar për 100.000 banorë? A është arritur një shpërndarje proporcionale e stafit administrativ gjyqësor për gjykatën dhe për seksionin familjar në vecanti dhe a është garantuar një ekuilibër i drejtë i këtij raporti (gjyqtar/staf administrativ) pas hartës së re gjyqësore?*
- 11) *Sa është numri i çështjeve të gjykuara brenda afatit të arsyeshëm dhe sa është numri i çështjeve të gjykuara jashtë afatit të arsyeshëm (për secilin vit)?*
- 12) *A është kryer një kontroll i efektshëm i shkëlqeve ligjore dhe faktike të gjykatave më të ulëta nga ato më të larta (psh. Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm për vendimet e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë) për çështjet gjyqësore që kanë për objekt të drejtat e fëmijëve apo që kanë ndikim tek fëmijët?*
- 13) *A garantohet efica dha transparenca për përdoruesit e jashtëm të sistemeve të teknologjisë dhe informacionit të gjykatës dhe palët e interesuara në proces? Si është kryer migrimi i bazës së të dhënave dhe transferimi i dosjeve nga gjykatat e mbyllura, rishortimi i çështjeve pas largimit të gjyqtarëve për shkak të procesit veting dhe për shkak të mbylljes së gjykatave sipas hartës së re gjyqësore? A kanë ndikuar këto procedura në kohëzgjatjen e gjykimit?*

Eksplorimi i informacionit të mësipërm shërbeu eventualisht për të evidentuar edhe shkaqet apo shkaktarët e vonesave, zvarritjeve, shtyrjeve të gjykimit të çështjeve objekt i kësaj analize, e për rrjedhim daljen në konkluzione e rekomandime sa më të qarta, për t'u adresuar më tej nga institucioni i Avokatit të Popullit.

2. Mbledhja dhe studimi i të dhënave statistikore të publikuara

2.a Analiza sasiore dhe cilësore e të dhënave të publikuara.

Të dhënat e publikuara për periudhën nga viti 2020 deri në vitin 2023, të disponueshme nga bazat e të dhënave (web) të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, raportet e publikuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, u analizuan dhe u studiuan, duke u evidentuar në këtë Raport Monitorimi.

2.b Mbledhja dhe studimi i të dhënave statistikore të papublikuara, nëpërmjet takimeve dhe intervistave me interlokutorët (pyetësi)

Metoda e përdorur në këtë studim u bazua në intervistën gjysëm të strukturuar, e cila u zhvillua nëpërmjet dërgimit me shkresë dhe email të Pyetësit, përfaqësuesve të shtatë institucioneve të sipërpërmendura (interlokutorëve). Përveç të dhënave statistikore, nga ana e disa përfaqësuesve të interlokutorëve që u intervistuan, u dha edhe një panoramë e situatës në drejtim të efikasitetit të drejtësisë për fëmijë, për çështjet që lidhen me mbrojtjen e fëmijëve dhe çështjet e tjera familjare që i prekin ata. Intervistat u zhvilluan nga Komisioneri për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve të Avokatit të Popullit, i shoqëruar nga konsulenti, për ndihmë dhe orientim në mbledhjen e të dhënave.

3. Draft-Raporti i Monitorimit

Pas shqyrtimit të dokumentave të kuadrit ligjor për periudhën para dhe pas hartës së re gjyqësore, si dhe pas mbledhjes, studimit dhe evidentimit të të dhënave statistikore mbi situatën faktike të kohëzgjatjes së çështjeve gjyqësore në fushën e mbrojtjes së fëmijëve dhe çështjeve familjare që prekin ata, u realizua përmbledhja e gjetjeve kryesore, mbi bazën e të cilave u zhvilluan dhe adresuan edhe rekomandimet përkatëse në draftin e Raportit të Monitorimit.

4. Raporti Përfundimtar i Monitorimit dhe publikimi i tij

Përmbledhja e situatës ligjore dhe faktike në lidhje me kohëzgjatjen e gjykimit të çështjeve në fushën e mbrojtjes së fëmijëve dhe çështjeve familjare që prekin ata, gjetjet kryesore dhe rekomandimet e bazuara në këto gjetje, janë evidentuar në këtë Raport Monitorimi, i cili është produkt i rishikuar i draft-Raportit të Monitorimit, nga Komisioneri për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve, Avokati i Popullit dhe UNICEF, zyra Tiranë.

Raporti Përfundimtar i Monitorimit do të bëhet publik në eventin që do të organizohet nga Avokati i Popullit me mbështetjen e UNICEF, zyra Tiranë.

V. KUADRI LIGJOR NDËRKOMBËTAR, ME FOKUS EFICENCËN E DREJTËSISË PËR FËMIJËT

Tanimë ekziston një gamë e gjerë instrumentesh ndërkombëtare, të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian, të detyrueshme për shtetet dhe ato që përfaqësojnë deklaratat jodetyruese të praktikave të mira për të drejtat e fëmijëve, që prekin të gjithë elementët e sistemit të drejtësisë për fëmijët, në aspektin civil dhe penal. E drejta ndërkombëtare, kolektivisht, përshkruan të drejtat e fëmijëve dhe mbrojtjen e tyre, si dhe angazhimin për trajtimin e përshtatshëm të fëmijëve në cdo hallkë të procesve gjyqësore. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenet e saj 5, 116 dhe 122, parashikon se Republika e Shqipërisë zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të, duke i rradhitur marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, të cilat përbëjnë pjesë të sistemit të brendshëm juridik, në hierarkinë e akteve normative që kanë fuqi përpara ligjeve. Shqipëria ka ratifikuar shumicën e instrumenteve të miratuara në kuadër të sistemit të të drejtave të njeriut të Kombeve të Bashkuara (OKB), si edhe në kuadër të organizatës së Këshillit të Evropës (KE), ndërkohë që është duke bërë punë përpara nëpërmjet mekanizmit të përafrimit të ligjeve me direktivat e Bashkimit Evropian (BE)¹⁵.

Afatet kohore specifike në lidhje me "kohën e arsyeshme" të procesit gjyqësor nuk janë përcaktuar në kuadrin ligjor të KE-së dhe BE-së, por çështjet vlerësohen në baza individuale dhe në dritën e të gjitha rrethanave specifike. Ky vlerësim bëhet në përputhje me kriteret e përcaktuara nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) në praktikën e saj gjyqësore, të cilat zbatohen edhe nga Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Evropian. GJEDNJ fillimisht identifikon periudhën që duhet marrë në konsideratë në përcaktimin e kohëzgjatjes së procedurave dhe më pas shqyrton nëse afati kohor është i arsyeshëm.¹⁶

V.1 Akte ndërkombëtare me karakter universal në kuadër të OKB-së

1) Konventa për të drejtat e fëmijëve¹⁷

Konventa për të Drejtat e Fëmijëve ("KDF") është traktati i parë gjithëpërfshirës, ndërkombëtarisht i detyrueshëm, për njohjen e plotë të të drejtave individuale të fëmijëve. E drejta e fëmijëve për një gjykim të drejtë, duke përfshirë mbrojtjen ligjore dhe respektimin e afateve të arsyeshme gjyqësore, është sanksionuar në nenin 40¹⁸ të KDF-së, ku parashikohen ndër të tjera garancitë procedurale për fëmijët e dyshuar ose të akuzuar për shkelje të ligjit penal, në lidhje me shqyrtimin

¹⁵ European Charter of Fundamental Rights (Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Evropian) ende nuk është miratuar nga Shqipëria, me gjithë insistimin dhe rekomandimet e vazhdueshme të Avokatit të Popullit.

¹⁶ GJEDNJ, Kudla kundër Polonisë [GC], Nr. 30210/96, 26 tetor 2000, parag. 124

¹⁷ Vendi ynë e ka nënshkruar Konventën më datë 26 Janar 1990 dhe e ka ratifikuar atë me Ligjin nr. 7531, datë 11.12.1991 "Për ratifikimin e Konventës për të Drejtat e Fëmijës (OKB)"

¹⁸ KDF – Neni 40 pika 2, germa b – "(b) Çdo fëmijë i dyshuar ose i akuzuar për shkelje të ligjit penal të ketë të paktën garancitë që vijojnë: (iii) Çështja e tij të shqyrtohet pa vonesë nga një autoritet ose instancë gjyqësore kompetente, e pavarur dhe e paanshme, sipas një procedure të drejtë ligjore, në praninë e ndihmës juridike ose të një ndihme tjetër të përshtatshme, dhe, kur gjykohet se kjo nuk është në interesin më të lartë të fëmijës, sidomos për arsye të moshës ose gjendjes së tij, në prani të prindërve ose përfaqësuesve të tij ligjorë."

pa vonesë nga një instancë gjyqësore, sipas një procedure të drejtë ligjore, në praninë e ndihmës juridike ose të një ndihme tjetër të përshtatshme, dhe, kur gjykohet se kjo nuk është në interesin më të lartë të fëmijës, sidomos për arsye të moshës ose gjendjes së tij, në prani të prindërve ose përfaqësuesve të tij ligjorë. Megjithatë, ky parashikim mbetet brenda kuadrit të një procesi penal dhe nuk ekzistojnë parashikime mbi mbarëvajtjen e proceseve civile.

Përdorimi i KDF në proceset gjyqësore është padyshim një mënyrë e menjëhershme për të avancuar qëllimet specifike për të drejtat e fëmijëve (në proceset gjyqësore në nivele kombëtare dhe ndërkombëtare nga GJEDNJ-ja), në një sistem tashmë efektiv të ankimit individual për shkelje të të drejtave themelore.

Zbatimi i KDF-së monitorohet nga Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve (Komiteti) përmes Vëzhgimeve Përfundimtare, të cilat detajojnë masën në të cilën çdo shtet palë e ka zbatuar Konventën. Pavarësisht punës monitoruese të Komitetit, në kushtet e mungesës së parashikimit në KDF, të një mekanizmi gjyqësor për të zbatuar dispozitat e saj (*duke qenë se sipas KDF-së nuk ka asnjë gjykatë ndërkombëtare që të gjykojë për çështjet e të drejtave të fëmijëve*), me anë të Protokollit Opsional të KDF-së “Mbi procedurën e komunikimit”¹⁹ (OPIC) të Kombeve të Bashkuara të vitit 2011 (hyrë në fuqi nga muaji Prill 2014), është garantuar ankimi individual i fëmijës përpara Komitetit, pas ezaurimit të rrugëve ligjore sipas legjislationit vendas. OPIC i njohur gjithashtu si Protokoll i Tretë Opsional i KDF-së, është një akt ndërkombëtar për të drejtat e njeriut që lejon Komitetin të dëgjojë ankesat e fëmijëve, që pretendojnë se iu janë shkelur të drejtat. Fëmijët mund t'i drejtohen Komitetit vetëm nëse sistemi ligjor vendas nuk ka qenë në gjendje të sigurojë një zgjidhje për shkeljen. Komunikimi individual mund të paraqitet nga individ që pretendon të jetë viktimë e ndonjë shkelje nga shteti palë, të KDF-së, Protokollit Opsional të KDF-së mbi shitjen e fëmijëve, prostitucionin dhe pornografinë me fëmijë dhe Protokollit Opsional të KDF-së mbi përfshirjen e fëmijëve në konflikt të armatosur (neni 5). Komiteti ka kompetencën të nisë hetime për shkelje të rënda ose sistematike të të drejtave të fëmijëve në shtetet palë të OPIC (neni 13).

Së fundmi, Komiteti për të Drejtat e Fëmijëve ka vendosur t'i kushtojë Komentin²⁰ e tij të 27-të të Përgjithshëm, të drejtave të fëmijëve për akses në drejtësi dhe mjete efektive juridike. Një shumicë dërrmuese e fëmijëve të drejtat e të cilëve shkelen, nuk kanë akses në drejtësi dhe në mjete juridike pas shkeljes ose mohimit të të drejtave. Statusi i fëmijëve, mungesa e njohurive për të drejtat e tyre dhe aftësia për t'i kërkuar ato, si dhe mungesa e mekanizmave të aksesueshëm dhe efektiv të ankesave në nivel lokal, janë barriera të menjëhershme. Nëse fëmijët i drejtohen gjykatave, fakti që proceset ligjore janë rrallë miqësore për fëmijët, përveç faktorëve ekonomikë, socialë dhe kulturorë, krijojnë pengesa të mëtejshme në ndjekjen e mjeteve juridike. Komiteti ka pohuar se e

¹⁹ Republika e Shqipërisë e ka ratifikuar me ligjin nr. 86/2013, datë 14.02.2013 “Për ratifikimin e protokollit opsional të konventës për të drejtat e fëmijës “Për procedurën e komunikimit”. - (OPIC-Optional Protocol to the Convention on the Rights of the Child on a Communications Procedure)

²⁰ Committee on the Rights of the Child - Concept Note: General Comment on Children’s Rights to Access to Justice and Effective Remedies, on 95th session in January 2024. <https://www.ohchr.org/en/documents/general-comments-and-recommendations/draft-general-comment-no-27-childrens-rights-access>

drejta për mjete juridike është e nënkuptuar në Konventën për të Drejtat e Fëmijës, ndërsa kjo e drejtë përmendet në mënyrë eksplicite në traktatet e tjera kryesore ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Pavarësisht nga njohja e kësaj të drejte, shpesh keqkuptohet se aksesit në drejtësi ka të bëjë vetëm me fëmijët e pretenduar, të akuzuar ose të njohur se kanë shkelur ligjin penal, por **cështja e aksesit në drejtësi dhe mjeteve efektive juridike është shumë më e gjerë**. Aksesit në drejtësi përfshin aftësinë për të kërkuar, individualisht ose kolektivisht, dhe për të marrë një zgjidhje të drejtë, të barabartë dhe **në kohë** për shkeljet e të drejtave. Aksesit përfshin të drejtën për t'u njohur para ligjit dhe për një gjykim të drejtë, të drejtën për ankim, akses të barabartë dhe **në kohë në gjykata**, mbrojtje efektive gjyqësore dhe mekanizma të tjerë ankimi për të sjellë një rezultat efektiv. Këto të drejta janë gjithashtu kyçe për sundimin e ligjit dhe nënkuptojnë se të gjithë – **duke përfshirë fëmijën më të cenueshëm në zonën më të largët – duhet të kenë akses në drejtësi dhe mjete juridike**. Me anë të këtij Komenti të Përgjithshëm, ndër të tjera synohet:

- Nxitja e një kuptimi gjithëpërfshirës të **elementeve që janë kritike për të siguruar akses** në drejtësi dhe mjete efektive juridike për të gjithë fëmijët;
- **Identifikimi i barrierave praktike, ligjore, sociale dhe kulturore** që i pengojnë fëmijët të kenë akses në drejtësi dhe ofrimi i udhëzimeve për të siguruar një zgjidhje efektive;
- Qartësimi i detyrimit të shteteve për të garantuar të gjitha të drejtat e përcaktuara në Konventë, nëpërmjet një sërë **mekanizmash ankesash efektive dhe të aksesueshme**;
- Dhënia e udhëzimeve për **fuqizimin e fëmijëve** për të njohur të drejtat e tyre, për të kërkuar drejtësi dhe **për të marrë dëshmipërblim**;
- **Përshtatja e sistemit të drejtësisë për ta bërë atë miqësor ndaj fëmijëve**;
- Krijimi i lidhjes dhe sinergjisë ndërmjet Konventës dhe mekanizmave të tjerë ndërkombëtarë, që janë kritike për të siguruar **akses në drejtësi dhe mjete efektive juridike për fëmijët**;
- Theksimi i nevojës për të ofruar **mbrojtje miqësore për fëmijët**, për të drejtat thelbësore dhe procedurale të fëmijëve, për të pasur akses në drejtësi dhe mjete efektive juridike;
- Ofrimi i shembujve dhe udhëzimeve konkrete për shtetet, për të ngritur **mekanizma efektivë**, që do të mbështesin fëmijët kur ata kanë nevojë për akses në drejtësi dhe mjete juridike.

2) Konventa e Hagës mbi “Juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen, zbatimin dhe bashkëpunimin në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve”²¹

Konventa mbi “Juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen, zbatimin dhe bashkëpunimin në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve” e nënshkruar në Hagë, më 19 tetor 1996, mbulon një gamë të gjerë masash civile për mbrojtjen e fëmijëve, parashikon rregulla uniforme që parandalojnë vendimet kontradiktore dhe që sigurojnë njohjen dhe zbatimin e masave ndërmjet shteteve. Konventa sjell përkufizimin e “përgjegjësisë prindërore” si autoritetin prindëror ose çdo marrëdhënie të ngjashme të autoritetit që përcakton të drejtat, kompetencat dhe përgjegjësitë e prindërve, kujdestarëve ose përfaqësuesve të tjerë ligjorë në lidhje me fëmijën ose pasurinë e tij. Ajo përcakton shtetin që ka në juridiksion marrjen e masave në lidhje me mbrojtjen

²¹ Republika e Shqipërisë ka aderuar në këtë Konventë me ligjin nr. 9443, datë 16.11.2005, hyrë në fuqi më 1.4.2007

e fëmijëve ose pasurinë e tyre; ligjin e zbatueshëm për përgjegjësinë prindërore; njohjen dhe zbatimin e masave mbrojtëse në të gjitha shtetet kontraktuese, etj. Më konkretisht, Konventa iu referohet masave të tilla si: dhënia, ushtrimi, përfundimi, kufizimi ose delegimi i përgjegjësisë prindërore; të drejtat e kujdestarisë, kujdesi për fëmijën, përcaktimi i vendbanimit të fëmijës, të drejtën për ta marrë fëmijën për një periudhë të kufizuar kohe në një vend tjetër nga ai i banesës së përhershme të fëmijës; kujdestarinë dhe institucionet e ngjashme; vendosjen e fëmijës në një familje kujdestare nën kujdesin institucional; administrimin, ruajtjen ose eliminimin e pasurisë së fëmijës, etj. Republika e Shqipërisë ka rezervuar të drejtën e juridiksionit të autoriteteve të veta, për të marrë masa për mbrojtjen e pasurisë së fëmijës në territorin e vet, si dhe të drejtën e mosnjohjes së një përgjegjësie prindërore apo të një mase, për sa kohë nuk është në përputhje me ndonjë masë të marrë nga autoritetet e veta, në lidhje me këtë pasuri (parashikuar në paragrafin e parë të nenit 55 të Konventës). Konventa nuk përmban referime mbi zbatimin e afateve të arsyshme në procedimet gjyqësore objekt i saj.

3) Konventa e Hagës nr.23 “Mbi njohjen dhe zbatimin e vendimeve në lidhje me detyrimet ushqimore”²²”

Konventa nr.23 “Mbi njohjen dhe zbatimin e vendimeve në lidhje me detyrimet ushqimore” e nënshkruar në Hagë, më 2 tetor 1973, rregullon njohjen e ndërsjellë dhe zbatimin e vendimeve që lidhen me detyrimet ushqimore për sa i përket fëmijëve dhe të rriturve, për një vendim të dhënë nga një autoritet gjyqësor/ administrativ në një shtet kontraktues ose për një marrëveshje të bërë nga ose para një autoriteti të tillë, në lidhje me një detyrim ushqimor, ndërmjet: a) një përfituesi të detyrimit ushqimor dhe një ofruesi të detyrimit ushqimor; apo b) një ofruesi të detyrimit ushqimor dhe një autoriteti publik, i cili pretendon rimbursimin e fitimeve të dhëna një përfituesi të detyrimit ushqimor (neni 1). Efekti i Konventës kufizohet vetëm në pjesët e vendimit gjyqësor/administrativ apo marrëveshjes që lidhet me detyrimet ushqimore. Sipas Konventës, një autoritet publik mund të kërkojë njohjen apo zbatimin e një vendimi gjyqësor/ administrativ, nëse atij i është dhënë e drejta *ipso jure* sipas ligjit vendas, për të kërkuar njohjen apo zbatimin e vendimit në vend të përfituesit të detyrimit ushqimor (neni 19).

4) Konventa e Hagës nr.38 “Për rivendosjen ndërkombëtare të detyrimit ushqimor ndaj fëmijëve dhe formave të tjera të mbështetjes për anëtarët e tjerë të familjes”²³”

Konventa nr.38 “Për rivendosjen ndërkombëtare të detyrimit ushqimor ndaj fëmijëve dhe formave të tjera të mbështetjes për anëtarët e tjerë të familjes” e nënshkruar në Hagë, më 23 nëntor 2007, sanksionon detyrimin e shteteve palë që të marrin të gjitha masat e duhura, për të siguruar rivendosjen e detyrimit të mbështetjes financiare për fëmijën nga prindi (prindërit) ose persona të tjerë përgjegjës, në veçanti kur këta persona jetojnë në një shtet të ndryshëm nga ai i fëmijës. Ajo ka për qëllim garantimin e procedurave që sjellin rezultate dhe janë më të arritshme, të shpejta,

²² Republika e Shqipërisë ka aderuar në këtë Konventë me ligjin nr. 10398, datë 17.3.2011, hyrë në fuqi më 1.12.2012

²³ Republika e Shqipërisë e ka ratifikuar me Ligjin nr.63/2012 datë 15.06.2012.

efektive, ekonomike, të hapura dhe të drejta. Vlen për t'u theksuar se Konventa parashikon një mekanizëm (neni 7), sipas të cilit një autoritet qendror mund t'i bëjë një kërkesë të arsyetuar një autoriteti tjetër qendror, për të marrë masa të nevojshme të veçanta, kur nuk është përfunduar asnjë kërkesë drejtuar një kreditori ose debitori, në një shtet kërkues, që synon të rivendosë mbështetjen financiare sipas kësaj Konvente (neni 10). Ky mekanizëm bazohet në krijimin e një rrjeti autoritetesh publike/administrative ndërkombëtare bashkëpunuese midis tyre, ku çdo shtet kontraktues duhet të caktojë një autoritet qendror për të përmbushur detyrat që vendosen nga Konventa për këtë autoritet (neni 4). Në rastin e Shqipërisë, autoriteti vendas është Ministria e Drejtësisë. Konventa nuk përmban asnjë parashikim afatesh mbi shqyrtimin e kërkesave objekt i saj.

5) Konventa e Hagës, nr.33 “Për mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin për birësimet jashtë vendit”²⁴

Konventa nr.33 “Për mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin për birësimet jashtë vendit”, e nënshkruar në Hagë më 29 maj 1993, mbron fëmijët dhe familjet e tyre nga rreziqet e birësimeve të paligjshme, të parregullta, të parakohshme ose të keqpërgatitura jashtë vendit. Në kontekstin e kësaj analize vlen të përmenden parashikimet e nenit 9, ku kërkohet lehtësimi, ndjekja dhe

p
ë
r
s
h

6) Konventa e Hagës “Për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës”²⁵

e

Konventa për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës e nënshkruar në Hagë, në 25.10.1980, parashikon përdorimin e procedurave më të shpejta të mundshme, për mbrojtjen ndërkombëtare të fëmijëve nga pasojat e dëmshme të largimit ose mbajtjes së tyre padrejtësisht, si dhe që të drejtat e kujdestarisë dhe të kontaktit të respektohen efektivisht në shtetet e tjera kontraktuese, duke pranuar se interesat e fëmijëve janë të një rëndësie të veçantë në çështjet që lidhen me kujdestarinë e tyre (nenet 1 dhe 2). Autoritetet qendrore, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë, qoftë me anë të ndërmjetësve, mund të iniciojnë ose ndihmojnë në fillimin e procedimit, me qëllim organizimin ose mbrojtjen e këtyre të drejtave dhe sigurimin e respektimit të kushteve ndaj të cilave mund të jetë objekt ushtrimi i këtyre të drejtave (neni 21). Autoriteti kompetent për zbatimin, tek i cili është bërë një kërkesë për ekzekutimin e një vendimi në një shtet tjetër anëtar, duhet të veprojë gjithashtu me shpejtësi në shqyrtimin e kërkesës. Në rastet kur ky vendim nuk është zbatuar brenda gjashtë javëve nga data e fillimit të procedurave përmbartimore,

e

d

²⁴ Ratifikuar me ligjin nr. 8624, datë 15.6.2000 “Për aderimin në “Konventën e Hagës “Për mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin për birësimet jashtë vendit””

²⁵ Republika e Shqipërisë ka aderuar në këtë Konventë me ligjin nr. 9446, datë 24.11.2005 (me rezervat dhe deklaratimet e parashikuara në këtë ligj).

a

v

e

t

pala që kërkon ekzekutimin ose autoriteti qendror i shtetit anëtar të zbatimit ka të drejtë të kërkojë një deklaratë të arsyeve për vonesë nga autoriteti kompetent për zbatimin (Neni 28 dhe neni 11(2) të Konventës së Hagës 1980). Në rastin e Shqipërisë, autoriteti qendror për përmbushjen e detyrave të kësaj konvente është Ministria e Drejtësisë. Republika e Shqipërisë ka rezervuar të drejtën të mos jetë e detyruar të marrë përsipër ndonjë kosto, si rezultat i pjesëmarrjes së konsulentit apo konsulentëve ligjorë ose nga procesi gjyqësor, vetëm deri në atë shkallë, që këto kosto mund të mbulohen nga sistemi i asistencës apo konsulencës ligjore (paragrafi i tretë i nenit 26 të Konventës).

7) Konventa e Hagës “Për marrëveshjet për zgjedhjen e gjykatës”²⁶

Konventa për marrëveshjet për zgjedhjen e gjykatës, bërë në Hagë më 30 qershor 2005, zbatohet për marrëveshjet ekskluzive për zgjedhjen e gjykatës, të cilat janë lidhur në çështje civile ose tregtare, por nuk zbatohet për marrëveshjet ekskluzive për zgjedhjen e gjykatës në rastet ku është palë një person fizik (konsumator), që vepron fillimisht për qëllime personale, familjare ose shtëpiake. Konventa nuk zbatohet për çështjet me objekt detyrimin ushqimor apo çështje të tjera të së drejtës familjare, duke përfshirë regjimet pasurore martesore, të drejtat ose detyrimet e tjera që lindin nga martesë ose marrëdhënie të ngjashme. Megjithatë, këto procese gjyqësore nuk përjashtohen nga fusha e veprimit të kësaj Konvente nëse lindin vetëm si çështje paraprake dhe jo si objekt i proceseve gjyqësore. Kjo Konventë nuk rregullon masat mbrojtëse të përkohshme, as nuk kërkon apo pengon dhënien, refuzimin ose përfundimin e masave mbrojtëse të përkohshme nga një gjykatë e një shteti kontraktues. Konventa nuk ndikon tek mundësia që një palë t’i kërkojë këto masa, as tek mundësia që një gjykatë të japë, refuzojë ose përfundojë këto masa.

8) Konventa e Hagës nr.24 “Për ligjin e zbatueshëm për detyrimet ushqimore”²⁷

Konventa nr.24 “Për ligjin e zbatueshëm për detyrimet ushqimore” e nënshkruar në Hagë, më 2 tetor 1973, vendosi dispozita të përbashkëta në lidhje me ligjin e zbatueshëm për detyrimet ushqimore ndaj fëmijëve dhe të rriturve, që rrjedhin nga një marrëdhënie familjare, prindërore, martesore apo lidhje tjetër jogjaku, duke përfshirë edhe ndaj një të mituri të lindur jashtë martesë (neni 1). Kjo konventë rregulloi vetëm konfliktet e ligjeve në lidhje me detyrimet ushqimore dhe sipas saj, ligji i brendshëm i vendqëndrimit të zakonshëm, të përfituesit të detyrimit ushqimor, rregullon detyrimet ushqimore të referuara në këtë Konventë (nenet 2 dhe 3). Megjithatë, ajo nuk përmban asnjë parashikim kohor brenda të cilit këto konflikte duhet të shqyrtohen, duke i lënë ato në "mëshirën" e të drejtës së brendshme të shteteve anëtare. Republika e Shqipërisë e ka shfuqizuar ligjin nr. 10397, datë 17.3.2011 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën “Për ligjin e zbatueshëm për detyrimet ushqimore”, me anë të ligjit nr.42/2024, datë 02.05.2024 (neni 2)

²⁶ Ratifikuar me ligjin nr.42/2024, datë 02.05.2024 “Për ratifikimin e Konventës për marrëveshjet për zgjedhjen e gjykatës”, publikuar në F.Z. nr.87, datë 23.05.2024.

²⁷

duke ratifikuar nga ana tjetër Protokollin për ligjin e zbatueshëm për detyrimet ushqimore” i cili ka zëvendësuar Konventën nr.24.

9) Protokoli “Për ligjin e zbatueshëm për detyrimet ushqimore”²⁸

Protokoli për ligjin e zbatueshëm për detyrimet ushqimore, bërë në Hagë, më 23 nëntor 2007, zëvendëson në marrëdhëniet midis shteteve që palë, Konventën e Hagës së 2 tetorit 1973 “Mbi ligjin e zbatueshëm për detyrimet ushqimore” dhe Konventën e Hagës së 24 tetorit 1956 “Mbi ligjin e zbatueshëm për detyrimet ushqimore ndaj fëmijëve”. Protokoli rinovoi dispozitat e Konventës së Hagës nr.24, duke përcaktuar rregulla të përgjithshme në lidhje me ligjin e zbatueshëm, që mund të plotësojnë edhe Konventën e Hagës nr.38 “Për rivendosjen ndërkombëtare të detyrimit ushqimor ndaj fëmijës dhe për pjesëtarët e tjerë të familjes”. Me anë të këtij protokoli u rikonfirmua rregulli i përgjithshëm që ligji i zbatueshëm është ai i vendqëndrimit të zakonshëm të përfituesit të detyrimit ushqimor, për detyrimet që rrjedhin nga një marrëdhënie familjare, prindërore, martesore apo lidhje tjetër jogjaku, duke përfshirë edhe një detyrim ushqimor ndaj një të mituri, pavarësisht gjendjes civile të prindërve. Protokoli saktësoi konceptin e “vendqëndrimit” ose “vendbanimit” duke zëvendësuar kështu termat “shtetësi” dhe “kombësi”. Protokoli theksoi se ligji i zbatueshëm për detyrimin ushqimor, duhet të përcaktojë ndër të tjera masën dhe ndaj kujt mund të pretendohet detyrimi ushqimor; masën e detyrimit ushqimor me efekt prapaveprues; bazën e llogaritjes së shumës së detyrimit ushqimor dhe indeksimin; cili gëzon të drejtën e fillimit të procedurave për detyrim ushqimor; afatet e parashkrimit për kërkimin e detyrimit; masën e detyrimit të ofruesit të detyrimit ushqimor, kur një organ publik kërkon rimbursimin e përfitimeve të parashikuara për përfituesin e detyrimit, në vend të detyrimit ushqimor. Në lidhje me përcaktimin e shumës së detyrimit ushqimor, merren parasysh nevojat e përfituesit të detyrimit ushqimor dhe burimet e ofruesit të këtij detyrimi, si edhe çfarëdolloj kompensimi që përfituesit i jepet në vend të pagesave periodike të detyrimit ushqimor. Rregullat e vecanta favorizuese zbatohen në rastin e detyrimeve ushqimore, të: a) prindërve ndaj fëmijëve të tyre; b) personave të tjerë, përveç prindërve, ndaj personave që nuk kanë arritur moshën 21 vjeç; c) fëmijëve ndaj prindërve të tyre. Ligji *lex fori* zbatohet nëse përfituesi i detyrimit ushqimor nuk është në gjendje ta përfitojë atë në bazë të ligjit të shtetit të vendqëndrimit të përfituesit. Pavarësisht këtij parashikimi, ligji *lex fori* zbatohet nëse përfituesi i drejtohet autoritetit kompetent të shtetit ku ka vendqëndrimin e zakonshëm ofruesi i detyrimit. Nëse edhe nga sa më sipër, përfituesi nuk është në gjendje për të përfituar detyrimin ushqimor nga ofruesi i detyrimit, atëherë zbatohet ligji i shtetësisë së tyre të përbashkët, nëse ka.

V.2 Akte ndërkombëtare me karakter rajonal

V.2.a Instrumente në kuadër të Këshillit të Evropës

²⁸ Republika e Shqipërisë ka aderuar në Protokoll me ligjin nr.43/2024, datë 02.05.2024.

1) Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut²⁹

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (“KEDNJ”) përmban pak referenca të shprehura për të drejtat e fëmijës, megjithatë në Nenin 6³⁰ është sanksionuar e drejta e çdo personi për një proces të rregullt brenda një afati të arsyeshëm, për mosmarrëveshje në lidhje me të drejta dhe detyrime të natyrës civile, duke përcaktuar njëkohësisht edhe garantimin e interesit më të lartë të fëmijës, përsa i përket publikimit të vendimit dhe pranisë (prezencës) së fëmijës në sallën e gjyqit. Nën prizmin e kësaj analize, Neni 6 i KEDNJ-së është mjaft relevant, sepse përveçse garanton të drejtat procedurale të palëve në procesin civil (neni 6 §1) duke përfshirë fëmijët, thekson edhe rolin kryesor të gjyqësorit në administrimin e drejtësisë. E drejta për aksesin në gjykatë shoqërohet me një varg garancish, në lidhje me organizimin dhe përbërjen e gjykatës, ashtu edhe me zhvillimin e procedurës, dhe e tëra përbën të drejtën për një gjykim të drejtë.³¹ Një nga këto garanci ka të bëjë me respektimin e kërkesës për gjykim brenda një kohe të arsyeshme si dhe për të kundërshtuar procedurat gjyqësore tepër të gjata. Ndërkohë që shtetet duhet të organizojnë sistemet e tyre ligjore, në mënyrë që t'u mundësojnë gjykatave të tyre të garantojnë të drejtën për të marrë një vendim përfundimtar brenda një kohe të arsyeshme, sistemi gjyqësor luan një rol kyç në zhvillimin e shpejtë të gjyqimit.

KEDNJ-ja i përmend fëmijët veçanërisht në Nenin 8³² mbi të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës, si dhe në Nenin 14³³ i cili garanton gëzimin e të drejtave të përcaktuara në konventë “*pa diskriminim për asnjë arsye*”, duke përfshirë këtu edhe moshën. Ndërsa në Protokollin Shtesë nr.7 të KEDNJ-së, në Nenin 5³⁴ është përcaktuar barazia ndërmjet bashkëshortëve në të drejtat dhe përgjegjësitë në marrëdhëniet me fëmijët e tyre, në lidhje me martesën, gjatë martesës dhe gjatë zgjidhjes së saj, por duke garantuar njëkohësisht marrjen e masave të nevojshme në interes të fëmijëve nga shtetet.

²⁹ Ratifikuar me Ligjin Nr.8137, datë 31.7.1996 “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, si dhe Protokollit Shtesë Nr.1, Nr.2, Nr.4, Nr.7 dhe Nr.11 të Konventës”. KEDNJ hyri në fuqi në Shqipëri në vitin 1996

³⁰ KEDNJ, Neni 6 - E drejta për një proces të rregullt – “1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohe shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonin interesat e drejtësisë.”.

³¹ Sipas çështjes Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar, në vitin 1975

³² KEDNJ, Neni 8 - E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare: - “1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij. 2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjerëve.”

³³ KEDNJ, Neni 14 - Ndalimi i diskriminimit – “Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër”.

³⁴ Protokollin Shtesë nr.7 i KEDNJ, Neni 5 - Barazia ndërmjet bashkëshortëve – “Bashkëshortët gëzojnë barazinë e të drejtave dhe të përgjegjësisë me karakter civil midis tyre, si dhe në marrëdhëniet me fëmijët e tyre, në lidhje me martesën, gjatë martesës dhe gjatë zgjidhjes së saj. Ky nen nuk i pengon Shtetet që të marrin masat e nevojshme në interes të fëmijëve.”

Potenciali i Konventës për të mbrojtur të drejtat e fëmijëve është bërë i mundur nga qasja në të drejtën e ankimit individual nga fëmijët dhe përfaqësuesit e tyre, gjë që ka çuar në një numër në rritje të kërkesave pranë GJEDNJ-së. Një sërë qasjesh interpretuese kanë qenë të rëndësishme në zhvillimin e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së në rastet e fëmijëve, duke përfshirë zhvillimin e detyrimeve procedurale dhe vënia e theksit në mbrojtjen efektive të të drejtave të tyre.³⁵ Është pikërisht qasja e “detyrimeve pozitive” të KEDNJ-së ajo që ka mbështetur praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së në zhvillimin e jurisprudencës së saj për të drejtat e fëmijëve, duke e lejuar atë të japë një kontribut vërtet unik në standardet ndërkombëtare të të drejtave të fëmijëve.

1.a) Jurispridenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ)

Si KEDNJ ashtu edhe vendimet përfundimtare të dhëna nga GJEDNJ kundër shtetit shqiptar, kanë përparësi në rendin juridik kombëtar, për shkak të fuqisë detyruese dhe ekzekutimit të vendimeve të GJEDNJ-së sipas parashikimeve të nenit 46³⁶ të KEDNJ-së. Vendimet e GJEDNJ-së përmbajnë parime të përgjithshme, të cilat mund të gjejnë zbatim konkret edhe në situata dhe vende të ndryshme nga ato kundër të cilave janë dhënë. Sipas sistemit të Konventës, shteteve u kërkohet të marrin një qasje proaktive dhe të përshtatin legjislacionin dhe praktikën e tyre me këto parime të përgjithshme, duke sanksionuar se, megjithëse vendimet e GJEDNJ-së nuk janë të zbatueshme *erga omnes striktu sensu*, shtetet nuk mund të injorojnë parimet e përcaktuara në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së. Referuar këtij parimi të përgjithshëm, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë i ka përcaktuar të drejtat e sanksionuara në KEDNJ si standarde minimale të garantimit të të drejtave të njeriut, e për rrjedhim i ka dhënë teorikisht praktikës së GJEDNJ-së një rëndësi më të madhe zbatimi.

i) Standardet e GJEDNJ-së në lidhje me eficientësinë e sistemit gjyqësor, në kuadrin evropian

Në lidhje me *backlog*-un e çështjeve ose vështirësitë e përgjithshme administrative, GJEDNJ ka theksuar se nuk pranohen shfaqësimet, sepse shtetet janë të detyruara të organizojnë sistemet e tyre gjyqësore, në mënyrë të tillë që gjykatat të përmbushin standardet e Konventës. Megjithatë, një ngarkesë e përkohshme e gjykatës nuk e ngarkon shtetin me përgjegjësi, nëse autoritetet ndërmarrin veprime të arsyeshme, të menjëhershme dhe korrigjuese, për të zgjidhur situatën e jashtëzakonshme. Në rastet kur gjendja zgjat në kohë ose kthehet në një çështje organizimi strukturor, metodat e përkohshme si dhënia e përparësive (çështjet prioritare), nuk janë më të mjaftueshme dhe shteti duhet të miratojë masa të reja efektive. GJEDNJ ka vlerësuar se është e *vetëdijshme për vështirësitë që nganjëherë vonojnë dëgjimin e çështjeve nga gjykatat*

³⁵ Ursula Kilckelly, “Protecting children’s rights under the ECHR: the role of positive obligations Protecting children’s rights under the ECHR: the role of positive obligations”

³⁶ KEDNJ, Neni 46 - Forca detyruese dhe ekzekutimi i vendimeve – “1. Palët e Larta Kontraktuese marrin përsipër të respektojnë vendimin e formës së prerë të Gjykatës në çdo çështje ku ato janë palë”.

kombëtare".³⁷ Megjithatë, GJEDNJ mban qëndrimin se kërkesa për shqyrtim brenda një afati të arsyeshëm (neni 6§1 i KEDNJ) tregon rëndësinë që Konventa i jep *dhënies së drejtësisë pa vonesa, që mund të rrezikojë efektivitetin dhe besueshmërinë e saj*.³⁸ Kështu, GJEDNJ ka krijuar një doktrinë që vlerëson fleksibilitetin me vendosmërinë, si dhe mirëkuptimin me vigjilencën, në lidhje me eficientësinë e sistemeve gjyqësore të shteteve.

GJEDNJ gjithashtu kërkon që të aplikohet një kujdes i veçantë (*particulare diligence*) në rastet që kanë të bëjnë me procedura të nisura nga prindërit, në lidhje me vendosjen dhe mbajtjen e fëmijëve të tyre në kujdesin publik ose, në lidhje me kujdestarinë dhe të drejtat e tyre të aksesit, të cilat kërkojnë shpejtësi të jashtëzakonshme. Sipas Gjykatës, procedura të tilla janë vendimtare për marrëdhëniet e ardhshme midis prindërve dhe fëmijëve, sepse kanë *një cilësi të veçantë të pakthyeshmërisë*, sic mund të jenë procedurat e birësimit. Për rrjedhim, *çdo vonesë në këto procedura, do të rezultojë në përcaktimin de facto të çështjes, përpara se të shprehet me vendim gjykata*.

Më konkretisht, për çështje me objekt fokusin e kësaj analize, GJEDNJ ka mbajtur qëndrimet si vijon:

1. Në çështjet që kanë të bëjnë me kufizimet e aksesit ndërmjet një prindi dhe një fëmije të marrë në kujdesin publik (përkujdesje nga shteti), natyra e interesave në rrezik për aplikantin dhe pasojat serioze dhe të pakthyeshme që mund të ketë marrja e kujdesit në gëzimin e tij/saj të së drejtës për respektimin e jetës familjare, kërkojnë që autoritetet të veprojnë me kujdes të jashtëzakonshëm në sigurimin e mbarëvajtjes së procedurës. E njëjta gjë vlen edhe për procedurat e ngritura nga prindërit birësues për zbatimin e urdhrave të birësimit. Gjykata vlerëson se “zbatimi i vendimeve të këtij lloji kërkon trajtim urgjent pasi kalimi i kohës mund të ketë pasojë të pariparueshme për marrëdhëniet midis fëmijëve dhe prindërve që nuk jetojnë me ta”.³⁹
2. Gjykata ka konstatuar shkelje të nenit 6 në lidhje me kohëzgjatjen e procesit civil që kishte zgjatur tetë vjet. Duke pasur parasysh se çfarë ishte në rrezik për kërkuesen znj. V.A.M. dhe fëmijën e saj, veçanërisht në lidhje me gjendjen shëndetësore të znj. V.A.M., GJEDNJ konstatoi se autoritetet vendase, në vend që të tregonin kujdes të jashtëzakonshëm në përshpejtimin e procedimeve, vazhdimisht nuk i përdornin procedurat për të detyruar të atin D.M. për të marrë pjesë në proces. Gjykata ka theksuar se afati i arsyeshëm i kohëzgjatjes së procedurave vlerësohet në dritën e rrethanave të çështjes dhe duke pasur parasysh kompleksitetin e çështjes, sjelljen e kërkuesit dhe sjelljen e autoriteteve përkatëse. Ajo që është në rrezik për aplikantin duhet të merret në konsideratë dhe të kërkohet kujdes i veçantë në funksion të pasojave të mundshme që mund të ketë zgjatja e tepërt e procedurave, veçanërisht në gëzimin e së drejtës për respektimin e jetës familjare. Një grumbull kronik (numër i lartë

³⁷ H kundër Francës, 24 Tetor 1989, §58

³⁸ Ibid.

³⁹ Paulsen-Medalen and Svensson kundër Suedisë, 19 Shkurt 1998, §39.

dhe i zgjatur në kohë i çështjeve të prapambetura të pazgjidhura) i çështjeve nuk është një shpjegim i vlefshëm për vonesat e tepërta, pasi shtetet kanë për detyrë të organizojnë sistemet e tyre gjyqësore në mënyrë të tillë që gjykatat e tyre të përmbushin detyrimin për të dëgjuar çështjet brenda një kohe të arsyeshme.⁴⁰

3. Gjykata ka vlerësuar se një vonesë prej rreth pesë vjet nuk mund të konsiderohet e pranueshme, përsa i përket përshtatshmërisë së masave të marra nga juridiksionet kombëtare. Në çështjen konkrete të përcaktimit të atësisë, GJEDNJ mori parasysh se çfarë ishte në rrezik për fëmijën kërkues në çështjen në fjalë, pra e drejta për t'i vërtetuar ose hedhur poshtë atësinë e saj, dhe për të eliminuar kështu pasigurinë e saj për identitetin e babait të saj natyror. Ndërsa i padituri nuk ishte paraqitur për disa seanca për të marrë pjesë në të gjashtë takimet për një test të ADN-së, GJEDNJ vlerësoi se i takon shtetit të organizojë sistemin e tij ligjor dhe të veprojë me kujdesin e duhur, për të siguruar mbarëvajtjen e procesit, pra të organizojnë sistemet e tyre ligjore në mënyrë të tillë që të garantojnë të drejtën e secilit për të marrë një vendim përfundimtar për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet civile brenda një kohe të arsyeshme.⁴¹
4. Në lidhje me procedurat e kërkimit të kujdestarisë nga familjarët, GJEDNJ thekson se *ajo që është në rrezik për kërkuesin është gjithashtu një konsideratë thelbësore dhe kërkohet kujdes i veçantë duke pasur parasysh pasojat e mundshme që mund të ketë zgjatja e tepërt e procedurës, veçanërisht në gëzimin e së drejtës për respektim të jetës familjare.* Në vendimin e saj, GJEDNJ u shpreh se: *“Për sa i përket sjelljes së autoriteteve që merren me çështjen, Gjykata vlerëson se, duke pasur parasysh atë që ishte në rrezik për kërkuesin (ndarja gjyqësore dhe përcaktimi i masave për kujdestarinë e fëmijëve dhe aksesin në të drejta), gjykatat e brendshme nuk arritën të vepronin sipas nenit 6 § 1 të Konventës në raste të tilla”.*⁴²
5. Rreziku i rrëmbimit të fëmijës së kërkueses nga babai i saj dhe si rrjedhim, çështja e mbrojtjes së fëmijës, nuk duhet të mbizotërojë mbi trajtimin e mjaftueshëm të të drejtave të kontaktit të nënës me fëmijën e saj. Në vlerësimin e asaj që konsiderohet të jetë në interesin më të mirë të fëmijës, duhet të peshohen mjaftueshëm pasojat e mundshme negative, afatgjata, të humbjes së kontaktit mes prindërit e fëmijës dhe detyra pozitive, për të marrë masa për të lehtësuar bashkimin e familjes sa më shpejt të jetë e mundur. Sipas GJEDNJ, është e domosdoshme të merren parasysh efektet afatgjata, që mund të ketë një ndarje e përhershme e një fëmije nga nëna e tij natyrale.⁴³
6. Për shkak të zgjatjes së tepërt të procedurave para gjykatave vendase, në çështjen në lidhje me kujdestarinë dhe kontaktet me djalin e kërkuesit (i cili kishte lindur në 2003 dhe jetonte me nënën e tij në një qytet tjetër, rreth 300 km larg të atit), u pretendua se sipas vendimit të gjykatave vendase atij nuk i garantohej e drejta si prind jorezident, që të kishte kohën cilësore të zgjatur me djalin e tij dhe të ushtronte në mënyrë efektive përgjegjësinë e tij prindërore mbi djalin e tij, takimet për më shumë se 24 orë (të kalonte një ditë gjatë tre fundjavave në

⁴⁰ V.A.M. kundër Serbisë, ku aplikantja znj.V.A.M. në shkurt 1999 inicioi një proces gjyqësor civil në të cilin ajo kërkoi të zgjidhte martesën me bashkëshortin e saj, D.M. si dhe të fitonte kujdestarinë ekskluzive mbi vajzën e saj, S.M.

⁴¹ Mikulić kundër Kroacisë

⁴² Laino kundër Italisë

⁴³ Jansen kundër Norvegjisë.

vendbanimin e fëmijës) dhe pushimet verore e dimërore. Kërkuesi pretendonte shkelje të nenit 6 (e drejta për gjykim të drejtë) e lexuar në prizmin e nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare). GJEDNJ konsideroi se procedurat e mësipërme përfshijnë vetëm “një shkallë të caktuar kompleksiteti”, për shkak të natyrës së zakonshme të ndjeshme të çështjeve në lidhje me kujdestarinë e fëmijëve dhe të drejtat e kontaktit, duke përfshirë, në rastin konkret, moshën e re të fëmijës dhe faktin që aplikanti banonte në një qytet tjetër, por nuk pranoi qëndrimin justifikues të qeverisë së çështja paraqitej “mjaft komplekse”, pra zgjatja e procedimit nuk mund t’i atribuohet asnjëherë nga palët, e cila u konsiderua se ka vepruar me kujdesin e nevojshëm pa penguar procesin. GJEDNJ vlerësoi se arsyet kryesore për karakterin e stërzgatur të gjykimit mund t’i ngarkoheshin kryesisht sjelljes së autoriteteve gjyqësore, të cilat, megjithë caktimin e një numri seancash dhe marrjen e gjashtë raporteve të ekspertëve, nuk treguan kujdesin e nevojshëm në funksion të asaj që ishte në rrezik për aplikantin. Gjetjet e GJEDNJ të cilat përbënin shkelje të Nenit 6, të cilat janë mjaft relevante edhe në tablonë gjyqësore shqiptare në praktikë, janë si më poshtë:

- nuk mund të konsiderohet e pranueshme të caktohet nga gjykata, seanca e parë tetë muaj pas datës së depozitimit të kërkesëpadisë dhe vetëm atëherë, të kërkojë informacionin e nevojshëm nga shërbimet sociale dhe të mbajë vetëm një seancë shtesë gjatë vitit të parë;
- duhet të shmanget, për aq sa është e mundur, që çështja të dëgjohet nga katër gjyqtarë të ndryshëm gjatë përcaktimit të të drejtave të kujdestarisë dhe kontaktit, në mënyrë që të shmanget humbja e vazhdimësisë;
- disa seanca u shtynë, për arsye që lidhen kryesisht me mungesën e organizimit të brendshëm të autoriteteve kompetente dhe disa nga seancat e planifikuara zgjatën vetëm një kohë shumë të shkurtër, duke u shtyrë pas disa minutash, pa bërë asnjë përparim në lidhje me çështjen;
- palët u dëgjuan vetëm dy herë në katër vjet: u deshën një vit e tre muaj për të dëgjuar palët për herë të parë (në maj 2006) dhe nëntë muaj të tjerë për t’i dëgjuar ato për herë të dytë (në shkurt 2007);
- ekspertja e parë u dëgjua gjashtë muaj pasi ajo kishte dorëzuar raportin e saj dhe ndërkohë, nuk ishte marrë asnjë masë në lidhje me raportin e saj;
- gjykata nuk kishte, ose nuk përdori, mjete për të siguruar disiplinë në lidhje me afatet e veta kohore, të përcaktuara për ekspertët e përfshirë në procedurë;
- së fundmi, dhe më e rëndësishmja, disa vonesa të gjata të papranueshme në transferimin e dosjeve, ndërmjet gjykatave vendase dhe në dorëzimin e vendimeve palëve, në një çështje kaq të ngutshme.⁴⁴

Në përmbledhje të sa më lart, mund të konkludohet se në rastet që kanë të bëjnë me marrëdhënien e një prindi me fëmijën e tij, ekziston detyrimi për të ushtruar kujdes të jashtëzakonshëm, duke pasur parasysh rrezikun që kalimi i kohës mund të rezultojë në një përcaktim de facto të çështjes⁴⁵. Kjo detyrë, e cila është vendimtare në vlerësimin nëse një çështje është dëgjuar brenda një kohe të arsyeshme, siç kërkohet nga neni 6 § 1 i Konventës, gjithashtu është pjesë e kërkesave procedurale

⁴⁴ Popadic kundër Serbisë

⁴⁵ T.C. kundër Italisë, § 58

të nënkuptuara në nenin 8.⁴⁶ Qëllimi për përfundimin e procedurave brenda një kohe të arsyeshme "zbatohet për të gjitha palët në proceset gjyqësore dhe qëllimi i saj është t'i mbrojë ato nga vonesat e

ii) Standardet e GJEDNJ-së në lidhje me eficientësinë e sistemit gjyqësor në praktikën shqiptare

e

Në rastin *Bara dhe Kola kundër Shqipërisë*⁴⁸, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut vendosi, njëzëri, se kishte pasur: shkelje të nenit 6 paragrafi 1 (e drejta për një gjykim brenda një kohe të arsyeshme) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe shkelje të nenit 13 (e drejta për zgjidhje efektive). Rasti kishte të bënte me procedurat para gjykatave vendase në një kohë kur kishin ndodhur reformat në drejtësi. Kërkuarit kanë pretenduar se kohëzgjatja e procedimeve, veçanërisht ato që ishin në pritje përpara Gjykatës së Lartë, ishte në shkelje të kërkesës për gjykim brenda një "afati të arsyeshëm" sipas nenit 6 § 1 të Konventës. Konkretisht, kërkuari i parë parashtrroi se kishte pasur një shkelje të kërkesës së "afatit të arsyeshëm" sipas nenit 6 § 1 të Konventës për shkak të vonesës nga Gjykata e Lartë në shqyrtimin e rekursit të tij (nga 27 tetor 2016 kur ishte paraqitur rekursi në Gjykatën e Lartë, deri më 24 shkurt 2021). Kërkuari pretendoi se nuk kishte kontribuar në asnjë mënyrë në zvarritjen e procedurës, përkundrazi, disa herë kishte kërkuar nga Gjykata e Lartë shqyrtimin e çështjes së tij. Ai pretendoi se vonesa në Gjykatën e Lartë kishte ardhur për shkak të reformave të vazhdueshme në drejtësi, të cilat kishin bërë që Gjykata e Lartë të funksiononte me shumë pak gjyqtarë.

a

GJEDNJ konstatoi në veçanti se, edhe duke marrë parasysh reformat gjyqësore që po ndodhnin në Shqipëri në atë kohë, gjykatat vendase kishin dështuar t'i trajtonin çështjet e parashtruesve me një shpejtësi të mjaftueshme, që do të thotë se procedurat nuk ishin zhvilluar brenda një kohe të arsyeshme. Përveç kësaj, ajo konstatoi se mjeti i ri sipas Kodit të Procedurës Civile, i miratuar në vitin 2017, nuk kishte ndihmuar në përshpejtimin e procedurave, duke e lënë kërkuarin e parë pa asnjë mjet juridik në dispozicion për të trajtuar shkeljen e të drejtave të tij sipas nenit 6 § 1. Gjykata vuri në dukje interpretimin e Gjykatës së Lartë të nenit 399/2 § 3 të KPrC-së se, periudhat kohore gjatë të cilave "rrethanat e bënë objektivisht të pamundur [për gjykatën] të procedojë" me shqyrtimin e një çështjeje - i cili përfshinte, sipas saj, efektet e reformave të vazhdueshme të sektorit të drejtësisë në funksionimin e vetë Gjykatës së Lartë - nuk do të llogariteshin në kohëzgjatjen e përgjithshme të procedurave. Ndonëse nuk i takon GJEDNJ-së të vendosë për interpretimin e duhur të ligjit të brendshëm, ajo konsideroi se, në rrethanat e kërkesës aktuale, një qasje e tillë nuk do të ishte në përputhje me jurisprudencën e saj sipas nenit 6 § 1 mbi "afatin e arsyeshëm" pasi mund të zhvendosë tek palët individuale ndërgjyqëse barrën e plotë të çdo vonese të shkaktuar nga reformat në sektorin e drejtësisë.

⁴⁶ Süß kundër Gjermanisë, § 100; Strömblad kundër Suedisë, § 80; Ribić kundër Kroacisë, § 92.

⁴⁷ GJEDNJ, Stögmüller kundër Austrisë, nr. 1602/62, 10 nëntor 1969, para. 5.

⁴⁸ Bara dhe Kola kundër Shqipërisë (kërkesa nr. 43391/18 dhe 17766/19), 22 Shkurt 2022

Megjithatë, GJEDNJ deklaroi se mjete i ri juridik i parashikuar në KPrC është parimisht në përputhje me nenin 13. Në dritën e konsideratave të mësipërme, Neni 399/6 § 3 i KPrC, pra mjete i ri juridik për përshpejtimin e procedurave dhe sigurimin e dëmshpërblimit për individët, është efektiv në atë që mund të parandalojë vazhdimin e shkeljes së pretenduar të së drejtës së individit për të dëgjuar çështjen e tij/saj pa vonesa të tepërta dhe sigurimi i kompensimit të duhur për shkeljet që tashmë kanë ndodhur. Rrjedhimisht, mjete juridik në parim përmbush detyrimin e shtetit të paditur për të ofruar mjete juridike efektive në lidhje me shkeljet e pretenduara të të drejtave të një individi sipas Konventës dhe për këtë arsye duhet të shterohet para se të paraqiten ankesa të ngjashme në Gjykatë.

2) Konventa Evropiane “Mbi ushtrimin e të drejtave të fëmijëve”⁴⁹ e Këshilit të Evropës

Konventa mbi ushtrimin e të drejtave të fëmijëve (“KEUDF”) u miratua në Strasburg, më 25 janar 1996, me synim mbrojtjen e interesave më të mira të fëmijëve dhe promovimin e të drejtave të tyre, veçanërisht në proceset familjare përpara autoriteteve gjyqësore. Republika e Shqipërisë ka deklaruar se do të zbatojë Konventën për çdo çështje familjare para një autoriteti gjyqësor që i përket fëmijës, lidhur me⁵⁰: shqyrtimin e mosmarrëveshjeve që lindin gjatë martesës; shqyrtimin e pasojave të zgjidhjes së martesës; njohjen dhe kundërshtimin e amësisë dhe atësisë; shqyrtimin e mosmarrëveshjeve për dhënien e detyrimit për ushqim; ushtrimin e përgjegjësisë prindërore; birësimin; kujdestarinë; mbrojtjen nga të gjitha format e dhunës. Detyrimi i shteteve për të vepruar shpejt, për të shmangur vonesat e panevojshme dhe për të vënë në dispozicion procedura që garantojnë zbatimin me shpejtësi të vendimeve, është sanksionuar në nenin 7 të KEUDF, duke iu referuar në mënyrë eksplicite cdo procedimi që ndikon tek fëmijët. Ndërsa në lidhje me rastet urgjente, të cilat janë mënjëherë të ekzekutueshme, ky nen ka përcaktuar se është në kompetencën e autoriteteve gjyqësore për të marrë një vendim të tillë. Detyra e vendosur mbi autoritetet gjyqësore për të vepruar me shpejtësi, me qellim shmangien e vonesave të panevojshme, shpjegohet me faktin se një vonesë e tillë mund të jetë e dëmshme për mirëqenien e fëmijëve dhe për rrjedhojë në kundërshtim me interesat e tyre më të mira.

3) Konventa Evropiane “Për marrëdhëniet me fëmijët”⁵¹ e Këshillit të Evropës

Konventa për marrëdhëniet me fëmijët u miratua në Bruksel me 15 maj 2003, me synimin e shteteve palë, për të vendosur bashkëpunim ndërmjet të gjitha organeve qendrore ose organeve të tjera, për të nxitur dhe përmirësuar marrëdhëniet ndërmjet fëmijëve, prindërve të tyre dhe personave të tjerë që kanë lidhje familjare me këta fëmijë, por sidomos për të nxitur bashkëpunim gjyqësor në çështjet që kanë të bëjnë me marrëdhëniet ndërkufitare, si dhe për të lehtësuar zbatimin e instrumenteve ndërkombëtare në këtë fushë. Konventa solli risi zëvendësimin e konceptit “e drejta e vizitës tek fëmijët” me nocionin “marrëdhëniet me fëmijët” dhe afirmoi dobinë e njohjes

⁴⁹ Republika e Shqipërisë e ka ratifikuar Konventën me ligjin nr. 10425, datë 2.6.2011, hyrë në fuqi më 1 Shkurt 2012.

⁵⁰ Republika e Shqipërisë ka depozituar deklaratën më datë 19 tetor 2011 pranë Sekretariatit të Konventës.

⁵¹ Ratifikuar me Ligjin Nr.9359, datë 24.3.2005 “Për ratifikimin e “Konventës Evropiane “Për marrëdhëniet me fëmijët””

si mbajtës të të drejtave jo vetëm prindërit, por edhe fëmijët (preambula). Sipas nenit 7 të Konventës, gjatë zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në lidhje me marrëdhëniet me fëmijët, organet gjyqësore duhet marrin të gjitha masat: për të informuar të dy prindërit mbi rëndësinë e vendosjes dhe të mbajtjes së marrëdhënieve të rregullta me fëmijën e tyre, për fëmijën dhe për ata vetë; për të nxitur prindërit dhe persona të tjerë që kanë lidhje familjare me fëmijën, për të lidhur marrëveshje miqësore, sidomos duke përdorur ndërmjetësimin familjar ose ndonjë formë tjetër për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve; për të patur informacion të mjaftueshëm, nga ata që mbajnë përgjegjësinë familjare, nga organe ose persona të tjerë, para marrjes së një vendimi gjyqësor, me qëllim që vendimi të jetë në favor të interesave më të larta të fëmijës. Organet gjyqësore e konfirmojnë një marrëveshje mbi marrëdhëniet në lidhje me një fëmijë, përveç kur kjo është kundër interesave të larta të fëmijës ose kur parashikohet ndryshe në ligjin e brendshëm, si dhe shtetet kanë detyrimin të marrin të gjitha masat e duhura, për të siguruar që vendimet në lidhje me marrëdhëniet të zbatohen (nenet 8 dhe 9)..Organet qendrore të shteteve palë kanë detyrimin që të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin dhe të nxisin edhe bashkëpunimin ndërmjet organeve gjyqësore, për të vepruar me të gjithë shpejtësinë dhe efektivitetin e duhur (neni 12). Në lidhje me njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, në nenin 14 është parashikuar se shtetet palë duhet të parashikojnë një sistem për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të dhëna në shtetet e tjera palë në, lidhje me marrëdhëniet dhe të drejtën e kujdestarisë, si dhe një procedurë ku vendimet në lidhje me marrëdhëniet dhe të drejtën e kujdestarisë, të dhënë në shtete të tjera palë, të mund të njihen dhe të deklarohen të ekzekutueshme para se të ushtrohet marrëdhënia në shtetin pritës. Nëse një shtet palë e kushtëzon njohjen dhe/ose ekzekutimin e një vendimi të huaj me ekzistencën e një marrëveshjeje ose të reciprocitetit, ai mund ta konsiderojë këtë Konventë si bazë ligjore për njohjen dhe/ose ekzekutimin të një vendimi të huaj për marrëdhëniet. Shtetet palë kanë detyrimin të marrin masa legjislative dhe të tjera, që mund të jenë të nevojshme për të siguruar zbatimin e parimeve të konventës nga organet gjyqësore (neni 3). Republika e Shqipërisë ka caktuar Ministrinë e Drejtësisë si organ qendror për të kryer funksionet e parashikuara nga kjo Konventë.

4) Konventa “Mbi njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve në lidhje me kujdestarinë e fëmijëve dhe rivendosjen e kujdestarisë mbi fëmijët”⁵² e Këshillit të Evropës

Konventa mbi njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve në lidhje me kujdestarinë e fëmijëve dhe rivendosjen e kujdestarisë mbi fëmijët, e 20 majit 1980 (ETS No.105), synon marrjen e masave për të siguruar që vendimet në lidhje me kujdestarinë e një fëmije të mund të njihen dhe zbatohen më gjerësisht, duke theksuar se e drejta e aksesit e prindërve është një pasojë normale e të drejtës së kujdestarisë. Ajo parashikon mundësinë dhe procedurat që një vendim në lidhje me kujdestarinë e një fëmije të njihet ose zbatohet në një shtet tjetër kontraktues, nëpërmjet paraqitjes së një kërkesë për këtë qëllim autoritetit qendror në çdo kontraktues (neni 4). Një vendim në lidhje me kujdestarinë e dhënë në një shtet kontraktues do të njihet dhe, kur ai është i detyrueshëm në shtetin e origjinës, do të bëhet i zbatueshëm në çdo shtet tjetër kontraktues (neni 7). Në këtë mënyrë

⁵² European Convention on Recognition and Enforcement of Decisions concerning Custody of Children and on Restoration of Custody of Children, Luxemburg, 20.V.1980, European Treaty Series - No. 105, <https://rm.coe.int>

konventa ka përcaktuar vendosjen e bashkëpunimit ligjor ndërmjet autoriteteve të shteteve kontraktuese. Republika e Shqipërisë nuk rezulton ta ketë ratifikuar këtë konventë.

5) Rekomandimi Nr.R(91)9, “Për masat emergjente në çështjet familjare” i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës⁵³

Rekomandimi për masat emergjente në çështjet familjare, përcakton hapat që mund të ndërmerren për të siguruar që gjykatat dhe autoritetet e tjera kompetente, që merren me çështjet familjare për të mbrojtur fëmijët, interesat e të cilëve janë në rrezik serioz, kanë në dispozicionin e tyre masat efektive emergjente. Sipas tij, gjykatat dhe autoritetet e tjera kompetente që merren me çështjet familjare, duhet të kenë kompetenca dhe burime (njerezore?) të mjaftueshme emergjente për të mbrojtur fëmijët, si dhe duhet të kenë të disponueshme procedura të thjeshta dhe të shpejta, për të siguruar që vendimet të merren shumë shpejt. Për këtë qëllim, mund të përdoren masat si: paraqitja e një kërkesë me aplikim të thjeshtë; lejimi i një gjykate ose autoriteti kompetent që të veprojë kryesisht; masat e përkohshme të marra pa seancë dëgjimore; duke përdorur të gjithë teknologjinë moderne të komunikimit për të lehtësuar prezantimin dhe vijimin e ndonjë seance, transmetimin e kërkesave dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet gjykatave dhe autoriteteve kompetente të tjera dhe palëve të ndryshme në një procedim; lejimin e gjykatës ose autoritetit kompetent për të luajtur një rol aktiv në zhvillimin e çështjes, në thirrjen dhe marrjen e provave; parandalimi i ndonjë pale nga shtyrja fiktive e marrjes së masave të përkoheshme. Ky rekomandim përmban edhe parashikime specifike kohore (paragrafi 6 i parimit 4), si psh. në rastet kur kërkohet

b
a
s
h

6) Opinioni Nr.6 (2004) i Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropiane (CCJE/ KKGJE) “Për gjykimin e drejtë brenda një kohë të arsyeshme, mjetet alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve⁵⁴”

u

Opinioni i dhënë në Strasburg, me 22-24 nëntor 2004 nga Këshillit Konsultativ i Gjyqtarëve Evropiane CCJE/ KKGJE), ka nënvizuar se Këshilli i Evropës ka pasur shqetësim të vazhdueshëm për mirësimin e aksesit të publikut në drejtësi, siç pasqyrohet në Rezolutat dhe Rekomandimet e tij të ndryshme, për ndihmën juridike, thjeshtimin e procedurave, uljen e kostove të procedimeve, përdorimin e teknologjive të reja, reduktimin e ngarkesës së gjykatave dhe mjeteve alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve. Opinioni është dhënë për: a) çështje të aksesit në drejtësi; b) ëilësinë e sistemit të drejtësisë dhe vlerësimin e tij, të dhënat sasiore statistikore, procedurat e monitorimit; c) ngarkesën e gjykatave dhe menaxhimin e çështjeve; d) zgjidhjen alternative të

k

⁵³ Rekomandimi Nr. R (91) 9 I Komisionit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi masat urgjente në çështjet familjare, miratuar nga Komiteti i Ministrave më 9 shtator 1991 në mbledhjen e 461-të të Zëvendës Ministrave.

⁵⁴ <https://www.coe.int/en/web/ccje/ccje-opinions-and-magna-carta>

ë
t
a
r

mosmarrëveshjeve, me theks tek roli i gjyqtarit në zbatimin e parimeve të përcaktuara në KEDNJ dhe në praktikën gjyqësore të GJEDNJ. Gjithashtu, Këshilli Konsultativ ka risjellë në vëmendje zbatimin e Rekomandimit Nr. R (84) 5⁵⁵, i cili identifikoi 9 “parime të procedurës civile të krijuara për të përmirësuar funksionimin e drejtësisë civile”. Ky është një rekomandim i hershëm largpamës, por ende në praktikë shpesh i pazbatuar, ndaj është konsideruar se, nëse zbatohet në përgjithësi, do të ofronte një garanci reale për respektimin e detyrës së shteteve sipas nenit 6 të KEDNJ-së për të siguruar “një proces të drejtë dhe publik brenda një kohe të arsyeshme” në çështjet civile.

Rekomandimi përcakton 9 parimet thelbësore të menaxhimit të çështjeve, të cilat CCJE/ KKGJE konsideron se gjyqtarët duhet t'i kenë dhe t'i ushtrojnë, e konkretisht:

- Parimi 1: sugjeron një kufi në procedurat “jo më shumë se dy seanca”, një paraprake dhe e dyta për prova, argumente dhe, nëse është e mundur, gjykim, pa shtyrje të lejuara, përveç kur shfaqen fakte të reja, rrethana të jashtëzakonshme dhe të rëndësishme, si dhe sanksione ndaj palëve, dëshmitarëve dhe ekspertëve, që nuk respektojnë afatet e gjykatës ose pjesëmarrjen.
- Parimi 2: gjyqtarët duhet të kenë kompetencë për të kontrolluar keqpërdorimin e procedurës, duke sanksionuar një palë ose avokatët.
- Parimi 3: pasqyron thelbin e menaxhimit modern të çështjeve: “Gjykata duhet të luajë një rol aktiv në sigurimin e përparimit të shpejtë të procedurës, duke respektuar të drejtat e palëve, përfshirë të drejtën për trajtim të barabartë. Në veçanti, ajo duhet të ketë kompetenca *proprio motu* për të urdhëruar palët që të japin sqarime të nevojshme; të urdhërojë palët të paraqiten personalisht; për të ngritur çështje juridike; të kërkojë prova, në ato raste kur ka interesa të tjera nga ato të palëve në fjalë; të kontrollojë marrjen e provave; të përjashtohen dëshmitarët, dëshmia e mundshme e të cilëve do të ishte e parëndësishme për rastin; për të kufizuar numrin e dëshmitarëve në një fakt të caktuar ku një numër i tillë do të ishte i tepruar.
- Parimi 4: gjykata, përveç rasteve të parashikuara shprehimisht me ligj, duhet të jetë në gjendje të vendosë nëse do të përdorë procedurën me shkrim apo me gojë.
- Parimi 5: nevojën për të kristalizuar pretendimet e palëve, natyrën e provave në fazën më të hershme të mundshme, për të përjashtuar pranimin e fakteve të reja gjatë apelimit (përveç rastit kur ato nuk ishin të njohura në shkallën e parë ose për ndonjë arsye tjetër të veçantë). Palët kanë të drejtën për “një dëgjim të drejtë brenda një kohe të arsyeshme”, jo për mundësi të pacaktuara për të paraqitur çështje të tjera dhe të ndryshme, veçanërisht jo përmes një seance dëgjimore në shkallë të dytë në apel.
- Parimi 6: “aktgjykimi duhet të jepet në përfundim të procedurës ose për aq sa është e mundur në përfundim të procedurës”. Disa shtete ose gjykata funksionojnë pak a shumë me rregulla formale që përcaktojnë periudhën(at) maksimale brenda së cilës duhet të jepen vendimet.
- Parimi 7: “duhet të ndërmerren hapa për të penguar abuzimin me mjetet juridike pas gjykimit”.
- Parimi 8: identifikon disa aspekte të menaxhimit të çështjeve, duke përfshirë procedurat e veçanta për: (a) rastet urgjente, (b) rastet e padiskutueshme, kërkesat e likuiduara (çështjet e gjykuara më parë) dhe pretendimet e vogla, (c) llojet specifike të çështjeve. Ndër aspektet që

⁵⁵ Rekomandimi nr. R(84)5 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës “Për parimet e procedurës civile, të parashikuara për përmirësimin e funksionimit të drejtësisë” (miratuar nga Komiteti i Ministrave më 28 shkurt 1984), <https://rm.coe.int/>

përmenden, janë: metodat e thjeshtuara të fillimit të procesit gjyqësor; asnjë seancë dëgjimore ose thirrja e vetëm një seance dëgjimore, ose e seancës përgatitore paraprake; procedura ekskluzivisht me shkrim ose me gojë; ndalimi ose kufizimi i disa përjashtimeve dhe mbrojtjeve; rregulla më fleksibël të provave pa shtyrje ose vetëm shtyrje të shkurtra; caktimi i një eksperti gjyqësor; një rol aktiv për gjykatën në drejtimin e çështjes dhe në thirrjen dhe marrjen e provave.

- Parimi 9: thekson nevojën që “mjetet teknike më moderne të vihen në dispozicion të autoriteteve gjyqësore”. CCJE/ KKGJE miraton dhe nënvizon marrëdhënien midis teknologjisë efikase dhe aftësisë së gjyqtarëve, për të mbajtur gjurmët dhe kontrollin e proceseve gjyqësore në dosjet e tyre ose të gjykatave të tyre.

Arsyetimi i përgjithshëm i të gjitha këtyre parimeve është se proceset gjyqësore civile rrezikojnë të bëhen komplekse dhe të gjata, deri në pikën ku nuk është e mundur të përmbushen kërkesat e nenit 6 (1) të KEDNJ-së, as në ndonjë rast të veçantë ose në çdo rast tjetër, sjellja e shpejtë dhe efikase e të cilave ndikohet në mënyrë indirekte nga koha dhe burimet e zëna nga rasti(et) e mëparshëm. Shtetet duhet të sigurojnë burime dhe fonde adekuate - por jo të pafundme - për çështjet gjyqësore civile dhe penale. Për shkak se, as shteti dhe as palët nuk kanë burime të pafundme, gjykatat duhet të kontrollojnë proceset gjyqësore, në interes të palëve individuale dhe ndër-gjyqëse në çështje të tjera.

V.2.b Instrumente në kuadër të Bashkimit Evropian (BE)

Bashkimi Evropian ka një rol të kufizuar në çështjet e së drejtës familjare, duke qenë se çdo shtet anëtar ka legjislacionin e tij për zgjidhjen e martesës, pensionin ndaj bashkëshortëve dhe fëmijëve, birësimet, kujdestarinë dhe çështje të tjera të së drejtës familjare. Për shkak dhe të natyrës kryesisht ekonomike të BE-së, e drejta familjare është fusha më pak e rregulluar në aspektin ligjor komunitar. Në rastet e të drejtave të fëmijëve, Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian (GJDBE) deri më tani ka shqyrtuar kryesisht ato që quhen “referenca paraprake”⁵⁶. GJDBE-ja jep gjithnjë e më shumë vendime në lidhje me të drejtat e fëmijëve në fusha të ndryshme, si lëvizja e lirë, shtetësia e BE-së, migrimi, kujdestaria, qëndrimi i zakonshëm, jeta familjare dhe mosdiskriminimi.

1) Traktati për Bashkimin Evropian⁵⁷

Traktati për Bashkimin Evropian (TBE) është një nga traktatet parësore qeverisëse të BE-së, ku përshkruhen parimet themelore dhe vlerat mbi të cilat bazohet BE, duke përfshirë respektin për dinjitetin njerëzor, lirinë, demokracinë, barazinë, sundimin e ligjit dhe respektimin e të drejtave të

⁵⁶ Neni 267 i Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFBE) i përcakton si procedura ku një gjykatë kombëtare i kërkon GJDBE-së një interpretim të ligjit parësor të BE-së (traktateve) ose të ligjit dytësor të BE-së (vendimeve dhe legjislacionit) për një çështje në pritje.

⁵⁷ Nënshkruar në Maastricht, më 7 shkurt 1992.

njeriut (neni 2). Traktati parashikon në nenin 19 se *"Shtetet Anëtare do të ofrojnë mjete juridike të mjaftueshme për të siguruar mbrojtje efektive ligjore në fushat e mbuluara nga ligji i Bashkimit"*.

2) Karta e të drejtave themelore e Bashkimit Evropian⁵⁸

Karta përmban referencat e para të detajuara për të drejtat e fëmijëve në nivelin kushtetues të BE-së, duke përfshirë: të drejtën për një mbrojtje dhe kujdes të tillë, që është e nevojshme për mirëqenien e tyre, si dhe të drejtën për të shprehur lirisht dhe për t'u marrë parasysh pikëpamjet në përputhje me moshën dhe pjekurinë e tyre (neni 24/1); të drejtën që interesat e tyre më të larta të merren si konsideratë parësore në të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me ta (neni 24/2); të drejtën për të mbajtur rregullisht një marrëdhënie personale dhe kontakt të drejtpërdrejtë me të dy prindërit, përveç nëse kjo është në kundërshtim me interesat e tyre (neni 24/3) si dhe të drejtën për jetë private dhe familjare (neni 7). Aksesit në drejtësi garanton të drejtën për një gjykim të drejtë dhe një mjet efektiv (neni 47), siç interpretohet nga Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Evropian (GJDBE). Krahas barazisë para ligjit, neni 47 i kësaj Karte parashikon se *"çdokush ka të drejtë për një gjykim të drejtë dhe publik brenda një kohe të arsyeshme nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e krijuar më parë me ligj..."*.

3) Rregullorja e Këshillit (BE) 2019/1111⁵⁹ - Rregullorja e Brukselit IIB.

Rregullorja e Brukselit IIB, përcakton rregulla për juridiksionin, njohjen dhe zbatimin e vendimeve për çështjet e martesës dhe të përgjegjësisë prindërore, duke shërbyer si referim në bashkëpunimin gjyqësor në çështjet familjare, me synim që të sigurojë aksesin dhe efikasitetin në procedurat gjyqësore. Fushëveprimi i saj kufizohet në çështjet familjare (zgjidhja e martesës, ndarja ligjore, anulimi), ndërsa përgjegjësia prindërore përfshin të drejtat e kujdestarisë dhe të drejtat e aksesit, vendosjen e një fëmije në një familje kujdestare ose në përkujdesje institucionale. Njohja në një shtet anëtar të BE-së, i një vendimi të dhënë në një shtet tjetër, nuk kërkon ndonjë procedurë të veçantë, veçanërisht, kur paraqitet një vendim i formës së prerë i dhënë në një shtet anëtar (parag.54), në mënyrë që arsyet për refuzimin e njohjes së një vendimi të jenë minimale. Rregullorja strukturon edhe mënyrat e ndryshme të transferimit të juridiksionit (neni 15), në dy dispozita të ndryshme: transferimi i juridiksionit të nisur nga një gjykatë që dëshiron të transferojë juridiksionin e saj (neni 12) dhe transferimi i juridiksionit me kërkesë të një gjykate që dëshiron të marrë juridiksionin (neni 13), duke parashikuar një afat brenda 6 javësh për të vendosur pranimin ose jo të transferimit nga gjykatat (nenet 12(2) dhe 13(2)). Rregullorja parashikon procedura në lidhje me proceset gjyqësore, për shkak të natyrës imediate objekt gjykimi, si dhe rregulla në lidhje me procedurat gjyqësore (neni 24), ekzekutimin e përkohshëm (neni 27(6)) dhe ekzekutimin e vendimeve që urdhërojnë kthimin e fëmijës (neni 28). Një mjet për të përshpejtuar procedurat gjyqësore është kufizimi i numrit të apelimeve të mundshme kundër një vendimi, duke inkurajuar shtetet të marrin në konsideratë të kenë vetëm një fazë apelimi për këto lloje çështjesh. Për më

⁵⁸ Shpallur solemnisht më 7 Dhjetor 2000 si dhe me 12 Dhjetor 2007 në Strasburg, si një instrument i veçantë.

⁵⁹ Rregullorja e Këshillit (BE) 2019/1111, ndryshe e njohur si Rregullorja e Brukselit IIB, e datës 25 qershor 2019

tepër, është parashikuar një rregull uniform që lejon gjykatën të deklarojë vendimin e saj përkohësisht të detyrueshëm, pavarësisht nga çdo ankim, kur kjo kërkohet nga interesat më të mira të fëmijës (neni 27(6)). Mënyra se si do të arrihet zbatimi efektiv dhe në kohë është një çështje e ligjit kombëtar dhe në çdo rast, procedura konkrete kombëtare duhet të jetë në përputhje me KEDNJ.

4) Rregullorja e Këshillit (BE) 4/2009

Rregullorja 4/2009 përcakton rregullat për njohjen dhe zbatimin e vendimeve që përcaktojnë detyrimin ushqimor në shtetet anëtare të BE-së, duke synuar të sigurojë rikuperimin e detyrimit ushqimor brenda BE-së. Duke marrë parasysh ndikimin që lëvizja e lirë e njerëzve shpesh shkakton në strukturat familjare, Bashkimi Evropian vendosi të merret në mënyrë specifike me zbatimin, ndonjëherë problematik, ndërkombëtar të detyrimeve ushqimore, duke u përpjekur gjithashtu të promovojë "lirinë e pestë" në lidhje me qarkullimin e lirë të vendimeve gjyqësore.⁶⁰ Në marrëdhëniet ndërmjet Shteteve Anëtare, në përputhje me nenin 69(2) dhe në varësi të nenit 68(3) të tij, Rregullorja 4/2009 aplikohet dhe qëndron mbi çdo konventë që rregullon të njëjtën çështje për aq sa ka të njëjtën fushë zbatimi. Kjo rregullore nuk përcakton afate kohore brenda së cilës duhet të gjejnë veprim procedurat e parashikuara në të.

⁶⁰ Council Regulation (EC) 4/2009 of 18 December 2008 – Another Qualified Achievement for European Family Law

VI. KUADRI LIGJOR VENDAS ME FOKUS EFICENCËN E DREJTËSISË PËR FËMIJËT.

Pushteti gjyqësor është guri i themelit për funksionimin e shtetit ligjor, si dhe një garanci për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave themelore të individit, mirëfunksionimi i të cilit është një kusht thelbësor për vendin tonë në procesin e integritimit në Bashkimin Evropian dhe në konsolidimin e shtetit të së drejtës.⁶¹ Garantimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, përfshin edhe të drejtën për një proces të rregullt ligjor brenda një afati të arsyeshëm, parim ky i rëndësishëm i parashikuar në nenin 6 të KEDNJ-së dhe nenin 42 pika 2 të Kushtetutës.

VI.1 Kuadri ligjor përpara hartës së re gjyqësore

Në periudhën 2014-2015, periudhë që i parapriu reformës në drejtësi në Shqipëri, një sërë institucionesh dhe organizmash ndërkombëtare kanë dhënë vlerësimet dhe opinionet e tyre mbi situatën dhe eficientësinë e sistemit të drejtësisë në vendin tonë, duke përfshirë edhe drejtësinë për fëmijët/ të miturit. Më konkretisht:

- Bashkimi Evropian ka bërë vlerësimin e tij të përvitshëm në lidhje me sistemin e drejtësisë në Shqipëri, nëpërmjet raporteve të progresit mbi ecurinë e Shqipërisë në rrugën e reformave me qëllim anëtarësimin. Në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian të vitit 2014 për Shqipërinë⁶², ndër të tjera është evidentuar se funksionimi i sistemit të drejtësisë vazhdon të cenohet nga zvarritjet e procedimeve dhe çështjet e papambetura.
- Parlamenti Evropian në projekt-rezolutën e Komisionit të Jashtëm të datës 22.04.2015, ka nënvizuar nevojën për të forcuar shtetin e së drejtës dhe reformuar gjyqësorin, duke shprehur keqardhjen për mangësitë e vazhdueshme në funksionimin e sistemit gjyqësor, backlog ose vonesat (prapambetjet) në shqyrtimin e çështjeve gjyqësore dhe nevojën për përpjekje të mëtejshme për të siguruar eficientësinë e gjyqësorit, si dhe ka vënë në dukje gjendjen e papërshtatshme të sistemit gjyqësor për të miturit, duke u bërë thirrje autoriteteve të marrin masa për të përmirësuar situatën⁶³.
- Këshilli i Europës nëpërmjet Komisionerit për të Drejtat e Njeriut⁶⁴, në vitin 2014 ka theksuar se për shkak të mungesës së një sistemi të efektshëm për ndjekjen e historikut të çështjeve gjyqësore ka procese gjyqësore civile paralele bazuar në të njëjtin subjekt, çka e ndërlikon më tej problematikën e tejzgjatjes së proceseve. Gjithashtu sipas Komisionerit, edhe GJEDNJ në

⁶¹ Strategjia e Reformës në Sistemin e Drejtësisë – Projekt, 24 korrik 2015 – Kuvendi, Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë, Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë.

⁶² Commission Staff Working Document Albania 2014 - Progress Report, Brussels, 8.10.2014, SWD(2014) 304 final {COM(2014) 700 final} - <https://op.europa.eu/en/publication>

⁶³ Analizë e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri - Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë - Qershor 2015 - <https://www.reforamedrejttesi.al/>

⁶⁴ Raporti i posaçëm i Komisionerit të Këshillit të Europës për të Drejtat e Njeriut për Shqipërinë, CommDH (2014)1, 16 janar 2015. <http://www.coe.int/en/ceb/portal/home>

një çështje⁶⁵ kishte arritur në përfundimin se sistemi ligjor shqiptar nuk siguronte mjete të brendshme efektive për riparimin e tejzgjatjes së proceseve, përfshirë edhe kompensimin.

- Komisioni i Venecias, në opinionin e tij nr.754/2014⁶⁶ mbështeti propozimin për prezantimin e amendamenteve të reja në Kodin e Procedurës Civile dhe atë Penale, në lidhje me mundësinë e gjyqtarëve për të vendosur gjoba për avokatët apo prokurorët që i shmangen detyrës, duke ndëshkuar ata që shkaktojnë vonesa të qëllimshme në gjykim dhe zvarritje të procesit.
- Komisioni European për Efiçencën në Drejtësi (CEPEJ), në raportin për vitin 2012, kishte evidentuar dhe analizuar numrin e punonjësve të gjykatës për një gjyqtar, ku Shqipëria kishte numrin më të vogël (2,12 për 1 gjyqtar), ndërsa shtetet e tjera të grupit kishin vlera më të afërta me mesataren evropiane (3 punonjës për 1 gjyqtar). Në vitin 2014 raporti i stafit administrativ me stafin e gjyqtarëve ishte 2.25 punonjës për 1 gjyqtar, ndërsa për vitin 2015 raporti ishte 2.33 punonjës për 1 gjyqtar. Raporti i CEPEJ ka evidentuar një dallim në ndarjen e stafit të gjykatave shqiptare dhe të vendeve të tjera, në numrin shumë të vogël të asistentëve gjyqësorë (juristë të diplomuar) në Shqipëri. Delegimi i detyrave nga gjyqtarët te punonjësit e gjykatave dhe posaçërisht tek asistentët e diplomuar në ligj ose te sekretarët gjyqësorë është i rekomanduar nga Këshilli i Europës dhe lejon performancë më të mirë të gjykatave. Ekspertët e CEPEJ, nga vizitat e bëra në ndërtesat e gjykatave në vendin tonë, kanë vlerësuar se ato janë përgjithësisht të vjetra dhe pak prej tyre të reja. Në të dyja llojet e ndërtesave nuk ka salla gjyqi të mjaftueshme dhe shumë seanca duhet të zhvillohen në zyrat e gjyqtarëve.
- Komisioni European për Efiçencën në Drejtësi (CEPEJ), në raportin për vitin 2021 për Ballkanin Perëndimor⁶⁷, theksoi se në Shqipëri, procedura e vetting-ut ndikoi jo vetëm në uljen e numrit të magjistratëve, por edhe në rritjen e numrit të çështjeve të pazgjidhura (për shkak të numrit më të ulët të gjyqtarëve) dhe rrjedhimisht në normën e evadimit të çështjeve (CR) dhe në kohëzgjatjen e procedimeve (sidomos në shkallën e dytë dhe të tretë, ku shumë gjyqtarë u shkarkuan ose u pensionuan vullnetarisht). Kështu, gjyqtarët nuk ishin në gjendje të përballonin fluksin e çështjeve dhe CR ishte gjithmonë nën 100% në 2019, 2020 dhe 2021. Në veçanti, CR për çështjet në apel në vitin 2021 ishte shumë nën 100%. Kohëzgjatja e procesit (DT) ishte jashtëzakonisht e lartë në vitin 2020, veçanërisht për çështjet civile dhe tregtare (1742 ditë në apel) dhe për çështjet administrative (4485 ditë në apel). Në vitin 2021 situata u përmirësua dhe DT u ul për të gjitha kategoritë e çështjeve në shkallën e parë dhe apel, me përjashtim të rasteve administrative në apel. Në veçanti, DT për çështjet civile dhe tregtare ndryshoi nga 366 ditë në 279 ditë, ndërsa për çështjet penale u ul nga 294 ditë në 67 ditë, më e ulët se në vitin 2018. Në vitin 2021, në shkallë të parë, DT ishte më e ulët se mesatarja e Ballkanit Perëndimor, në tre kategoritë kryesore të çështjeve (civile dhe tregtare, administrative, penale), ndërsa në apel ishte më e lartë.

⁶⁵ Gjon Boçari dhe të tjerë kundër Shqipërisë

⁶⁶ Komisioni i Venecias, Opinioni nr.754/2014, për projekt ndryshimet penale.

⁶⁷ European Commission for the Efficiency of Justice (CEPEJ) HFII: Towards a better evaluation of the results of judicial reform efforts in the Western Balkans “DASHBOARD Western Balkans” Data collection: 2021 - Report prepared by the CEPEJ for the attention of the European Commission, <https://rm.coe.int/albania>

- Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë (OSBE) ka evidentuar ndër të tjera se vonesat në dhënien e vendimeve të arsyetuara kombinuar me afatet e shkurtra për ankim cenojnë të drejtën kushtetuese të palëve për ankim. Koha e pamjaftueshme për rishikimin e vendimeve të arsyetuara me shkrim përpara afatit për ankim, komprometon më tej të drejtën për një gjykim të drejtë në gjykatën e apelit⁶⁸.

Reagime ka patur edhe nga institucione dhe organizata vendase, e më konkretisht:

- Avokati i Popullit ka evidentuar se mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore e bën mjetin ankimor gjyqësor të paefektshëm në rezultat. Në problematikat e evidentuara gjatë ekzekutimit të vendimeve gjyqësore civile, nga përmbartimi shtetëror ose ai privat, është mungesa e cilësisë profesionale e përmbartuesve gjyqësor dhe mosnjohja e ligjit, mungesa e vullnetit të përmbartuesve gjyqësor për vendosjen e sanksioneve ndaj subjektit të detyruar sipas vendimit gjyqësor të formës së prerë apo personave të tjerë në procesin e ekzekutimit; kryerje veprimesh jashtë objektit të ekzekutimit si dhe keqinterpretim i dispozitivit të vendimit gjyqësor; mosmbështetja e organit të ngarkuar me ligj për ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutiv, me mjete dhe forca nga organet e njësisë së qeverisjes vendore apo qendrore, Policisë së Shtetit, etj.⁶⁹
- Unioni i Gjyqtarëve të Shqipërisë në studimin e tij për të drejtën për akses në gjykatë ka identifikuar se çështje jo komplekse apo të një niveli të zakonshëm vështirësie, kanë zgjatur për më tepër se dy vjet vetëm në shkallë të parë, duke kërkuar zhvillimin e 23 seancave gjyqësore. Në studim është vërejtur se: - “nga këto (23) seanca 13 prej tyre janë shtyrë për t’i dhënë kohë ekspertit për të relatuar aktin e ekspertimi dhe më pas palëve për t’u njohur me aktin e për të diskutuar rreth konkluzioneve të tij. [...], rezulton se 4 seanca gjyqësore janë shtyrë për shkak të mosparaqitjes së palëve ndërgjyqëse dhe përfaqësuesve të tyre, 5 seanca gjyqësore janë shtyrë për paraqitjen e provave dhe të kundërpadisë dhe vetëm 1 seancë gjyqësore është shtyrë për mosformim të trupit gjykues⁷⁰.

Tejzgjatja e proceseve dhe moszbatimi i vendimeve gjyqësore janë evidentuar si faktorë që kanë ndikuar edhe në perceptimin negativ të opinionit publik ndaj sistemit gjyqësor, në periudhën pas reformës në drejtësi dhe para hartës së re gjyqësore të zbatuar në vitin 2023.

Për rrjedhim, Kuvendi i Shqipërisë nëpërmjet Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë⁷¹, në Qershor të vitit 2015 publikoi Analizën e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri, dhe në vitin 2015 Parlamenti miratoi Strategjinë e Reformës së Sistemit të Drejtësisë, e cila parashikonte ndër të tjera edhe hartimin dhe zbatimin e një Harte të re Gjyqësore. Më 22 korrik 2016, përveç një sërë ndryshimesh kushtetuese, u miratua një paketë prej 7 ligjesh të reformës në

⁶⁸ Raporti “Drejt drejtësisë së OSBE-se”.

⁶⁹ Analizë e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri - Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë - Qershor 2015 - <https://www.reformanedrejttesi.al/>

⁷⁰ Po aty.

⁷¹ Ngritur me vendimin nr. 96/2014, dt. 27.11.2014 të Kuvendit.

drejtësi, të cilat synonin ndër të tjera përmirësimin e cilësisë dhe efikasitetit të shërbimeve në gjyqësor. Legjislativi i ri prezantoi qasje të reja në shpërndarjen territoriale të gjykatave të vendit, duke përcaktuar parime dhe kritere të reja të konfigurimit të hartës së re gjyqësore.

Reforma në drejtësi përfshin edhe “procesin e vetingut”, në të cilin duhet të kalojnë të gjithë magistratët, kancelarët e gjykatave, kandidatët për magistrat (gjyqtar e prokuror) që ndjekin Shkollën e Magistraturës. Rezultatet e këtij procesi verifikimi kanë sjellë largimin e shumë gjyqtarëve dhe prokurorëve nga sistemi, e më konkretisht deri në fund të vitit 2022, me vendim të KPK-së janë shkarkuar nga detyra në total 126 gjyqtarë (magjistratë) dhe 65 gjyqatërë (magjistratë) të shkarkuar në pritje të procesit në KPA⁷². Rrjedhimisht si pasojë e këtij procesi u shkaktua edhe një “backlog” i konsiderueshëm i çështjeve në prokuroritë dhe gjykatat e vendit të të gjitha niveleve.

Në raportet e progresit për vitet 2020-2022 mbi ecurinë e Shqipërisë në rrugën e reformave me qëllim anëtarësimin, Bashkimi Evropian në vlerësimet e tij të përvitshme në lidhje me sistemin e drejtësisë në Shqipëri, në vecanti në lidhje me efikasitetin dhe efikasitetin, ka evidentuar si vijon:

1. Raporti i Progresit i Komisionit Evropian i vitit 2020⁷³, evidentoi se:

- Ka ende mungesë të raportimit të konsoliduar për efikasitetin e sistemit të drejtësisë, i cili ndikohet nga çështje të tilla si: kohëzgjatja e procedimeve, shkalla e evadimit dhe numri i çështjeve të mbetura në të gjitha nivelet e gjykatave. Shkalla e evadimit është më e ulëta në gjykatat e apelit dhe vendet e paplotësuara në gjyqësor kanë kontribuar në rritjen e numrit të çështjeve të mbetura. Masat për rishpërndarjen dhe transferimin e gjyqtarëve në vendet vakante prioritare kanë pasur ndikim të kufizuar. Përveç kohëzgjatjes së përgjithshme të proceseve gjyqësore, ekzekutimi i vendimeve gjyqësore mbetet një shkak shqetësues. Masat e mëtejshme të efikasitetit duhet të zbatohen me prioritet, duke përfshirë një hartë të re gjyqësore dhe masa për të adresuar numrin e çështjeve të pazgjidhura.
- Shumë mangësi janë bërë të dukshme në sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve të gjykatave, i cili duhet të forcohet ndjeshëm dhe të përdoret në mënyrë efektive. Kërkohej përpjekje vendimtare për të siguruar një sistem efektiv dhe të besueshëm të menaxhimit të çështjeve, i aftë për të prodhuar automatikisht të dhëna statistikore të besueshme, në përputhje me rekomandimet dhe metodologjinë e CEPEJ-it për performancën, si të gjyqësorit ashtu edhe të prokurorisë. Për këtë qëllim, është e nevojshme të miratohet baza ligjore, të sigurohet ndarja e duhur buxhetore dhe burimet njerëzore, si dhe të miratohet një udhërrëfyes i qartë që përcakton hapat konkretë drejt funksionimit efektiv të sistemit të menaxhimit të rasteve.
- Ndryshimet në kodet procedurale në kuadër të reformës kanë parashikuar përmirësime të dispozitave ligjore për kohëzgjatjen e procedimeve, megjithatë, zbatimi korrekt i këtyre

⁷² Raport mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2022 – www.klgi.al

⁷³ Commission Staff Working Document Albania 2020 - Report Accompanying the Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions 2020 Communication on EU Enlargement Policy, Brussels, 6.10.2020

dispozitave ligjore të përmirësuara kërkon më shumë trajnime për gjyqtarët dhe avokatët. Përdorimi i zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve vazhdon të jetë i kufizuar dhe duhet të forcohet më tej;

2. Raporti i Progresit i Komisionit Europian i vitit 2021⁷⁴, evidentoi se:

- Efikasiteti i sistemit gjyqësor është ndikuar nga kohëzgjatja e procedurave, shkalla e ulët e evadimit dhe numri i madh i çështjeve të pazgjidhura. Kohëzgjatja mesatare për një çështje në nivelin e apelit është 998 ditë për çështjet penale dhe 1742 ditë për çështjet civile dhe tregtare. Gjykatat e apelit kanë një numër të madh çështjesh të trashëguara dhe vende vakante gjyqësore, me vetëm 40 nga 78 gjyqtarë të apelit në detyrë. Një hartë e re gjyqësore duhet të miratohet urgjentisht dhe të zbatohet për të rishpërndarë gjyqtarët dhe burimet brenda sistemit gjyqësor.
- Mbledhja dhe raportimi i të dhënave statistikore gjyqësore është përmirësuar, por nevojiten përpjekje të mëtejshme. Nevojiten urgjentisht përpjekje vendimtare për politikën, planifikimin dhe buxhetin për të krijuar një sistem të ri të integruar të menaxhimit të çështjeve dhe për të siguruar ndërveprimin e tij në të gjithë sistemin e drejtësisë, në përputhje me metodologjinë e Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ).
- Kuadri legjislativ është forcuar më tej për të siguruar një dhënie më efektive të drejtësisë. Më 23 mars 2021, Kuvendi miratoi amendamentet në 10 ligje që synojnë të forcojnë më tej efikasitetin e sistemit të drejtësisë dhe të lehtësojnë një funksionim më të mirë të gjykatave, në përputhje me standardet e BE-së. Në veçanti, ndryshimet legjislative parashikojnë masa specifike për të lehtësuar reduktimin e çështjeve të pazgjidhura, për të përsheptuar procedurat gjyqësore. Përdorimi i zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve vazhdon të jetë i kufizuar dhe duhet të forcohet më tej. Ndërgjegjësimi i qytetarëve për shërbimin alternativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve është i ulët dhe duhet të rritet.

3. Raporti i Progresit i Komisionit Europian i vitit 2022⁷⁵, evidentoi se:

- Pas ndryshimeve kushtetuese dhe ligjore në kuadër të reformës në drejtësi, sistemi gjyqësor i Shqipërisë ka arritur një nivel të moderuar përgatitjeje. Megjithatë, procedurat e gjata, shkalla e ulët e evadimit dhe numri i madh i çështjeve të mbetura, vazhdojnë të ndikojnë negativisht në efikasitetin e sistemit gjyqësor. Për të trajtuar këto probleme, pas konsultimeve u miratua një hartë e re gjyqësore. Kërkohen ende përpjekje shtesë për ta vënë atë në fuqi, si dhe për të përmirësuar sistemin e menaxhimit të çështjeve dhe sistemin e trajnimit për magistratët.
- Është bërë përparim i kufizuar në rekomandimin për përmirësimin e sistemit të menaxhimit të rasteve dhe sistemit të trajnimit ligjor, i cili ka qenë në pritje për disa vite.
- Rekomandimet përfshijnë vazhdimin e konsolidimit të kapaciteteve të sistemit gjyqësor dhe institucioneve të tij vetëqeverisëse, duke bërë njëkohësisht përmirësime të cilësisë dhe

⁷⁴ Commission Staff Working Document Albania 2021 - Report Accompanying the document Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions 2021 Communication on EU Enlargement Policy, Strasbourg, 19.10.2021

⁷⁵ Commission Staff Working Document Albania 2022 - Report Accompanying the document Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions 2022 Communication on EU Enlargement policy - Brussels, 12.10.2022

efikasitetit në Shkollën e Magjistraturës, si dhe hartimi i një plani të qendrueshëm zbatimi për hartën e re gjyqësore. Gjithashtu, është rekomanduar konsolidimi i përpjekjeve për të rritur efikasitetin dhe transparencën e të gjitha gjykatave dhe prokurorive, duke përfshirë veprime të shpejta dhe vendimtare për ngritjen e një Sistemi të Menaxhimit të Çështjeje, të integruar dhe modern, si dhe hartimi i një plani të qendreshëm zbatimi për hartën e re gjyqësore.

II.1.a Kuadri ligjor përpara hartës së re gjyqësore

1) Kushtetuta dhe jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese

Si rezultat i reformës së thellë në sistemin e drejtësisë nga viti 2016 e në vijim, të shoqëruar me ndryshimet kushtetuese, shumë aspekte të organizimit dhe funksionimit të sistemit të drejtësisë u shndërruan thelbësisht. Neni 42, pika 2 e Kushtetutës përcakton detyrimin për organizimin e sistemit ligjor në mënyrë të tillë që gjykatat të plotësojnë kërkesat e standardeve për një proces të rregull ligjor, përfshirë këtu edhe atë të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm. Në këtë drejtim, ky nen i Kushtetutës nuk pësoi ndryshime për shkak të reformës në drejtësi, duke u garantuar nga ky nen aksesin në drejtësi dhe eficienten e gjykimeve.

1. Me ndryshimet e bëra në vitin 2016, Kushtetuta ka parashikuar tashmë Avokatin e Popullit si subjekt të pakushtëzuar, e konkretisht në nenin 134, shkronja “ç” ku parashikohet se: “*1. Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë të: ç) Avokatit të Popullit;*”
2. Zgjerimi i ankimit kushtetues individual, nëpërmjet të cilit para kësaj gjykate kërkohet kontroll jo vetëm i procesit të rregullt ligjor procedural, kompetencë kushtetuese e konsoliduar, por edhe të çdo të drejte dhe lirie themelore të parashikuar në Kushtetutë. Tashmë, Gjykata vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e këtyre të drejtave. Më konkretisht, në nenin 131 (*ndryshuar nënparagrafi “f” me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016*) parashikohet se: “*Gjykata Kushtetuese vendos për: f) gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e këtyre të drejtave, përveçse kur parashikohet ndryshe në Kushtetutë.*”
3. Përsa i përket zbatimit në praktikë të juridiksionit të ri të Gjykatës Kushtetuese, në lidhje me ankimin kushtetues individual, nga praktika janë evidentuar disa problematika, sic është shkurtimi i afatit ankimor për paraqitjen e ankimit. Sipas ndryshimeve në nenin 50, pika 4, si dhe nenin 71/a, pika 1, gërma “b” të Kushtetutës, afati i ankimit kundër ligjeve, akteve normative nënligjore, akteve të pushtetit publik apo vendimeve gjyqësore që pretendohet se çënojnë të drejtat dhe liritë themelore është 4 muaj, nga 2 vjet që ka qenë më parë. Ky ndryshim

është përafuar dhe barazohet me afatin ankimor që duhet të kenë individët për t'u ankuar në GJEDNJ në momentin e hyrjes në fuqi të Protokollit nr. 15 të KEDNJ-së.⁷⁶

Pra, ndryshimet kushtetuese dhe ligjore sollën një sërë risish, si në drejtim të juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese, të subjekteve që legjitimohen, kushteve dhe kritereve, procedurave dhe afateve ligjore për t'u respektuar dhe plotësuar, me qëllim të një aksesit më të madh, qasjeje sa më cilësore të subjekteve kërkues ndaj gjykimit kushtetues, dhe për më shumë efektivitet të vetë Gjykatës Kushtetuese, si mjet ankimi gjithëpërfshirës.⁷⁷

1.a) Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese në lidhje me gjykimin brenda një afati të arsyeshëm, ka mbajtur qëndrimin se e drejta për një proces të rregullt ligjor, pjesë e të cilit është edhe gjykimi brenda një afati të arsyeshëm, luan një rol kyç në drejtim të garantimit të të drejtave të njeriut.

Gjykata Kushtetuese ka theksuar se, edhe pse sistemi gjyqësor në tërësi po përballet me ngarkesë si rezultat i zbatimit të reformës në drejtësi, kjo problematikë e përgjithshme nuk mund të rëndojë ose justifikojë shkeljen e së drejtës kushtetuese të kërkuesve. Sipas saj, sjellja e autoriteteve shtetërore, në veçanti të atyre që miratojnë ligjet dhe politikat e sistemit të drejtësisë, nuk ka qenë në nivelin e duhur të efikasitetit, duke shkaktuar vonesa të paarsyeshme në gjykimin e çështjeve⁷⁸. Gjykimi përtej afatit të arsyeshëm, bazuar vetëm në faktin se shteti ka dështuar të marrë masa efikase, që efektet e zbatimit të reformës në drejtësi janë të përkohshme dhe që gjykatat të plotësohen me personel dhe të organizohen në kohën e duhur dhe sipas standardeve kushtetuese, nuk mund të përligjë cenimin e të drejtave kushtetuese të individëve. Për më tepër, mbingarkesa në gjykata është një situatë e njohur dhe e zgjatur në kohë, e cila nuk varet nga kërkuesit, por vetëm nga përgjegjësit e administrimit të sistemit të drejtësisë, detyra e të cilëve është të krijojnë një sistem gjyqësor efikas dhe të pajisur me personel, në mënyrë që t'i përgjigjet më së miri kërkesave të shtetit të së drejtës, ku përfshihet edhe përfundimi i proceseve gjyqësore në përputhje me standardet që imponon e drejta për proces të rregullt, ndërkohë që ky detyrim kushtetues prej tyre nuk rezulton të jetë respektuar⁷⁹. Kohëzgjatja e gjykimit normalisht llogaritet nga momenti i fillimit të procesit gjyqësor deri në momentin kur jepet vendimi⁸⁰ dhe në kohëzgjatjen e përgjithshme të gjykimit nuk përjashtohen vonesat e shkaktuara nga zbatimi i reformës në drejtësi, pasi barra e këtyre vonesave nuk duhet të zhvendoset te palët ndërgjyqëse⁸¹. Në vlerësimin e kërkesave për konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosgjykimit të çështjes brenda afatit të arsyeshëm, arsyeshmëria e zgjatjes së procesit duhet të vlerësohet sipas rrethanave të veçanta të çështjes, duke pasur parasysh sidomos: a) sjelljen e

⁷⁶ Monitorimi i Zbatimit të Reformës në Drejtësi 2019, mbështetur nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë-pika 3.8 "Gjykata Kushtetuese", fq.26.

⁷⁷ Monitorimi i Zbatimit të Reformës në Drejtësi 2019, mbështetur nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë

⁷⁸ Vendim nr.25, datë 11.05.2023, parag.75 -76, i GJK-së.

⁷⁹ Vendim nr.2, datë 17.02.2022, parag.57-58, i GJK-së.

⁸⁰ Vendimet nr.3, datë 17.02.2022 parag.34; nr.4, datë 20.02.2013, parag.11; nr.6, datë 31.03.2006, parag.26, të GJK.

⁸¹ Vendimet nr.25, datë 11.05.2023, parag.57; nr.2, datë 17.02.2022, parag.2, të GJK.

kërkuesit; b) kompleksitetin e çështjes; c) sjelljen e autoriteteve; ç) si dhe çfarë përbën rrezik për kërkuesin⁸². Kriteri “*interesi i kërkuesit dhe rreziku që passjell tejzgjatja e procedurave për të*” përbën një aspekt të rëndësishëm të vlerësimit të kohëzgjatjes së arsyeshme të gjykimit. Disa kategori çështjesh, për shkak të natyrës së tyre, kërkojnë përshpejtim të posaçëm të gjykimit. Në këto raste duhet të merret parasysh ajo çfarë përbën rrezik për pozitën e kërkuesit në procesin gjyqësor, pra rëndësia për kërkuesin e së drejtës objekt gjykimi. Në të tilla çështje ndër të tjera hyjnë edhe ato që kanë të bëjnë me mosmarrëveshjet familjare, vërtetimin e amësisë ose atësisë, mosmarrëveshjet familjare për fëmijët, statusin martesor dhe heqjen ose rivendosjen e aftësisë juridike, të tilla që cenojnë nenin 3 të KEDNJ-së, të cilat janë edhe më urgjente⁸³.

Edhe ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm i vendimit të formës së prerë të gjykatës është pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së. Parimet kushtetuese të lidhura me procesin e rregullt ligjor, si dhe detyrimi për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, i parashikuar në nenin 142/3 të Kushtetutës, nënvizojnë faktin se çdo qytetar, i cili i drejtohet një gjykate kompetente për realizimin e një të drejte, nuk mund të presë pa kufi për realizimin e saj. Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë dhe çdo organ shtetëror duhet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre.⁸⁴

Nga ana tjetër, Kushtetuta ka garantuar mbrojtje të veçantë për familjen dhe fëmijët në vecanti, duke përcaktuar se familja dhe martesë gëzojnë mbrojtjen e veçantë të shtetit, se kushdo ka të drejtë të martohet dhe të ketë familje, dhe se lidhja dhe zgjidhja e martesës rregullohen me ligj (neni 53). Fëmijët kanë të drejtën e një mbrojtjeje të veçantë nga shteti, fëmijët e lindur jashtë martese kanë të drejta të barabarta me të lindurit nga martesë, si dhe çdo fëmijë ka të drejtë të jetë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi, përdorimi për punë veçanërisht nën moshën minimale për punën e fëmijëve, që mund të dëmtojë shëndetin, moralin ose të rrezikojë jetën a zhvillimin e tij normal (neni 54). Të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor dhe kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë brenda një afati të arsyeshëm (neni 42).

2) Kodi i Procedurës Civile⁸⁵

a) Në lidhje me gjykimin e kërkesave për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, përshpejtimin e procedurave dhe shpërblimin e dëmit, për shkak të kohëzgjatjes së paarsyeshme të çështjes, sipas përkufizimit të nenit 6/1 të KEDNJ-së⁸⁶, me Ligjin nr.38, datë

⁸² Vendimet nr.6, datë 16.02.2023, parag.39; nr.17, datë 29.06.2022; nr.18, datë 19.07.2005, parag.7, të GJK.

⁸³ Vendim nr.6, datë 16.02.2023, parag.58, i GJK

⁸⁴ Vendimet nr.75, datë 23.11.2017, parag.13; nr.1, datë 19.01.2009, parag.2.1; nr.6, datë 31.03.2006, parag.34, të GJK.

⁸⁵ Ligji nr.8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

⁸⁶ Neni 399/1 i KPC

30.3.2017⁸⁷ është shtuar tërësisht Kreu X “Gjykimi i kërkesave për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, përshpejtimin e procedurave dhe shpërblimin e dëmit”, në Kodin e Procedurës Civile (K.Pr.C).

Me ndryshimet që iu bënë K.Pr.C-së, u përcaktua se cilat konsiderohen afate të arsyeshme (neni 399/2), llojet e mjeteve për t’u mbrojtur nga cenimi, si: kërkesa për përshpejtimin e procedurave (neni 399/4), kërkesa për dëmshpërblim dhe çfarë konsiderohet shpërblim i drejtë (neni 399/3); cila është gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesës (nenet 399/4 dhe 399/6); rregullat për gjykimin e kërkesës (neni 399/7), e deri tek marrja e vendimit dhe zbatimi i tij (nenet 399/8 – 399/12).

Më konkretisht, afate të arsyeshme të përfundimit të gjyimit apo ekzekutimit të një vendimi të formës së prerë, do të konsiderohet përfundimi i procesit të gjyimit:

- brenda dy viteve në gjykimin civil në shkallë të parë,
- brenda dy viteve në gjykimin civil në apel,
- brenda dy viteve në gjykimin civil në Gjykatën e Lartë,

Në procedurën e ekzekutimit të një vendimi civil, me përjashtim të detyrimeve periodike ose të përcaktuara në kohë, afati është njëvjeçar dhe fillon nga dita e paraqitjes së kërkesës për vënie në ekzekutim.

Kërkesa për konstatimin e tejzgjatjes së procedurave, mund të paraqitet edhe pa kaluar afatet e mësipërme, dhe në kohëzgjatjen e gjyimit, nuk llogaritet koha kur çështja është pezulluar për shkaqe ligjore, kur është shtyrë për shkak të kërkesave të palës kërkuese, ose kur shfaqen rrethana të pamundësisë objektive për procedim (neni 399/2, pika 2 dhe 3).

Gjykimi i kërkesave për shkelje të afatit të arsyeshëm bëhet në dhomë këshillimi dhe gjykata merr vendim brenda 45 ditëve. Në rast se gjatë shqyrtimit të kërkesës dhe brenda 30 ditëve nga paraqitja e saj, gjykata që shqyrton çështjen i ndërmerr hapat kërkohe nga pala, atëherë pushon shqyrtimi i kërkesës për shkelje afati të arsyeshëm. Në rast se kërkesa refuzohet, ajo nuk mund të përsëritet më për të njëjtat fakte (neni 399/7, pika 2) Pas shqyrtimit të kërkesës gjykata vendos: a) pranimin e kërkesës, konstatimin e shkeljes dhe urdhërimin e ndërmarrjes brenda afateve të veprimeve të caktuara procedurale gjatë gjyimit ose ekzekutimit; b) rrëzimin e kërkesës. Ky vendim i gjykatës është përfundimtar dhe i formës së prerë.

Për rrjedhojë, ligji procedural ka parashikuar mjete ligjore nëpërmjet të cilave individit i garantohet mbrojtja në rastet e cenimit të së drejtës për gjykimin ose për ekzekutimin e vendimit gjyqësor brenda afatit të arsyeshëm. K.Pr.C parashikon tashmë një mjet juridik ankimi efektiv, i cili garanton si përshpejtimin e procesit gjyqësor, ashtu edhe dëmshpërblimin, pra ofron një rezultat konkret në

⁸⁷ Ligji nr.38, datë 30.3.2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar” (hyrë në fuqi në datën 05.11.2017)

drejtim të rivendosjes të së drejtës së shkelur për proces gjyqësor brenda afateve të arsyeshme ligjore.

Megjithatë, përcaktimi i afateve maksimale të përfundimit të gjykimit të çështjeve civile në përgjithësi (ku hyjnë edhe çështjet familjare që prekin fëmijët), në gjykatat përkatëse në të tre shkallët e gjykimit, mendojmë se nuk është i mjaftueshëm përsa i përket çështjeve fokus analize, sepse efikasiteti i parashikimit të këtyre afateve duhet të lidhet me situatën faktike të zbatimit të tyre. Këto afate janë përcaktuar për proceset civile në përgjithësi ndërsa për çështjet familjare që prekin fëmijët nuk janë parashikuar afate specifike (sidomos afate minimale), duke u bërë kështu të pazbatueshme në praktikë këto afate, për shkak të mungesës së kapaciteteve në gjykata.

Si rregull, shqyrtimi i çështjeve dhe vlerësimi përfundimtar në lidhje me kohëzgjatjen e arsyeshme të gjykimit duhet të bëhet nga gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm, sipas kompetencës që parashikon K.Pr.C-ja, në përputhje me parimin e subsidiaritetit. Për sa i përket kriterit të shterimit të mjeteve juridike efektive, të parashikuara nga nenet 399/1 e vijues të K.Pr.C-së, në parim ato janë efektive, ndërsa në praktikë efektiviteti i tyre shihet sipas rrethanave të çdo rasti konkret.

b) Përsa i përket kërkesës për përshpejtimin e procedurave, ky lloj mjeti është “efektiv” nëse arrin të përshpejtojë vendimmarrjen e gjykatës. Në vlerësimin e efektivitetit në praktikë të këtij mjeti juridik, është e rëndësishme që të analizohet nëse ai është real, i drejtpërdrejtë, konkret dhe i shpejtë në kohë, pra që ai nuk është një mundësi e tërthortë për individin. Në këtë kuptim, kur kërkesa për përshpejtimin e procedurave nuk i ka shërbyer qëllimit të saj, pra përshpejtimin të procedurave ose parandalimit të tejzgjatjes së paarsyeshme të shqyrtimit të çështjes, atëherë ky mjet juridik nuk ka qenë *efektiv* në praktikë. Në lidhje me këtë, vet Gjykata Kushtetuese është shprehur se, ndonëse interpretimi rast pas rasti i nenit 399/2 të K.Pr.C-së, i takon vetë Gjykatës së Lartë, qasja për të mos llogaritur efektet e reformës së drejtësisë në kohëzgjatjen e përgjithshme të procedurave, nuk përputhet me standardin e “afatit të arsyeshëm” të procesit të rregullt ligjor⁸⁸.

Në lidhje me gjykimin në apel K.Pr.C ka parashikuar në nenin 460 se relatori cakton datën dhe orën e gjykimit në përputhje me kalendarin e shqyrtimit të çështjeve, duke marrë për bazë radhën, sipas kohës së ardhjes së dosjes në gjykatën e apelit. Palët mund t’i kërkojnë me shkrim relatorit përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes për shkaqe veçanërisht të rënda dhe të motivuara, kur kjo nuk vjen në kundërshtim me ligjin dhe është Këshilli i Lartë Gjyqësor që përcakton rregulla të hollësishme për zbatimin e këtij neni.

c) Në lidhje me kohëzgjatjen e arsyetimit të vendimeve gjyqësore, K.Pr.C ka parashikuar në nenin 308 se, në gjykimin në shkallë të parë gjykata mund të shpallë vetëm dispozitivin e vendimit duke e dorëzuar atë të arsyetuar në sekretari jo më vonë se 20 ditë ose të shtyjë shpalljen e arsyetuar të vendimit deri në 20 ditë. Ankimet dhe rekursat e veçanta kundër vendimeve jopërfundimtare

⁸⁸ Vendim nr.3, datë 17.02.2022, parag.20 & 26, i GJK-së.

shqyrtohen në dhomë këshillimi brenda 30 ditëve nga dita e regjistrimit të tyre në gjykatën më të lartë (neni 471/a). Në këtë aspekt, afati i arsyeshëm i gjykimit duhet të përfshijë edhe periudhën nga shpallja e vendimit e deri në njoftimin e vendimit të arsyetuar palëve ndërgjygjëse. Kjo është shumë e rëndësishme për t'u evidentuar, referuar edhe afateve të ankimit (neni 443 e në vijim), e konkretisht: në gjykatën e apelit, kundër vendimeve përfundimtare të gjykatës së shkallës së parë, prej 15 ditë; rekurs në Gjykatën e Lartë, kundër vendimeve të gjykatës së apelit, prej 30 ditë; për të kërkuar rishikimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë prej 30 ditë; për ankime dhe rekurse të veçanta prej 5 ditë, të cilat janë të prera dhe fillojnë nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

c) Mosmarrëveshjet që lidhen me të miturit dhe familjen, janë parashikuar të gjykohen nga seksione të veçanta të cilat krijohen në përbërje të gjykatave të shkallës së parë (neni 320, gërma “c” i K.Pr.C). Gjykatat në të cilat do të krijohen këto seksione, si dhe zonat ku do të shtrijnë kompetencat ato, mbi bazën e bashkimit të kompetencave tokësore të një apo disa gjykatave të shkallës së parë, caktohen nga Presidenti i Republikës me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, i cili cakton numrin e gjyqtarëve për çdo seksion dhe kujdeset për kualifikimin e tyre sipas seksionit përkatës (neni 321 i K.Pr.C).

Kur e kërkojnë interesat e të miturve, K.Pr.C ka parashikuar në nenin 173, se gjykata mund të vendosë të mos lejojë pjesëmarrjen e organeve të medias dhe publikut gjatë një pjese ose gjatë gjithë zhvillimit të procesit gjyqësor. Gjithashtu, K.Pr.C ka përcaktuar se nuk lejohet qëndrimi në seancë gjyqësore me dyer të mbyllura i të miturve nën 16 vjeç, përveç kur ata thirren nga gjykata. Një garanci tjetër e parashikuar në K.Pr.C për të miturit, është ndalimi i pyetjes së tyre si dëshmitar (Neni 235), i kategorisë së bashkëshortëve ende të pandarë, fëmijëve, prindërve, gjyshërve, ose kushërinjve, në vijë të drejtë ose të tërthortë deri në shkallë të dytë, përveç kur çështja ka lidhje me probleme personale e familjare, si dhe të miturit nën katërmëdhjetë vjeç, përveç kur thëniet e tyre janë të domosdoshme për zgjidhjen e çështjes. Këta persona vendosin vetë nëse do të dëshmojnë dhe nuk mund të dënohen për refuzimin për të bërë dëshmi.

Në kreun IV “Shqyrtimi i mosmarrëveshjeve që lidhen me familjen” është përcaktuar kompetenca e seksioneve për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve familjare pranë gjykatave të shkallës së parë, për: a) shqyrtimin e mosmarrëveshjeve për zgjidhjen e martesës me shkurorëzim, për pavlefshmërinë dhe për anulimin e martesës; b) vënien dhe heqjen e kujdestarisë mbi të miturit, mbajtjen për rritje dhe edukim të fëmijëve deri në zgjidhjen e martesës dhe ndryshimin e vendimit të gjykatës për shkak të rrethanave të reja; c) miratimin e birësimit; ç) mosmarrëveshjet lidhur me dhënien e ndihmës për jetesë; d) ndarjen e pasurisë bashkëshortore dhe të banesës së bashkëshortëve; dh) kërkesat për heqjen dhe kthimin pushtetit prindëror.

Për efekt të çështjeve gjyqësore fokus i kësaj analize, përmendim se K.Pr.C ka përcaktuar kompetencën tokësore për: a) paditë kundër të miturve që nuk kanë mbushur moshën katërmëdhjetë vjeç, ngrihen në gjykatën e vendit ku ka banimin përfaqësuesi ligjor i tyre (neni

44); b) paditë për pjesëtimin e sendeve të përbashkëta ngrihen në gjykatën e vendit ku ndodhen sendet ose pjesa më e madhe e tyre (neni 45); c) paditë për kërkim ushqimi mund të ngrihen si në gjykatën e vendit ku ka banimin i padituri, ashtu dhe në gjykatën e vendit ku ka banimin paditësi, ndërsa padia për heqjen ose pakësimin e ushqimit të caktuar ngrihet në gjykatën e vendit ku ka banimin i padituri (neni 47); ç) paditë për zgjidhjen e martesës mund të ngrihen si në gjykatën e vendit ku bashkëshortët kanë pasur banimin e tyre të përbashkët të fundit ose në gjykatën e vendit ku ka banimin i padituri. Kur i padituri nuk ka banim ose vendqëndrim dhe as banesë të përkohshme në Republikën e Shqipërisë, padia ngrihet në gjykatën e vendit ku ka banimin, vendqëndrimin ose banimin e përkohshëm paditësi dhe kur as paditësi nuk i ka ato, padia ngrihet në gjykatën e kryeqytetit (neni 51); d) paditë për vendosjen ose heqjen e kujdestarisë, si dhe për heqjen ose kthimin e pushtetit prindëror, ngrihen pranë seksionit përkatës të gjykatës së shkallës së parë ku banon i mituri (neni 350); dh) paditë për të kërkuar ekzekutimin e detyrueshëm për kryerjen ose moskryerjen e një veprimi të caktuar, ngrihen në gjykatën e vendit ku duhet të përmbushet një detyrim i tillë. Kompetenca tokësore mund të ndryshohet me marrëveshje me shkrim të palëve, përveç padisë për pjesëtimin e sendit të përbashkët dhe kur ligji e ndalon këtë marrëveshje.

1. Procedura për vendosjen e kujdestarisë (nenet 350-357) ose heqjen e kujdestarisë, si dhe për heqjen ose kthimin e pushtetit prindëror, është në kompetencë të seksionit përkatës të gjykatës së shkallës së parë ku banon i mituri. Të drejtën për paraqitjen e kërkesës në gjykatë e kanë të afërmit e fëmijës së mitur dhe cilido që merr njoftimin për mbetjen e fëmijës pa prindër, për lindjen e një fëmije me prindër të panjohur dhe për çdo rrethanë tjetër që ligji kërkon vendosjen e kujdestarisë. I mituri që ka mbushur moshën 16 vjeç mund ta ushtrojë vetë këtë të drejtë. Gjykata e heq kujdestarin në çdo kohë dhe e zëvendëson me një tjetër, sipas rasteve të parashikuara në K.Pr.C, vetëm pasi ta ketë dëgjuar ose njoftuar atë rregullisht. Kur në çeljen e një testamenti, noteri, që bën publikimin e tij vihet në dijeni për caktimin e një kujdestari, duhet të njoftojë gjykatën jo më vonë se 10 ditë nga marrja e dijeni, e cila procedon dhe vendos jo më vonë se 15 ditë (neni 351). Gjykata emëron një kujdestar të posaçëm, kur këtë e kërkojnë interesat e të miturit dhe kujdestaria e posaçme hiqet, kur pushojnë shkaqet për të cilat është vendosur (neni 355). Pyetja e të miturit nga gjykata bëhet përpara se të procedohet për emërimin e kujdestarit, kur i mituri e ka mbushur moshën 10 vjeç. Kujdestaria merr fund kur i mituri mbush moshën 18 vjeç ose kur e mitura martohet para kësaj moshe (neni 356).

2. Pjestimi gjyqësor në lidhje me sendet në bashkëpronësi (nenet 369-374), shqyrtohet në dy faza: a) faza e parë ka për qëllim të hetojë e të përcaktojë të drejtën e bashkëpronësisë së ndërgjyqësve, pjesët takuese të tyre, si dhe sendet që do të pjesëtohen. Pasi mer provat e nevojshme, gjykata, me vendim të ndërmjetëm, lejon pjesëtimin dhe përcakton rrethin e bashkëpjesëtarëve, sendet që do të pjesëtohen, si dhe pjesët takuese të secilit prej tyre. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi i veçantë, paraqitja e të cilit pezullon vazhdimin e mëtejshëm të gjykimit. Gjithshtu palët mund të deklarojnë se nuk kanë ankim ndaj këtij vendimi të ndërmjetëm dhe në këtë rast kalohet në fazën e dytë; b) faza e dytë zhvillohet në rastin kur vendimi i ndërmjetëm, që ka lejuar pjesëtimin, ka

marrë formën e prerë, gjykata vazhdon gjykimin në fazën e dytë, duke marrë në shqyrtim kërkesat që rrjedhin nga marrëdhëniet e bashkëpronësisë. Gjykata bën vlerësimin e sendeve që do të pjesëtohen, pasi më parë të ketë marrë mendimin e ekspertëve. Kur sendi ndahet në natyrë dhe pjesët e formuara janë të barabarta ose barazohen me para, gjykata harton një projekt pjesëtimi të cilin e depoziton në sekretari jo më pak se 10 ditë përpara seancës së ardhshme gjyqësore. Palët kanë të drejtë të parashtrajnë vërejtjet e tyre për projektin e depozituar, jo më vonë se 5 ditë përpara seancës së ardhshme gjyqësore. Në vendimin përfundimtar gjykata cakton pjesën e secilit bashkëpjesëtar. Kur në vendimin përfundimtar është urdhëruar që një send të shitet në ankand për shkak se nuk mund të ndahet në natyrë, vendimi, pasi të ketë marrë formën e prerë, ekzekutohet nga përmbaruesi gjyqësor, sipas rregullave mbi ekzekutimin e detyrueshëm.

d) Në lidhje me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore (neni 517 e në vijim), K.Pr.C parashikon ekzekutimin vullnetar një afat prej 5 ditësh (për pagë ose detyrim për ushqim) dhe prej 10 ditësh në të gjitha rastet e tjera, nga marrja e lajmërimit të përmbaruesit gjyqësor. Me kërkesë të debitorit gjykata e shkallës së parë të vendit të ekzekutimit, në raste të veçanta, duke marrë parasysht gjendjen pasurore të debitorit ose rrethana të tjera të çështjes dhe pasi të dëgjojë kreditorin, mundet të shtyjë afatin e ekzekutimit të detyrimit në të holla ose të ndajë këtë detyrim në këste, Vendimi jepet në seancë gjyqësore, brenda 20 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës dhe kundër tij mund të bëhet ankim i veçantë. Ekzekutimi i detyrueshëm nuk mund të fillojë para se të kenë kaluar afatet për ekzekutimin vullnetar, përveç kur ka rrezik se me kalimin e afatit, ekzekutimi do të bëhet i pamundshëm, rast në të cilin përmbaruesi gjyqësor mund të fillojë menjëherë nga ekzekutimi i detyrueshëm. Për ekzekutimin e titujve ekzekutivë, me objekt “Takim dhe kujdestari fëmije”, përmbaruesi gjyqësor kërkon asistencën e psikologut, kur ky i fundit është i detyruar në bazë të ligjit për bashkëpunim (neni 523).

dh) Vendimet me ekzekutim të përkohshëm mund të jepen nga gjykata (neni 317 e në vijim), kur është vendosur detyrimi për ushqim, ose kur nga vonesa e ekzekutimit, paditësi mund të pësojë dëme të rëndësishme, që nuk mund të vihen në vend, ose kur ekzekutimi i vendimit do të bëhej i pamundur, ose do të vështirësohej së tepërmi. Në këtë rast gjykata mund të kërkojë që paditësi të japë një garanci. Kundër vendimit me të cilin pranohet ose rrëzohet kërkesa për ekzekutim të përkohshëm të vendimit, mund të bëhet ankim i veçantë. Si rrjedhojë e prishjes së vendimit nga gjykata e apelit ose Gjykata e Lartë, ekzekutimi i përkohshëm pezullohet.

3) Kodi i Familjes⁸⁹

Në Kodin e Familjes, në pjesën e parimeve të përgjithshme, në nenin 2, është parashikuar se jo vetëm prindërit e fëmijës, por edhe gjykatat e organet kompetente, duhet të kenë si konsideratë parësore interesin më të lartë të fëmijës në veprimtarinë e tyre vendimmarrëse. Në nenin 6 të Kodit është parashikuar se e drejta e fëmijës për t’u dëgjuar dhe për të dhënë pëlqimin në procedurat që

⁸⁹ Ligji nr.9062, datë 8.5.2003 “Kodi i Familjes”, ndryshuar me ligjin nr. 134/2015, datë 5.12.2015.

i përkasin, duke përfshirë edhe ato gjyqësore. Kjo e drejtë sigurisht që kufizohet në njëfarë mënyrë me moshën dhe aftësinë për të kuptuar të fëmijës, por gjithsesi, në rastet kur fëmija kërkon të dëgjohet, kërkesa e tij nuk mund të rrëzohet, veçse për shkaqe të rënda dhe me vendim tepër të motivuar.

Kohëzgjatja, efica dha e efikasiteti i menaxhimit të çështjeve gjyqësore familjare që prekin fëmijët, të parashikuara në Kodin e Familjes, janë në fokus të këtij monitorimi. Më specifikisht për disa prej çështjeve të rregulluara në Kodin e Familjes dhe për qëllim të kësaj analize, evidentohen si vijon:

1. Në lidhje me “zgjidhjen e martesës” Kodi i Familjes ka parashikuar në nenet 125 e në vijim, përvec procedimit sipas ritit të zakonshëm, edhe zgjidhjen e martesës me marrëveshje, kur bashkëshortët bien dakord. Në këtë rast, ata i paraqesin gjykatës për miratim kërkesën për zgjidhje martesë si dhe një projekt marrëveshje që rregullon pasojat e zgjidhjes së martesës.. Gjykata vendos për zgjidhjen e martesës dhe miraton marrëveshjen që rregullon pasojat e zgjidhjes së martesës, ose kur konstaton se marrëveshja nuk siguron në mënyrë të mjaftueshme interesat e fëmijëve ose të njërit prej bashkëshortëve, pezullon gjykimin për 3 muaj dhe u kërkon bashkëshortëve të bëjnë rregullimet e duhura në marrëveshje. Në qoftë se edhe pas këtij afati nuk janë bërë rregullimet e duhura, gjykata refuzon miratimin dhe rrëzon kërkesën për zgjidhjen e martesës me pëlqim reciprok të bashkëshortëve. Parashikimi në Kodin e Familjes e një mundësie të tillë për zgjidhjen e martesës dhe rregullimin e pasojave të zgjidhjes së saj me marrëveshje ndërmjet bashkëshortëve, krijon edhe mundësinë e përfundimit të gjykimit në afate më të shkurtra kohore sesa në rastin e gjykimit sipas ritit të zakonshëm, si dhe shmangjet mundësia për ta apeluar vendimin e gjykatës, duke bërë që ai të marrë formë të prerë dhe të bëhet menjëherë i ekzekutueshëm.

2. Në lidhje me “detyrimin për ushqim” Kodi i Familjes ka parashikuar në nenet 192 e në vijim, se cilët janë subjektet që mbartin detyrim për ushqim sipas rradhës. Një fëmijë i mitur mund t’u kërkojë prindërve të tij detyrimin për ushqim edhe kur ka pasuri, kur të ardhurat nga pasuria dhe nga puna e tij nuk i përmbushin nevojat e tij. Detyrimi për ushqim vazhdon edhe për kohën që fëmijët madhorë ndjekin shkollën e mesme ose të lartë, deri në moshën njëzetepesë vjeç.

3. Në lidhje me “marrjen e masave të përkohshme për detyrimin për ushqim”, Kodi i Familjes ka parashikuar në nenin 139 se gjykata, me kërkesën e palës së interesuar, mund të marrë masa të përkohshme për detyrimin për ushqim, edukimin dhe arsimimin e fëmijëve të mitur, për detyrimin për ushqim të bashkëshortit kur shihet e arsyeshme, për sigurimin e banimit, si dhe administrimin dhe përdorimin e pasurisë së vënë gjatë martesës, nëse është rasti. Vendimi i gjykatës për marrjen e një mase të tillë të përkohshme, ka fuqi derisa të jepet vendimi përfundimtar sipas neneve 192 e në vijim të Kodit të Familjes, por ai mund të ndryshohet ose të shfuqizohet nga gjykata, kur ndryshojnë rrethanat ose kur vendimi është marrë mbi të dhëna jo të sakta.

4. Në lidhje me “kontributin kompensues” Kodi i Familjes ka parashikuar në nenin 147 e në vijim se gjykata mund të detyrojë njërin nga ish-bashkëshortët të derdhë për llogari të tjetrit, një kontribut të destinuar për të kompensuar sa të jetë e mundur pabarazinë që mund të shkaktojë në jetën e tjetrit ndarja e pasurisë në zgjidhjen e martesës, përveç detyrimit për ushqim, duke përcaktuar dhënien e një kontributi të menjëhershëm ose periodik dhe mënyrën e pagimit të tij. Kohëzgjatja e dhënies së kontributit kompensues caktohet nga gjykata, sipas nevojave të ish-bashkëshortit përfitues dhe ndërpritet nëse ish-bashkëshorti përfitues lidh martesë të re. Kodi i Familjes ka parashikuar edhe mundësinë e caktimit të shumës dhe mënyrës së dhënies së kontributit kompensues me marrëveshje, e cila i paraqitet gjyqtarit për miratim. Marrëveshja e miratuar nga gjykata mund të ndryshohet vetëm me një marrëveshje të re, të miratuar nga gjykata, kur rrethanat kanë ndryshuar ose kur ato e imponojnë një gjë të tillë. Bashkëshortët, në rast ndryshimi të papritur të burimeve dhe nevojave të tyre, mund t’i kërkojnë gjykatës të rishikojë kontributin kompensues.

5. Në lidhje me “të drejtën e përdorimit të banesës” Kodi i Familjes ka parashikuar në nenin 153 se në rast se banesa familjare është në pronësi të njërit ish-bashkëshort dhe bashkëshorti tjetër nuk ka në pronësi banesë tjetër të përshtatshme në vendbanimin e tyre, gjykata mund të lejojë përdorimin nga ish-bashkëshorti jopronar të banesës kur: a) fëmijët i janë lënë për rritje dhe edukim këtij të fundit, derisa ata të arrijnë moshën madhore; b) zgjidhja e martesës bëhet nga ish-bashkëshorti pronar për ndërprerje prej tij të jetesës së përbashkët. Në këtë rast e drejta e përdorimit të banesës është deri në 7 vjet, por në rast se ish-bashkëshorti jopronar rimartohet, e humbet këtë të drejtë; c) kur ish-bashkëshorti jopronar ka instaluar në banesën e ish-bashkëshortit pronar një kabinet profesional me vlerë të madhe, lëvizja e të cilit do të kërkonte shpenzime të mëdha, dhe në këtë rast e drejta e përdorimit është deri në 3 vjet. Në këto raste gjykata përcakton afatin e përdorimit dhe masën e qirasë që detyrohet të paguajë ish-bashkëshorti jopronar në përputhje me të ardhurat e tij. Në çdo rast gjykata mund të zgjidhë kontratën e qirasë, në qoftë se kjo justifikohet nga rrethana të reja.

6. Në lidhje me “kërkimin e ushtrimit e përgjegjësisë prindërore” Kodi i Familjes ka parashikuar në nenin 155 e në vijim se, para se gjykata të marrë një vendim të përkohshëm ose përfundimtar lidhur me mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, të drejtës së vizitës ose të besuarit të fëmijës njërit ish-bashkëshort, në një proces gjyqësor me objekt zgjidhje martese, duhet të thërrasë një psikolog ose punonjës social, i cili, para se të japë mendimin, duhet të marrë të dhëna për gjendjen materiale dhe morale të familjes, kushtet në të cilat jetojnë dhe ku është më e përshtatshme të jetojë fëmija. Në rast se gjykata arrin në konkluzionin se fëmija, përkohësisht, duhet t’i besohet një personi të tretë ose një familjeje kujdestare, duhet të marrë mendimin e sektorit të ndihmës dhe shërbimeve sociale pranë bashkisë së vendit ku zhvillohet gjykimi. Gjukata vendos për mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore ose për t’i besuar fëmijën një të treti, mbi bazën e kërkesës së njëres prej palëve, pjesëtarëve të familjes ose prokurorit, në rast se ka shkaqe të rënda që janë të lidhura me ushtrimin abuziv të përgjegjësisë prindërore, duke marrë disa kritere në konsideratë për këtë rast, si: a) marrëveshjen e bërë ndërmjet ish-bashkëshortëve; b) mendimin dhe ndjenjat e shprehura nga fëmija i mitur, duke vlerësuar moshën dhe zhvillimin e tij;

c) mendimin e psikologut ose të sektorit të shërbimeve sociale pranë bashkisë, pasi këta të kenë dëgjuar fëmijën. Vendimi lidhur me ushtrimin e përgjegjësisë prindërore mund të ndryshohet në çdo çast nga gjykata, me kërkesën e njërit prej ish-bashkëshortëve, një të afërmi ose të prokurorit.

7. Në lidhje me “kthimin e fëmijës së mitur” Kodi i Familjes ka parshikuar në nenin 218 se prindërit mund të kërkojnë nga gjykata kthimin e fëmijës së tyre të mitur, kur nuk jeton pranë tyre dhe mbahet pa të drejtë nga persona të tjerë. Gjykata, për rrethana të rënda, mund të mos vendosë kthimin, në qoftë se ky vjen në kundërshtim me interesin më të lartë të fëmijës, si dhe merr mendimin e fëmijës kur ka mbushur moshën dhjetë vjeç.

8. Në lidhje me “ushtrimin, heqjen, kthimin ose humbjen e përgjegjësisë prindërore” Kodi i Familjes ka parashikuar në nenet 220 e në vijim, se përgjegjësia prindërore u përket dhe ushtrohet së bashku nga të dy prindërit për fëmijën e lindur gjatë martesës ose jashtë martese nëse është njohur nga të dy prindërit. Gjykata vendos, pasi është përpjekur ta zgjidhë çështjen me pajtim, nëse prindërit nuk bien dakord për atë që kërkon interesi i fëmijës. Me kërkesë të të atit, të nënës ose të prokurorit, gjykata mund të ndryshojë kushtet e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore dhe të vendosë që ai të ushtrohet nga njëri prind ose nga të dy bashkërisht, si dhe vendos se me cilin prind do të banojë fëmija, të drejtën e vizitës dhe të mbikëqyrjes së prindit me të cilin fëmija nuk banon. Ushtrimi i përgjegjësisë prindërore pas zgjidhjes së martesës bëhet sipas pikës 6 më sipër.

Humbja e përgjegjësisë prindërore bëhet me vendim gjykate, në rast se prindi është dënuar me vendim penal si autor ose bashkëpunëtor për një vepër penale ndaj fëmijës së tij, si bashkëpunëtor në një vepër penale të kryer nga fëmija i tij ose nëse është dënuar për ndonjë nga shkaqet e braktisjes së familjes.

Heqja e përgjegjësisë prindërore bëhet me vendim të gjykatës kur prindi shpërdoron përgjegjësinë prindërore ose tregon pakujdesi të rëndë në ushtrimin e saj, ose me veprimet e tij ndikon në mënyrë të dëmshme në edukimin e fëmijëve, me kërkesën e prindit tjetër, të të afërmeve të fëmijës ose të prokurorit. Kthimi i përgjegjësisë prindërore bëhet me vendim të gjykatës, kur pushon shkakun për të cilin është hequr kjo përgjegjësi.

9. Në lidhje me “përfaqësimin dhe administrimin e pasurisë së fëmijës” Kodi i Familjes ka parashikuar në nenet 231 e në vijim, se administrimi i pasurisë së fëmijës bëhet nga të dy prindërit bashkërisht, në rastin kur ata e ushtrojnë përgjegjësinë prindërore bashkërisht dhe në rastet e tjera, ose nga i ati apo nga nëna nën kontrollin e gjykatës. E drejta e përdorimit të pasurisë së fëmijës është e lidhur me të drejtën e administrimit ligjor dhe kjo e drejtë u takon të dy prindërve bashkërisht ose atij që është i ngarkuar me administrimin e pasurisë së fëmijës. Fëmija që nuk ka mbushur moshën katërbëdhjetë vjeç përfaqësohet nga prindërit në të gjitha veprimet juridike dhe pasuria e tij administrohet nga prindërit në dobi të fëmijës. Fëmija që ka mbushur moshën katërbëdhjetë vjeç i kryen vetë veprimet juridike dhe pasuria e tij administrohet nga vetë i mituri, por kurdoherë me pëlqimin paraprak të prindërve. Tjetërsimi i pasurisë së paluajtshe të fëmijëve deri në moshën tetëmbëdhjetë vjeç (lënia hipotekë, ngarkimi me një barrë, marrja hua në emër të të miturit, heqja dorë nga trashëgimia apo legu ose mospranimi i një dhurimi) si dhe përgjithësisht

veprimet që kapërcejnë kufijtë e një administrimi të thjeshtë të çdo pasurie të të miturit, mund të kryhen vetëm kur e kërkon interesi i të miturit dhe me autorizim të gjykatës së vendbanimit të të miturit..

10. Në lidhje me “birësimin e fëmijës” Kodi i Familjes ka parashikuar në nenet 240 e në vijim, institucionin e “birësimit”, i cili lejohet vetëm në rast se është në interesin më të lartë të fëmijës dhe njëkohësisht garanton respektimin e të drejtave të tij themelore. Në lidhje me të drejtën e fëmijës për t’u dëgjuar, Kodi përcakton se në procedurat e birësimit merret mendimi i fëmijës së birësuar kur ka mbushur moshën dhjetë vjeç dhe kërkohet pëlqimi i fëmijës së birësuar kur ka mbushur moshën dymbëdhjetë vjeç (neni 246). Pëlqimi për birësim jepet përpara gjykatës kompetente dhe mund të tërhiqet nga prindërit biologjikë, brenda 3 muajve nga çasti i dhënies së tij, periudhë kjo që shërben edhe si periudhë provë për marrëdhëniet midis birësuesve dhe të birësuarit (neni 248). Gjykatë kompetente për shqyrtimin e kërkesave për birësim, të bëra nga një shtetas shqiptar, është gjykata e vendbanimit të personit që kërkon të birësojë, ndërsa për kërkesat për birësim, të bëra nga një shtetas i huaj ose shqiptar që banon jashtë shtetit, gjykata kompetente është ajo e vendbanimit të të miturit. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë është kompetente për shqyrtimin e kërkesave për birësimin të të miturve shqiptarë që banojnë jashtë shtetit (neni 254).

11. Në lidhje me “braktisjen e fëmijës” Kodi i Familjes ka parashikuar në nenin 250 e në vijim, se gjykata e rrethit mund të deklarojë të braktisur të miturin që ndodhet pranë një institucioni të përkujdesjes sociale, publik ose privat, ose te personi që e ka në përkujdesje, kur prindërit e tij, në mënyrë të dukshme, nuk janë interesuar për të gjatë një viti, përpara paraqitjes së kërkesës për deklarimin e braktisjes. Kur i mituri ka qenë strehuar që nga lindja e tij në një institucion, afati prej 1 viti kufizohet në 3 muaj. Braktisja nuk deklarohet kur gjatë këtij afati, një anëtar i familjes ka kërkuar të marrë përsipër rritjen e fëmijës dhe kjo kërkesë është konsideruar në përputhje me interesin e fëmijës. Kërkesa për deklarimin e braktisjes bëhet nga drejtuesi i institucionit ku ndodhet fëmija ose nga personi që e ka në përkujdesje, përpara gjykatës nën juridiksionin e së cilës ndodhet institucioni ose vendbanimi i personit që e ka marrë në përkujdesje të miturin. Gjykata, që deklaron të braktisur të miturin, cakton në të njëjtin vendim edhe kujdestarin për mirërritjen, edukimin dhe arsimimin e fëmijës, një institucion të përkujdesjes sociale ose një person të caktuar, nisur nga interesi më i lartë i të miturit.

12. Në lidhje me “vendosjen e kujdestarisë mbi fëmijën, heqjen dhe zëvendësimin e kujdestarit” Kodi i Familjes ka përcaktuar në nenin 263 e në vijim dhe nenin 305, se fëmijët e mitur vendosen në kujdestari dhe gëzojnë mbrojtje të veçantë nga shteti kur prindërit e tyre janë në pamundësi për të ushtruar përgjegjësinë prindërore. Gjykatë kompetente për vendosjen në kujdestari të të miturit, është ajo e vendbanimit ose vendqëndrimit të të miturit. Për vendosjen dhe mbarimin e kujdestarisë, kancelari i gjykatës njofton brenda 10 ditëve nëpunësin e gjendjes civile për të bërë shënimin në aktin e lindjes së të miturit (neni 305). Të drejtën për paraqitjen e kërkesës në gjykatë për kujdestar mbi të miturin e kanë: a) të afërmit e fëmijës së mitur; b) cilido që merr njoftim për

mbetjen e fëmijës pa prindër ose për lindjen e një fëmije me prindër të panjohur; c) vetë i mituri që ka mbushur moshën katërbëdhjetë vjeç; ç) prokurori; d) noteri, i cili në çeljen e një testamenti vihet në dijeni për caktimin e një kujdestari (neni 264). Gjykata i jep prioritet zgjedhjes së kujdestarit midis paraardhësve, personave të afërt të të miturit, një familjeje kujdestare dhe, si alternativë të fundit, institucionin publik ose privat.

Familja kujdestare është përcaktuar në Kodin e Familjes si një familje alternative, e vendosur nga gjykata, për t'i ofruar fëmijës një mjedis familjar, kushte për mirërritje, përkujdesje fizike dhe mbështetje emocionale (neni 266).

Kujdestaria në Institucionet e Përkujdesjes, është parashikuar në nenin 271 të KF-së, si kujdestari mbi të miturin, që mund t'i jepet nga gjykata një institucioni publik ose privat të licensuar për përkujdesjen e fëmijëve, në rastet kur fëmija nuk ka të afërm të njohur ose të aftë për të ushtruar detyrën e kujdestarit. Drejtuesi i institucionit publik apo privat, ia delegon njërit nga punonjësit e tij të drejtën e ushtrimit të funksioneve të kujdestarit, si dhe brenda 10 ditëve nga caktimi i personit që merr funksionet e kujdestarit, drejtuesi i institucionit i dërgon gjykatës aktin përkatës, i cili depozitohet në dosjen gjyqësore dhe pasqyrohet në regjistrin e kujdestarisë.

Para se gjyqtari të caktojë kujdestarin, duhet të marrë edhe mendimin e të miturit nëse ai ka mbushur moshën dhjetë vjeç; mendimin e sektorit të ndihmës dhe shërbimeve sociale (PMF) pranë bashkisë së vendit ku zhvillohet gjykimi, si dhe mendimin e një psikologu, që duhet të jetë i pranishëm gjatë gjykimit (neni 267).

Në rastin kur vdesin të dy prindërit ose prindi i vetëm, që ka lënë fëmijë në moshë të mitur, ose kur lind një fëmijë nga prindër të panjohur, nëpunësi i gjendjes civile ka detyrimin të njoftojë brenda 10 ditëve gjykatën me qëllim caktimin e një kujdestari. Këtë detyrim e ka edhe noteri që çel një testament ku parashikohet caktimi i një kujdestari. Njoftimi i gjykatës mund të bëhet edhe nga të afërmit e të miturit ose persona të tjerë të interesuar. Në këto raste, Kodi ka parashikuar që gjykata brenda 30 ditëve nga marrja njoftim ose nga paraqitja e kërkesës, duhet të vendosë për caktimin e kujdestarit të të miturit (neni 268).

Heqja e kujdestarit dhe zëvendësimi me një tjetër, bëhet nga gjykata kur ai shpërdoron të drejtat e tij, tregohet i pakujdesshëm në kryerjen e detyrës ose, në mënyra të tjera, vë në rrezik interesat e të miturit, si dhe kur vetë kujdestari kërkon largimin e tij për shkaqe të arsyeshme. Kërkesa për zëvendësimin e kujdestarit mund të bëhet nga personat e interesuar ose prokurori (neni 300).

13. Në lidhje me “kujdestarinë e posaçme” Kodi i Familjes ka parashikuar në nenet 275 dhe 280, se kujdestaria e posaçme caktohet nga gjykata mbi bazën e kërkesës së prindit, të kujdestarit, së të afërmeve të të miturit, të miturit që ka mbushur moshën katërbëdhjetë vjeç dhe personave të interesuar, si dhe mbarimi i saj bëhet me kërkesën e po këtyre personave, kur pushojnë shkaqet për të cilat është vendosur. Gjykata merr vendim për caktimin e një kujdestari të posaçëm, bazuar në

kërkesën e paraqitur nga subjektet e mësipërme, të cilët mund të paraqesin edhe kërkesën për mbarimin e kujdestarisë së posaçme (neni 274).

14. Në lidhje me “kujdestarinë e përkohshme” ose marrjen e masave urgjente për mbrojtjen e fëmijës, Kodi i Familjes ka përcaktuar në nenin 281 se gjykata, qoftë kryesisht, qoftë me kërkesë të prokurorit, të një të afërmi ose të çdo personi të interesuar, mund të vendosë një kujdestar të përkohshëm ose të marrë masa të tjera urgjente, që janë të nevojshme për mbrojtjen e të miturit ose për të ruajtur dhe administruar pasurinë e tij, përpara se kujdestari i caktuar nga gjykata të marrë përsipër funksionet e tij.

4) Ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”

Ligji për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës (LDMF) ka për qëllim ndër të tjera mbrojtjen e fëmijës, dhe parashikimin e mekanizmave efikasë në fushën e mbrojtjes së fëmijës (neni 2). Interesi më i lartë i fëmijës është konsiderata parësore në çdo veprim që ka të bëjë me fëmijën dhe realizimi e mbrojtja e të drejtave të fëmijës, bëhet duke zbatuar parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit (neni 5, pika 3).

E drejta e fëmijës për t’u dëgjuar në proceset gjyqësore që lidhen me të, si dhe e drejta e ankimit kundër vendimeve apo masave të marra nga autoritetet shtetërore lidhur me të, janë të garantuara nga LDMF në nenin 13. E drejta për ndihmë juridike dhe psikologjike gjatë një procesi gjyqësor garantohet falas, ofrohet drejtpërdrejt dhe pa pengesa, bazuar në parimin e mosdiskriminimit dhe të interesit më të lartë të fëmijës (neni 29). Ndihma psikologjike përfshin të gjitha veprimet, si dhe këshillimet që kryen psikologu i caktuar nga autoritetet përgjegjëse. Ndihma juridike ndaj fëmijës përfshin të gjitha veprimet administrative, gjyqësore, si dhe këshillimet që kryen përfaqësuesi, avokati i zgjedhur prej tij ose i caktuar nga autoritetet përgjegjëse gjatë të gjithë procesit gjyqësor. Fëmija, vetë ose nëpërmjet prindit, kujdestarit ose përfaqësuesit të tij, bën kërkesë për ndihmë juridike tek institucionet përgjegjëse, të cilat informojnë fëmijën, kujdestarin ose përfaqësuesin e tij për procedurat. Gjatë zhvillimit të procedurave gjyqësore, të dhënat personale të fëmijës dhe jeta e tij private nuk bëhen publike.

Gjykata vlerëson si konsideratë parësore interesin më të lartë të fëmijës në marrjen e vendimit për masat e mbrojtjes së fëmijës dhe vendosjen e tyre në kujdestari.

Masat e mbrojtjes që LDMF përcakton në nenin 55, janë:

- a)** masa emergjente e mbrojtjes, e cila është një masë e përkohshme mbrojtjeje për largimin e fëmijës nga familja dhe vendosjen në përkujdesje alternative;
- b)** masa e mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative;
- c)** masa e mbrojtjes për mbikëqyrje të specializuar të fëmijës në mjedisin familjar.

a) Masa emergjente e mbrojtjes⁹⁰ për largimin e fëmijës nga familja dhe vendosjen e tij në përkujdesje alternative, është një masë e përkohshme mbrojtjeje, që vendoset kur:

- i. fëmija vlerësohet të jetë në situatë rreziku të lartë dhe të menjëhershëm,
- ii. fëmija është braktisur që në lindje nga prindërit ose është më i vogël se 16 vjeç dhe gjendet i braktisur në çdo lloj mjedisi;
- iii. fëmija është pa përkujdes prindëror.

Masa emergjente e mbrojtjes bazohet në Planin Individual të Mbrojtjes (PIM). Punonjësi i mbrojtjes së fëmijës ose drejtori i njësisë së mbrojtjes së fëmijës në nivel bashkie i dërgon PIM, drejtorit të strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në nivel bashkie, i cili merr vendimin e masës së mbrojtjes brenda 24 orëve dhe ky vendim hyn në fuqi ditën e marrjes së tij. Kjo masë mbrojtje ka fuqi deri në marrjen e vendimit gjyqësor përkatës për konfirmimin ose jo të tij. Për fëmijët mbi moshën 14 vjeç, kjo masë vendoset vetëm pasi është marrë pëlqimi i fëmijës dhe në rast se fëmija nuk jep pëlqimin, atëherë masa e mbrojtjes është e vlefshme deri në marrjen e një vendimi gjyqësor për lënien ose jo në fuqi. Kundër vendimit për marrjen e masës emergjente të mbrojtjes, kanë të drejtë të bëjnë ankim brenda 5 ditëve, vet fëmija, prindërit e fëmijës, të afërmit e tij dhe çdo person tjetër që ka një interes të ligjshëm. Ankimi nuk e pezullon zbatimin e masës, ai shqyrtohet nga gjykata së bashku me kërkesën për vlerësimin e masës, dhe ka të njëjtat efekte si vendimi gjyqësor për kujdestarinë.

Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës, brenda 5 ditëve nga marrja e vendimit depoziton në gjykatë kërkesën për vlefshmërinë e masës, së bashku me kërkesën për vendosjen e fëmijës në kujdestari. Gjykata shqyrton dhe vendos, brenda 5 ditëve për vlefshmërinë e masës emergjente të mbrojtjes, duke shqyrtuar edhe ankimet e paraqitura nga palët. Kur gjykata vendos dhënien e masës së mbrojtjes, atëherë ajo duhet të gjykojë edhe vendosjen e fëmijës në kujdestari dhe vendimi është i vlefshëm deri në vendosjen e fëmijës në kujdestari.

b. Masa e mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative⁹¹, është një masë e përkohshme mbrojtjeje, për fëmijën pa përkujdesje prindërore dhe kur për mbrojtjen e tij është e nevojshme strehimi apo vendosja e tij në përkujdesje alternative, duke ndjekur këtë rradhë:

- i. pranë një të afërmi të fëmijës;
- ii. pranë një familjeje kujdestare;
- iii. në një institucion rezidencial të përkujdesjes, kur nuk është e mundur asnjë nga alternativat e tjera.

Masat e mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative bazohet në Planin Individual të Mbrojtjes (PIM). Punonjësi i mbrojtjes së fëmijës ose drejtori i njësisë së mbrojtjes së fëmijës në nivel bashkie i dërgon PIM, drejtorit të strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në nivel bashkie, i cili merr vendimin e masës së mbrojtjes brenda 24 orëve. Kjo masë mbrojtje ka fuqi

⁹⁰ Ligji nr. 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës,” Neni 56

⁹¹ Ligji nr. 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës,” Neni 57

deri në marrjen e vendimit gjyqësor për konfirmimin ose jo të tij. Për fëmijët mbi moshën 14 vjeç, kjo masë vendoset vetëm pasi është marrë pëlqimi i fëmijës dhe në rast se fëmija nuk jep pëlqimin, atëherë masa e mbrojtjes është e vlefshme deri në marrjen e një vendimi gjyqësor për lënien në fuqi ose jo. Kundër vendimit për marrjen e masës emergjente të mbrojtjes, kanë të drejtë të bëjnë ankim brenda 5 ditëve vet fëmija, prindërit e fëmijës, të afërmit e tij dhe çdo person tjetër që ka një interes të ligjshëm. Ankimi nuk e pezullon zbatimin e masës, ai shqyrtohet nga gjykata së bashku me kërkesën për vlerësimin e masës, dhe ka të njëjtat efekte si vendimi gjyqësor për kujdestarinë.

Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës, brenda 5 ditëve depoziton në gjykatë kërkesën për vlefshmërinë e masës, së bashku me kërkesën për vendosjen e fëmijës në kujdestari. Gjykata shqyrton dhe vendos, brenda 5 ditëve për vlefshmërinë e masës emergjente të mbrojtjes, duke shqyrtuar edhe ankimet. Kur gjykata vendos dhënien e masës së mbrojtjes, atëherë ajo duhet të gjykojë edhe vendosjen e fëmijës në kujdestari. Vendimi i gjykatës për dhënien e kësaj mase mbrojtje është i vlefshëm deri në vendosjen e fëmijës në kujdestari.

c. Masa e mbrojtjes për mbikëqyrje të specializuar në mjedisin familjar⁹² vendoset si masë mbrojtjeje për fëmijën, në rastet kur:

- i. fëmija ka mundësi të trajtohet dhe të mbrohet brenda familjes, duke u monitoruar me një plan të përcaktuar nga strukturat e mbrojtjes së fëmijës;
- ii. fëmija mund të qëndrojë me njërin nga prindërit, i cili ka aftësitë dhe mundësitë për t'u kujdesur dhe për ta mbrojtur atë nga veprimet e prindit tjetër, i cili dyshohet ose provohet se ka abuzuar, dhunuar, shfrytëzuar apo neglizhuar fëmijën dhe i cili nuk banon apo i cili, për shkak të një urdhri të menjëhershëm mbrojtjeje apo një urdhri mbrojtjeje nuk lejohet të frekuentojë të njëjtën banesë apo mjedis familjar me atë ku ndodhet fëmija në nevojë për mbrojtje.

Plani Individual i Mbrojtjes, që përmban masën hartohet nga strukturat e mbrojtjes së fëmijës në bashkëpunim me prindërit ose jo. Vendimi për dhënien e kësaj mase ka fuqi deri në shfuqizimin e masës nga drejtori i strukturës përgjegjëse të shërbimeve shoqërore, bazuar në propozimin e punonjësit të mbrojtjes së fëmijës, dhe nuk dërgohet për shqyrtim gjyqësor.

Masat e mësipërme të mbrojtjes, vendosen për fëmijën kur plotësohet ndonjë nga kushtet e nenit 55 të LDMF-së.

5) Ligji nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”⁹³

Ky ligj ka për qëllim parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje në të gjitha format e saj, me anë të masave të përshtatshme ligjore dhe të masave të tjera të nevojshme, si dhe garantimin e

⁹² Ligji nr. 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës,” Neni 58

⁹³ Ligji nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar me ligjin nr. 9914, datë 12.5.2008, nr. 10 329, datë 30.9.2010, nr. 47/2018, datë 23.7.2018, nr.125/2020, datë 15.10.2020.

mbrojtjes me masa ligjore dhe me masa të tjera të nevojshme të pjesëtarëve të familjes, të cilët janë viktimat e dhunës në familje, duke u kushtuar vëmendje të veçantë ndër të tjera, grave, vajzave dhe fëmijëve, me objekt, ndër të tjera, fuqizimin e sistemit gjyqësor për marrjen e masave të mbrojtjes ndaj dhunës në familje (neni 1).

Shtesat dhe ndryshimet që u bënë në vitin 2020 (me Ligjin nr. 125/2020, datë 15.10.2020) kishin ndër objektivat kryesorë fuqizimin e gjyqësorit për marrjen e masave të mbrojtjes ndaj dhunës në familje dhe sigurimin/garantimin për viktimat e dhunës në familje të shërbimit të shpejtë, të pakushtueshëm dhe të thjeshtë në përputhje me ligjin, pranë gjykatës apo organeve të tjera kompetente për zbatimin e ligjit.

Në lidhje me afatet e shqyrtimit gjyqësor, ligji ka parashikuar se kërkesëpaditë për urdhërat e mbrojtjes regjistrohen në një regjistër të veçantë, protokollohen ditën e dorëzimit dhe hidhen në short ditën e nesërme. Gjykata kryen gjykimin në afatet e parashikuara nga ky ligj dhe zbaton format e njoftimit të parashikuara në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, për palët ose subjektet e tjera. Për nevoja të zhvillimit të gjykimit, kur rrethanat e çështjes e diktojnë, gjykata, sipas nevojës, mund të zhvillojë seancën gjyqësore në mungesë të palëve, pavarësisht nga konfirmimi i marrjes dijani (neni 14, pika 5).

Gjykata kompetente për lëshimin e urdhrave të mbrojtjes në rastin e dhunës në familje është gjykata e juridiksionit të përgjithshëm e shkallës së parë, bazuar në Kodin e Procedurës Civile. Për të vendosur sigurimin e masave mbrojtëse gjykata lëshon urdhra mbrojtjeje (UM) dhe urdhra të menjëhershëm mbrojtjeje (UMM).

a. Për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme⁹⁴, të vendosura nga titullari i strukturës përgjegjëse të Policisë së Shtetit, në juridiksionin e së cilës është raportuar dhuna, gjykata ka detyrimin që brenda 48 orëve nga dita e paraqitjes së kërkesës, në seancë gjyqësore të vendosë:

- i. vlerësimin e masave mbrojtëse të vendosura në urdhër dhe lëshimin e urdhrimit të menjëhershëm të mbrojtjes;
- ii. anulimin e urdhrimit dhe ndërprerjen e pasojave të tij, nëse nuk provohen faktet dhe rrethanat për të cilat është lëshuar (neni 13/1).

Kërkesën për urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje mund ta paraqesin: a) vetë viktimat; b) përfaqësuesi ligjor ose avokati i viktimës; c) policia/prokuroria; ç) personi me të cilin viktimat ka marrëdhënie familjare; d) përfaqësuesit e zyrës së shërbimeve sociale pranë bashkisë ose komunës, ku ka banimin e përhershëm apo të përkohshëm viktimat, që kanë dijani për ushtrimin e dhunës; dh) qendrat dhe shërbimet për mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje, të njohura/licencuara nga ministria përgjegjëse. Në rastin kur kërkesa është paraqitur nga

⁹⁴ Ligji nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, Neni 3, pika 12 - “Urdhri për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme” është urdhri i arsyetuar dhe i lëshuar sipas parashikimeve të nenit 13/1, të këtij ligji, që përmban masat e menjëhershme për ndalimin e dhunës, që merren nga organet përgjegjëse për trajtimin e rasteve të dhunës në familje pranë Policisë së Shtetit, deri në marrjen e vendimit nga gjykata.

policia/prokuroria, tërheqja e viktimës nga procesi nuk sjell si pasojë mosgjykimin e çështjes së filluar.

b. Për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes⁹⁵, gjykata vendos në lidhje me kërkesën për mbrojtje të menjëhershme të një të mituri brenda 24 orëve pas parashtrimit të kërkesës, ndërsa për subjekte të tjera të dhunës në marrëdhëniet familjare, brenda 48 orëve (neni 18). Vendimi përfundimtar i gjykatës për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, duhet të përmbajë ndër të tjera edhe kohëzgjatjen e masës, e cila mbaron në momentin që fillon të zbatohet urdhri i mbrojtjes i vendosur nga gjykata, si dhe datën e dëgjimit për vërtetimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, brenda 20 ditëve prej lëshimit të tij me vendim gjykate.

Gjykata, brenda 24 orëve pas lëshimit të vendimit, u dërgon nga një kopje: a) viktimës dhe personave të tjerë të shënuar në vendim; b) kërkuësve; c) zyrës së shërbimeve sociale të njërive vendore, ku janë me banim të përhershëm apo të përkohshëm viktimat dhe personat e tjerë të përmendur në vendim; ç) komisarit të policisë në rajonin ku janë me banim të përhershëm apo të përkohshëm viktimat dhe personat e tjerë të përmendur në vendim; d) zyrave përbarimorë të vendit të ekzekutimit. Vendimi i gjykatës për nxjerrjen e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes përbën titull ekzekutiv dhe nuk mund të ankimohej. Vendimi ekzekutohet menjëherë nga organet e policisë, në bashkëpunim me shërbimin përbarimor gjyqësor dhe zyrën e shërbimeve sociale të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

c. Për vërtetimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, gjykata kryen seancën jo më vonë se 20 ditë, nga dita e lëshimit të urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, duke vendosur sipas rastit:

- i) anulimin, si dhe ndërprerjen e efekteve të urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, të lëshuar më parë me vendim gjykate, kur ky i fundit nuk arrin të provohet;
- ii) refuzimin e lëshimit të urdhrit të mbrojtjes, kur nuk arrin të provohet urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes, i lëshuar më parë me vendim gjykate;
- iii) lëshon urdhrin e mbrojtjes i cili mund t'i ndryshojë kushtet e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes të lëshuar më parë me vendim gjykate.

ç) Për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes⁹⁶, gjykata vendos brenda 15 ditëve nga dita e regjistrimit të kërkesës (neni 16). Kërkesën për urdhër mbrojtjeje të një të mituri mund ta paraqesin: a) prindi ose kujdestari i të miturit; b) përfaqësuesi ligjor ose avokati i viktimës; c) të afërmit; ç) përfaqësuesit e zyrës së shërbimeve sociale pranë bashkisë ku ka banimin viktimat, që kanë dijeni për ushtrimin e dhunës; d) qendrat dhe shërbimet për mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje, të njohura/licencuara nga ministria përgjegjëse. dh) policia/prokuroria; e) personat ligjërisht përgjegjës për fëmijët. Në vendimin e gjykatës përcaktohet në cdo rast

⁹⁵ Ligji nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, Neni 3, pika 11 - “Urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje” është urdhri i lëshuar përkohësisht me vendim gjykate, i vlefshëm deri në lëshimin e urdhrit të mbrojtjes me vendim gjykate.”

⁹⁶ Ligji nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, Neni 3, pika 10 - “Urdhër mbrojtjeje” është urdhri i lëshuar me vendim gjykate, ku parashikohen masat mbrojtëse për viktimën, fëmijët dhe sipas rastit, masa për rehabilitimin e dhunuesit.

kohëzgjatja e masës, e cila nuk mund të jetë më e gjatë se 12 muaj, por me të drejtë shtyrjeje. Gjykata, brenda 24 orëve pas lëshimit të urdhrin të mbrojtjes, u dërgon nga një kopje: a) viktimës dhe personave të tjerë të shënuar në vendim; b) prokurorit, nëse ka bërë kërkesë; c) zyrës së shërbimeve sociale të njësisë vendore, ku janë me banim viktimat dhe personat e tjerë të përmendur në vendim; ç) komisarit të policisë në rajonin ku janë me banim viktimat dhe personat e tjerë të përmendur në vendim. Vendimi për urdhrin e mbrojtjes dhe urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes regjistrohet në një regjistër të veçantë, i cili administrohet pranë çdo gjykate sipas modelit, rregullave dhe procedurave që miratohen me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor (neni 17).

Kundër vendimit të gjykatës për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes, vërtetimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes, si dhe moslëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes, mund të bëhet ankim brenda 5 ditëve nga e nesërmeja e njoftimit të vendimit të arsyetuar. Kundër vendimit të gjykatës që ka lëshuar urdhrin e mbrojtjes nuk lejohet ankim nga viktimat, përveç rastit kur viktimat pretendon se masat e vendosura nuk garantojnë mbrojtje. Paraqitja e ankimit nuk e pezullon ekzekutimin e vendimit të gjykatës për lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes ose të urdhrin të mbrojtjes (neni 21).

Gjykata e apelit ka detyrimin që të shprehet me vendim brenda 15 ditëve nga dita e regjistrimit të ankimit. Kundër vendimit të gjykatës së apelit nuk lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë.

Me ndryshimet ligjore të vitit 2020, në masat e mbrojtjes⁹⁷ të dhunës në familje që mund të marrë gjykata, si masë e menjëhershme e mbrojtjes është parashikuar largimi i dhunuesit nga banesa për një afat kohor të caktuar, kur viktimat dhe dhunuesi banojnë në të njëjtën strehë. Gjykata, në vendosjen e kësaj mase merr në konsideratë nevojat e veçanta të dhunuesit të mitur dhe urdhri i largimit nga banesa vendoset vetëm kur asnjë masë tjetër nuk garanton mbrojtjen e viktimës nga dhuna.

Në urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes, të lëshuar me vendim gjykate, përveç masës së mbrojtjes së largimit të dhunuesit nga banesa për një afat kohor të caktuar, mund të vendoset dhe një ose disa nga masat e tjera të parashikuara në nenin 10 të këtij ligji. Gjykata, kryesisht, në urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes ose/dhe në urdhrin e mbrojtjes, mund të parashikojë masa mbrojtëse për fëmijët që kanë pësuar dhunë ose kanë qenë të pranishëm kur është ushtruar dhunë në familje. Gjykata, sipas vlerësimit të saj, mund të zbatojë edhe masa mbrojtëse e procedura të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, derisa nuk cenohen afatet e procesit gjyqësor të parashikuara nga ky ligj.

Vendimi për zgjidhjen e martesës, i shpallur nga gjykata gjatë kohës së zbatimit të UMM/UM-së për pasojat e njëkohshme, fillon të zbatohet nga dita e përfundimit të UMM/UM-së. Në rast se

⁹⁷ Ligji nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, Neni 10

gjkata ka vendosur detyrime të ndryshme ushqimore për fëmijët në këto vendime, zbatohet vendimi më i favorshëm për fëmijët.

Ministria përgjegjëse për drejtësinë bashkëpunon me Këshillin e Lartë Gjyqësor, për përcaktimin e rregullave për krijimin e një baze të dhënash të posaçme për çështjet e dhunës në familje në gjykata dhe siguron unifikimin e regjistrimit të këtyre çështjeve (neni 7, pika 3/ç).

6) Ligji nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”

Aksesi në drejtësi përfshin ndër të tjera edhe të drejtën që kanë individët për t’iu drejtuar gjykatave edhe nëse nuk kanë mundësi ekonomike, kohëzgjatjen e arsyeshme të proceseve gjyqësore si dhe të ekzekutimit të vendimeve të formës së prerë. E drejta për t’iu drejtuar gjykatave në rastin kur individët nuk kanë mundësi ekonomike, është thelbësore për të garantuar barazinë dhe gëzimin e të drejtave sidomos për grupet vulnerabël. Në shumë raste, individët nuk u drejtohen gjykatave për shkak të pamundësisë ekonomike, duke mos pasur mundësi për të përfituar nga të drejtat e tyre të garantuara nga ligji ose duke mos rivendosur në vend të drejtat e shkelura.

Ligji nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” solli ndryshime në administrimin e skemës së ndihmës juridike, duke përfshirë edhe gjykatat si institucione përgjegjëse në proces, së bashku me Ministrin e Drejtësisë, Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas dhe Dhomën Kombëtare të Avokatisë (neni 6). Kategoria e subjekteve të cilët përfitojnë ndihmë juridike të garantuar nga shteti u zgjerua, duke parashikuar si përfitues edhe disa kategori të veçanta (pavarësisht të ardhurave dhe pasurisë së tyre) si: viktimat e dhunës në familje; viktimat e abuzuara seksualisht dhe viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore; viktimat e mitur dhe të miturit në konflikt me ligjin; fëmijët, të cilët jetojnë në institucionet e përkujdesjes shoqërore; fëmijët nën kujdestari, të cilët kërkojnë të nisin një proces pa miratimin e kujdestarit të tyre ligjor ose kundër kujdestarit të tyre ligjor; personat, të cilëve u është cenuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim, bazuar në vendimin e organit kompetent, etj, (neni 11).

Ndihma juridike jepet në format e: a) ndihmës juridike parësore; b) ndihmës juridike dytësore; c) përjashtimit nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore, si dhe përjashtimit nga detyrimi për të parapaguar tarifën e vënies në ekzekutim të urdhrit të ekzekutimit (neni 5). Konceptet e ndihmës juridike parësore dhe dytësore si dhe diferencimi i procedurave për secilën u saktësuan me ligjin e ri, e më konkretisht si vijon:

a. Ndihma juridike parësore ofrohet nëpërmjet dhënies së informacionit mbi sistemin ligjor dhe aktet ligjore e nënligjore në fuqi, të drejtat e detyrimet e subjekteve të ligjit, metodat për ushtrimin e të drejtave në procesin gjyqësor e jashtëgjyqësor; dhënies së këshillimit duke përfshirë edhe mbi procedurat e ndërmjetësimit dhe zgjidhjes me marrëveshje; dhënies së ndihmës në hartimin dhe përpilimin e dokumenteve të nevojshme për të vënë në lëvizje administratën shtetërore ose për të kërkuar ndihmë juridike dytësore; përfaqësimit përpara organeve administrative, si dhe dhënies së

mbështetjes së nevojshme juridike që nuk përbën ndihmë juridike dytësore (neni 3, gërma “b”). Procedurat për ndihmën juridike parësore (neni 13 e në vijim) janë thjeshtuar dhe njihen me ligj si ofrues të saj: punonjësit me trajnim të posaçëm, organizatat jofitimprurëse të autorizuar dhe klinikat ligjore pranë institucioneve të arsimit të lartë. Në ligj janë vendosur rregullat bazë të ofrimit të ndihmës juridike parësore, procedurat dhe kriteret që duhet të përmbushë secili prej ofruesve, etj. Me ndryshimin e kuadrit ligjor për ndihmën juridike të garantuar nga shteti, OJF-të njihen si një nga ofruesit e mundshëm të ndihmës juridike parësore. Për të rregulluar raportin e OJF-ve me Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas dhe veprimtarinë e tyre në këtë fushë, janë miratuar edhe aktet nënligjore⁹⁸ në zbatim të ligjit.

Administrimi i qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore (neni 8, gërma “gj”), në ambientet e gjykatave të rretheve gjyqësore ose në ambiente të tjera të përshtatshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi për administratën shtetërore, është parashikuar si kompetencë e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas.

b. Ndhma juridike dytësore ofrohet nga avokatët që përfshihen në listën e miratuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë, në bazë të kërkesës së personit që gëzon të drejtën për përfitimin e ndihmës juridike dytësore sipas ligjit (neni 18). Kërkesa për dhënie të ndihmës juridike dytësore mund të paraqitet përpara fillimit të një procesi gjyqësor, në fillim të një procesi gjyqësor dhe/ose në çdo fazë të procesit gjyqësor, derisa nuk është deklaruar i mbyllur hetimi gjyqësor, nga personi që gëzon të drejtën për ndihmë juridike dytësore, nëpërmjet një përfaqësuesi ligjor apo të pajisur me prokurë, ose nëpërmjet bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/es ose një të afërmi të shkallës së parë. Kjo kërkesë përjashtohet nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore (neni 19). Gjykata kompetente për shqyrtimin e çështjes në themel ka njëkohësisht kompetencën për të dhënë një vendimin të arsyetuar, për të pranuar ose rrëzuar kërkesën për ndihmë juridike dytësore. Vendimi në lidhje me kërkesën për ndihmë juridike dytësore merret nga gjykata: a) brenda 5 ditëve kur kërkesa paraqitet përpara fillimit të procesit; b) në seancën përgatitore përpara se të caktohet seanca gjyqësore, kur kërkesa është paraqitur bashkë me kërkesë-padinë; c) sipas parashikimeve të legjislacionit procedural dhe dispozitave të këtij ligji, kur kërkesa paraqitet gjatë shqyrtimit gjyqësor. Kundër vendimit të gjykatës për rrëzimin e kërkesës për ndihmën juridike dytësore mund të bëhet ankim i veçantë në Gjykatën e Apelit, ankim i cili nuk pengon vazhdimin e shqyrtimit të çështjes. Gjykata e apelit shqyrton çështjen në dhomë këshillimi dhe merr vendim brenda 15 ditëve nga regjistrimi i saj, ndaj të cilit nuk lejohet rekurs në Gjykatë të Lartë. Vendimi i gjykatës mbi kërkesën për ndihmë juridike dytësore i njoftohet menjëherë: a) kërkuarit; b) personit që ka dorëzuar kërkesën për ndihmë juridike dytësore, në rast se është një person i ndryshëm nga kërkuari; c) organit procedues; ç) Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas; d) dhomës vendore të avokatisë, në rast se kërkesa për ndihmë juridike dytësore është miratuar (neni 23).

⁹⁸ VKM nr.110, datë 6.3.2019 “Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuar për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre”; VKM nr.55, datë 6.2.2019 “Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit për autorizimin e organizatave jofitimprurëse, që ofrojnë ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti”.

c. Përrjashtimi nga pagimi i tarifave gjyqësore, shpenzimeve gjyqësore dhe nga detyrimi për parapagim të tarifave të vënies në ekzekutim të urdhrin të ekzekutimit, për personat të cilët kanë të drejtën për ndihmë juridike dytësore, është një nga format e ndihmës juridike të parashikuar nga ligji, ku përfshihen: a) pagimi i tarifave të përgjithshme dhe të veçanta, sipas përcaktimeve të ligjit për tarifën gjyqësore në Republikën e Shqipërisë; b) pagimi i shpenzimeve gjyqësore (shpenzimet për dëshmitarët, ekspertët, përkthyesit dhe për këqyrjen e sendeve ose këqyrjen në vend), sipas përcaktimeve të legjislacionit procedural; c) detyrimi për të parapaguar tarifën e vënies në ekzekutim të urdhrin të ekzekutimit pranë shërbimit përmbartimor gjyqësor shtetëror (neni 25). Kërkesa për përjashtim nga pagimi i tarifave dhe shpenzimeve gjyqësore mund të paraqitet: a) së bashku me kërkesën për ndihmë juridike dytësore; b) së bashkë me kërkesëpadinë; c) në çdo fazë të procesit, derisa nuk është deklaruar i mbyllur hetimi gjyqësor, për një, disa ose të gjitha tarifën dhe/ose shpenzimet, nga personi që e përfiton, nga një përfaqësues ligjor apo i pajisur me prokurë, ose nga bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja ose i afërm i shkallës së parë (neni 26). Gjykata kompetente për shqyrtimin e çështjes në themel ka njëkohësisht kompetencën për të dhënë një vendimin të arsyetuar, për të pranuar ose rrëzuar kërkesën për përjashtim nga pagimi i tarifave dhe shpenzimeve gjyqësore. Vendimi në lidhje me këtë kërkesë merret nga gjykata, për aq sa është e mundur, në të njëjtat afate si shqyrtimi i kërkesës për dhënien e ndihmës dytësore. Kundër vendimit të gjykatës për rrëzimin e kërkesës për ndihmën juridike dytësore mund të bëhet ankim i veçantë në Gjykatën e Apelit, ankim i cili nuk pengon vazhdimin e shqyrtimit të çështjes. Gjykata e apelit shqyrtton çështjen në dhomë këshillimi dhe merr vendim brenda 15 ditëve nga regjistrimi i saj, ndaj të cilit nuk lejohet rekurs në Gjykatë të Lartë. Vendimi i gjykatës për pranimin e kërkesës për përjashtim nga pagimi i tarifave dhe shpenzimeve gjyqësore, i njoftohet menjëherë Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas (neni 27). Ky vendim përbën titull ekzekutiv dhe përfituesit gëzojnë të drejtën për të mos parapaguar tarifën e vënies në ekzekutim të urdhrin të ekzekutimit pranë shërbimit përmbartimor gjyqësor shtetëror (nenet 28 dhe 29).

Një mbrojtje të veçantë gëzojnë të miturit, të cilët bëjnë pjesë në kategorinë e përfituesve të ndihmës juridike të garantuar nga shteti, pavarësisht situatës së tyre ekonomike. Në këtë aspekt, në vitin 2017, Kuvendi miratoi ligjin nr. 98/2017 “Për Tarifën Gjyqësore në Republikën e Shqipërisë”, sipas të cilit palët ndërgjyqëse mund të përjashtohen nga detyrimi për të paguar tarifë gjyqësore ose shpenzimet e tjera gjyqësore kur është bërë kërkesë prej tyre, sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për ndihmën juridike (neni 9). Këtu përfshihen: a) tarifa gjyqësore të përgjithshme, për paraqitjen e çështjeve në gjykata; b) tarifa gjyqësore të veçanta, për kryerjen e veprimeve procedurale në gjykata dhe shërbimet e administratës gjyqësore; dhe c) tarifa gjyqësore shtesë, në funksion të administrimit korrekt të procesit gjyqësor.

Megjithatë, ligji nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, përkatësisht neni 25 krijon një vakuim ligjor sa i përket mbulimit të shpenzimeve të ekspertëve gjatë fazës së ekzekutimit të vendimeve, për personat në pamjaftueshmëri financiare, të cilët përfitojnë nga

ndihma juridike dytësore falas. Tarifa e psikologut apo çdo eksperti tjetër gjatë fazës së ekzekutimit nuk përfshihet në skemën e ndihmës juridike dytësore falas, duke sjellë kështu vështirësi dhe vonesa gjatë ekzekutimit të titujve ekzekutiv. Në kuadrin e garantimit të procesit të rregullt ligjor, shërbimi përmbarrimor (shtetëror apo privat), ndjek veprimet procedurale për realizimin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, brenda afatit ligjor të arsyeshëm, me objekt “pension ushqimor”, “takim me fëmijë”, “kujdestari fëmije”, “urdhër i menjëhershëm i mbrojtjes” dhe “urdhër i mbrojtjes”, për garantimin jo vetëm të të drejtës së parashikuar në Konventën CEDAW⁹⁹ për barazi në martesë dhe në jetën familjare, por edhe të përmbushjes së misionit të përmbarrimit dhe realizimin e të drejtës së kreditorit. Ekzekutimi efektiv i titujve të ekzekutimit me objekt “takim me fëmijë” mbetet ende sfidues dhe paraqet problematika në praktikë, në rastet kur palët ndërgjyqëse mbulojnë nga ndihma juridike dytësore falas. Pavarësisht faktit se ligji përjashton personat e trajtuar me ndihmë juridike dytësore falas nga detyrimi për të parapaguar tarifën përmbarrimore, nuk shprehet për shpenzimet e tjera përmbarrimore. Në rastin e ekzekutimit të vendimeve me objekt takimin e fëmijëve të mitur nga prindi jo-kujdestar (pas divorcit bashkëshortor), neni 523 i K.Pr.C parashikon si kusht të detyrueshëm prezencën e një eksperti psikolog që asiston në këtë takim. Nga parashikimet e akteve ligjore dhe në praktikë evidentohet mungesa e përfshirjes së pagesës së psikologut në skemën e ndihmës juridike dytësore falas, e cila vështirëson ekzekutimin e titujve ekzekutivë, duke u bërë pengesë reale në cenimin e të drejtave të prindit jo-kujdestar dhe shkeljen e afateve procedurale gjatë ekzekutimit të vendimeve gjyqësore.¹⁰⁰

Sipas të dhënave të publikuara në vitin 2023 nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, në dokumentin e Raportit të Auditimit të Performancës të shërbimit përmbarrimor shtetëror për vitet 2019-2022, për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore rezultoi një numër i lartë çështjesh që prekin fëmijët dhe që për vitin 2022, rezultojnë:

- 9,455 çështje në total, nga të cilat:
 - o 8,176 çështje me objekt “pension ushqimor”,
 - o 1,279 çështje me objekt “takim me fëmijë” dhe
 - o 14 çështje me objekt “kujdestari fëmije”.
- 8,117 çështje “pension ushqimor” që janë në ekzekutim të vazhdueshëm, nga të cilat:
 - o në 2,740 çështje nuk shlyhet detyrimi për pamundësi paguese nga ana e debitorit dhe veprimet procedurale përsëriten në mënyrë të vazhdueshme për verifikim të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme të tij me qëllim ekzekutimin e detyrimit,
 - o në 1,345 çështje detyrimi shlyhet pjesërisht dhe jo i plotë, gjithashtu për paaftësi paguese.

⁹⁹ Konventa e Këshillit të Europës “Për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje” - Stamboll, 11.5.2011.

¹⁰⁰ Bazuar në Raport Auditimi Performance i Kontrollit të Lartë të Shtetit , v.2023, me objekt “Shërbimi përmbarrimor shtetëror në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore” , për vitet 2019 – 2022.

Nga ana tjetër, për vënien në ekzekutim të një titulli ekzekutiv të njohur si të tillë nga juridiksioni gjyqësor shqiptar, përmbarimi shtetëror nuk ka tagrin ligjor¹⁰¹ të ndjekë procedurat e ekzekutimit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Në këtë rast, kërkesa mund të bëhet nëpërmjet autoritetit qendror të shtetit kontraktues në të cilin banon kërkuesi/përfituesi, për autoritetin qendror të shtetit ku ndodhet debitori kundër të cilit ka një vendim për detyrim ushqimor. Pra, referuar detyrimeve të mësipërme, në funksion të mbrojtjes së interesit të fëmijës, i cili përbën edhe një interes publik, autoritetet shtetërore duhet të bashkëpunojnë me autoritetet e huaja për të zgjidhur çështje që kanë të bëjnë me interesat e fëmijëve. Në këtë kuadër, roli i Ministrisë së Drejtësisë, si autoritet shtetëror kompetent, që transmeton kërkesat për njohje dhe ekzekutim vendimi jashtë territorit shqiptar, është i rëndësishëm si për fillimin e procedurave përkatëse apo lehtësimin e tyre, ashtu edhe për marrjen e masave të duhura për ofrimin e ndihmës ligjore.¹⁰²

Implementimi i duhur i Protokollit të ratifikuar për zbatimin e detyrimit ushqimor (i cili ka zëvendësuar Konventën nr.24, prej datës 02.05.2024 të ratifikimit të Protokollit), ndihmon në ekzekutimin e vendimeve të mbartura, të cilat pengohen për shkak të emigrimit të debitorëve jashtë vendit. Për sa më sipër, përmbaruesit duhet ta kthejnë në praktikë të zakonshme pune referimin e rasteve të tilla pranë Ministrisë së Drejtësisë, pa qenë e nevojshme që përfituesi/ kreditori të hartojë një kërkesë të re për këtë. Një praktikë e tillë rrit eficiencën e ekzekutimit të vendimeve, duke ofruar shërbim në formën e një ‘one-stop shop’¹⁰³.

Vendimmarrja për ndihmë juridike dytësore dhe përjashtimi nga tarifatat gjyqësore janë kompetencë e gjykatave në të gjithë Shqipërinë, dhe nga momenti i hyrjes në fuqi të ligjit nr.111/2017 ato kanë detyrimin ligjor të njoftojnë Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas për vendimet e dhëna.

Ndryshimet ligjore çuan në një rritje të ndjeshme të numrit të rasteve të dhëna me ndihmë juridike, nga 270 raste në vitin 2019, në 8153 raste në vitin 2021, dhe 7946 raste në vitin 2023. Numri i rasteve për 100.000 banorë (314) u bë më i lartë se mesatarja në Ballkanin Perëndimor (285)¹⁰⁴.

Të miturit që kanë përfituar ndihmë juridike falas, kanë qenë pjesë e një prej kategorive a) viktimë e mitur dhe të mitur në konflikt me ligjin, në çdo fazë të procedimit penal; b) fëmijë, i cili jeton në institucionet e përkujdesjes shoqërore; c) fëmijë nën kujdestari, i cili kërkon të nisë një proces.

¹⁰¹ Bazuar në Titullin IV të Kodit të Procedurës Civile dhe ligjin nr.8730 datë 18.01.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor”.

¹⁰² Bazuar në Raport Auditimi Performance i Kontrollit të Lartë të Shtetit , v.2023, me objekt “Shërbimi përmbarimor shtetëror në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore” , për vitet 2019 – 2022.

¹⁰³ Bazuar në Raport Auditimi Performance i Kontrollit të Lartë të Shtetit , v.2023, me objekt “Shërbimi përmbarimor shtetëror në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore” , për vitet 2019 – 2022.

¹⁰⁴ European Commission for the Efficiency of Justice (CEPEJ) HFII: Towards a better evaluation of the results of judicial reform efforts in the Western Balkans “DASHBOARD Western Balkans” Data collection: 2021 - Report prepared by the CEPEJ for the attention of the European Commission, <https://rm.coe.int/albania>

7) Ligji nr. 10385, datë 24.2.2011 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”¹⁰⁵

Ndërmjetësimi është veprimtari jashtëgjqësore, në të cilën palët kërkojnë zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje me anë të një personi të tretë asnjanes (ndërmjetësit), për të arritur një zgjidhje të pranueshme të mosmarrëveshjes dhe që nuk bie në kundërshtim me ligjin. Ndërmjetësimi për zgjidhjen me pajtim të mosmarrëveshjeve është veprimtari e pavarur, që ushtrohet në përputhje me këtë ligj dhe nën monitorimin dhe mbikëqyrjen e Ministrisë së Drejtësisë (neni 1).

Dokumenti i Analizës së Sistemit të Drejtësisë evidentoi se ligji për ndërmjetësimin dhe zbatimin i tij nuk kishte qenë shumë i suksesshëm, për shkak të mungesës së harmonizimit me pjesën tjetër të legjislacionit. Ndërmjetësimi ishte aplikuar në mënyrë të kufizuar dhe impakti i ndërmjetësve nuk kishte pasur efektin e duhur, ndërsa gjykatat nuk kishin qenë aktive në thirrjen e ndërmjetësve. Në dokumentin e Strategjisë së Reformës në Drejtësi u parashikua si objektiv rritja e përdorimit dhe nivelit të shërbimit të ndërmjetësimin, profesionalizmit, përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies së ndërmjetësve, duke e harmonizuar atë me kodet e procedurave dhe ligjet e tjera, duke forcuar kualifikimin e tyre me anë të trajnimeve më të mira fillestare dhe vazhduese, si dhe promovimi i standardeve të etikës dhe sjelljeve antikorrutive, fuqizimin e profesionit të ndërmjetësit duke rritur kapacitetet e dhomës, përmirësimin e bashkëpunimit me institucionet e tjera, etj. Në Planin e Veprimit të Reformës në Drejtësi u parashikua të bëhen ndërhyrjet e nevojshme ligjore në këtë ligj, të fokusuara kryesisht në modernizimin e statusit të ndërmjetësve, duke forcuar dhe konsoliduar njëkohësisht standardet etike si dhe kompetencat e një Komiteti Disiplinor, i cili mund të aplikojë masa disiplinore.¹⁰⁶

Në kuadër të reformës në drejtësi, me ndryshimet e bëra me ligjin nr.26/2018, datë 17.05.2018, ndër të tjera u synua rritja e efikasitetit të institucionit të ndërmjetësit, duke ftuar gjykatat që të ingranojnë sa më shumë ndërmjetës në zgjidhjen e çështjeve, me qëllim uljen e volumit të punës sidomos në çështje familjare.

Në ligjin në fuqi për ndërmjetësimin janë parashikuar procedura që kanë të bëjnë me rolin e gjykatës në dërgimin e çështjeve për zgjidhje me marrëveshje, qysh në fazën përgatitore të procesve civile, ku gjyqtari fton palët për zgjidhje me pajtim të konfliktit. Në këtë aspekt, ligji nuk bie ndesh me dispozitat e K.Pr.C që rregullojnë hapat e procesit civil.

Ndërmjetësimi, zbatohet ndër të tjera edhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në fushën e të drejtës civile dhe familjare, në çdo kohë që palët në konflikt, me vullnetin e tyre të lirë kërkojnë dhe pranojnë ndërmjetësimin si alternativë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, pavarësisht nëse mosmarrëveshja është paraqitur përpara gjykatës për zgjidhjen e saj. Ndërmjetësimi zbatohet edhe në ato raste kur gjykata, pas vënies në lëvizje për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, njofton dhe

¹⁰⁵ Ligji nr. 10385, datë 24.2.2011 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”, ndryshuar me ligjin nr. 81/2013, datë 14.2.2013, nr. 26/2018, datë 17.5.2018.

¹⁰⁶ Relacioni i projekt-ligjit nr.26/2018

udhëzon palët drejt ndërmjetësimit. Gjykata, detyrimisht njofton, udhëzon dhe, sipas rastit, informon në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme palët për zgjidhjen me ndërmjetësim, veçanërisht, por pa u kufizuar vetëm në to, të mosmarrëveshjeve: a) Në çështjet civile dhe familjare, kur ndërthuren interesat e të miturve; b) Në çështjet e pajtimit në rastet e zgjidhjes së martesës, të parashikuar nga neni 134 i Kodit të Familjes; c) Me karakter pasuror, që lidhen me të drejtat e pronësisë ose të bashkëpronësisë, pjesëtimin e pasurisë, etj. (neni 2).

Gjykata, në përputhje me dispozitat e K.Pr.C, njofton dhe udhëzon palët për zgjidhjen me ndërmjetësim të mosmarrëveshjes objekt gjykimi, dhe kur palët bien dakord pezullon gjykimin duke u caktuar palëve një afat në përputhje me natyrën e mosmarrëveshjes, por jo më shumë se 30 ditë. Secila nga palët ka të drejtë të kërkojë në çdo kohë rifillimin e gjykimit (neni 13).

Kur çështja është referuar për ndërmjetësim nga gjykata, ndërmjetësi, në përfundim të procedurës së ndërmjetësimit, ose në afatin e përcaktuar në këtë ligj, i njofton ato për zgjidhjen ose jo të mosmarrëveshjes, duke dërguar edhe aktet përkatëse. Në rastin kur është zgjidhur çështja me anë të ndërmjetësimit, organet gjyqësore vendosin, sipas rastit, miratimin e zgjidhjes me pajtim të çështjes civile, përveç rasteve kur arrihet në përfundimin se vërehet pavlefshmëri. Nëse aktmarrëveshja respekton kushtet e përcaktuara në këtë ligj, përbën titull ekzekutiv dhe, në këtë rast, ngarkohet shërbimi përmbartimor për ekzekutimin e tij.

Ndër risitë kryesore që sollën ndryshimet ligjore të vitit 2018, për efekt të kësaj analize mund të përmendim:

- Specializimin e ndërmjetësve në fushën e drejtësisë për të mitur¹⁰⁷;
- Zgjerimin e rrethit të konflikteve që mund të zgjidhen me ndërmjetësim.

8) Ligji nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”

Ligji për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror ka përkufizuar “fëmijë në nevojë për mbrojtje të veçantë” individin deri në moshën 18 vjeç, i cili mund të jetë viktimë e abuzimit, neglizhencës, shfrytëzimit, trafikimit, diskriminimit, dhunës, braktisjes apo i një veprimtarie kriminale, si dhe individi nën 18 vjeç, i cili ka kryer ose akuzohet se ka kryer një vepër penale (neni 3). Në nenin 8 të ligjit përfshihen kriteret për përfitimin e disa prej shërbimeve si strehimi në strehezë përfshijnë edhe rastet e fëmijëve që gjenden pa pambikëqyrje nga prindërit, në rrezik, apo në situatë rruge dhe fëmijët në nevojë të mbrojtjes së veçantë. Ky ligj referon në masa përkujdesjeje alternative për fëmijën e privuar në mënyrë të përkohshme/të përhershme nga mjedisi familjar ose kur nuk është në interesin më të lartë të tij të qëndrojë në këtë mjedis, të tilla si a) vendosja në një familje alternative ose në një institucion të përkujdesjes për fëmijë; b) vendosja në një familje birësuese. Në rastin e fëmijës të vlerësuar në situatë emergjente, ligji ngarkon strehën e përkohshme ku është

¹⁰⁷ Ligji nr. 10385, datë 24.2.2011 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve” Neni 50, pika 3 – “Ndërmjetësit për çështjet ku përfshihen interesat e të miturve duhet të kenë kualifikimin dhe specializimin e duhur në këto fusha dhe mundësisht të jenë të diplomuar si psikologë, juristë apo punonjës socialë.”

strehuar fëmija me detyrën e paraqitjes së kërkesës për urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje në gjykatën kompetente për të legjitimuar qëndrimin e tij në qendrat e kujdesit shoqëror (neni 19).

9) Ligji nr.9695, datë 19.3.2007 “Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit¹⁰⁸”

Ligji nr.9695, datë 19.3. “Për procedurat e birësimit dhe komitetin shqiptar të birësimit”, i ndryshuar, përcakton procedurat e birësimit, si dhe organizimin, funksionimin e detyrat e Komitetit Shqiptar të Birësimit. Qëllimi i ligjit është a) mbrojtja e fëmijës, nëpërmjet vendosjes së përhershme në një familje birësuese; b) marrja e masave, që birësimet, vendase dhe ndërvendase, të bëhen në interesin më të lartë të fëmijës, i cili është mbizotërues ndaj çdo interesi tjetër; c) krijimin e një sistemi bashkëpunimi, brenda dhe jashtë vendit, për marrjen dhe respektimin e masave mbrojtëse, që parandalojnë dështimin e birësimit, rrëmbimin, shitjen ose trafikimin e fëmijëve; ç) sigurimin e bashkëpunimit me autoritetet vendore, autoritetet qendrore të vendeve të tjera apo organizatave të miratuara prej tyre, për mbarëvajtjen e periudhës pasbirësuese.

Ligji parashikon në nenin 20 regjistrimin në listat e Komitetit Shqiptar të Birësimit të fëmijëve shqiptarë, për të cilët: a) është deklaruar braktisja me një vendim gjyqësor të formës së prerë; b) është dhënë pëlqimi nga prindërit biologjikë; c) është dhënë pëlqimi nga gjykata për fëmijët që ndodhen në përkujdesje, sipas paragrafit të tretë të nenit 246 të Kodit të Familjes. Hiqen nga listat e Komitetit dhe nuk mund të birësohen fëmijët kur: a) është tërhequr pëlqimi i prindërve biologjikë për birësim, sipas Kodit të Familjes; b) është vendosur nga gjykata, që fëmija të qëndrojë pranë prindërve biologjikë, me ndërhyrjen në proces të prindërve, nisur nga interesi më i lartë i fëmijës; c) janë bërë madhorë; ç) fëmija vdes; d) fëmija mbi 12 vjeç kundërshton birësimin (neni 21).

Birësimi i shpallur në një vend të huaj, me kërkesën e shtetasve shqiptarë, prodhon pasoja juridike në Republikën e Shqipërisë nëse gjykata, në bazë të vërtetimit të lëshuar nga Komiteti, vëren se janë zbatuar kriteret e parashikuara në nenin 4 të Konventës së Hagës dhe parimet e legjislacionit shqiptar në fuqi (neni 31).

Në lidhje me procedurat e birësimit, në ligj janë përcaktuar afate për ndjekjen e procedurave nga ana e Komitetit Shqiptar të Birësimit, detyrimi i përgatitjes së raportit për përshtatshmërinë e aplikantëve birësues me fëmijën, si dhe dokumentat e tjerë të dosjes që i dërgohet gjykatës për vendimmarrje, por nuk janë përcaktuar afate konkrete më të shkurtra se ato që përcakton K.Pr.C për shqyrtimin e kësaj kategorie çështjesh nga ana e gjykatës, në funksion të garantimit të interesit më të mirë të fëmijës.

¹⁰⁸ Ligji nr.9695, datë 19.3.2007 “Për procedurat e birësimit dhe komitetin shqiptar të birësimit”, ndryshuar me ligjin nr. 10 358, datë 16.12.2010 dhe nr. 132/2015, datë 5.12.2015

10) Ligj nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë¹⁰⁹”

Ky ligj rregullon organizimin dhe funksionimin e sistemit të gjykatave në Republikën e Shqipërisë si dhe parashikon rregulla në lidhje me çështjet të tilla si: përcaktimi i kompetencës tokësore, madhësisë, organizimi i brendshëm dhe caktimi i seksioneve në gjykata, harta e gjykatave, etj. Në ndryshim nga sistemi i mëparshëm, ky ligj parashikon një sistem të konsoliduar nën kompetencën e Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ) për të rregulluar, zbatuar dhe mbikëqyrur në praktikë organizimin dhe funksionimin e punës në gjykata, duke zvogëluar rolin e Ministrisë së Drejtësisë në rol konsultativ dhe duke forcuar kompetencat e KLGJ, sipas rekomandimeve ndërkombëtare (*Projekti i KiE/BE “Mbështetje e BE/KiE-së për Eficiencën e Drejtësisë – MED”*) për forcimin e rolit të KLGJ-së në administrimin gjyqësor.¹¹⁰

Përsa i përket aksesit në gjykata, ligji ka parashikuar se çdo person trajtohet në mënyrë të barabartë dhe pa asnjë diskriminim nga gjykatat, ka akses të barabartë në gjykatë, si dhe ka të drejtë t’i drejtohet gjykatës për mbrojtjen dhe zbatimin e të drejtave të tij ligjore. Gjykatat funksionojnë në mënyrë transparente, të shpejtë dhe efikase¹¹¹. Për të garantuar që pushteti gjyqësor të jetë i pavarur, efikas, i besueshëm dhe transparent, në kuadër edhe të administrimit gjyqësor, KLGJ, Këshillat e Gjykatave, kryetarët e gjykatave, kancelarët, kategoritë e ndryshme të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe çdo institucion tjetër i përcaktuar me ligj, kanë detyrimin të bashkëpunojnë. Nga ana tjetër, edhe veprimtaria e shërbimit civil gjyqësor bazohet ndër të tjera mbi parimin e orientimit drejt shërbimeve eficiente dhe të aksesueshme për çdo person¹¹².

Pushteti gjyqësor në vendin tonë ushtrohet nga Gjykata e Lartë, si dhe nga gjykatat e apelit dhe gjykatat e shkallës së parë, të cilat krijohen me ligj. Gjykatat me juridiksion të përgjithshëm janë gjykata me juridiksion të përgjithshëm të shkallës së parë dhe gjykata me juridiksion të përgjithshëm të apelit. Gjykatat me juridiksion të përgjithshëm të shkallës së parë mund të kenë degë. Gjykata të posaçme janë: a) gjykatat administrative të shkallës së parë dhe Gjykata Administrative e Apelit; b) Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë dhe e Apelit për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Ligji solli një qasje të dyfishtë përsa i përket hartës së re gjyqësore, duke përcaktuar: a) hartën gjyqësore vetëm për gjykatat e nivelit më të lartë, gjykatat e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe gjykatën administrative të apelit; b) për të gjitha gjykatat e tjera vetëm objektivat, kriteret dhe procedurën për përcaktimin e hartës gjyqësore. Më konkretisht:

¹⁰⁹ Ligj nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” ndryshuar me ligjin nr. 46/2021, datë 23.3.2021

¹¹⁰ Relacion shpjegues i përmbajtjes së ligjit “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” (datë 21.06.2016) - <https://www.reformanedrejttesi.al>

¹¹¹ Ligj nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” Neni 5

¹¹² Ligj nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” Nenet 7 dhe 8

1. Në lidhje me kompetencën tokësore të gjykatave, në nenet 10 deri 12 të ligjit janë përcaktuar qartë kompetenca tokësore e Gjykatës së Lartë dhe gjykatave të posaçme (Gjykatat e Posaçme të Shkallës së Parë dhe të Apelit për Gjykimin e Veprave Penale të Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar; Gjykatën Administrative të Apelit), të cilat organizohen dhe funksionojnë për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe me seli në Tiranë.

Për gjykatat e tjera¹¹³, ligji nuk e përcaktoi kompetencën tokësore, por parashikoi krijimin e hartës së gjykatave të shkallëve të para dhe të apeleve të jurisdiksionit të përgjithshëm, të krijuara mbi bazën e rretheve gjyqësore, si dhe procesin për caktimin ose caktimin rishtas të rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave, duke ngarkuar autoritetet përgjegjëse që të vlerësojnë çdo pesë vjet faktorët kryesorë dhe të zhvillojnë një hartë gjyqësore. Ligji i jep Këshillit të Lartë Gjyqësor kompetencën për të kryer vlerësimet e rregullta dhe për të përgatitur propozimin për rishikimin e hartës gjyqësore, pas marrjes së mendimit të Ministrit të Drejtësisë, Prokurorit të Përgjithshëm, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Ministrit të Financave dhe këshillimit me aktorë të tjerë. Kjo është në përputhje me një opinion të Komisionit të Venecias, CDL-AD (2013) 034, i cili thotë se "*organi më kompetent për hartimin dhe ndryshimin e rrjetit të gjykatës është Këshilli i Lartë Gjyqësor. [...] iniciativa për vendime të tilla duhet të vijë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor sesa nga Presidenti*".¹¹⁴

Një risi që solli ligji ishte edhe krijimi i gjykatave të përqëndruara. Ligji përcaktoi në nenet 14 dhe 15, objektivat për caktimin e kompetencave tokësore për gjykatat e tjera, si: garantimin e aksesit në drejtësi, uljen e kostove, rritjen e cilësisë dhe përshtatshmërisë së shërbimit gjyqësor. Parimet e kriteret për caktimin e kompetencave sipas rretheve gjyqësore, duhet të bazohen në: a) ndarjen administrative territoriale e vendit, zhvillimin demografik, numrin e banorëve në raport me numrin e gjykatave, zhvillimin ekonomik, infrastrukturën rrugore dhe kushtet e transportit për në gjykata dhe midis gjykatave, si dhe karakteristikat gjeografike; b) ngarkesën në gjykata, në lidhje me çështjet e ardhura, të përfunduara dhe në shqyrtim, eficientë e gjykatave dhe gjyqtarëve në dhënien e drejtësisë, burimet njerëzore në dispozicion, vendndodhjen dhe përmasat e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale.

2. Në lidhje me madhësinë e gjykatave, ligji solli risi përse i përket rritjes së numrit minimal të gjyqtarëve në përbërjen e një gjykate, që duhet respektuar në rast krijimi ose riorganizimi të saj. Me qëllim rritjen e eficientë dhe për të siguruar specializimin në gjykata, numri minimal i gjyqtarëve¹¹⁵ është përcaktuar të jetë të paktën:

- a) 7 gjyqtarë në gjykatën e shkallës së parë me jurisdiksion të përgjithshëm dhe administrativ,
- b) 10 gjyqtarë në gjykatën e apelit me jurisdiksion të përgjithshëm dhe administrativ,

¹¹³ Ligj nr.98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë" Neni 13

¹¹⁴ Relacion shpjegues i përmbajtjes së ligjit "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë" (datë 21 06 2016) - <https://www.reformanedrejttesi.al>

¹¹⁵ Ligj nr.98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", Neni 15, pika 4

Sipas ligjit, gjyqtarët dhe gjykatat në Shqipëri duhet të kenë një ngarkesë të ekuilibruar pune,¹¹⁶ si dhe objektivi është pasja e një numri minimal gjyqtarësh në çdo gjykatë, për të siguruar funksionimin e duhur dhe për të mundësuar gjykimin e çështjeve nga trupa gjykues.

Ky ndryshim është bazuar në standardet ndërkombëtare evropiane për të patur gjykata të përqëndruara me numër më të madh gjyqtarësh, për ta bërë sistemin gjyqësor sa më efektiv dhe eficient në krahasim me sistemin e mëparshëm. Sipas udhëzimit të CEPEJ-it, mbi krijimin e hartave gjyqësore në shtetet anëtare të BE-së (*CEPEJ (2013) 7, 2.3.2 Madhësia e gjykatave*) produktiviteti më i lartë në nivel evropian është arritur në gjykatat me një numër të përafërt gjyqtarësh ndërmjet 40 dhe 80. Raporti i CEPEJ-it “Për organizimin e gjykatave dhe kapacitetet e administratorëve të gjykatave në Shqipëri, 2016”, rekomandon për Shqipërinë një madhësi minimale të gjykatave nga 12 deri 14 gjyqtarë, për të mbështetur ndarjen efikase dhe të drejtë të çështjeve, përdorimin efikas të burimeve, cilësinë në drejtësi dhe të lejojë specializimin. Për të siguruar që harta gjyqësore *de facto* do të zvogëlojë numrin e gjykatave të vogla, ligji parashikon një numër minimal të gjyqtarëve për gjykatë dhe nga ky parashikim ligjor për rritjen e numrit të gjyqtarëve në gjykata, logjikisht do të zvogëlohej numri i gjykatave në 50%¹¹⁷.

3. Në lidhje me organizimin e brendshëm dhe të jashtëm të gjykatave¹¹⁸, me qëllim për të mundësuar specializimin, ligji ka parashikuar krahas trupave gjykuese edhe krijimin e seksioneve në gjykata, bazuar në kritere objektive, si numri i përgjithshëm i gjyqtarëve në gjykatë, lloji dhe numri i çështjeve në të paktën tri vitet e fundit në atë gjykatë. Seksionet e gjykatave duhet të kenë të paktën 6 (gjashtë) gjyqtarë dhe caktimi i tyre në seksione, bëhet mbi bazën e përvojës profesionale dhe fushës së tyre të interesit. Këshilli i Gjykatës, pas marrjes së mendimit të mbledhjes së përgjithshme të gjyqtarëve, mund të krijojë një ose më shumë seksione në gjykatë. Këshilli krijon trupat gjykues, më pas cakton gjyqtarët në seksione dhe trupa gjykues, me të drejtën për ta rishikuar këtë vendim të paktën çdo dy vjet dhe sa herë është e nevojshme, në rastet kur zëvendësohen gjyqtarët që nuk janë më në detyrë në atë gjykatë, kur caktohen gjyqtarët e rinj, të transferuar ose të ngritur në detyrë në gjykatë, në seksione dhe trupa gjykues. KLGJ ka detyrimin të miratojë rregulla të detajuara për kriteret dhe procedurën e krijimit të seksioneve, trupave gjykues dhe caktimin e gjyqtarëve në to.

Në lidhje me krijimin e seksioneve brenda gjykatave, me Udhëzimin Nr. 79, datë 30.05.2019 “*Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve të drejtësisë për të mitur*” të Këshillit të Lartë Gjyqësor, është formalizuar krijimi i seksioneve për gjykimin e çështjeve penale për të miturit në konflikt me ligjin apo viktimat të veprës penale. Seksionet për gjykimin e çështjeve të të miturve në konflikt me ligjin apo viktimat të veprës penale duhet të krijohen në gjykatat me së paku 6 gjyqtarë dhe krijimi i tyre bëhet me vendim të Këshillave të Gjykatave. Në ato gjykata ku nuk

¹¹⁶ Ligj nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” Neni 15, pika 5

¹¹⁷ Relacion shpjegues i përmbajtjes së ligjit “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” (datë 21 06 2016) - <https://www.reformanedrejttesi.al>

¹¹⁸ Ligj nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” Neni 23 e në vijim

mund të krijohen seksione të specializuara me 6 gjyqtarë për gjykimin e çështjeve të të miturve për shkak të numrit të pakët të gjyqtarëve, KLGJ orienton që Këshillat e Gjykatave të caktojnë së paku 3 gjyqtarë për trajtimin dhe gjykimin e këtyre çështjeve. Ai orienton që në gjykatat e vogla të paktën njëri nga gjyqtarët të jetë i trajnuar në fushën e drejtësisë penale për të mitur me qëllim mbulimin e trajtimit të këtyre çështjeve.

Me qëllim rritjen e përgjegjshmërisë dhe profesionalizimit të gjyqtarëve në administrimin e çështjeve të drejtësisë penale për të mitur, KLGJ orienton gjyqtarët e caktuar, sikundër edhe gjyqtarët e seksioneve për të mitur, për të ndjekur programet e trajnimeve vazhduese në fushën e drejtësisë penale për të mitur. Lista e gjyqtarëve të caktuar për gjykimin e çështjeve të të miturve në konflikt me ligjin dhe çdo ndryshim i saj, duhet t'i njoftohet Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Shkollës së Magjistraturës, me qëllim përditësimin e listës së gjyqtarëve që specializohen në fushën e drejtësisë penale për të mitur e trajnimin e vazhdueshëm të tyre.

Në të njëjtën mënyrë theksojmë se nuk është formalizuar krijimi i seksioneve për gjykimin e çështjeve civile (familjare dhe ato të mbrojtjes së fëmijës sipas LDMF) të cilat janë edhe fokus i kësaj analize.

Ligji nr. 98/2016 e lejon KLGJ-në të krijojë degë të përhershme ose të përkohshme gjykatash, për gjykatat e shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm. “Degë e gjykatës” i referohet nëndarjes gjeografike të gjykatës së shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm, e cila përbën një njësi administrative me gjykatën.¹¹⁹ Degët e gjykatave gjykojnë çështje civile dhe penale, të cilat gjykohen nga një gjyqtar i vetëm¹²⁰ ndërsa degët e përhershme do të përbëhen prej jo më pak se 3 gjyqtarë me një ngarkesë mesatare vjetore jo më të vogël se ngarkesa mesatare vjetore për gjyqtar në të njëjtën shkallë gjykimi në tre vitet e fundit¹²¹. KLGJ-ja ka autoritetin të miratojë rregullat dhe procedurat e funksionimit të degëve dhe shpërndarjen e gjyqtarëve në to (deri aktualisht nuk janë krijuar degë të gjykatave). Gjyqtarët e gjykatës së shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm shërbejnë si gjyqtarë në selinë kryesore të gjykatës ose në degën përkatëse të gjykatës dhe caktimi i gjyqtarëve në degë të gjykatës është çështje e organizimit të brendshëm të gjykatës. KLGJ miraton rregulla të detajuara në lidhje me procedurën dhe kriteret për caktimin e gjyqtarëve në degët e gjykatës (ende nuk janë krijuar degë dhe as miratuar rregullat për caktimin e gjyqtarëve në to), duke mos përfshirë në organizimin e shortit gjyqtarët me kualifikim dhe performancë të lartë, si dhe me përvojë të gjatë profesionale.

Zyrat e Shërbimit janë struktura të ngritura dhe që funksionojnë pranë godinave të disa prej gjykatave të suprimuara, me qëllim ofrimin e shërbimeve administrative. Pranë tyre mund të paraqiten kërkesa të ndryshme, si kërkesëpadi dhe akte të tjera procedurale, ankime e kundërankime, rekurse e kundërrekurse, kërkesa për informacion për çështjet e regjistruara në gjykatë, kërkesa për përsheptim, etj. Përdorimi i godinave ekzistuese dhe detyrat që ushtrojnë

¹¹⁹ Ligj nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” Neni 2, gërma “ç”

¹²⁰ Ligj nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” Neni 17

¹²¹ Ligj nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” Neni 18

nëpunësit e këtyre zyrave, që janë ato të sekretarit gjyqësor për veprime që lidhen me administrimin e dosjeve gjyqësore, i kanë mundësuar individit qasje më të lehtë drejt informacionit dhe marrje të ndihmës së nevojshme për këto veprime administrative.

4. Në lidhje me çështjet urgjente, për të cilat dispozitat procedurale parashikojnë se duhet të vendoset brenda 14 ditëve nga regjistrimi i çështjes në gjykatë¹²², ligji ka përcaktuar në kompetencat e Kryetarit të gjykatës¹²³, se në fillim të çdo viti ai miraton një listë që përditësohet kur është e nevojshme, për përcaktimin e gjyqtarëve për gjykimet e rasteve urgjente, sipas rendit alfabetik me bazë mbiemrin, në përputhje me rregullat e miratuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor¹²⁴.

11) VKM nr. 659, datë 3.11.2021 “Për miratimin e Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve”

Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve ka në fokus të saj drejtësinë miqësore për fëmijët. Ajo ka vënë në dukje, ndër të tjera, se ekzistojnë pengesa për fëmijët që të kenë akses në drejtësi, për shkak të vonësive të tepërta në procedurat gjyqësore; mungesës së prindit ose kujdestarit ligjor; mungesës së specialistëve të pavarur për të kryer vlerësimin psikologjik të fëmijës. Për më tepër ajo ka theksuar se ende nuk është kryer riorganizimi gjyqësor i gjykatave dhe prokurorive, që do të mundësonte krijimin e seksioneve në rrethe të tjera gjyqësore, përveç atyre që funksionojnë në 7 rrethe (Tiranë, Durrës, Korçë, Gjirokastrë, Elbasan, Shkodër, Vlorë).

Agjenda ka evidentuar se procesi i kujdestarisë alternative në familje paraqitet shumë sfidues për realitetin tonë. Numri i familjeve të gatshme për ofrimin e shërbimit të kujdestarisë është pothuaj i papërfillshëm dhe procesi në gjykatë merr një kohë shumë të konsiderueshme që mund të zgjasë nga disa muaj deri në 1 vit. Ndër masat e parashikuara nga Agjenda është edhe ngritja e kapaciteteve të profesionistëve ku përfshihet edhe gjykata, për të vënë në zbatim legjislacionin e rishikuar për kujdesin alternativ, që përfshin dhe kuadrin e ri ligjor për birësimin.

12) VKM Nr. 892, datë 27.12.2022 “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale të drejtësisë për të mitur 2022–2026, planit të veprimit dhe të pasaportës së indikatorëve” (SDM 2022-2026)

Strategjia e Drejtësisë për të Mitur 2022–2026 dhe Plani i saj i Veprimit është strategjia e dytë në fushën e drejtësisë për të mitur. Reforma “Drejtësi për të mitur” ishte pjesë e reformës në drejtësi e ndërmarrë nga Kuvendi i Shqipërisë në vitin 2014. Fillimisht ishte “SDM 2018–2021” që parashikoi 5 objektiva strategjike, ndër të cilët: a) garantimi i aksesit të të miturve në drejtësi; b) garantimi i procesit të rregullt ligjor për të miturit; c) forcimi i bashkëpunimit të institucioneve të sistemit të drejtësisë për të miturit. “SDM 2018–2021” ishte më e fokusuar në drejtësinë penale

¹²² Ligj nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” Neni 2, gërma “c”

¹²³ Ligj nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” Neni 37, gërma “b”

¹²⁴ Nga faqja web e KLGJ-së nuk rezulton të jenë publikuar ende rregullat.

për të mitur dhe fare pak tek të drejtat e fëmijës në proceset civile, familjare, administrative ose në vendimmarrjet e gjykatave që ndikojnë tek të drejtat e fëmijës. Zbatimi i kësaj strategjie hodhi bazat e një drejtësie miqësore për fëmijët. “SDM 2022–2026” synon ndër të tjera, që çdo fëmijë të ketë në çdo kohë akses te një sistem miqësor për të rivendosur të drejtat e tij/e saj të cenuara në fushën familjare, civile, administrative dhe penale.

Në krahasim me strategjinë e mëparshme “SDM 2022–2026” i zgjeron objektivat e saj edhe në qasjen e çdo fëmije në një drejtësi miqësore në proceset civile, familjare dhe administrative, për shkak se numri i fëmijëve që marrin pjesë në proceset e tjera gjyqësore, sidomos civile dhe familjare është i lartë dhe se të drejtat e tyre cenohen shpesh. Masat e parashikuara në “SDM 2022–2026” synojnë një drejtësi që udhëhiqet nga parimi i interesit më të lartë të fëmijës në kontakt/konflikt me ligjin, si dhe në çdo veprim apo vendimmarrje që ka të bëjë me fëmijën ose që ndikon te fëmija, në çdo fazë të proceseve civile, familjare, administrative dhe penale.

Një nga fushat kryesore të Strategjisë së Drejtësisë për të Mitur 2022–2026 (SDM – 2022-2026) është “Drejtësia miqësore për të gjithë fëmijët”, e cila konsiston në dhënien e mundësisë fëmijëve që të dëgjohen, në çdo proces gjyqësor dhe administrativ që i prek ata dhe të kenë akses në mekanizmat kompetentë kur të drejtat e tyre shkelen. Në të gjitha veprimet në lidhje me fëmijët, institucionet/organat duhet të kenë në konsideratë parësore interesin më të lartë të fëmijës dhe duhet të forcohet aksesin në drejtësi i fëmijëve (në fushat civile, administrative, penale).

“SDM 2022–2026” përmban 4 qëllime kryesore, ndër të cilat: a) një kuadër ligjor, institucional dhe me profesionistë që mundësojnë një drejtësi miqësore për çdo fëmijë; b) garantimi i qasjes në çdo kohë të drejtësisë miqësore për çdo fëmijë. SDM 2022-2026 synon të konsolidojë zbatimin e kuadrit rregullator dhe institucional për një drejtësi miqësore për çdo fëmijë, duke adresuar jo vetëm çështje të legjislacionit penal, por edhe disa çështje të legjislacionit civil, familjar etj. në lidhje me pjesëmarrjen dhe dëgjimin e fëmijës në proces (si për shembull në proceset familjare), rritjen e vendimmarrjeve të institucioneve të bazuara në interesin më të lartë të fëmijës si dhe rritjen e efektivitetit të procedimeve dhe e proceseve ku vendimmarrja e institucioneve ndikon te fëmija. Një synim tjetër është konsolidimi dhe specializimi i trupës së profesionistëve të cilët punojnë me dhe për fëmijët, si dhe kapacitetet monitoruese nga institucionet përgjegjëse. Përmirësime të legjislacionit civil dhe familjar që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijës në vendimmarrjet e gjykatave, si dhe ekzekutimin e detyrimit ushqimor për fëmijën, çështje që lidhen me kujdestarinë për fëmijët, janë një tjetër synim i kësaj strategjie.

Në çështjet me objekt “zgjidhje martesë”, kryesisht gratë dhe fëmijët janë viktimë e mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore me objekt “detyrim ushqimor”, “takim me fëmijë”, “kujdestari fëmije”, “urdhër i menjëhershëm i mbrojtjes” dhe “urdhra të mbrojtjes”. Këto çështje trajtohen nga shërbimi përmbartimor shtetëror dhe privat, e për këtë arsye mes masave të propozuara nën këtë objektiv nga strategjia, synohet të përmbushen detyrimet që burojnë nga

vendimi nr.24, datë 21.4.2014 i Gjykatës Kushtetuese,¹²⁵ në rastet kur prindi nuk e përmbush detyrimin pasi ai jeton jashtë shtetit. Sipas ekspertëve të fushës, ekzekutimi i detyrimit ushqimor është i mundur të kryhet nëse merren disa masa.⁴⁸

Strategjia synon të adresojë disa çështje, ku për qëllim të kësaj analizen përmendim: a) krijimin e praktikave të mira për mbrojtjen e fëmijës dhe marrjen e masave të duhura të mbrojtjes së fëmijës lidhur me kujdestarinë, detyrimin për ushqim dhe ekzekutimin e tij, ushtrimin e përgjegjësisë prindërore, rastet e fëmijëve viktimë të dhunës në familje ose formave të tjera të dhunës ndaj fëmijës. b) rekomandime miqësore për gjykatat nga Avokati i Popullit dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në çështjet që janë në interes të fëmijës. c) ngritja dhe funksionimi i rrjetit të gjyqtarëve dhe prokurorëve që punojnë në seksionet për të mitur me qëllim shkëmbimin e përvojave pozitive dhe për të diskutuar problematikat e hasura në praktikë. ç) evidentimi dhe promovimi i praktikave më të mira për çështjet gjyqësore për të miturit. d) hartimi i një udhëzuesi e cili përcakton qartësisht definicionin e interesit më të lartë të fëmijëve. dh) gritja dhe funksionimi i seksioneve për të mitur në prokuroritë dhe në dhomat penale e civile të gjykatave, sipas hartës gjyqësore, sipas një kalendarit të ndërhyrjeve dhe lista e gjykatave pilot ku do të krijohen mjediset miqësore. e) forcimi i kapaciteteve të mbrojtësve ligjore të zgjedhur ose të caktuar në teknikat e mbrojtjes miqësore të fëmijës dhe metodologjinë e komunikimit. ë) fuqizimi i kapaciteteve të punonjësve të shërbimit përmbarrimit gjyqësor që trajtojnë çështje të fëmijëve

Strategjia ka evidentuar se statistikat për të miturit në kontakt ose në konflikt me ligjin janë fragmentare, të pastandardizuara dhe të pakta. Nuk ka të dhëna të publikuara për fëmijën që marrin pjesë në proceset civile, familjare dhe administrative ose që ndikohen nga vendimmarrjet në këto procese, duke përcaktuar si objektiv se deri në fund të vitit 2026 mbledhja, përpunimi dhe publikimi i statistikave për çështjet civile, familjare, administrative dhe penale ku fëmijët janë pjesë ose vendimmarrja ndikon te fëmijët, do të jenë përmirësuar bazuar në standardet ndërkombëtare. Gjithashtu, stafi i Ministrisë së Drejtësisë do të jetë aftësuar mjaftueshëm për të qenë aktor koordinues mes institucioneve që punojnë me ose për fëmijën, në gjenerimin e statistikave cilësore bazuar në standardet ndërkombëtare.

Si përfundim, në objektivat kryesore të Strategjisë mund të përmendim: a) garantimi i aksesit te një drejtësi miqësore për çdo fëmijë; b) koordinimi dhe bashkërendimi mes institucioneve me qëllim forcimin e kapaciteteve të profesionistëve që punojnë me dhe për fëmijët; c) forcimi i rolit koordinues të Ministrisë së Drejtësisë për çështjet që lidhen me fëmijët dhe mbledhja, përpunimi dhe publikimi i statistikave për çështjet civile, familjare, administrative dhe penale ku fëmijët janë pjesë ose vendimmarrja ndikon te fëmijët, bazuar në standardet ndërkombëtare.

¹²⁵ Shih vendimin në adresën: ne www.gjk.al. Gjykata evidenton faktin se “ky organ, edhe pse nuk mund të investohej drejtpërdrejt nga kërkuesja në procesin e nisjes së një procedure për njohje dhe zbatim vendimi gjyqësor në territorin grek, nëpërmjet ekspertizës dhe praktikës që kjo ministri ndjek në zbatim të këtyre konventave, ka pasur të gjitha mundësitë për të orientuar drejt kërkuesen mbi bazën ligjore të përshtatshme, të zbatueshme në këtë rast, si dhe hapat që duhet të ndërmerre për paraqitjen e kërkesës për njohje dhe ekzekutim vendimi në shtetin grek”.

13) Vendimi nr.78, datë 30.05.2019 “Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në gjykatën e apelit” i Këshillit të Lartë Gjyqësor

KLGJ-ja, referuar ligjit, ka detyra të rëndësishme që lidhen edhe mirëfunksionimin e sistemit gjyqësor në tërësinë e tij. Bazuar në nenin 460, pika 4, të KPC-së, KLGJ-ja ka nxjerrë vendimin nr. 78, datë 30.05.2019 “Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në gjykatën e apelit” (*vendimi nr. 78/2019*), që ka përcaktuar disa kategori çështjesh, shqyrtimi i të cilave, për shkak të natyrës dhe kategorisë, duhet përshpejtuar nga gjykatat.

Sipas këtij vendimi, për sa i përket natyrës, në çështjet që kërkojnë përshpejtim ndër të tjera janë përfshirë edhe:

- a) çështjet që kanë për objekt të drejta të fëmijës ose që kanë ndikim te një fëmijë i mitur;*
- b) çështjet që kanë për objekt zgjidhjen ose pavlefshmërinë e martesës;*
- c) çështjet që kanë për objekt detyrimin për ushqim;*
- ç) çështjet që kanë për objekt kujdestarinë;*
- dh) çështjet që kanë për objekt birësimin;*
- i) çështjet me interes ose ndjeshmëri veçanërisht të lartë për opinionin publik ose ato që prekin interesat e komuniteteve të caktuara, në veçanti ato në nevojë.*

Përveç sa më lart, vendimi i KLGJ-së parashikon se për çdo lloj çështjeje, pavarësisht natyrës dhe kategorisë së saj, palët mund të kërkojnë përshpejtimin e shqyrtimit të saj për shkaqe veçanërisht të rënda dhe të motivuara, kur kjo nuk bie në kundërshtim me ligjin. Këto shkaqe vlerësohen nga gjyqtari relator sipas bindjes së tij të brendshme, bazuar në rrethanat e parashtruara nga pala.

Me “shkaqe veçanërisht të rënda dhe të motivuara” nënkuptohen ato shkaqe personale të palës, të lidhura me shqyrtimin e çështjes dhe objektin e saj apo ato shkaqe që përcaktojnë ose kushtëzojnë ecurinë e zgjidhjes së mosmarrëveshjes kryesore të palëve ndërgjyqëse, ekzistenca e të cilave motivon shqyrtimin e përshpejtuar të çështjes, domethënë shqyrtimin e saj në një afat më të shkurtër nga afati ligjor ose nga afati i arsyeshëm sipas nenit 399/2 të K.Pr.C-së dhe/ose sipas këtij neni në lidhje me nenin 109, pika 4, të ligjit nr. 38/2017, datë 30.03.2017.

Ndër “Shkaqet veçanërisht të rënda dhe të motivuara” mund të jenë, pa u kufizuar:

- “ç) çështjet, shqyrtimi i të cilave në gjykatën e shkallës së parë ka zgjatur përmbi 2 vjet;*
- d) çështjet të cilat ligji i ka përcaktuar në juridiksionin fillestar gjyqësor të gjykatës së apelit dhe shqyrtimi i të cilave në juridiksionin administrativ ka zgjatur përmbi 2 vjet (shih vendimin nr.78/2019 të KLGJ-së)”.*

Në rastet kur pala bën kërkesë për përshpejtim, gjyqtari relator shqyrton kërkesën e palës për përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes, jo më vonë se 30 ditë nga dita e dorëzimit të kërkesës. Kur

kërkesa e palës për përsheptimin e shqyrtimit të çështjes vlerësohet e bazuar, gjyqtari relator vendos pranimin e saj, duke parashtruar edhe arsyet në lidhje me vlerësimin e tij, në këtë rast, në varësi të ngarkesës dhe të urgjencës së çështjes, edhe intervalin kohor brenda të cilit çështja do të planifikohet në kalendarin e shqyrtimit të çështjeve¹²⁶.

II.2 Kuadri ligjor pas hartës së re gjyqësore

Shumica e vendeve evropiane i kanë përqendruar ose janë duke përqendruar gjeografikisht funksionet gjyqësore, duke zvogëluar në këtë mënyrë numrin e gjykatave. Arsyet për këtë janë të ndryshme, si psh: a) për të rritur cilësinë e drejtësisë (rasti në Danimarkë, Norvegji dhe Holandë); b) përveç cilësisë më të lartë, mund të arrihet zvogëlimi i kostove duke mbyllur gjykatat më pak të përdorura dhe ndonjëherë edhe gjykatat e rrënuara dhe kalimin e çështjeve në gjykatat e afërta (rasti në Portugali dhe Greqi, por edhe në vende të ndryshme si Austria, Irlanda, Britania e Madhe, Polonia, Rumania dhe Turqia. Ashtu si Holanda, edhe Polonia e Turqia gjithashtu po synojnë të sjellin disa gjykata të vogla nën një ombrellë, për të reduktuar kostot e menaxhimit dhe ato operative në përgjithësi).¹²⁷

Numri i madh i gjykatave së bashku me shpërndarjen jo racionale, ishin nxitjet kryesore për reformën e shumë hartave gjyqësore në Europë, si në Kroaci dhe në Itali. Më konkretisht në Itali, çështja e shpërndarjes gjeografike të gjykatave është debatuar për më shumë se një shekull, që prej bashkimit të Italisë në vitin 1861 dhe deri më sot, edhe pse nuk ka pasur kurrë një qëllim serioz legjislativ për të ri-hartuar hartën gjyqësore, në përputhje me strukturën dhe nevojat reale të shoqërisë civile. Në një vend si Italia, ku përpara reformës kishte më shumë se 2000 gjykata, vendimi ishte pakësimi i numrit të gjykatave të shkallës së parë për të përmirësuar efikasitetin dhe eficientësinë e të gjithë sistemit gjyqësor. Për riformatimin e sistemit gjyqësor, teknika e përdorur ishte shkrirja e strukturave më të vogla dhe më pak efikase, duke i bashkuar ato me gjykatat më të mëdha. Në Itali, në fakt ekzistojnë edhe një sërë anomalish (edhe pse ato janë adresuar pjesërisht gjatë reformës 2011-2012), si psh: rrethet e Tarantos, Mesinës dhe Rexhio Kalabrias zënë një sipërfaqe nga 2500 deri në 3200 km² (secila prej tyre me 1% të sipërfaqes së vendit), ndërsa rrethet e Torinos, Bolonjës dhe Firences mbulojnë një sipërfaqe dhjetë herë më të madhe, nga 22000 deri në 29000 km² (secila rreth 8% të sipërfaqes së vendit). Tribunali i Mistretas në Sicili u shërben 22.154 banorëve, ndërsa Roma përfshin 2.612.068 banorëve. Pra, 50 gjykatat më të vogla për nga popullsia (30% e të gjithë gjykatave italiane) mbulojnë 9% të popullsisë italiane.¹²⁸

¹²⁶ Shih pikat 7 dhe 8, Kreu III, të vendimit nr. 78/2019 të KLGJ-së.

¹²⁷ Relacion shpjegues i përmbajtjes së ligjit "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë" (datë 21 06 2016) - <https://www.reformanedrejttesi.al>

¹²⁸ Komisioni European për Eficencën në Drejtësi (CEPEJ) - Grupi i Punës për Cilësinë e Drejtësisë (CEPEJ-GT-QUAL) - Udhëzime të rishikuara mbi krijimin e hartave gjyqësore për të mbështetur aksesin në drejtësi në një sistem gjyqësor cilësor; Miratuar në takimin plenar të 22-të të CEPEJ, më 6 Dhjetor 2013.

Nga 47 sistemet e vlerësuara prej CEPEJ, duke iu referuar situatës në vitin 2010, shumica e shteteve kishin më pak se një gjykatë të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm për 100.000 banorë. Më saktësisht, ashtu siç mund të rezultojë në vende të tjera, edhe nëse vërejmë mesataret e sistemeve gjyqësore europiane, mund të vëmë re një variacion të caktuar statistikor në numrin e popullsisë e cila merr shërbime nga gjykata e shkallës së parë (që do të thotë numri në total i gjykatave për juridiksionin e përgjithshëm dhe çështjet e specializuara). Për shembull, në Belgjikë gjendet një gjykatë e parë për 401.478 njerëz mesatarisht, por nga ana tjetër, në një vend me një numër popullsie të ngjashëm me atë në Hungari, numri i popullsisë e cila merr shërbim nga secila gjykatë e shkallës së parë është shumë më i ulët, në vlerën 76.229 njerëz. Në dy vende krahasimisht të mëdha si Spanja dhe Italia, numri i njerëzve të cilët kanë marrë shërbim është 20.503 për gjykatë në Spanjë dhe 49.250 (që do të thotë më shumë se dyfish) në Itali.

Me qëllim rritjen e cilësisë së vendimmarrjes, garantimin e një sistemi të përgjegjshëm, cilësor dhe eficient, duke siguruar transparencë e akses për çdo qytetar, si dhe në funksion të një sistemi funksional me fokus qytetarin, pushteti gjyqësor në Shqipëri u angazhua ndër të tjera edhe për: trajtimin e çështjeve të prapambetura me masa emergjente, rritjen e transparencës dhe besimit të publikut te gjyqësori, përmirësimin e infrastrukturës së gjykatave, ngritjen e një sistemi të unifikuar të menaxhimit të çështjeve gjyqësore, si dhe krijimin e hartës së re gjyqësore, që lejon rritjen e efikasitetit të gjykatave dhe aksesit në drejtësi për qytetarët.

Kuadri i ri ligjor parashikon kompetenca të mirëpërcaktuara për KLGJ në drejtim të rregullimit të brendshëm të gjykatave, të administratës gjyqësore, financave dhe përgatitjes profesionale të gjyqtarëve.

Në vitin 2022, KLGJ përgatiti një Raport Vlerësimi për krijimin e një harte të re gjyqësore e cila u miratua nga Parlamenti, si dhe më pas Qeveria u angazhua për të mbështetur zbatimin e saj. Harta e re gjyqësore është parë si celësi për zgjidhjen e sfidave të sistemit gjyqësor në Shqipëri lidhur me ngarkesën e punës, delegimet, aksesin, koston dhe efektshmërinë, me qëllim garantimin e aksesit në drejtësi, në kuptimin e afërsisë së qytetarëve me gjykatat, uljen e kostove, përmirësimin e cilësisë dhe performancës së duhur të shërbimeve të ofruara. Përveç kësaj, në objektivat e hartës së re gjyqësore është vendosja e një ekuilibri midis shpërndarjes së ngarkesës së punës dhe shpërndarjes së gjyqtarëve ndërmjet gjykatave.

Raporti i Progresit i Komisionit European i vitit 2023¹²⁹, evidentoi se:

- Shqipëria ka një nivel mesatar përgatitjeje për funksionimin e gjyqësorit. Zbatimi i reformës në drejtësi ka vazhduar, duke rezultuar me një progres të mirë në përgjithësi. Efikasiteti i sistemit gjyqësor dhe qasja në drejtësi vazhduan të ndikohen nga afati i gjatë i procedurave, ngarkesa e shtuar e punës dhe numri i madh i çështjeve të pazgjidhura, që mbetet veçanërisht

¹²⁹ Commission Staff Working Document Albania 2022 - Report Accompanying the document Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions 2022 Communication on EU Enlargement policy - Brussels, 12.10.2022

i lartë në gjykatat e apelit dhe ato të shkallës së parë. Është bërë përparim në trajtimin e çështjes së vendeve vakante të gjyqësorit me betimin e 40 magistratëve të rinj në tetor 2023.

- Vlerësimi i përkohshëm i të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve (procesi i vettingut) ka vazhduar të ecë me ritme të kënaqshme. Deri më 6 tetor 2023, institucionet e vetting-ut kishin përfunduar 689 raste të vetting-ut në shkallë të parë, që përbënin 84% të totalit, nga të cilat 537 vendime të formës së prerë. Gjithsej rreth 805 profesionistë do t'i nënshtroheshin rivlerësimit kalimtar. Në përgjithësi, 57% e dosjeve të vettingut të përpunuara deri më tani kanë rezultuar me shkarkim ose përfundim për shkak të dorëheqjes ose mbushjes së moshës së pensionit. Rezultati i vendimeve të shkallës së parë të verifikimit, Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (KPK) dhe, sipas rastit, të Komisionit të Posacëm të Apelimit (KPA), rezultoi me 257 shkarkime (gjyqtarë e prokurorë, kryesisht për çështje që lidhen me pasuritë e pajustificuara); 278 konfirmime në detyrë; 152 vendime për pushimin e procedurës së vettingut dhe 2 vendime pezullimi me detyrim trajnimi. Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit ka vijuar të mbikëqyrë procesin e vetting-ut dhe ka dhënë opinione për vlerësimet e KPK, duke përfshirë 33 rekomandime për ankimim dhe 8 mendime kundërshtuese ose kontradiktore pas vendimeve përfundimtare. Institucioni i Komisionerëve Publikë ka ndjekur të gjitha rekomandimet për ankim. Në të njëjtën periudhë KPA ka trajtuar 208 raste.
- Sistemi i menaxhimit të çështjeve dhe sistemi i trajnimit gjyqësor kanë nevojë për përmirësim për të rritur më tej efikasitetin dhe profesionalizmin në gjithë sektorin. Janë ndërmarrë veprime pozitive për rritjen e rëndësisë së programit të trajnimit të vazhdueshëm në periudhën raportuese. Është bërë njëfarë progresi në sistemin e menaxhimit të rasteve, veçanërisht me ngritjen e grupit të punës për ndërveprimin dhe miratimin e kornizës së ndërveprimit që vendos bazat për vënien në punë të sistemit¹³⁰.

Për vitin në vijim, nga Komisioni Evropian është rekomanduar:

- avancimi i mëtejshëm i procesit të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve (vetting) dhe përsheptimi i procedurave, veçanërisht në apel, duke pasur parasysh cilësinë e procesit;
- konsolidimi i përpjekjeve për të përmirësuar efikasitetin e të gjitha gjykatave dhe zvogëlimi i numrit të çështjeve të pazgjidhura, duke përfshirë plotësimin e vendeve vakante të hapura, përmirësimin e funksionimit të gjykatave dhe thjeshtimin/ lehtësimin e procedurave gjyqësore, veprime të mëtejshme për ngritjen e një sistemi të integruar modern të menaxhimit të çështjeve dhe krijimi i një plani të fuqishëm zbatimi dhe komunikimi për hartën e re gjyqësore, që garanton respektimin e së drejtës për akses në drejtësi dhe të kuadrit ligjor në fuqi, veçanërisht për transferimet dhe ngritjet në detyrë;
- të vazhdojë forcimi i kapaciteteve dhe pavarësisë së sistemit gjyqësor dhe institucioneve të tij vetëqeverisëse, duke bërë përmirësimet të cilësisë dhe efikasitetit në Shkollën e Magistraturës, duke përfshirë edhe rishikimin e provimit të pranimit në përputhje me standardet evropiane.

¹³⁰ Commission Staff Working Document Albania 2023 – Report Accompanying the document Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions 2023 Communication on EU Enlargement policy - Brussels, 8.11.2023 - <https://ec.europa.eu/eeec>

II.2.a Kuadri ligjor pas hartës së re gjyqësore

Përpara implementimit të Hartës së Re Gjyqësore, sistemi gjyqësor në Shqipëri ishte i ndarë në gjykata të shkallës së parë, gjykata apeli dhe një gjykatë e lartë. Në Shqipëri, kishte:

- 29 gjykata të shkallës së parë, ku
 - 22 ishin gjykata rrethi me juridiksion të përgjithshëm,
 - 6 gjykata administrative dhe
 - 1 gjykatë e posaçme.
- 8 gjykata apeli, ku
 - 6 ishin gjykata apeli me juridiksion të përgjithshëm,
 - 1 gjykatë administrative dhe
 - 1 gjykatë e posaçme.

Ligji nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” (6 tetor 2016), parashikon që KLGJ në bashkëpunim me MD, të përgatisë një propozim të përbashkët për hartën e re gjyqësore, i cili miratohet më pas nga Këshilli i Ministrave. Pasi miratohet, harta gjyqësore mund të rishikohet periodikisht, në bazë të vlerësimeve të bëra nga KLGJ-ja çdo 5 vjet.¹³¹.

Projekti për hartën e re gjyqësore ka patur për qëllim që prej vitit 2023 të garantojë: a) aksesin në drejtësi, b) marrjen e shpejtë të shërbimeve gjyqësore për publikun, c) shpërndarjen e ekuilibruar të ngarkesës mes gjykatave dhe gjyqtarëve, ç) përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve dhe, d) specializimin e profilizimin e gjyqtarëve.

Pas implementimit të Hartës së Re Gjyqësore, sistemi gjyqësor në Shqipëri është i ndarë në gjykata të shkallës së parë, gjykata apeli dhe një gjykatë e lartë. Në Shqipëri, ka:

- 16 gjykata të shkallës së parë, nga të cilat:
 - 13 gjykata të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm,
 - 2 gjykata të shkallës së parë me juridiksion administrativ
 - 1 gjykatë e shkallës së parë e posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar
- 3 gjykata apeli, nga të cilat:
 - 1 gjykatë apeli e juridiksionit të përgjithshëm
 - 1 gjykatë apeli me juridiksion administrativ
 - 1 gjykatë apeli e posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar

1) VKM Nr. 495, datë 21.7.2022 “Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave”

¹³¹ Ligji nr. 98/2016, Neni 13

Me anë të VKM-së 495/2022, është përcaktuar riorganizimi i gjykatave sipas rretheve gjyqësore si dhe kompetencat tokësore, në një hartë të re gjyqësore, e cila hyri në fuqi në periodat e mëposhtme:

- me 1.2.2023 hyri në fuqi riorganizimi i gjykatave të apelit të juridiksionit të përgjithshëm,
- me 1.5.2023 hyri në fuqi riorganizimi i gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm,
- me 1.7.2023 hyri në fuqi riorganizimi i gjykatave administrative të shkallës së parë,

Më konkretisht, u mbyllën dhe u riorganizuan gjykatat si më poshtë:

Nga 22 gjykata u mbyllën 9 gjykata të rretheve gjyqësore (në Tropojë, Mat, Kurbin, Krujë, Pukë, Lushnjë, Kavajë, Përmet, Pogradec) dhe gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm **u riorganizuan në 13 gjykata** (në Berat, Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Lezhë, Korçë, Kukës, Sarandë, Shkodër, Tiranë, dhe Vlorë). Për qëllime të kësaj analize, përmendim Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me kompetencë tokësore në bashkitë Tiranë, Kamëz, Vorë dhe Krujë.

Nga 6 gjykata apeli me juridiksion të përgjithshëm u mbyllën 5 gjykata apeli (në Shkodër, Durrës, Vlorë, Korçë, Gjirokastrë) dhe gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm **u riorganizuan në 1 Gjykatë Apeli të Juridiksionit të Përgjithshëm**, që organizohet dhe funksionon në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, me seli në qytetin e Tiranës.

Gjykatat administrative të shkallës së parë u riorganizuan në **2 (dy) gjykata administrative të shkallës së parë** me kompetenca tokësore: 1) Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me seli në qytetin e Tiranës dhe kompetencë tokësore, që përfshin rrethet gjyqësore Tiranë, Durrës, Shkodër, Kukës, Dibër, Elbasan, Lezhë dhe Korçë; 2) Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë, me seli në qytetin e Lushnjës dhe kompetencë tokësore, që përfshin rrethet gjyqësore Berat, Fier, Gjirokastrë, Sarandë dhe Vlorë.

Në mbështetje të vendimit të mësipërm, KLGJ miratoi një pakete të plotë aktesh, të cilat mundësojnë zbatimin në praktikë të hartës së re gjyqësore përmes miradministrimit të aspekteve të ndryshme teknike që lidhen qoftë me procedurat e shortimit të çështjeve ashtu dhe me burimet njerëzore nëpër gjykata.

Harta e re synoi të japë zgjidhjen më të mirë në situatën ku ndodhej sistemi gjyqësor, e kryesisht përse i përket kohëzgjatjes së proceseve tej afateve të arsyeshme dhe mungesës së specializimit të gjyqtarëve në fushat e së drejtës (penale, civile, administrative), për një drejtësi eficiente dhe profesionale. Krijimi i gjykatave me numër më të madh gjyqtarësh pritet të sjellë normalizimin e ngarkesës së punës në gjykata, shpërndarjen e drejtë të çështjeve dhe rritjen e produktivitetit,

eficiencës, efikasitetit të sistemit të drejtësisë dhe cilësisë së gjykimeve, si dhe garantimin e afateve të arsyeshme për zhvillimin e proceseve gjyqësore.

2) Vendim nr. 505, datë 21.11.2022 “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm” i Këshillit të Lartë Gjyqësor

Në lidhje me transferimin e çështjeve gjyqësore të regjistruara në Gjykatën e Apelit Tiranë, Durrës, Gjirokastrë, Korçë, Shkodër dhe Vlorë deri në datën 31.1.2023, por që nuk kishin përfunduar sipas ligjit, nga KLGJ u parashikua që të transferoheshin në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, si dhe të regjistroheshin në regjistrat manualë dhe sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve ICMIS. Departamenti i Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor u ngarkua me zbatimin e këtyre parashikimeve (neni 6).

Në lidhje me menaxhimin e çështjeve gjyqësore të transferuara në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, nga KLGJ u parashikua që të rindaheshin me short elektronik, në përputhje me kriteret e miratuara nga KLGJ. Çështjet e transferuara për të cilat kishte filluar apo ishte planifikuar shqyrtimi gjyqësor në gjykatat e apelit Tiranë, Durrës, Gjirokastrë, Korçë, Shkodër dhe Vlorë, nuk i nënshtroheshin rindarjes me short si dhe u parashikua vijimi i shqyrtimit të tyre nga të njëjtët gjyqtarë. Për efekt të riorganizimit, transferimit dhe menaxhimit të çështjeve, planifikimi i datave për gjykimin e çështjeve gjyqësore në gjykatat e apelit Tiranë, Durrës, Gjirokastrë, Korçë, Shkodër dhe Vlorë, do të bëhej deri në 31.12.2022. Ky rregull nuk gjente zbatim për çështjet urgjente sipas ligjit (neni 7).

78 gjyqtarë është numri i gjyqtarëve të caktuar për këtë gjykatë me Vendimin nr.553, datë 29.12.2022 “Për caktimin e numrit të gjyqtarëve në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm”, të KLGJ-së. Gjyqtarët e gjykatës së apelit Tiranë qëndruan në pozicionin që kishin në strukturën e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe gjyqtarët e gjykatave të apelit Durrës, Gjirokastrë, Korçë, Shkodër dhe Vlorë, u transferuan në pozicion të përhershëm në strukturën e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm (neni 2).

3) Vendim nr. 137, datë 28.03.2023 “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë” i Këshillit të Lartë Gjyqësor

Në lidhje me transferimin e çështjeve gjyqësore të regjistruara në gjykatat e rrethve gjyqësore Tiranë dhe Krujë deri në datën 30.04.2023, por që nuk kishin përfunduar sipas ligjit, nga KLGJ u parashikua që të transferoheshin në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, si dhe të regjistroheshin në regjistrat manualë dhe sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve Ark-IT. Departamenti i Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor u ngarkua me zbatimin e këtyre parashikimeve.

Në lidhje me menaxhimin e çështjeve gjyqësore të transferuara në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, nga KLGJ u vendos që nuk i nënshtroheshin rindarjes me short si dhe vijimi i shqyrtimit nga i njëjti trup gjykues.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë u emërtua Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe filloi funksionimin më datë 01.05.2023, ndërsa Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, e ndërpreu veprimtarinë më datë 30.04.2023. Numri i gjyqtarëve të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë përcaktohet me akt të veçantë të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë qëndruan në pozicionin që kishin në strukturën e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ndërsa gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë u transferuan në pozicion të përhershëm në strukturën e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Këshilli i Lartë Gjyqësor pas datës 1.05.2023 vijon procedurat e papërfunduara për llogari të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

4) Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese në lidhje me hartën e re gjyqësore¹³².

VKM nr.495, datë 21.07.2022 “Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave”, pati edhe kundërshtime, e më konkretisht nga Dhoma e Avokatisë e Shqipërisë dhe Komiteti Shqiptar i Helsinkit, u pretendua në Gjykatën Kushtetuese se ky vendim ishte i papajtueshëm me Kushtetutën dhe se ndër të tjera, cënonte të drejtën e aksesit në gjykata.

Në pretendimet e Dhomës së Avokatisë, vlerësimi i hartës së re nuk analizonte varfërinë në vend, cilësinë e rrugëve dhe transportit rrugor, aksesin e grupeve të disavantazuara ekonomikisht dhe as ngarkesën në gjykata në lidhje me çështjet e ardhura, të përfunduara dhe ato në shqyrtim. Në mënyrë jo të ekuilibruar është synuar rritja e eficiencës së sistemit gjyqësor dhe shpejtësisë së gjykimit, duke mos peshuar me kujdesin e duhur aksesin në drejtësi, që kërkon edhe afërsinë e qytetarit me gjykatën. Harta e re bazohet në numrin faktik të gjyqtarëve, ndërkohë që ligji¹³³ vendos kufij minimalë të numrit të gjyqtarëve, të kushtëzuar nga nevoja për eficiencë dhe specializim në gjykata. Në drejtim të ofrimit të ndihmës juridike dytësore ndaj kategorive përfituese sipas ligjit nr. 111/2017, harta e re sjell vonesa dhe efekte të ngadalshme.¹³⁴

KSHH-ja ndër të tjera theksoi të dhënat e monitorimit të kryer prej saj në disa qytete ku më parë ka pasur gjykata të apelit, ku ka rezultuar se kostot e proceseve gjyqësore janë rritur ndjeshëm. Reformimi nuk është mirëpritur nga qytetarët për shkak të pasojave negative si në plan financiar, në rritjen e ndjeshme të kostove, ashtu edhe për shkak të distancës, kushteve infrastrukture të

¹³² Vendim nr.70, datë 29.12.2023 i GJK-së, publikuar me datë 09.02.2024 në www.gjk.al

¹³³ Neni 15, pika 4, i ligjit nr. 98/2016

¹³⁴ Vendim nr.70, datë 29.12.2023 i GJK-së, parag. 69

papërshtatshme dhe një sërë efektesh të tjera negative që ndikojnë në mungesën e aksesit në drejtësi.¹³⁵

Kolegji i GJK-së kërkoi edhe mendimin me shkrim nga Avokati i Popullit i cili u shpreh se riorganizimi i gjykatave ka sjellë një ulje të konsiderueshme të numrit të gjykatave dhe kjo është ulja më e thellë në vitet e fundit, e parë edhe në raport me situatën në vendet e tjera të rajonit. Avokati i Popullit në mendimin e tij me shkrim është shprehur se zbatimi i hartës së re nuk e përmirëson aksesin, por e cenon atë, duke sjellë rritjen e kostove për qytetarët dhe uljen e cilësisë së shërbimeve të ofruara. Harta e re nuk ka marrë në konsideratë dhe nuk ka adresuar nevojat e qytetarëve, veçanërisht të kategorive vulnerabël, shtetasve të privuar nga liria, etj., për të garantuar aksesin e tyre në drejtësi, çka do të ndikojë në uljen e mëtejshme të besimit në drejtësi, ndaj duhet të rishikohet.¹³⁶

Gjykata Kushtetuese i ka vlerësuar të pabazuara pretendimet për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë. Ajo ka vlerësuar fillimisht, se riorganizimi gjyqësor ka sjellë një kufizim në të drejtën e aksesit të individit në gjykatë si dhe ka konstatuar se riorganizimi i rretheve gjyqësore, duke ulur numrin e gjykatave është një masë që sjell pasoja të drejtpërdrejta edhe në drejtim të së drejtës për akses në gjykatë. Kjo reflektohet si në drejtim të rritjes së distancës mes gjykatës dhe individit, ashtu edhe në drejtim të mundësisë së tij për të vënë në lëvizje gjykatën, për shkak të rritjes së shpenzimeve dhe kostove të përfaqësimit me avokat, pra të procesit gjyqësor, të cilat u ngarkohen palëve në proces. Në këtë mënyrë harta e re gjyqësore përbën kufizim të aksesit të individit në gjykatë, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë, qoftë përmes përfaqësuesit ligjor të zgjedhur ose të caktuar¹³⁷.

Megjithatë, Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar më tej se:

1. organizimi i ri i rretheve gjyqësore dhe kompetencave territoriale ka synuar arritjen e objektivave të ligjit nr. 98/2016, që nuk arriheshin nga organizimi i mëparshëm dhe që kanë të bëjnë me garantimin e aksesit në drejtësi, në kuptimin e afërsisë së qytetarëve me gjykatat, uljen e kostove, me qëllim përdorimin efikas të burimeve, si dhe përmirësimin e cilësisë dhe performancës së duhur të shërbimeve. Pra përmbushen objektivat e synuar në drejtim të uljes së numrit të çështjeve të pashqyrtuara, përfundimin e proceseve gjyqësore në kohë më të shpejtë, ngarkesën e njëjtë mes gjyqtarëve, specializimin e gjyqtarëve, si dhe unifikimin e praktikave gjyqësore;¹³⁸
2. harta e re plotëson kërkesën e të qenit e domosdoshme sepse nuk u evidentua ndonjë zgjidhje tjetër e organizimit gjyqësor që të mund të ishte në të njëjtën mënyrë efektive për përmbushjen e qëllimit të synuar;¹³⁹

¹³⁵ Vendim nr.70, datë 29.12.2023 i GJK-së. parag. 70

¹³⁶ Vendim nr.70, datë 29.12.2023 i GJK-së. parag. 71

¹³⁷ Vendim nr.70, datë 29.12.2023 i GJK-së. parag. 76 & 77

¹³⁸ Vendim nr.70, datë 29.12.2023 i GJK-së. parag. 81

¹³⁹ Vendim nr.70, datë 29.12.2023 i GJK-së. parag. 82

3. nuk vërehet dekurajimi i përdoruesve për t'iu drejtuar sistemit gjyqësor dhe nuk është provuar që riorganizimi i rretheve gjyqësore të ketë qenë barrierë në këtë drejtim;¹⁴⁰
4. me qëllim sigurimin e aksesit, janë parashikuar edhe masa lehtësuese, të tilla si: krijimi i degëve të gjykatave¹⁴¹ dhe funksionimi i Zyrate të Shërbimit. Degët e gjykatave ende nuk janë funksionale dhe sipas KLGJ-së, me normalizimin e situatës mund të vendoset hapja e tyre me përparësi, në ato njësi administrative në të cilat ka pasur më parë gjykatë të shkallës së parë, por parashikimi ligjor për krijimin e tyre është një element që vlerësohet se rrit aksesin në gjykatë. Ndërkohë, Zyrat e Shërbimit janë struktura të ngritura dhe që funksionojnë pranë godinave të disa prej gjykatave të suprimuara, me qëllim ofrimin e shërbimeve administrative;¹⁴²
5. në drejtim të ndihmës juridike falas, interesi i avokatëve që të jenë pjesë e listës së ndihmës juridike falas nuk ka rënë, përkundrazi është në rritje vit pas viti;¹⁴³
6. për sa u përket viktimave të dhunës, ligji nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar, ka parashikuar hapësirat dhe mundësitë në drejtim të mjeteve ligjore, përfshirë edhe kërkesëpadinë, që sigurojnë mbrojtjen e viktimave të kësaj kategorie, ashtu edhe aksesin në çdo organ/institucion, përfshirë gjykatën, pavarësisht vendbanimit ose vendqëndrimit të vetë viktimës;¹⁴⁴
7. në lidhje me aksesin e individit në gjykatën e apelit, për shkak të natyrës së gjykimit, mund të sigurohet edhe përmes paraqitjes së dokumenteve. Referuar dispozitave procedurale që rregullojnë gjykimin në apel, paraqitja e palëve është fakultative dhe gjykata mund ta shqyrtojë çështjen në mungesë të tyre, përveç rasteve të parashikuara nga neni 461 i KPC-së¹⁴⁵, pa sjellë mosparaqitja pasoja që kufizojnë aksesin në gjykim;¹⁴⁶
8. ligji ka parashikuar edhe mekanizma mbrojtës për të evituar impaktin e kundërt me atë që kërkohet të arrihet. Harta e re gjyqësore nuk konsiderohet e pandryshueshme dhe ka efekte të kufizuara në kohë, për shkak të lejimit të rishikimit të hartës gjyqësore cdo 5 vjet dhe kufizimit të kohëzgjatjes. KLGJ-ja ka detyrën të ndjekë në mënyrë të vazhdueshme pasojat dhe efektet e këtij riorganizimi, duke vlerësuar mundësinë e riformatimit të hartës gjyqësore edhe në një afat më të shpejtë, nëse kjo konsiderohet e nevojshme dhe e domosdoshme¹⁴⁷;
9. në balancimin e interesave është respektuar interesi publik i së mirës së përgjithshme, nga njëra anë, me kufizimin e së drejtës së aksesit, nga ana tjetër. Duke vënë në balancë pasojat që synon zbatimi i hartës së re gjyqësore, që lidhen me të drejtën e individit për eficiencë, efikasitet dhe cilësi në dhënien e shërbimit të drejtësisë, me pasojat në të drejtën e aksesit efektiv në gjykatë,

¹⁴⁰ Vendim nr.70, datë 29.12.2023 i GJK-së. parag. 83

¹⁴¹ Sipas nenit 2, shkronja “ç”, të ligjit nr. 98/2016, i referohet nënndarjes gjeografike të gjykatës së shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm, e cila përbën një njësi administrative me gjykatën.

¹⁴² Vendim nr.70, datë 29.12.2023 i GJK-së. parag. 84

¹⁴³ Vendim nr.70, datë 29.12.2023 i GJK-së. parag. 85

¹⁴⁴ Vendim nr.70, datë 29.12.2023 i GJK-së. parag. 85

¹⁴⁵ KPC, neni 461 – “Fillimisht gjykata verifikon paraqitjen e rregullt të palëve, ... dhe bën përpjekje për zgjidhjen e çështjes me pajtim. Mosparaqitja e palëve, për të cilat njoftimi është bërë me shpallje, nuk pengon shqyrtimin e çështjes, me përjashtim të rastit kur janë njoftuar shkaqe të arsyeshme për mungesën. Gjykata nuk mund të shqyrtojë çështjen në mungesë atëherë kur dëgjimi i palëve është një nga detyrat e rigjyimit ose kur njoftimi ka qenë i parregullt.”

¹⁴⁶ Vendim nr.70, datë 29.12.2023 i GJK-së. parag. 86

¹⁴⁷ Vendim nr.70, datë 29.12.2023 i GJK-së. parag. 88

kjo ndërhyrje nuk cenon parimin e proporcionalitetit. Individët kanë mundësinë të ushtrojnë të drejtën kushtetuese për akses në gjykatë, pavarësisht efekteve të riorganizimit gjyqësor, të cilat, në thelb, nuk e kanë bërë të pamundur ushtrimin e kësaj të drejte.

VII. SITUATA FAKTIKE E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE CIVILE, TË MBROJTJES SË FËMIJËVE DHE ÇËSHTJEVE FAMILJARE QË PREKIN FËMIJËT, PARA DHE PAS HARTËS SË RE GJYQËSORE (2020-2023)

Përvec shqyrtimit të dokumentave ligjorë dhe politikë për periudhën para dhe pas hartës së re gjyqësore, kjo analizë përfshin edhe vlerësimin e situatës faktike, para dhe pas implementimit të hartës së re gjyqësore, duke sjellë edhe të dhëna specifike për eficientë dhe efikasitetin e gjykimit të çështjeve fokus analize në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për ta konkretizuar dhe për t'i bërë më të kuptueshme gjetjet dhe rekomandimet, në drejtim të evidentimit të mungesës ose jo të eficientës së sistemit të ri gjyqësor, për sa i përket çështjeve gjyqësore në fokus të kësaj analize.

Shqyrtimi i situatës faktike është bërë në bazë të të dhënave statistikore dhe cilësore, të publikuara, nga pyetësorët ose nga intervistat me interlokutorët. Të dhënat statistikore dhe cilësore, të cilat i referohen dokumenteve zyrtare të publikuara, përgjigjeve dhe të dhënave të marra nga interlokutorët nëpërmjet pyetësorëve, intervistave gjysëm të strukturuar me interlokutorët, bazohen kryesisht në:

- raportet vjetore mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor, për vitet 2020, 2021, 2022 dhe 2023, të publikuara në faqen web të KLGJ-së;
- analizat vjetore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për vitet 2020, 2021, 2022 dhe 2023, të publikuara në faqen web të gjykatës;
- analizat vjetore të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për vitet 2022 dhe 2023, të dërguara nga gjykata.
- analizat vjetore të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas në Ministrinë e Drejtësisë, për vitet 2020, 2021, 2022 dhe 2023, të publikuara në faqen web të drejtorisë.

Gjithashtu, bazuar në metodologjinë e miratuar, një Pyetësor me 14 pyetje dhe nënpyetjet përkatëse, iu është dërguar për plotësim 7 interlokutorëve: Këshillit të Lartë Gjyqësor, Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të

Përgjithshëm Tiranë, Shkollës së Magjistraturës, Ministrisë së Drejtësisë, Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas dhe Dhomës Kombëtare të Avokatisë.

Nëpërmjet Pyetësorit u bënë përpjekje për të marrë të gjithë informacionin e nevojshëm për të vlerësuar nëse ndryshimet kushtetuese e ligjore, që kanë të bëjnë me organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor dhe hartën e re gjyqësore, kanë përmbushur synimin e rritjes së efikasitetit të drejtësisë për fëmijët, për çështjet gjyqësore objekt i kësaj analize. Pyetësi me 14 pyetje kryesore dhe nënpyetjet përkatëse, u përdor gjatë zhvillimit të intervistave gjysëm të strukturuar me interlokutorët, nga Komisioneri për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve i Avokatit të Popullit.

Nga ana e interlokutorëve është dërguar Pyetësi i plotësuar me përgjigjet përkatëse si dhe evidenca statistikore, me të dhënat cilësore dhe sasiore të lidhura kryesisht me kohëzgjatjen e shqyrtimit të çështjeve gjyqësore familjare dhe urdhërat e mbrojtjes që prekin fëmijët, por edhe me kohëzgjatjen e ekzekutimit të tyre, të cilat janë analizuar duke evidentuar situatën, problematikat dhe rekomandimet përkatëse. Statistikat të cilat janë konsideruar të rëndësishme dhe që lidhen me fokusin e kësaj analize, janë përmbledhur në formë tabelare dhe grafiku në Aneksin nr.1 (bashkëngjitur).

Nga eksplorimi i bazës ligjore si ndryshimet Kushtetuese, ndryshimet e Kodeve dhe Ligjeve të posacme apo miratimi i Ligjeve të reja, nxjerrja e vendimeve, urdhërave apo akteve të tjera nga organet vendimmarrëse të pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor, në kuadër të Reformës në Drejtësi dhe të Hartës së Re Gjyqësore, të bëra në këtë analizë, arrijmë edhe në disa gjetje/ rezultate si dhe rekomandime, si vijon.

VII.1 Situata e përgjithshme për gjykimin në shkallë të parë, përpara dhe pas hartës së re gjyqësore (2020-2023):

Viti 2020¹⁴⁸: Numri i gjyqtarëve në vitin 2016 para se të fillonte reforma në drejtësi ka qenë 8 gjyqtarë në seksionin familjar. Numri i përgjithshëm i gjyqtarëve nuk ka qenë i plotësuar sipas strukturës në vitin 2020, me 12 gjyqtarë më pak, ndërsa seksioni familjar ka patur 8 gjyqtarë. Në fund të vitit 2020, stoku (backlog-u) i çështjeve të mbartura për gjykim në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm u rrit me 29% më shumë sesa fundi i vitit 2019. Pandemia Covid-19 dhe reduktimi i numrit të gjyqtarëve në detyrë si pasojë e procesit të Vetting-ut, patën ndikimin e tyre në efektivitetin dhe efikasitetin e shqyrtimit të çështjeve gjyqësore, duke sjellë përkeqësim gjatë këtij viti në rritjen e kohës mesatare të nevojshme për zgjidhjen e tyre.

¹⁴⁸ Këshilli i Lartë Gjyqësor, Raport mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2020. www.klqj.al; Analiza vjetore e gjykatës për vitin 2020 dhe përgjigje e pyetësorit.

Sipas parashikimeve të ligjit 98/2016, nga ana e gjykatave kërkohet dërgimi i statistikave të hollësishme në drejtim të volumit të punës, drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor apo Ministrisë së Drejtësisë. Në këtë gjykatë është angazhuar një sekretar gjyqësor, i cili në të shumtën e rasteve i ka nxjerrë të dhënat manualisht, pasi sistemi me të cilin operon gjykata nuk e mundëson prodhimin elektronikisht të tyre, pra nuk arrin të vetgjenerojë të dhëna statistikore. Gjykata e Tiranës aplikon sistemin për menaxhimin e çështjeve gjyqësore ARK IT, një sistem që funksionon që nga viti 2002, i përmirësuar dhe i konfiguruar sipas nevojave të gjykatës për nxjerrjen e statistikave të detajuara dhe implementimin e ndryshimeve ligjore. Sistemi i menaxhimit të çështjeve gjyqësore ARK IT mundëson nxjerrjen e disa statistikave në nivel gjykate, mbi vlerësimin e kohëzgjatjes së përgjithshme të proceseve gjyqësore, sipas llojit të tyre¹⁴⁹.

Viti 2021¹⁵⁰: Numri i gjyqtarëve nuk ka qenë i plotësuar sipas strukturës, ndërsa seksioni familjar ka patur 4 gjyqtarë, pra 4 më pak se viti i mëparshëm. Gjatë këtij viti, gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm në rang vendi kanë funksionuar me 70% të gjyqtarëve, për shkak të reduktimit të numrit të gjyqtarëve në detyrë si pasojë e procesit të Vetting-ut. Në fund të vitit 2021, stoku (backlog-u) i çështjeve të mbartura për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë u rrit dhe përbënte 53% të stokut të përgjithshëm të gjykatave të shkallës së parë në vend, ndërsa numri i çështjeve backlog ndër vite u rrit në 1.613 çështje.

Sistemi i menaxhimit të çështjeve në gjykatën e shkallës së parë është i kompjuterizuar. Në lidhje me sistemin e menaxhimit të çështjeve gjyqësore, sistemi ARK-IT ka shfaqur problematikë me regjistrin e çështjeve civile të themelit, pasi nuk ka arritur mbartjen automatike në kohë në fund të vitit (dy çështje me të njëjtën numër akti, kod çështjeje dhe objekt padie të njëjtë, si dhe kodi i çështjes, data e regjistrimit, objekti i padisë dhe palët e çështjes po të njëjta), duke u zgjidhur në mënyrë manuale. Në vitin 2021, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë është caktuar për herë të parë një sekretar gjyqësor i dedikuar për statistikën, i cili kryen detyra funksionale në lidhje me grumbullimin, përpunimin dhe raportimin e statistikave të gjykatës, bazuar në çdo kërkesë që vjen pranë saj, kryesisht nga institucione shtetërore, veçanërisht Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Ministria e Drejtësisë, organizata të shoqërisë civile dhe individë. Evidentojmë se struktura organizative e Gjykatës nuk ka patur të parashikuar një Zyrë për Statistikat, mjaft e domosdoshme për nga ngarkesa e punës, kërkesat e vazhdueshme dhe raportimet periodike¹⁵¹.

Gjatë vitit 2021 në bashkëpunim me Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe EURALIUS V, është pilotuar ngritja e një njësie ligjore e përbërë nga sekretarë gjyqësorë me eksperiencë, të cilët janë ngarkuar me draftimin e akteve të urdhëruara nga gjyqtarët. Ky pilotim është diktuar nga situata e ngarkesës së krijuar për shkak të rritjes së numrit të madh të urdhrave të ekzekutimit. Kjo njësi është marrë kryesisht me përgatitjen e draft - urdhrave të ekzekutimit. Ky projekt pilot ka vazhduar edhe gjatë

¹⁴⁹ Analiza vjetore e gjykatës për vitin 2020 dhe përgjigje e pyetësorit.

¹⁵⁰ Këshilli i Lartë Gjyqësor, Raport mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2021; www.klqj.al; Analiza vjetore e gjykatës për vitin 2021 dhe përgjigje e pyetësorit.

¹⁵¹ Analiza vjetore e gjykatës për vitin 2021 dhe përgjigje e pyetësorit.

vitit 2022 duke ndihmuar në këtë mënyrë evadimin në një kohë më të shpejtë të urdhrave të ekzekutimit dhe lehtësuar ngarkesën e madhe të krijuar në gjykatë me urdhrat e ekzekutimit. Në dhomën penale është krijuar një sallë e re për zhvillimin e gjyqeve me të mitur, ndërsa është bërë i mundur edhe zhvillimi i seancave gjyqësore në distance nëpërmjet programit Microsoft Teams.¹⁵²

Viti 2022¹⁵³: Numri i gjyqtarëve në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë nuk ka qenë i plotësuar sipas strukturës, me 39 gjyqtarë më pak, ndërsa seksioni familjar ka vijuar me 4 gjyqtarë. Edhe gjatë vitit 2022 ka vijuar funksionimi i gjykatave të shkallës së parë me 70% të gjyqtarëve të parashikuar, për shkak të procesit të Vetting-ut. Si rezultat i largimit të gjyqtarëve për shkak të procesit të vetting-ut, si dhe për arsye të tjera, rezultoi se seksionet u reduktuan në numër dhe nga kjo situatë me qëllim për të bërë të mundur përbalimin e ngarkesës seksioni tregtar dhe seksioni civil vazhduan të jenë të shkrirë në një të vetëm.

Në lidhje me numrin e gjyqtarëve, bazuar në Dekretin nr. 7818, datë 16.11.2012¹⁵⁴ ishin përcaktuar 408 gjyqtarë gjithsej, nga të cilët 389 gjyqtarë të shkallës së parë dhe apelit dhe 19 gjyqtarë në Gjykatën e Lartë. Sistemi i drejtësisë mbështetej nga një personel gjyqësor prej 1.140 punonjësish. Në vitin 2022, Shqipëria kishte të emëruar në detyrë 318 gjyqtarë (11.4 gjyqtarë për 100.000 banorë), sipas Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ), ndërkohë që mesatarja e BE-së në vitin 2021 ishte 24.1 gjyqtarë. Numri i gjyqtarëve në Shqipëri u rrit në vitin 2022 krahasuar me raportin e një viti më parë, pas disa emërimeve të reja.¹⁵⁵

Në fund të vitit 2022, **stoku (backlog-u)** i çështjeve të mbartura për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë u rrit dhe përbënte 47% të stokut të përgjithshëm të gjykatave të shkallëve të para në vend, ndërsa numri i çështjeve backlog ndër vite u rrit në 2.377 çështje ose **gjithsej 19.275 çështje në pritje në 31 dhjetor 2022¹⁵⁶.**

Kërkesat dhe kërkesëpaditë pas paraqitjes së tyre në gjykatë, regjistroheshin ditën e nesërme të punës dhe maksimumi brenda dy ditëve nga paraqitja në gjykatë i nënshtroheshin procedurës së hedhjes në short. Të nesërmen e hedhjes së shortit, dosjet e këyre çështjeve iu dorëzoheshin gjyqtarëve për kryerjen e veprimeve të mëtejshme procedurale. Problematika është evidentuar tek vonesa në regjistrimin e çështjeve, për shkak të ngarkesës së madhe, por gjithsesi nga gjykata janë marrë masa të nevojshme për të bërë të mundur regjistrimin dhe kalimin e çështjeve pranë gjyqtarëve brenda një kohe të arsyeshme¹⁵⁷.

¹⁵² Id.

¹⁵³ Këshilli i Lartë Gjyqësor, Raport mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2022. www.klgj.al; Analiza vjetore e gjykatës për vitin 2022 dhe pergjigje e pyetesorit.

¹⁵⁴ Dekreti nr. 7818, datë 16.11.2012, “Për caktimin e numrit të gjyqtarëve për çdo gjykatë të shkallës së parë, të apelit dhe të gjykatave administrative, si dhe caktimin e kompetencave tokësore dhe selisë qendrore të gjykatave administrative”, i ndryshuar.

¹⁵⁵ Progres Raporti për Shqipërinë - 2023

¹⁵⁶ Analiza vjetore e gjykatës për vitin 2022 dhe pergjigje e pyetesorit.

¹⁵⁷ Id.

Një problem shqetësues që sjell rritjen e kohëzgjatjes së shqyrtimit të çështjeve nga gjykata, i hasur në rritje gjatë vitit 2022 është numri i madh i kërkesave për shtyrje të seancave gjyqësore, afërsisht 20 kërkesa për shtyrje në ditë. Këto kërkesa për shtyrje në shumë raste pranohen dhe kjo gjë rrit automatikisht ngarkesën për gjyqtarët. Nga ana tjetër, gjyqtarët trajtojnë me prioritet çështjet që janë urgjente, ndërsa dakordësojnë me palët rregullisht për kalendarin e gjykimit të çështjes gjyqësore. Kalendarin e gjykimit miratohet për ato çështje që zhvillohen me pjesëmarrjen e palëve dhe jo ato që zhvillohen në dhomë këshillimi¹⁵⁸.

Viti 2023¹⁵⁹: Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë u transferuan të gjitha dosjet civile dhe penale, **rreth 600 dosje, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë**, e cila u mbyll në muajin Korrik 2023. Për rrjedhim është bërë migrimi i bazës së të dhënave nga sistemi i menaxhimit të çështjeve të gjykatës së mbyllur (ICMIS) në sistemin e gjykatës (ARK-IT) dhe transferimi fizik i dosjeve nga gjykata e mbyllur brenda muajit Gusht 2023, si dhe rishortimi për çështjet në gjykim.

Numri i gjyqtarëve në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë ka qenë **52 gjyqtarë në detyrë nga 80 gjyqtarë** sipas organikës së miratuar, por krahasuar me vitin e mëparshëm rezulton se numri i gjyqtarëve në detyrë është rritur me 15 gjyqtarë. Ndërsa seksioni familjar është shtuar me 2 gjyqtarë krahasuar me vitin e mëparshëm, duke rezultuar **6 gjyqtarë në seksionin familjar për vitin 2023**. Ulja e numrit të gjyqtarëve në seksionin familjar gjatë periudhës përpara hartës së re gjyqësore, normalisht ka ndikuar në rritjen e backlogut dhe zvarritjen e çështjeve¹⁶⁰.

Ndonëse numri i gjyqtarëve aktualisht pjesë efektive e organikës së trupës gjyqësore pranë kësaj gjykate, është sa gjysma e kapacitetit të parashikuar në ligj (80 gjyqtarë në total), puna që përballohet prej këtij numri thuhet të përgjysmuar gjyqtarësh (Dhoma Civile me 31 gjyqtarë dhe Dhoma Penale me 18 gjyqtarë) është vetëm në rritje. Rjedhimisht rezulton se gjyqtarët në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë përgjatë vitit 2023, ndonëse shumë më të pakët në numër, kanë arritur që të gjykojnë 100 % numrin e të gjitha çështjeve të ardhura për gjykim në vitin 2023¹⁶¹.

Numri i stafit administrativ gjyqësor për vitin 2023 ka qenë 1 kancelar dhe 112 nëpunës civilë gjyqësorë (sekretare gjyqësore), plotësuar në përputhje me organikën dhe faktin. Në këtë mënyrë është arritur një shpërndarje proporcionale e tyre duke rezultuar në vitin 2023 në raportin 1 gjyqtar me 2 nëpunës civilë gjyqësorë¹⁶².

¹⁵⁸ Id.

¹⁵⁹ Analiza vjetore e gjykatës për vitin 2023 www.gjykatatirana.gov.al dhe pergjigje e pyetesorit..

¹⁶⁰ Analiza vjetore e gjykatës për vitin 2023. www.gjykatatirana.gov.al dhe pergjigje e pyetesorit.

¹⁶¹ Analiza vjetore e gjykatës për vitin 2023. www.gjykatatirana.gov.al

¹⁶² Pergjigje e pyetesorit

Gjatë vitit 2023, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, rezultojnë të jenë gjykuar/shqyrtuar (me vendim përfundimtar) 51.158 çështje gjyqësore (civile dhe penale), nga të cilat 18.225 çështje civile. Në fund të vitit 2023, stoku (backlog-u) i çështjeve civile të pazgjidhura për gjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë arriti në 16.563 çështje civile. Çështjet civile të reja të regjistruara në gjykatë gjatë vitit 2023 ishin gjithsej 18.211 çështje, ndërsa çështje të mbartura nga vitet e mëparshme ishin gjithsej 16.557 çështje. Treguesit e efikasitetit rezultuan me kohën e nevojshme për zgjidhjen e çështjeve civile (DT) 332 ditë, si dhe me normë likuidimi të çështjeve civile 100% (CR)¹⁶³.

Nga gjykata janë marrë masa për evadimin e backlog-ut, e konkretisht, me caktimin dhe emërimin e gjyqtarëve të rinj në seksionin familjar, me urdhër të Kryetarit të Gjykatës, është bërë shortimi i çështjeve familjare vetëm tek ata, duke u përjashtuar nga shorti gjyqtarët aktualë me një ngarkesë të lartë, për një periudhë të caktuar kohore¹⁶⁴.

Shkaqet që çojnë në zgjatjen përtej afateve ligjore dhe përtej afatit të gjykimit të arsyeshëm të çështjeve të mbrojtjes së fëmijëve dhe çështjeve të tjera familjare që prekin ata, të evidentuara nga gjykata përfshijnë¹⁶⁵:

a) pezullimi i çështjeve;

b) problematikat në komunikimin e njoftimeve të gjykatës palëve ndërgjyqëse, që çojnë në mosmarrjen dijeni, kryesisht për shkak të adresave të pasakta, të cilat e detyrojnë gjykatën që të përsërisë njoftimet dhe shtyjë seancat;

c) kërkesat e palëve ndërgjyqëse në proces, kryesisht për shtyrje seance ose veprime të tjera procedurale;

ç) rastet në rritje të shkarkimeve të gjyqtarëve si pasojë e procesit të Vettingut ose dorëheqjeve të gjyqtarëve, dosjet gjyqësore të të cilëve transferohen me short tek gjyqtarët e tjerë. Kur ka pasur shkarkime nga vetting-u me urdhër të Kryetarit të Gjykatës është bërë inventarizimi dhe rishortimi automatik i çështjeve të gjyqtarit të larguar, procedura këto që kanë ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimit¹⁶⁶. Në disa nga këto raste, çështjet rifillojnë shqyrtimin gjyqësor nga veprimet e para procedurale.

d) mbingarkesa e gjyqtarëve me çështje gjyqësore në shqyrtim¹⁶⁷.

Sipas gjykatës, vonesat në gjykimin e çështjeve familjare kanë ndikim në të drejtat e fëmijëve për ushqim, shkollim, etj¹⁶⁸. Mospasja e ndihmës juridike, sipas gjykatës, nuk është një nga shkaqet e zvarritjes së çështjeve të mbrojtjes së fëmijëve dhe çështjeve të tjera familjare që prekin ata.¹⁶⁹

¹⁶³ Analiza vjetore e gjykatës për vitin 2023. www.gjykatatirana.gov.al.

¹⁶⁴ Përgjigje e pyetesorit.

¹⁶⁵ Gjykata në veprimtarinë e saj për vitin 2023 është përpjekur të respektojë të drejtën e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm ligjor si një ndër të drejtat themelore kushtetuese, duke rezultuar 80.7% e çështjeve të gjykuara brenda afatit të arsyeshëm ligjor (civile + penale). Ndërsa 19.3% e çështjeve të gjykuara rezultojnë jashtë afatit procedural 2 vjeçar, të parashikuar nga neni 399/2 i K.P.Civile (civile + penale)

¹⁶⁶ Përgjigje e pyetesorit.

¹⁶⁷ Id.

¹⁶⁸ Id.

¹⁶⁹ Id.

Ndërsa në lidhje me shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palëve, tarifat e gjykatës dhe kosto të tjera gjatë procesit, gjykata ka theksuar se në raste të rralla mund të shkaktojnë zvarritje, por përgjithësisht shpenzimet gjyqësore nuk janë shkak i zvarritjes së çështjeve të mbrojtjes së fëmijëve dhe çështjeve të tjera familjare që prekin ata¹⁷⁰.

Nga e gjykatës është ngritur dhe evidentuar nevoja e padiskutueshme dhe imediate lidhur me infrastrukturën dhe ambientet e duhura, të mjaftueshme dhe dinjitoze (salla gjyqi, zyra, hapësira komode dhe të mjaftueshme ku palët dhe qytetarët marrin shërbimet përkatëse në ambientet e gjykatës) ku gjyqtarët duhet të kryejnë punën e tyre, dhe ku qytetarët duhet të marrin shërbimin e duhur, brenda një afati të arsyeshëm¹⁷¹. Gjithashtu, është theksuar domosdoshmëria e pranisë së këshilltarëve ligjore, shtimi dhe kualifikimi i duhur i stafit mbështetës (sekretarisë gjyqësore), nevoja e marrjes së masave lidhur me sigurinë në gjykatë, e të tjera, të cilat ndikojnë në punën e përditshme të gjyqtarëve.¹⁷²

VII.1.a) Çështjet e mbrojtjes së fëmijës, para dhe pas hartës së re gjyqësore (2020 - 2023) në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë

Sic rezulton nga të dhënat në Aneksin 1 “Statistikat 2020-2023” të kësaj analize, për çështjet që lidhen me mbrojtjen e fëmijëve, përveçse është rritur numri i tyre pas hartës së re gjyqësore, rezulton se ato vazhdojnë të gjykohen kryesisht në një afat mbi 2 muaj, pra nuk arrihen të gjykohen në shkallë të parë brenda afateve të përcaktuara në:

- ligjin nr.9669/2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar, ku janë përcaktuar afatet e gjykimit: *a) për vërtetimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes jo më vonë se 20 ditë, nga dita e lëshimit të urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes gjykata kryen seancën; b) për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes gjykata vendos brenda 15 ditëve nga dita e regjistrimit të kërkesës; c) për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes gjykata vendos në lidhje me kërkesën për mbrojtje të menjëhershme të një të mituri brenda 24 orëve pas parashtrimit të kërkesës, ndërsa për subjekte të tjera të dhunës në marrëdhëniet familjare, brenda 48 orëve;*
- ligjin nr.18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës,” ku janë përcaktuar afatet e gjykimit: *a) brenda 5 ditëve për vlefshmërinë e masës emergjente të mbrojtjes.*
- K.Pr.Civile ku janë përcaktuar afatet e arsyetimit të vendimit pas shpalljes dhe depozitimi në sekretarinë gjyqësore *jo më vonë se 20 ditë, ose të shtyrjes për shpalljen e arsyetuar të vendimit deri në 20 ditë.*

VII.1.b) Çështjet familjare që prekin fëmijët, para dhe pas hartës së re gjyqësore (2020 - 2023) në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë

¹⁷⁰ Id.

¹⁷¹ Analiza vjetore e gjykates për vitin 2023. www.gjykatatirana.gov.al

¹⁷² Analiza vjetore e gjykates për vitin 2023. www.gjykatatirana.gov.al

Sic rezulton nga të dhënat në Aneksin 1 “Statistikat 2020 – 2023”, për çështjet familjare që prekin fëmijët përveçse është rritur ndjeshëm numri i tyre nga viti 2020 në vitin 2021 me 32%, në vitin 2022 është ulur me 13% më pak se viti 2021, ndërsa pas hartës së re gjyqësore në vitin 2023 rezulton sërish një rritje nga viti i mëparshëm me 9.5%. Këto çështje rezulton se vazhdojnë të gjykohen kryesisht në një afat mbi 6 muaj edhe pas hartës së re gjyqësore, por sipas statistikave nuk arrihet të përcaktohet se sa prej tyre gjykohen në afatin mbi 2 vjet.

VII.2 Situata e përgjithshme për gjykimin në apel, përpara dhe pas hartës së re gjyqësore (2020 – 2023)

Viti 2020¹⁷³: Në Gjykatën e Apelit Tiranë, në vitin 2020 kanë ushtruar funksionin e tyre 12 gjyqtarë, 13 ndihmësa ligjorë dhe 34 sekretare gjyqësore. **Në të gjitha gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm stoku (backlog-u) i çështjeve në fillim të vitit 2020 ka qenë 17.253 çështje**, duke u rritur me 26% krahasuar me vitin 2019. Në këto gjykata, treguesi i kohës mesatare të nevojshme deri në zgjidhjen e një çështjeje (DT) ishte 402.4 ditë. Treguesi DT është dhënë për të gjitha gjykatat e apelit në rang vendi, duke qenë se nga muaji mars i vitit 2023 u shkrinë të gjitha në një gjykatë të vetme, pra në kontekstin e gjykimit në apel në rang vendi. DT është treguesi që krahason numrin total të çështjeve të pazgjidhura, në fund të periudhës së caktuar, me numrin e çështjeve të zgjidhura, brenda të njëjtës periudhë kohore, raport ky i konvertuar me numër ditësh. Treguesi mat se sa shpejt sistemi gjyqësor i gjykatës punon mbi çështjet e marra që nënkupton kohën që duhet për përfundimin e një lloj çështjesh të caktuara në gjykatë, në dritën e ritmit të punës në atë gjykatë. Ndërsa norma e likuidimit të çështjeve (“Clearance rate” ose shkurt CR) u ul me 9% nga viti 2019.

Numri i përgjithshëm i çështjeve të mbrojtjes së fëmijëve dhe çështjeve të tjera familjare që prekin ata që janë **regjistruar në Gjykatën e Apelit Tiranë**, rezulton të jetë gjithsej **487 çështje gjyqësore**¹⁷⁴.

Rezulton të jenë **gjykuar 62 çështje familjare** (ku përfshihen çështje me objekt zgjidhje martesë, pagim detyrimi ushqimor, ushtrim përgjegjësie prindërore) nga të cilat 52 çështje zgjidhje martesë, 4 çështje lidhur me detyrimin ushqimor të fëmijëve, 5 çështje për ushtrimin e përgjegjësisë prindërore dhe 1 çështje lidhur me atësinë e fëmijës, në të cilat rezulton të jenë përfshirë **72 fëmijë nga të cilët 39 djem dhe 33 vajza**¹⁷⁵.

Viti 2021¹⁷⁶: Në Gjykatën e Apelit Tiranë, në vitin 2021 kanë ushtruar funksionin e tyre 7 gjyqtarë, 11 ndihmësa ligjorë dhe 34 sekretare gjyqësore. **Për gjykatat e apelit të juridiksionit të**

¹⁷³ Këshilli i Lartë Gjyqësor - Raport mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2020 – www.klgj.al; pyetesori i plotësuar nga Gjykata e Apelit.

¹⁷⁴ Pyetesori i plotësuar nga Gjykata e Apelit

¹⁷⁵ Id.

¹⁷⁶ Këshilli i Lartë Gjyqësor – Raport mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2021; www.klgj.al; Pyetesori i plotësuar nga Gjykata e Apelit

përgjithshëm backlog-u (stoku) në fillim të vitit 2021 ka arritur në 22702 çështje, duke u rritur me 24% krahasuar me vitin 2020. Treguesi i kohës së nevojshme për zgjidhjen e çështjeve (DT) ishte 382.6 ditë dhe krahasuar me një vit më parë u shkurtua me 19.8 ditë ose 2%, përjashtuar Gjykatën e Apelit Tiranë, ku tendenca për zgjidhjen e çështjes në vitin 2021 shkon deri në 5.820.1 ditë (15.95 vjet). Norma e likuidimit të çështjeve (CR) ishte 93%, krahasuar me 66% që shënohej në vitin 2020. **Në fund të vitit 2022 mbetën për t'u shqyrtuar, gjithsej 28.140 çështje** nga të cilat 63% (17.651 çështje) në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Numri i përgjithshëm i çështjeve të mbrojtjes së fëmijëve dhe çështjeve të tjera familjare që prekin ata, që janë **regjistruar në Gjykatën e Apelit Tiranë** rezulton të jetë gjithsej **454 çështje gjyqësore**¹⁷⁷.

Rezultoni të jenë **gjykuar 53 çështje familjare** (ku përfshihen çështje me objekt zgjidhje martesë, pagim detyrimi ushqimor, ushtrim përgjegjësie prindërore, lëshim autorizimi për fëmijët e mitur), konkretisht 44 çështje zgjidhje martesë, 2 çështje për pension ushqimor, 3 çështje për ushtrim përgjegjësie prindërore, 3 çështje për lëshim autorizimi dhe 1 çështje për vërtetim atësie, ku rezultoni të jenë përfshirë **54 fëmijë nga të cilët 36 djem dhe 18 vajza**¹⁷⁸.

Dosjet gjyqësore i përcillen Gjykatës së Apelit Tiranë nga gjykatat e shkallëve të para, pas ezaurimit të afateve të ankimit dhe të kundërankimit nëpërmjet shërbimit postar. Nuk ka të parashikuar ndonjë procedurë të caktuar me qëllim koordinimin midis gjykatave për transferimin në kohë dhe pa zvarritje të dosjeve, gjithsesi për çështje specifike lidhur me afatet gjykatat komunikojnë rast pas rasti¹⁷⁹.

Njoftimet e palëve dhe trajtimi i dosjeve për çështjet e mbrojtjes së fëmijëve dhe çështje të tjera familjare që prekin ata, bëhen nga sekretari gjyqësor i secilit gjyqtar apeli njëlloj si për të gjitha çështjet e tjera, referuar kalendarit të planifikimeve të gjyqtarit duke patur parasysh edhe objektin ose karakterin e çështjes, por gjykata nuk ka një punonjës të caktuar që merret me këto procese pune. Vlen të theksohet se për çdo çështje ku palë është fëmija ose kur është e nevojshme mbrojtja e interesit të fëmijës, nga administrata gjyqësore merren gjithmonë masa për njoftimin dhe sigurimin e pjesëmarrjes në proces të një psikologu apo punonjësi social. Në lidhje me njoftimin e palëve pas vendimit të gjykatës dhe efektivitetin e sistemit të njoftimeve, evidentohet se të gjitha vendimet gjyqësore penale apo civile, pas dorëzimit të dosjeve në sekretari, referuar K.Pr.Civile dhe K.Pr.Penale dhe ndryshimeve ligjore të vitit 2021, u komunikohen palëve ndërgjyqësore nëpërmjet ftuesve të gjykatës dhe shërbimit postar¹⁸⁰.

¹⁷⁷ Pyetësi i plotësuar nga Gjykata e Apelit

¹⁷⁸ Id.

¹⁷⁹ Id.

¹⁸⁰ Id.

Viti 2022¹⁸¹: Në vitin 2022 kanë ushtruar funksionin e tyre 12 gjyqtarë, 12 ndihmësa ligjorë dhe 31 sekretare gjyqësore¹⁸². Backlog-u total në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm **në fillim të vitit 2022 kishte arritur vlerën 28.140 çështje** (24% më tepër krahasuar me vitin 2021) dhe për shtimin e stokut kishin kontribuar të gjitha gjykatat e apelit. Ngarkesa mesatare e gjyqtarëve u ul disi në Gjykatën e Apelit Tiranë me 2.142,5 çështje/gjyqtar.

Në Gjykatën e Apelit Tiranë, tendenca për zgjidhjen e çështjes përpara zbatimit të hartës së re gjyqësore përllogaritej të shkonte deri në 5.995,3 ditë (16,4 vjet). Me një gjykatë të vetme apeli, pritshmëria ishte që koha e nevojshme do bëhej 6 herë më pak, me një tregues DT prej 1.046 ditësh (2.9 vjet). Norma e likuidimit të çështjeve u rrit gjatë këtij viti. Në fund të vitit 2022 mbetën **për t'u shqyrtuar 31,370 çështje** në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Sic rezulton nga të dhënat, numri i çështjeve që janë gjykuar përtej afatit të arsyeshëm 2 vjecar është ulur në vitin 2022¹⁸³.

Numri i përgjithshëm i çështjeve të mbrojtjes së fëmijëve dhe çështjeve të tjera familjare që prekin ata, që janë **regjistruar në gjykatë** rezulton të jetë gjithsej **642 çështje gjyqësore**.

Rezulton të jenë **gjykuar 67 çështje familjare** (ku përfshihen çështje me objekt zgjidhje martesë, pagim detyrimi ushqimor, ushtrim përgjegjësie prindërore, lëshim autorizimi për fëmijët e mitur), nga të cilat 54 çështje zgjidhje martesë, 6 çështje lidhur me përgjigjësinë prindërore dhe 6 çështje lidhur me detyrimin ushqimor të fëmijëve, 1 çështje për dhënie autorizimi, ku rezulton të jenë përfshirë **56 fëmijë nga të cilët 34 djem dhe 22 vajza**¹⁸⁴.

Për vitet 2020 – 2022, për shkak të numrit të ulët të gjyqtarëve nuk ka patur ndarje në seksione, por vetëm gjyqtarë të caktuar për gjykimin e çështjeve penale me të mitur. Ulja e numrit të gjyqtarëve në seksionin civil (ku përfshihen çështjet familjare) të gjykatës së apelit, ka ndikuar në zvarritjen e çështjeve pasi ka sjellë një ngarkesë më të madhe çështjesh për secilin gjyqtar të këtij seksioni¹⁸⁵.

Në vijim të procesit të vetting-ut, gjatë vitit 2022 u shkarkuan 13 gjyqtarë të kësaj gjykate si dhe janë larguar 5 gjyqtarë me dorëheqje. Për rrjedhim, rihedhja në short 29 herë e të gjitha dosjeve në gjykim nga gjyqtarët që nuk kaluan procesin vetting, nga gjyqtarët që dhanë dorëheqjen nga detyra dhe nga gjyqtarët që u emëruan në GJL, në GJK apo anëtar në KLGJ, ndikoi në shtimin e ngarkesës së punës të pjesës tjetër të gjyqtarëve në detyrë, si dhe në rritjen e numrit të çështjeve gjyqësore në pritje të rradhës për gjykim¹⁸⁶.

¹⁸¹ Këshilli i Lartë Gjyqësor – Raport mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2022; www.klgj.al Pyetësori i plotësuar nga Gjykata e Apelit

¹⁸² Id.

¹⁸³ Id.

¹⁸⁴ Pyetësori i plotësuar nga Gjykata e Apelit

¹⁸⁵ Id.

¹⁸⁶ Analiza vjetore për vitin 2022 e Gjykatës së Apelit Tirane

Në vitin 2022 në Gjykatën e Apelit Tiranë është caktuar një sekretar gjyqësor i dedikuar për statistikat, por struktura organizative e gjykatës nuk e parashikon një Zyrë për Statistikat, mjaft e domosdoshme për të adresuar nevojat e mbledhjes, përpunimit të të dhënave dhe raportimit të tyre.

Viti 2023¹⁸⁷: Gjatë vitit 2023 u realizua si fazë e parë mbyllja e disa gjykatave të apelit dhe kalimi i çështjeve civile dhe penale në një gjykatë të vetme apeli në rang vendi. Në 31 Janar 2023 janë mbyllur 5 Gjykata Apeli e konkretisht Gjykata e Apleit në Durrës, Vlorë, Shkodër, Gjirokastrë, Korçë dhe në 1 Shkurt 2023 filloi funksionimin Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë si një gjykatë e vetme në nivel apeli. Ndërsa si fazë e dytë u realizua mbyllja e disa gjykatave të rretheve gjyqësore.

Në ish-Gjykatat e Apeleve vazhdojnë të ushtrojnë funksionin Zyrat e Shërbimeve në Durrës, Korçë, Gjirokastrë, Vlorë dhe Shkodër, si pjesë e strukturës së Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Veprimtaria e Zyrave të Shërbimit në ish-gjykatat e apelit ishte parashikuar për një periudhë kalimtare, ku punonjësit e Zyrave të Shërbimit kryejnë të gjitha detyrat e sekretarit gjyqësor, si dhe veprimet që lidhen me administrimin e dosjeve gjyqësore të çështjeve të përfunduara deri në datën 31 janar 2023. Aktualisht zyrat vazhdojnë të jenë të hapura dhe funksionale, ato përbëhen nga tre nëpunës civilë gjyqësorë, dhe përveç shërbimit ndaj publikut, këto zyra vazhdojnë të evadojnë edhe dosjet gjyqësore, si dhe të kryejnë veprime lidhur me komunikimin e vendimeve/rekurseve. Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë është në komunikim të vazhdueshëm, të përditshëm dhe të shpejtë me 5 Zyrat e Shërbimit të sipërcituara. Në kushtet kur ambientet e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm kanë qenë të papërshtatshme dhe pa kapacitetin e duhur, pranë këtyre zyrave është ruajtur një pjesë e arkivit të gjykatës¹⁸⁸.

Migrimi i bazës së të dhënave dhe transferimi i dosjeve nga gjykatat e apelit të mbyllura, rishortimi i çështjeve pas largimit të gjyqtarëve për shkak të procesit vetting dhe për shkak të mbylljes së gjykatave sipas hartës së re gjyqësore, rezulton se është bërë në një kohë shumë të shpejtë. Migrimi i të dhënave është kryer me ndihmën e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Të gjitha çështjet e regjistruara apo dhe të përfunduara nga gjykatat e apeleve të rretheve (gjykata të shkrira) janë transferuar edhe elektronikisht pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm pas datës 01.02.2023. Çështjet e paplanifikuara i janë nënshtruar procesit të rishortimit të kryera në dy data (për shkak të numrit të lartë të çështjeve), konkretisht me datë 03.02.2023 dhe me datë 07.02.2023 (publikuar dhe në faqen zyrtare të gjykatës). Rishortimi i çështjeve të regjistruara përpara datës 01.02.2023 (migruar nga gjykata e apeleve të rretheve) është bërë nëpërmjet shortit elektronik, referuar kategorisë së çështjeve penale apo civile dhe ndarjes së gjyqtarëve në seksione. Në rast largimi të ndonjë gjyqtari (për shkak të procesit të vettingut apo ndonjë arsye tjetër) rishortimi bëhet referuar vendimmarrjes së Këshillit të Gjykatës, në mënyrë të barabartë mes gjyqtarëve¹⁸⁹.

¹⁸⁷ Analiza vjetore për vitin 2023 e Gjykatës së Apelit Tiranë; Pyetësori i plotësuar nga Gjykata e Apelit.

¹⁸⁸ Analiza vjetore 2023 e Gjykatës së Apelit

¹⁸⁹ Id.

Në datën 01.02.2023, numri total i çështjeve gjyqësore për gjykim në gjykatën e apelit ka qenë **33.731 çështje (të mbartura)**, nga të cilat **23.886 çështje civile**. Çështje të regjistruara të reja nga data 01 Shkurt 2023 - 31 Dhjetor 2023 kanë qenë 12.146 çështje pas hartës së re gjyqësore. Numri i çështjeve të shqyrtuara në total për vitin 2023 (nga data 1 shkurt) është **8.215 çështje gjyqësore**, nga të cilat janë gjykuar **3.398 çështje civile (themeli, kërkesa civile)**¹⁹⁰. Rezulton se bilanci vijon të jetë negativ edhe për këtë vit, ndonëse nga 12 muaj që ka viti 2023, në 10 muaj funksioni është kryer si gjykatë e vetme e bashkuar në 10 muaj.

Numri total i dosjeve gjyqësore që presin radhën për shqyrtim në fund të vitit 2023 ka qenë **37.662 çështje**. Nga totali i çështjeve të cilat janë në pritje për gjykim (backlog) rezulton një numër shumë i lartë i çështjeve të natyrës civile gjithësej **25.980 çështje**, që nuk janë planifikuar për gjykim, ku ndër to rezultojnë në pritje:

- **6.555 çështje civile për periudhën 2-3 vjet,**
- **7.909 çështje civile për periudhën 3-5 vjet,**
- **3.240 çështje civile për periudhën më shumë se 5 vjet.**

Përsa më sipër, afati 2-vjeçar i gjykimit të çështjeve në apel ka kaluar, në kundërshtim me jurisprudencën e Gjykatës Europiane të Drejtave të Njeriut. Shkaqet e tejkalimit të afatit 2 – vjeçar janë mungesa e gjyqtarëve dhe vakancat që kanë lënë në sistemin e drejtësisë shkarkimet e gjyqtarëve¹⁹¹.

Backlog-u i dosjeve që kanë si objekt çështje që i përkasin mbrojtjes dhe të drejtave të fëmijëve apo që kanë ndikim tek fëmijët, për periudhën 01.02.2023-31.12.2023 (pas hyrjes në fuqi të hartës së re gjyqësore dhe mbartjes së çështjeve nga gjykatat e apelit të rretheve) në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm rezultojnë të jenë **2.037 çështje familjare në listë pritje**. Aktualisht në Gjykatën e Apelit gjykohen çështje që janë të regjistruara në vitin 2017, sipas radhës së gjykimit. Prioritet i është dhënë gjykimit të çështjeve familjare ku janë gjykuar 232 çështje dhe çështjeve me objekt zgjidhje martesë ku janë gjykuar 219 çështje¹⁹²

Masat që janë marrë për evadimin e backlog-ut nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, përfshijnë: krijimin e ambjenteve lidhur me sistemimin e gjithë dosjeve të ardhura nga gjykatat e apeleve të rretheve; shtimin e numrit të sallave për të krijuar një ambient të përshtatshëm dhe për të mos krijuar vonesa lidhur me gjykimin e çështjeve; gjyqtarëve ju është dhene lista e plote e çështjeve që kanë për gjykim, me nr. Akti, nr.sistemi, date regjistrimi, palet dhe objektin. Vështirësia kryesore e hasur pas datës 01.02.2023 në lidhje me evadimin e backlog-ut ka qenë numri i ulët i gjyqtarëve në detyrë në këtë gjykatë¹⁹³.

¹⁹⁰ Id.

¹⁹¹ Id.

¹⁹² Pyetesori i plotësuar nga gjykata

¹⁹³ Id.

Në lidhje me respektimin e të drejtës së **gjkimit brenda një afati të arsyeshëm ligjor**, si një ndër të drejtat themelore kushtetuese, nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm janë bërë përpjekje maksimale lidhur me respektimin e afatit ligjor të gjkimit, duke u dhënë përparësi planifikimi dhe gjykimi çështjeve ku ligji ka përcaktuar një afat gjykimi, përpos numrit të ulët të gjyqtarëve në raport me dosjet në listë pritje pas datës 01.02.2023. Sa i përket respektimit të afateve procedurale të parashikuara nga K.Pr.C (neni 399/2) për gjkimin e çështjeve dhe statistikave në këtë drejtim, evidentojmë se për gjkimin civil në shkallë të dytë, afat i arsyeshëm konsiderohet përfundimi i procesit brenda 2 (dy) viteve. Megjithatë ky afat jo gjithmonë respektohet për shkak të numrit në ulje të gjyqtarëve vit pas viti si pasojë e procesit të vetingut dhe rritjes së ngarkesës individuale të gjyqtarëve, sidomos pas hartës së re gjyqësore, pra datës 01.02.2023. Standardet e vendosura nga GJEDNJ-ja për afatin e arsyeshëm (p.sh. standardet në çështjen Bara dhe Kola kundër Shqipërisë ose çështjen Popadić kundër Serbisë) merren parasysh dhe përdoren në vendimmarrjet për çështjet gjyqësore që prekin fëmijët, nisur edhe nga fakti që vendimmarrja dhe arsyetimi i vendimit bëhet nga trupa gjyqësore e çështjes, e cila në shumë raste referohet edhe tek vendimet e GJEDNJ¹⁹⁴.

Shkaqet që cojnë në zgjatjen përtej afateve ligjore dhe përtej afatit të gjkimit të arsyeshëm të çështjeve të mbrojtjes së fëmijëve dhe çështjeve të tjera familjare që prekin ata, të evidentuara nga vetë gjykata e apelit, janë:

- a)** numri i lartë i çështjeve të mbartura nga gjykatat e apeleve pas datës 01.02.2023 (gjithsej 33.731 dosje të ardhura nga gjykatat e apelit të rretheve që u mbyllën);
- b)** numri jo i plotë i gjyqtarëve referuar vendimit të KLGJ-së nr. 505, datë 21.11.2022 “Për fillimin e funksionit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm” (nga 76 gjyqtarë që duhet të jenë në detyrë sipas organikës së miratuar, në fund të vitit 2023 rezultojnë 25 gjyqtarë)¹⁹⁵.

Norma e zgjidhjes/likujdimit për të gjitha llojet e çështjeve CR¹⁹⁶ në vitin 2023 është **67.6%** ndërsa për çështjet e natyrës civile, CR është **61.8%**. Norma e likujdimit jo e afërt me 100% është tregues jo i kënaqshëm për likujdimin e çështjeve. Norma e zgjidhjes së çështjeve tregon nëse gjykata ka qenë e aftë të zgjidhë më shumë çështje se sa janë regjistruar për shqyrtim në vitin 2023 dhe për rrjedhim nëse edhe një pjesë e çështjeve të mbartura nga viti i mëparshëm janë zgjidhur.¹⁹⁷

Koha e nevojshme për përfundimin/likujdimin e çështjeve (DT) për vitin 2023, sa i përket përfundimit/likujdimit të çështjeve të natyrës civile të themelit është 2790.6 ditë¹⁹⁸.

¹⁹⁴ Id.

¹⁹⁵ Pyetësori i plotësuar nga gjykata dhe Analiza Vjetore për vitin 2023

¹⁹⁶ Raporti i thjeshtë i dalë nga pjestimi ndërmjet çështjeve të zgjidhura me çështjet e reja të regjistruara brenda një periudhe vjetore, i shprehur në përqindje

¹⁹⁷ Analiza Vjetore 2023 e Gjykatës së Apelit

¹⁹⁸ Analiza Vjetore 2023 e Gjykatës së Apelit

Ngarkesa e gjyqtarëve me çështje gjatë vitit 2023 (duke pjestuar numrin total të çështjeve të regjistruara në vitin 2023 me numrin e gjyqtarëve të gjykatës), rezulton **357 çështje të shqyrtuara për gjyqtar si relator**. Ky tregues nxjerr në pah ngarkesën shumë të lartë në punë për gjyqtar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Ngarkesa e lartë e numrit të çështjeve të përfunduara për gjyqtar ka ndikuar në afatin e arsytimit të vendimeve gjyqësore dhe si rrjedhojë edhe në kryerjen me vonesë të veprimeve administrative lidhur me komunikimin e vendimeve¹⁹⁹.

Pas hartës së re gjyqësore, në fund të vitit 2023 në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ishin në detyrë **25 nga 78 gjyqtarë** që është numri i miratuar nga KLGJ²⁰⁰.

Raporti i gjyqtarëve me stafin administrativ rezulton të jetë në një ekuilibër të drejtë në gjykatën e apelit, pas hyrjes në fuqi të hartës së re gjyqësore. Këshilli i Gjykatës ka marrë të gjitha masat e nevojshme dhe është arritur të sigurohet një ekuilibër i drejtë i raportit gjyqtar-sekretar, duke arritur raportin **1 sekretar gjyqësor/ 1 gjyqtar**. Nga ana e Zv/Kryetarit është bërë shpërndarja e ndihmësave ligjorë pranë trupave gjyqësore në raportin **2 ndihmës/ 1 trupë gjyqësore**²⁰¹.

Gjykata e apelit **nuk ka një seksion të posacëm për çështjet familjare**. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, referuar Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” dhe bazuar në vendimin nr.1, date 02.02.2023 të Këshillit të Gjykatës, janë të ndarë në 2 seksione, seksioni penal dhe seksioni civil, ku përfshihen çështje civile të përgjithshme, familjare, tregtare, etj.. Në vitin 2023, **seksioni civil përbëhet nga 12 gjyqtarë, të ndarë në 4 trupa gjyqësore**²⁰².

Gjykata e apelit garanton një **shpërndarje proporcionale të ngarkesës mesatare të çështjeve për gjyqtar**, pasi shpërndarja e çështjeve bëhet nëpërmjet shortit elektronik (sistemi ICMIS) ose rishortimit të çështjeve nëpërmjet shortit elektronik, i cili përcakton një numër të barabartë ngarkese për secilin gjyqtar, referuar numrit të çështjeve të regjistruara²⁰³.

Raporti i gjyqtarëve të apelit për numër banorësh kur aktualisht në këtë gjykatë ushtrojnë funksionin 25 gjyqtarë, të cilët mbulojnë çështjet e ankmuara nga gjithë gjykatat e shkalleve të para të juridiksionit të përgjithshëm të të gjithë vendit, rezulton të jetë shumë larg normës evropiane (krahasimisht me normën evropiane 22.2 gjyqtarë për 100.000 banorë).

Në lidhje me sistemin e menaxhimit të çështjeve, gjykata ka në përdorim prej vitit 2007 sistemin **ICMIS**, i cili nuk arrin të vetgjenerojë të dhëna statistikore. Në sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore “ICMIS”, regjistrohen, planifikohen, hidhen të dhënat, procesverbalet, vendimet dhe

¹⁹⁹ Id.

²⁰⁰ Id.

²⁰¹ Analiza Vjetore 2023 e Gjykatës së Apelit dhe Pyetësori i plotësuar nga gjykata

²⁰² Id.

²⁰³ Id.

çdo e dhënë tjetër që ka lidhje me çështjet. Ndër problematikat e evidentuara në mënyrë të vazhdueshme për funksionimin e këtij sistemi nga vetë gjykata, ndër më kryesorët renditen:

- mosgjenerimi i të dhënave statistikore dhe raporteve të tjera të sakta dhe sipas modelit të kërkuar, në funksion të statistikave të kërkuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, Ministria e Drejtësisë;
- migrimi i databazave të gjykatave të tjera të apelit ka sjellë problem në dublikimin e informacionit për përdoruesit e sistemit;
- moskryerja e një sërë funksionesh, si mospërjashtimi automatik nga gjykimi në themel i çështjes i gjyqtarëve që kanë shqyrtuar kërkesat në fazën e hetimeve dhe në seancë paraprake njëkohësisht, pa qenë e nevojshme kryerja e veprimeve të tjera nga përdoruesi si rishortimi i çështjes, etj;
- dosjet e pambyllura në sistem vazhdojnë të jenë problematike në evidentimin e saktë të ngarkesës së gjyqtarëve. Numri i dosjeve që nuk janë mbyllur në sistem e kalojnë shifrën 20 mijë²⁰⁴.

Në vendimin nr.78, datë 30.05.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ) “Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në Gjykatën e Apelit”, është përcaktuar se çështjet gjyqësore që kanë për objekt të drejtat e fëmijëve apo që kanë ndikim tek një fëmijë i mitur janë çështje që shqyrtohen me prioritet. Në këtë aspekt, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm u ka dhënë prioritet të veçantë çështjeve penale me të mitur ose civile që kanë ndikim tek të miturit, e konkretisht me vendimin e datës 01.01.2023 dhe datës 13.12.2023 të Këshillit të Gjykatës, janë marrë masat për caktimin e gjyqtarëve që gjykojnë çështjet penale për të mitur në konflikt me ligjin dhe të mitur viktimë nga vepra penale si dhe grafikun e gjykimit të këtyre çështjeve. Prioritizimi i këtyre çështjeve, përveç caktimit të trupave gjyqësore nga Këshilli i Gjykatës, është shoqëruar edhe me masa të tjera, si: përcaktimi i grafikut të gjykimit të çështjeve gjyqësore, orareve, sallave si dhe listës së gadishmërisë, për çështjet me karakter urgjent ku përfshihen të mitur (çështje penale) si dhe çështjet civile me objekt urdhëra mbrojtje, urdhëra të menjëhershme mbrojtje²⁰⁵.

Gjykata e apelit ushtron një kontroll të efektshëm të shkeljeve ligjore dhe faktike të gjykatave më të ulëta, për çështjet gjyqësore që kanë për objekt të drejtat e fëmijëve apo që kanë ndikim tek fëmijët. Rezultojnë 3 çështje me objekt zgjidhje martesë, në të cilat preken dhe interesat e fëmijëve, të cilat janë kthyer për rigjykim në shkallë të parë, gjatë periudhës 2020 – 2022²⁰⁶.

Gjykata e apelit garanton efincencën dhe transparencën për përdoruesit e jashtëm të sistemeve të teknologjisë dhe informacionit të gjykatës dhe palët e interesuara në proces duke qenë se për çështjet e regjistruara apo të përfunduara në këtë gjykatë, informacioni është i aksesueshëm për këdo dhe në çdo kohë, qoftë duke u paraqitur fizikisht pranë sporteleve të kësaj gjykate apo Zyrave të Shërbimit nëpër rrethe ose nëpërmjet faqes zyrtare në internet të kësaj gjykate, ku pasqyrohen

²⁰⁴ Analiza Vjetore 2023 e Gjykatës së Apelit

²⁰⁵ Pyetësori i plotësuar nga gjykata

²⁰⁶ Id.

në mënyrë të saktë dhe në kohë reale, informacione për çështjet dhe veprimtarinë e gjykatës në përgjithësi. Në lidhje me marrjen e informacionit për çështje të caktuara gjyqësore nga faqja në internet e gjykatës, personat e interesuar duhet të jenë të pajisur me numrin e çështjes përkatëse në mënyrë që të aksesojnë në këto të dhëna²⁰⁷.

Gjykata e apelit ka sqaruar se ka aplikuar gjropa për rastet e zvarritjeve të çështjeve nga ana e palëve pjesëmarrëse në proces, referuar Ligjit 44/2021 (që ka ndryshuar nenin 62 të K.Pr.Civile) dhe ka patur raste që janë gjobitur palët për shkak të abuzimit me të drejtën e ankimit, ose gjobitjes së avokatëve gjatë seancave gjyqësore për shkak të mospjesëmarrjes në gjykim pa shkaqe të arsyeshme, shkaqe të cilat sjellin edhe zvarritje të çështjeve²⁰⁸.

VII.2.a) Çështjet e mbrojtjes së fëmijës, përpara dhe pas hartës së re gjyqësore (2020 - 2023) në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë

Numri i çështjeve të mbrojtjes së fëmijëve dhe çështjeve të tjera familjare që prekin ata, që janë **regjistruar** në gjykatë (për vitet 2020-2023), rezulton në rritje nga viti në vit, dhe në rritje edhe pas hartës së re gjyqësore. Më konkretisht, për vitin 2020 janë regjistruar 487 çështje, për vitin 2021 janë regjistruar 454 çështje, për vitin 2022 janë regjistruar 642 çështje.

Kërkesat civile me objekt Urdhër Mbrojtje janë gjykuar brenda afatit ligjor sipas analizës vjetore të gjykatës për vitin 2023.

VII.2.b) Çështjet familjare që prekin fëmijët, përpara dhe pas hartës së re gjyqësore (2020 - 2023) në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë

Gjykata e apelit disponon **statistika/ të dhëna të përgjithshme se sa zgjasin proceset gjyqësore të fëmijëve dhe çështjeve të tjera familjare që prekin ata deri në dhënien e vendimit përfundimtar.** Cdo proces gjyqësor ka specifikat e tij dhe kohëzgjatja e çështjes varet nga objekti, natyra e çështjes ose faktorë të tjerë që ndikojnë në zgjatjen e procesit. Përgjithësisht për çështje të kësaj natyre, gjyqtaret e apelit prioritojnë shqyrtimin në një afat sa më të shpejtë kohor. Te dhenat në këtë drejtim janë të ndryshme, por pjesa më e madhe e çështjeve të kësaj natyre zgjidhen për një afat kohor deri në 2 vite.

Numri i çështjeve që përfshijnë fëmijë (vajza dhe djem), të cilat janë **gjykuar** në periudhën 2020-2023, **rezulton në rritje nga viti në vit edhe pas hartës së re gjyqësore. Në vitin 2023 janë gjykuar 67 çështje familjare** (ku përfshihen çështje me objekt zgjidhje martesë, pagim detyrimi ushqimor, ushtrim përgjegjësie prindërore, lëshim autorizimi për fëmijët e mitur), nga të cilat 54 çështje zgjidhje martesë, 6 çështje lidhur me përgjigjësinë prindërore dhe 6 çështje lidhur me detyrimin ushqimor të fëmijëve, 1 çështje për dhënie autorizimi, ku rezulton të jenë përfshirë **56 fëmijë nga të cilët 34 djem dhe 22 vajza.**

²⁰⁷ Id.

²⁰⁸ Id.

Për çështje që janë regjistruar në gjykatën e apelit dhe që prekin fëmijët (deri në 18 vjec) por që gjatë fazës së zhvillimit të proceseve gjyqësore në gjykatën e apelit **këta fëmijë e kanë arritur moshën 18 vjecare**, të gjykuara përtej afateve të arsyeshme të gjykimit, rezultojnë si vijon: Për vitin 2020 ka patur 4 raste (3 djem dhe 1 vajzë); Për vitin 2021 ka patur vetëm 1 rast (vajzë); Për vitin 2022 ka patur 3 raste (2 djem dhe 1 vajzë).

Rritja e numrit të çështjeve në Gjykatën e Apelit, për shkak të hartës së re gjyqësore, ka ndikuar në tejkalimin e afateve të arsyeshme të gjykimit dhe zvarritjen e çështjeve, sidomos për shkak të mosplotësimit të numrit të gjyqtarëve të përcaktuar në vendimin KLGJ nr. 505, datë 21.11.2022 dhe numrit të madh të dosjeve të transferuara nga gjykata e apeleve të rretheve.

Numri i çështjeve të gjykuara brenda afatit të arsyeshëm dhe numri i çështjeve të gjykuara jashtë afatit të arsyeshëm (për secilin vit), lidhur me afatet e gjykimit të çështjeve fokus i kësaj analize, në gjykatën e apelit për vitet 2020-2023 rezultojnë sipas të dhënave statistikore në Aneksin “Statistikat 2020-2023” të kësaj analize.

VII.3. Përmbledhje e gjetjeve/ rezultateve, në lidhje me situatën faktike të drejtësisë për fëmijët, para dhe pas hartës së re gjyqësore

VII.3.a) Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë

- 1) Sipas parashikimeve të ligjit 98/2016, gjykatat dërgojnë statistika të hollësishme për volumin te punës, drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor apo Ministrisë së Drejtësisë. Gjykata e Tiranës aplikon sistemin për menaxhimin e çështjeve gjyqësore ARK IT, një sistem që funksionon që nga viti 2002, i përmirësuar dhe i konfiguruar sipas nevojave të gjykatës për nxjerrjen e statistikave të detajuara dhe implementimin e ndryshimeve ligjore. Sistemi i menaxhimit të çështjeve gjyqësore ARK IT mundëson nxjerrjen e disa statistikave në nivel gjykate, mbi vlerësimin e kohëzgjatjes së përgjithshme të proceseve gjyqësore, sipas llojit të tyre, por jo cdo lloj statistike sidomos për çështje familjare që prekin fëmijët dhe që gjykohen tej afateve të arsyeshme.
- 2) Problematikë e hasur nga ana e gjyqtarëve dhe punonjësve të gjykatës ka qenë njoftimi i palëve për të marrë pjesë në proces. Pavarësisht se është përmirësuar ndjeshëm në krahasim me vitet e kaluara, vazhdon të mbetet një problem i rëndësishëm mungesa e adresave të sakta për palët dhe selitë e avokatëve për të kryer me efektivitet njoftimin e tyre. Mungesa e përgjegjshmërisë të një pjese prej tyre për të ndihmuar mbarëvajtjen e procesit gjyqësor, përmes njoftimit të cdo lloj ndryshimi të adresës dhe kontakteve personale elektronike është bërë shkak për zvarritjen e gjykimit dhe njoftimin e vendimeve. Me ngritjen e platformës online për komunikimet, parashikohet se do të ketë një risi sa u përket njoftimeve në kohë reale, duke evituar kësaj shtyrjet e seancave gjyqësore.

- 3) Nuk ka një bazë të integruar të të dhënave ku gjyqtarët të kenë një akses të lehtësuar në jurisprudencë, ligjet e ndryshuara, pasi mungon një kodifikim i këtyre ligjeve me përmbajtje të integruar të një cilësie të lartë, që ndihmon gjyqtarët në punën e përditshme. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për legjislacionin ku mbështetet vendimmarrja për çështjet që prekin fëmijët, si mjet pune për gjyqtarët, ku konstatohet se ligjet nuk janë të përditësuara në kohë, në mënyrën e duhur e pa gabime. Të gjitha ndryshimet ligjore apo të kodeve gjenden në mënyrë të veçuar nga njëri-tjetri në faqet elektronike në ëeb, ndërsa dihet që kërkimi ligjor është një mjet i rëndësishëm për gjyqtarin, që e ndihmon për të interpretuar ligjin drejt dhe në mënyrë të unifikuar. Prandaj, kjo është një detyrë për organet e menxhimit të sistemit gjyqësor që të sigurojnë aksesin e gjyqtarëve në legjislacion dhe jurisprudencë në mënyrën e duhur.
- 4) Raporti i gjyqtarëve (efektiv) për numër banorësh në vitin 2023 ka rezultuar 5.6 gjyqtarë për 100.000 banorë (bazuar në numrin e popullsisë së Qarkut Tiranë më 01.01.2023 sipas INSTAT), shifër thelbesisht shumë e ulët kjo krahasimisht me normën evropiane 22.2 gjyqtar për 100.000 banorë.
- 5) Mbingarkesa e gjyqtarëve me çështje gjyqësore në shqyrtim, konkludohet si një nga shkaqet kryesore që çojnë në zgjatjen përtej afateve ligjore dhe përtej afatit të gjykimit të arsyeshëm të çështjeve të mbrojtjes së fëmijëve dhe çështjeve të tjera familjare që prekin ata.
- 6) Ndryshimi i vazhdueshëm i gjyqtarëve për shkak të procesit të vettingut është një shkak tjetër që ka ndikuar në zvarritjen në kohë të çështjeve. Kur ka pasur shkarkime nga vetting-u me urdhër të Kryetarit të Gjykatës është bërë inventarizimi dhe rishortimi automatik i çështjeve të gjyqtarit të larguar, procedura këto që kanë ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimit.
- 7) Ristrukturimi i hartës gjyqësore në Shqipëri, duke rezultuar në bashkimin e disa gjykatave, shënon një moment historik të rëndësishëm në peizazhin ligjor të vendit. Edhe pse për këtë raport janë siguruar të dhëna statistikore nga gjykatat, mungesa e të dhënave gjithëpërfshirëse që detajojnë ndikimin e drejtpërdrejtë të ndryshimeve të hartës gjyqësore në afatet kohore të çështjeve specifike, përbën një kufizim në nxjerrjen e konkluzioneve përfundimtare. Duke qënë se nuk na janë vendosur në dispozicion statistika të plota dhe nga të gjithë interlokutorët për vitin 2023 (kryesisht analiza vjetore të KLGJ-së, Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë), si dhe duke pasur parasysh që harta e re gjyqësore ka filluar të zbatohet në shkurt të vitit 2023, është e pamundur të kemi një panoramë të saktë, mbi jo vetëm të dhënat statistikore, po edhe sa i përket impaktit që vetë harta e re gjyqësore ka pasur në këtë nivel gjyqësor.

VII.3.b) Në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë

- 1) Ndryshimi i vazhdueshëm i gjyqtarëve për shkak të procesit të vettingut ka patur ndikim në zvarritjen në kohë të çështjeve. Procesi i vettingut ka krijuar vonesa në procesin e gjykimit,

pasi çdo çështje e gjyqtarëve të shkarkuar i është nënshtruar normalisht procesit të rishortimit dhe rikryerjes së veprimeve administrative përkatëse. Largimi i gjyqtarëve përmes procesit të vettingut, nuk është pasuar nga një strategji efikase për zëvendësimin e tyre në apel, me qëllim eliminimin e kushteve për zvarritje gjyqësore. Të dhënat mbi numrin e çështjeve dhe kohëzgjatjen e tyre, në rastet kur është ndryshuar gjyqtari gjatë procesit rezultojnë të larta (nuk është dhënë shifër), pasi çështjet e rishortuara i janë bashkuar çështjeve që gjyqtari i ri kishte në ngarkim, duke shtuar stokun e tyre.

- 2) Procedurat e migrimit të bazës së të dhënave dhe transferimit të dosjeve nga gjykatat e mbyllura të apelit kanë patur ndikimin e tyre në kohëzgjatjen e gjykimit, por arsye kryesore që ka ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimit, e vlerësuar nga vetë gjykata si e tillë, është mosplotësimi i organikës me gjyqtarë apeli.
- 3) Në lidhje me ambientet e vëna në dispozicion të gjykatës për salla gjykimi apo arkivë për dosjet e ardhura nga gjykatat e mbyllura të apelit, ato rezultojnë të pamjaftueshme duke ndikuar negativisht në gjykimin në afat të çështjeve.
- 4) Ngarkesa e lartë e numrit të çështjeve për gjyqtar në gjykatën e apelit, ka ndikuar në afatin e arsyetimit të vendimeve gjyqësore dhe, si rrjedhojë, edhe në kryerjen me vonesë të veprimeve administrative lidhur me komunikimin e vendimeve palëve në proces.
- 5) Një pengesë të konsiderueshme në shpejtësinë e gjykimit edhe në vitin 2023 përbën sistemi i shërbimeve postare të njoftimeve, mungesa e një sistemi të saktë adresash, mungesa e njohurive proceduriale të punonjësve të postës që kryejnë njoftimet për llogari të gjykatës.
- 6) Faktorët e jashtëm që kanë ndikuar në shpejtësinë në gjykim janë mosparaqitja e palëve në gjykim dheparaqitja e kërkesave për shtyrje të seancës. Edhe përfaqësuesit ligjorë të palëve kërkojnë në shumë raste shtyrje seance, për shkak të paaftësisë të shoqëruar me raport mjekësor apo pjesëmarrjes në gjykime të tjera.
- 7) Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë nuk ka seksion familjar. Këshilli i Gjykatës, me anë të dy vendimeve të vitit 2023 ka marrë masa për caktimin e gjyqtarëve që gjykojnë çështjet penale për të mitur në konflikt me ligjin dhe të mitur viktimë nga vepra penale si dhe grafikun e gjykimit të këtyre çështjeve, por nuk rezulton të ketë priorizuar me vendimmarrje të ngjashme edhe çështjet civile që prekin të miturit.

VII.3.c) Konkluzione të përgjithshme

Pas implementimit të hartës së re gjyqësore në vitin 2023, sistemi gjyqësor është përballur me një ulje të ngarkesës së punës, ku numri total i çështjeve në shqyrtim është 5.1% më i vogël se në vitin 2022. Një ndër faktorët kontribues në këtë drejtim është ulja e numrit të çështjeve të reja të

regjistruara në rang vendi. Gjatë vitit 2023, qytetarët i janë drejtuar më pak gjykatave në rang vendi, duke sjellë një ulje prej 9.5% të çështjeve të reja të regjistruara, krahasuar me vitin paraardhës. Pjesa më e madhe e gjykatave kanë funksionuar me kapacitet të reduktuar të gjyqtarëve, nën 70%, ndërsa në nivel kombëtar vetëm 60.5% e organikës së gjyqtarëve kanë qenë efektivisht në detyrë gjatë vitit 2023. Ngarkesa e punës në gjykata është përballuar nga vetëm 247 gjyqtarë ose 8.94 gjyqtarë për 100.000 banorë. Ky raport është 60% më pak se mesatarja e normës evropiane (22.2 gjyqtar për 100.000 banorë). Rendimenti mesatar i punës për gjyqtar në rang vendi, gjatë vitit 2023, ka qenë pothuajse 566 çështje për gjyqtar, që shënon një rritje me 5 çështje më tepër krahasuar me një vit më parë (561 në 2022). Nga fillimi i procesit të rivlerësimit kalimtar deri në fund të vitit 2023, me vendim të KPK-së janë shkarkuar nga detyra në total 137 gjyqtarë, ndërkohë që rezultojnë 161 numri i vakancave në sistem për magistratë (gjyqtarë).²⁰⁹

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit nga data **8 shkurt 2018 deri në datën 31 maj 2024** ka dhënë **763** vendime, nga të cilat²¹⁰:

- **konfirmim në detyrë** për 161 gjyqtarë;
- **shkarkim nga detyra** për 143 gjyqtarë;
- **ndërprerje procesi** për 60 gjyqtarë (dorëheqje sipas Kushtetutës);
- **pushimin e procesit** për 3 gjyqtarë (dorëheqje sipas ligjit për rivlerësimin kalimtar);
- **përfundimin e procesit** pa një vendim përfundimtar për 25 gjyqtarë (dalja në pension apo pamundësi në ushtrimin e detyrës sipas ligjit);
- **pezullimin nga detyra** për 3 prokuror.

Në lidhje me vendimmarrjen e KPK-së rezultojnë 96 vendime të apeluara për konfirmimin në detyrë dhe 250 vendime të apeluara për shkarkimin nga detyra, pra **250 gjyqtarë dhe prokurorë të cilët janë pezulluar në ushtrimin e detyrës së tyre deri në marrjen e një vendimi përfundimtar nga KPA.**

Vendimmarrja e Kolegjit të Posaçëm të Apelit për të njëjtën periudhë paraqitet me 248 vendime gjithsej, nga të cilat 63 vendime për lënien në fuqi të vendimit të KPK-së (25%) dhe 185 vendime për ndryshimin/pushimin/prishjen e vendimit të KPK-së (75%).

Pavarësisht përpjekjeve të gjykatave për të ulur numrin e çështjeve të prapambetura, rezultojnë se ato nuk i kanë plotësuar kërkesat e standardeve për proces të rregull ligjor, përfshirë këtu edhe atë të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm, sipas nenit 42 të Kushtetutës, nenit 6 të KEDNJ-së dhe jurisprudencës së konsoliduar të Gjykatës Kushtetuese. Kjo e fundit në vendimin nr. 34, datë 01.11.2021, ka evidentuar se pavarësisht se ka disa metoda që mund të zbatohen nga gjykatat për të nxitur përkohësisht përsheptimin e gjykimit të çështjeve, nëse edhe një zgjidhje e tillë rezultojnë në tejzgjatje dhe kthehet në një problem të organizimit strukturor, atëherë shteti duhet të sigurojë

²⁰⁹ Raport Vjetor për vitin 2023 i KLGJ-se

²¹⁰ Raport statistikor i KPK, për periudhën shkurt 2018 – 31 Maj 2024. www.kpk.al

miratimin e masave më efektive dhe të organizojë sistemin gjyqësor, në mënyrë që të garantohet e drejta për të marrë një vendim përfundimtar brenda një periudhe të arsyeshme.

Avokati i Popullit sjell gjithashtu në vëmendje Raportin e vecantë të tij “Për politikën e pensionit ushqimor pas divorcit” (2022) ku është trajtuar roli i gjykatave në aspektin e ekzekutimit të vendimeve për detyrimin për ushqim. Sipas këtij raporti “*është e rëndësishme që gjykatat të shprehin edhe për mënyrën e ekzekutimit të vendimmarrjes për caktimin e detyrimit ushqimor, me qëllim që vendimi të jetë realisht i zbatueshëm. Nuk ka ende një jurisprudencë gjyqësore për të shmangur rastet e mosekzekutimit të vendimeve për detyrimin për ushqim ndaj fëmijëve, brenda një afati të arsyeshëm*”. Më tej në raport theksohet se “*gjykata në vendimin e saj për zgjidhjen e martesës duhet të përcaktojë një masë paraprake për detyrimin ushqimor që duhet të paguajë prindi, të cilit nuk i është lënë fëmija për rritje dhe edukim. Roli i gjykatave duhet të rritet për të krijuar një standard të konsoliduar në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore me objekt “Caktimin e detyrimit ushqimor në interesin e fëmijës”, në respektim të afateve të arsyeshme të parashikuara në KPrC (nenet 399/2 e vijues)*”. Gjithashtu në raport evidentohet si zgjidhje e mundshme “*zëvendësimi i prindit debitor nga shteti, për një periudhë emergjente*”. Ky trajtim i veçantë duhet të realizohet të paktën për prindërit debitorë që duhet të paguajnë pension ushqimor për fëmijët deri në 14 vjeç. Kjo është një mundësi pozitive jo vetëm në interes të fëmijës, por edhe për prindin debitor. Më pas, shteti ka të drejtë të kërkojë nga prindi debitor të gjithë vlerën e paguar si detyrim ushqimor për fëmijën e tij.

Nga ana tjetër, përcaktimi në Kodin e Procedurës Civile i afateve maksimale të përfundimit të gjykimit të çështjeve civile në përgjithësi (ku hyjnë edhe çështjet familjare që prekin fëmijët), në gjykatat përkatëse në të tre shkallët e gjykimit, mendojmë se nuk është i mjaftueshëm për sa i përket çështjeve fokus analize, sepse efikasiteti i parashikimit të këtyre afateve duhet të lidhet me situatën faktike të zbatimit të tyre. Këto afate janë përcaktuar për proceset civile në përgjithësi ndërsa për çështjet familjare që prekin fëmijët nuk janë parashikuar afate specifike (sidomos afate minimale), duke u bërë kështu të pazbatueshme në praktikë këto afate, për shkak të mungesës së kapaciteteve në gjykata.

Gjykatat kanë bërë përpjekje për të ruajtur ritmin e zgjidhjes së çështjeve dhe mesatarja e normës së likuidimit të çështjeve në rang vendi paraqitet e ndryshme. Norma e likuidimit të çështjeve për Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm nuk paraqitet e kënaqshme. Vërehet se në krahasim me vitin e mëparshëm ka ulje të likuidimit të çështjeve. Nga të dhënat rezulton se, norma e likuidimit të çështjeve civile është ulur me 38%. Për Gjykatat e Shkallëve të Para të Juridiksionit të Përgjithshëm likuidimi i çështjeve civile për vitin 2023, paraqitet në vlera të ndryshme dhe treguesi mesatar për çështje civile është ulur me 5%. Megjithatë për shkak të kohës së shkurtër të zbatimit të Hartës së Re Gjyqësore, këto konstatime duhet të merren me rezervë, për t’u vlerësuar objektivisht gjatë viteve në vijim²¹¹.

²¹¹ Raport vjetor për vitin 2023 i KLGJ.

Me përfundimin e procesit të implementimit të Hartës së Re Gjyqësore, vlen të theksohet se KLGJ ka marrë masa të mëtejshme që lidhen me mirëfunksionimin e sistemit gjyqësor dhe në veçanti hartimin e një plani strategjik për reduktimin e çështjeve të prapambetura në gjykata. Për këtë qëllim KLGJ ka ngritur një grup pune²¹² dhe nëngrupet përkatëse të ndara sipas gjykatave, edhe pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë²¹³.

Për rrjedhim, nga KLGJ u publikua në muajin Maj 2024 “Strategjia kombëtare e uljes së numrit të çështjeve të prapambetura në gjykata (2024-2027)”, duke renditur 7 objektiva në synimet strategjike për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura, e konkretisht:

Objektivi 1: Ulja strukturore e numrit të çështjeve të prapambetura nëpërmjet marrjes së masave konkrete për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura

Objektivi 2: Forcimi i kapaciteteve të gjyqësorit (gjyqtarëve dhe ndihmësve ligjorë)

Objektivi 3: Përmirësimi i metodave të punës

Objektivi 4: Ndryshimet ligjore të përqendruara në uljen dhe parandalimin e çështjeve të prapambetura

Objektivi 5: Përcaktimi i standardeve minimale të kohës dhe sasisë dhe matja e performancës.

Objektivi 6: Rritja e bashkëpunimit dhe koordinimit institucional me aktorë të tjerë

Objektivi 7: Rritja e Transparencës dhe e Besimit të Publikut²¹⁴.

Konsolidimi i përpjekjeve për të forcuar efikasitetin dhe transparencën e të gjitha gjykatave dhe prokurorive, edhe nëpërmjet veprimeve të shpejta dhe vendimtare për ngritjen e një Sistemi Modern për Menaxhimin e Integruar të Çështjeve dhe hartimin e një plani efikas për zbatimin e Hartës së Re Gjyqësore,²¹⁵ është përmbushur tashmë në pjesën më të madhe të detyrimeve të tij që lidhen me implementimin e Hartës së Re Gjyqësore, plotësimin e disa vendeve vakante në gjykata, apo përmirësimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve. Për sa i përket përmirësimit të sistemit të menaxhimit të çështjeve, Këshilli në bashkëpunim me QTI-në ka marrë masa për të mundur nga pikëpamja ligjore dhe teknike ndërtimin e sistemit ICMIS të ri.²¹⁶

Në dritën e statistikave të dhëna nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për periudhën e analizuar, është evidente se ndonëse ato ofrojnë njohuri të vlefshme për backgroundin e paditësve të përfshirë në çështjet gjyqësore në lidhje me fëmijët, ato paraqesin disa kufizime. Mungesa e të dhënave në lidhje me afatet kohore të çështjeve, së bashku me mungesën e statistikave krahasuese të viteve të mëparshme, paraqet sfida në kryerjen e një analize gjithëpërfshirëse për të konstatuar ndikimin e ndryshimeve të hartës gjyqësore në zhvillimet

²¹² Urdhër nr.42, datë 20.07.2023 i Kryetares së LGJ-se “Për hartimin e strategjisë për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në gjykata”

²¹³ Raport Vjetor për vitin 2023 i KLGJ-se

²¹⁴ “Strategjia kombëtare e uljes së numrit të çështjeve të prapambetura në gjykata (2024-2027)”, www.klgj.al

²¹⁵ Nje nga Rekomandimet e dates 06.07.2023 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë per KLGJ-ne

²¹⁶ Raport Vjetor për vitin 2023 i KLGJ-se

procedurale dhe vonesat e mundshme. E njëjta problematikë e mungesës së statistikave specifike dhe sidomos e statistikave për çështjet e fëmijëve dhe rastet e zgjatjes së gjyqimit tej afateve të arsyeshme, është evidentuar edhe në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Pa një pikë referimi historik për t'u ballafaquar me statistikën e vitit 2023, bëhet e vështirë të dallosh ndonjë tendencë ose model të dallueshëm në afatet kohore të çështjeve përpara dhe pas ristrukturimit të hartës gjyqësore. Për më tepër, fokusimi vetëm në *backgroundin* e paditësve, ndonëse informues për të kuptuar përbërjen demografike të atyre që janë të përfshirë në proceset gjyqësore në lidhje me fëmijët, nuk ofron një pamje tërësore të aspekteve procedurale dhe pengesave të mundshme brenda sistemit ligjor.

Pavarësisht këtyre kufizimeve, është thelbësore të njihet vlera e të dhënave të disponuara nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë jo vetëm për të hedhur dritë mbi demografinë e paditësve të përfshirë në çështjet gjyqësore që kanë të bëjnë me fëmijët por edhe për ofrimin e informacionit në lidhje me faktorët socio-ekonomikë që ndikojnë në proceset ligjore dhe mund të informojë ndërhyrjet që synojnë adresimin e pabarazive sistematike dhe barrierave për aksesin në drejtësi.

Paralelisht, Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ka vendosur në dispozicion dhe statistikën për vitin 2023 të cilat ofrojnë disa njohuri mbi shpërndarjen e ngarkesës së punës midis gjyqtarëve në këtë gjykatë, si dhe vëllimin e çështjeve të regjistruara dhe të gjykuara gjatë vitit. Megjithatë dobia e tyre në formimin e një pamjeje gjithëpërfshirëse mbi veprimtarinë e gjykatës është disi e kufizuar e aq më tepër kur flasim për fokusimin statistikor në çështjet me ndikim të miturit.

Të dhënat për numrin e çështjeve të mbartura nga një vit në tjetrin për secilin gjyqtar ofrojnë njohuri për shpërndarjen e ngarkesës së punës dhe mund të tregojnë dallime në efikasitetin ose ngarkesën ndërmjet gjyqtarëve. Identifikimi i gjyqtarëve me ngarkesë jashtëzakonisht të lartë ose të ulët të çështjeve mund të ndihmojë në optimizimin e shpërndarjes së ngarkesës së punës për efikasitet më të mirë dhe sigurimin e zgjidhjes në kohë të çështjeve.

Të dhënat në lidhje me çështjet e regjistruara nga 1 shkurt 2023, ndihmojnë për të kuptuar vëllimin e çështjeve që hyjnë në Gjykatën e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë gjatë pjesës së mbetur të vitit 2023 që përkon dhe me ndryshimet në hartën gjyqësore. Analizimi i natyrës dhe llojeve të çështjeve të regjistruara nëpërmjet të dhënave më të detajuara mund të ndihmojë në identifikimin e tendencave sa i përket objektit të çështjeve

Raportet e KLGJ-së, që i referohen periudhës kohore përpara dhe pas zbatimit të hartës së re gjyqësore, janë të krahasueshme dhe tregojnë se nuk ka pasur regres në drejtim të aksesit në gjykatë, pra në drejtim të kërkesave të paraqitura (padi apo ankime në gjykatat më të larta). Këto

të dhëna janë tregues të faktit se kjo mënyrë organizimi, pavarësisht kohës së nevojshme për ristrukturimin, nuk ka sjellë pengesa në drejtim të aksesit efektiv, ashtu edhe në drejtim të zhvillimit të proceseve gjyqësore dhe gjykimit të çështjeve²¹⁷

Sistemi gjyqësor ka nevojë për më shumë kohë për të mundësuar evidentimin e efekteve të zbatimit të hartës së re gjyqësore. Në mes të kësaj sfide duhet nënvizuar rëndësia e monitorimit dhe vlerësimit të vazhdueshëm të këtij procesi. Është e domosdoshme që palët e interesuara të qëndrojnë vigjilentë në ndjekjen e rezultateve të reformave të tilla strukturore për të dalluar efektivitetin e tyre dhe për të identifikuar fushat për përmirësim. Në këtë situatë, një qëndrim i ndryshëm, në mungesë të të dhënave që provojnë se kufizimi në të drejtën e aksesit është më negativ se sa pasojat pozitive të pritshme, do të sillte efekte më të rënda në të drejtat e qytetarëve, pasi do i përballte ata sërish me një sistem drejtësie jo funksional të shkaktuar nga periudha tranzitore e nevojshme për riorganizimin²¹⁸.

Në të ardhmen, është thelbësore të adoptohet një qëndrim proaktiv ndaj mbledhjes dhe analizës së të dhënave, duke përfshirë masa cilësore dhe sasiore në këtë drejtim. Duke shfrytëzuar grupe të dhënash gjithëpërfshirëse dhe specifike, si dhe duke përdorur metodologji të caktuara me fokus të drejtat e fëmijëve, vlerësimet e ardhshme mund të ofrojnë një kuptim të nuancuar të ndikimit të ndryshimeve të hartës gjyqësore në afatet kohore të çështjeve që përfshijnë fëmijët. Kjo qasje holistike jo vetëm që do të lehtësojë politikëbërjen e bazuar në prova, por gjithashtu do të nxisë transparencën, llogaridhënien dhe besimin në sistemin gjyqësor.

Si përfundim, ndërkohë që raporti aktual mund të mos ofrojë prova përfundimtare në lidhje me ndikimin e drejtpërdrejtë të ndryshimeve të hartës gjyqësore në afatet kohore të çështjeve që përfshijnë fëmijë, ai nënvizon nevojën për një shqyrtim dhe vlerësim të qëndrueshëm me synimin për të monitoruar reformën gjyqësore dhe për të përmirësuar sistemin ligjor, në mënyrë që ky i fundit të jetë më i drejtë dhe efektiv në mbrojtje të të drejtave dhe mirëqenies së fëmijëve në Shqipëri.

Vetë Ligji 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”, ka parashikuar një periudhë 5-vjeçare për vlerësimin e organizimit të rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave. Kjo është një kohë e mjaftueshme për të monitoruar dhe vlerësuar përmbushjen e objektivave të Hartës së Re Gjyqësore dhe për të bërë ndryshimet e nevojshme për të garantuar përmirësimin e efikasitetit dhe cilësisë së drejtësisë. Ndërkohë ka nevojë thelbësore të bëhen ndryshimet infrastrukturore në lidhje me sistemin gjyqësor për të bërë të mundur krijimin e kushteve minimale të punës për këta gjyqtarë. Nga ana tjetër infrastruktura e sistemit, ndikon edhe në rritjen e ruajtjen e besimit të qytetarëve te drejtësia, cka edhe ka qenë një nga qëllimet e reformës në drejtësi.

²¹⁷ Vendim nr.70, datë 29.12.2023 i GJK-së, parag.83

²¹⁸ Vendim nr.70, datë 29.12.2023 i GJK-së, parag.87

VII.4. Kohëzgjatja e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore

Në lidhje me kohëzgjatjen e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, gjykatat nuk disponojnë statistika/ të dhëna, duke qenë se vendimi gjyqësor vihet në ekzekutim vullnetarisht nga palët ose nëpërmjet ekzekutimit të detyrueshëm nga përmbaruesit gjyqësor, shtetëror apo privat. Statistikat/ të dhënat mujore dhe vjetore të Gjykatës së Apelit, i dërgohen Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor, ndërsa me institucione të tjera të sistemit të ekzekutivit që mbulon mirëqenien sociale nuk ndahen këto të dhëna²¹⁹.

VII.5. Ndhimja Juridike Falas²²⁰

Mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijëve është një nga parimet më thelemore të mbrojtura në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Formë e mbrojtjes së këtij interesi është edhe aksesimi në drejtësi për të gjithë fëmijët në konflikt me ligjin duke garantuar një shërbim ligjor falas dhe cilësor. Ligji 111/2017, "Për Ndhimën Juridike të garantuar nga Shteti", në referim të nenit 11 të tij, tashmë *i ka cilësuar të miturit si subjekte të posaçëm* të cilët, pavarësisht nga të ardhurat e tyre janë përfitues të drejtëpërdrejtë të ndihmës juridike parësore dhe dytësore. Nga administrimi i të dhënave të ofruesve të ndihmës juridike parësore ndër vite, janë raportuar si vijon:

Ndhimja juridike parësore²²¹ evidentohet me raste në rritje të ndjeshme të kërkesave dhe ofrimit të ndihmës në tërësi, e për të miturit në vecanti, pas miratimit të Ligjit nr.111/2017 në kuadër të reformës në drejtësi dhe hartës së re gjyqësore. Më konkretisht rezultojnë: 4.191 përfitues **për v.2020 nga të cilët 172 të mitur**; 8.153 përfitues **për v.2021 nga të cilët 222 të mitur**; 7.616 përfitues **për v.2022 nga të cilët 317 të mitur** dhe 7.946 përfitues **për v.2023 nga të cilët 399 të mitur**.

Qendrat e ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore janë evidentuar në rritje, duke u trefishuar nga viti 2020 në vitin 2023, e konkretisht: 7 qendra në v.2020; 10 qendra në v.2021; 14 qendra në v.2022 dhe 20 qendra në v.2023.

OJF të autorizuar nga Ministri i Drejtësisë janë evidentuar në rritje, e konkretisht: 12 OJF në v.2020; 12 OJF në v.2021; 15 OJF në v.2022 dhe 15 OJF në v.2023.

Klinika Ligjore pranë Institucioneve të arsimit të Lartë (IAL) janë evidentuar në rritje, duke u dyfishuar nga viti 2020 në vitin 2023, e konkretisht: 6 IAL në v.2020; 11 IAL në v.2021; 12 IAL në v.2022 dhe 12 IAL në v.2023.

Në v.2021, për herë të parë në rajon u implementua një platformë online e dedikuar shërbimeve ligjore falas **juristionline.al**. Shërbimi ligjor falas ofrohet edhe pa pagesë në numrin i gjelbër 08001010.

²¹⁹ Pyetësi i plotësuar nga Gjykata e Apelit

²²⁰ Pytësorët e plotësuar nga Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Ndhimës Juridike Falas; analizat vjetore 2020-2023 te DNJF.

²²¹ Analizat Vjetore për vitet 2020-2023, të Drejtorisë së Ndhimës Juridike Falas; eëë.njf.gov.al

Ndihma juridike dytësore (që përfshin mbrojtjen dhe përfaqësimin me avokat, përjashtimin nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore) është evidentuar **në rritje të numrit të vendimeve të gjykatave** pas miratimit të Ligjit nr.111/2017 në kuadër të reformës në drejtësi, por **në ulje pas hartës së re gjyqësore**.

Më konkretisht për v.2020 janë dhënë 181 vendime nga të cilat 154 civile (2 vendime për të mitur); për v.2021 janë dhënë 849 vendime nga të cilat 754 civile (7 vendime për të mitur); për v.2022 janë dhënë 1030 vendime nga të cilat 691 civile (1 vendim për të mitur) dhe për v.2023 janë dhënë 773 vendime nga të cilat 647 civile (0 vendime për të mitur).

Avokatët ofruer të ndihmës juridike të garantuar nga shteti janë evidentuar në rritje të ndjeshme, duke u dyfishuar nga viti 2020 në vitin 2023, e konkretisht : 70 avokatë në v.2020; 124 avokatë në v.2021; 157 avokatë në v.2022 dhe 159 avokatë në v.2023.

Referuar parashikimit të nenit 11 të Ligjir nr.111/2017, çdo i mitur ka përfituar ndihmë juridike falas si pjesë e një prej kategorive të mëposhtme:

- a) viktimë e mitur dhe të miturve në konflikt me ligjin, në çdo fazë të procedimit penal;
- b) fëmijë, i cili jeton në institucionet e përkujdesjes shoqërore;
- c) fëmijë nën kujdestari, i cili kërkon të nis një proces pa miratimin e kujdestarit të tij ligjor ose kundër kujdestarit të tij ligjor;

Nga administrimi dhe analizimi i të dhënave të ofruesve të shërbimit të NDJ nuk rezulton asnjë rast refuzimi për dhënien e ndihmës juridike të garantuar nga shteti. Burimet financiare të parashikuara në buxhetin tre vjeçar afatmesëm kanë qenë të mjaftueshme duke mbuluar të gjitha shpenzimet e nevojshme.

Në lidhje me **ndihmën juridike parësore** në gjykatën e apelit, ka patur raste kur është kërkuar dhe dhënë ndihmë juridike falas (referuar nenit 11 të Ligjit nr.111/2017), për fëmijët dhe kujdestarët e fëmijëve interesat e të cilëve duhen mbrojtur në procese gjyqësore. Rastet kur janë pranuar kërkesat për ndihmë juridike falas i referohen çështjeve me objekt heqje zotësie për të vepruar, zgjidhje martesë, mbrojtje në çështjet penale, persona që përfitojnë pagesë për aftësi të kufizuar, njohje vjetërsie në punë për efekt pensioni.

Të dhënat në lidhje me pranimin apo refuzimin e ndihmës juridike falas në gjykatën e apelit, për çështje që prekin fëmijët janë evidentuar:

Për vitin 2022, rezulton të jenë regjistruar gjithsej 13 kërkesa për ndihmë juridike falas, nga të cilat 6 kërkesa janë pranuar dhe 7 kërkesa janë pushuar, kthyer për rigjykim apo dhe rrëzuar.

Për vitin 2023, rezulton të jenë regjistruar gjithsej 42 kërkesa për ndihmë juridike falas, nga të cilat 33 kanë përfunduar shqyrtimin me 19 kërkesa të pranuar, 2 kërkesa të kthyera për rigjykim, 11 kërkesa të rrëzuara dhe 1 kërkesë kthim aktesh.

Në lidhje me çështjen nëse mospasja e ndihmës juridike falas është ose jo një nga shkaqet e zvarritjes së çështjeve të mbrojtjes së fëmijëve dhe çështjeve të tjera familjare që prekin ata, nga gjykata e apelit është sqaruar se sipas GJEDNJ, në parim personave që u është mohuar ndihma falas, nuk u shkelet e drejta për akses sipas nenit 6, kur nuk bëjnë pjesë në kategoritë përfituese sipas skemës së përfitimit të sistemit ligjor vendas, por në raste përjashtimore, kjo lloj ndihme duhet të garantohet këtyre personave edhe jashtë skemës përfituese, kur thelbi i së drejtës për akses është cënuar.

Në lidhje me çështjen nëse **shpenzimet gjyqësore** në ngarkim të palëve, tarifat e gjykatës dhe kosto të tjera gjatë procesit janë ose jo një nga shkaqet e zvarritjes së çështjeve të mbrojtjes së fëmijëve dhe çështjeve të tjera familjare që prekin ata, nga gjykata e apelit është sqaruar se sipas ligjit shpenzimet gjyqësore parapaguhet në gjykimin e shkallës së parë, ndërsa gjatë gjykimit në apel, të vetmet shpenzime lidhen me njoftimet e palëve (për të cilat gjykata shprehet në fund të vendimit se kujt i ngarkohen) ose në rastet e riçeljes së shqyrtimit gjyqësor me marrjen e provës me ekspert për të cilat procedohet në të njëjtën mënyrë (gjyqtari shprehet në fund të gjykimit se kujt i ngarkohen).

VII.6. Trajnimet

Trajnimet e gjyqtarëve kryhen referuar programit të trajnimit të miratuar nga Shkolla e Magjistraturës për secilin vit dhe temave të përzgjedhura nga secili gjyqtar. Shkolla e Magjistraturës ka përgatitur një metodologji për procesin e matjes së efektivitetit të trajnimeve në punën e magjistratëve, bazuar në modelin e EJTN²²² (European Judicial Training Network) mbi vlerësimin e trajnimeve, të cilin do ta realizojë në disa tematika të rëndësishme, një prej të cilave është edhe standardi i zbatuar nga gjykatat për çështjet që lidhen me të mitur. Sipas metodologjisë së hartuar, procesi i vlerësimit kalon në dy faza dhe metodat për vlerësim janë sa akademike edhe të drejtpërdrejta. Faza e parë përfshin procesin e vlerësimit bazuar në të dhënat që vijnë nga vetë magjistratët që kanë zgjidhur çështje me të mitur, plotësimin e pyetësorëve të hartuar posacërisht për magjistratët e trajnuar në temat që trajtojnë çështjet me të mitur, diskutime dhe ushtrime lidhur me zbatimin në praktikë të njohurive apo rekomandimeve si dhe hartimin e një raporti të parë vlerësimi. Faza e dytë përfshin vlerësimin bazuar në të dhëna që merren nga pyetësorë drejtuar avokatëve, përdoruesve fundorë të gjykatës, kandidatëve për magjistratë në vitin e dytë dhe të tretë, shoqërisë civile/gazetarët, etj. Marrja e rezultateve, si për fazën e parë të procesit të vlerësimit, edhe për fazën e dytë parashikohet të dalë gjatë viteve 2025-2026²²³.

²²² "Rrjeti Evropian i Trajnimit Gjyqësor (EJTN) i krijuar në vitin 2000, një shoqatë ndërkombëtare jofitimprurëse e qeverisur nga dispozitat e ligjit belg, është platforma dhe promovuesi kryesor për trajnimin dhe shkëmbimin e njohurive të gjyqësorit evropian. EJTN përfaqëson interesat e mbi 120,000 gjyqtarëve, prokurorëve, trajnerëve gjyqësorë dhe stafit të gjykatave evropiane në të gjithë Evropën.

²²³ Intervista gjysëm e strukturuar me Drejtorin e Shkollës së Magjistraturës.

Nga Shkolla e Mgjistraturës janë zhvilluar gjithësej **38 trajnime për vitet 2020-2023** dhe janë planifikuar gjithsej **10 trajnime për tu zhvilluar gjatë vitit 2024**, me temë kryesore mbrojtjen e fëmijës dhe çështje të tjera familjare që i prekin ata.

Në lidhje me **trajnimet për të drejtat e fëmijëve dhe procedurat miqësore të drejtësisë për fëmijë**, nga Gjykata e Apelit është dhënë informacion se trajnimet e gjyqtarëve kryhen referuar programit të trajnimit të miratuar nga Shkolla e Magjistraturës për secilin vit dhe temave të përzgjedhura nga secili gjyqtar. Temat e trajnimeve që janë ndjekur nga gjyqtarët e apelit lidhen kryesisht me fushën penale (Pozita, statusi procedural i viktimës; Masat mjekësore dhe edukuese; Dënimet penale alternative ndaj të miturve në konflikt me ligjin; Dënimet alternative, për një jetë sa më të mirë; Kriteret ligjore dhe procedura specifike e aplikimit të lirimi me kusht; Masat e sigurimit personal ndaj të miturve në konflikt me ligjin; Roli i gjyqtarëve, prokurorëve në ekzekutimin e shmangies së dënimit; Alternativat e dënimit me burgim; etj.)²²⁴

VIII. REKOMANDIME

Me qëllim rritjen e efencës dhe efikasitetit të gjykimit të çështjeve të mbrojtjes së fëmijëve dhe çështjeve familjare që prekin ata, nisur nga rezultatet dhe problematikat e hasura në dy gjykatat e monitoruara, rekomandojmë si vijon:

- 1) Vlerësimin me prioritet të situatës dhe ndjekjen e procedurave nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ), për rritjen e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve në rang vendi, për të shkuar drejt normës europiane 22.2 gjyqtarë për 100.000 banorë.
- 2) Ndjekjen e procedurave të mëtejshme të plotësimit të vendeve vakante të gjyqtarëve në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ), për plotësimin në një kohë sa më të shpejtë të vendeve vakante.
- 3) Vlerësimin dhe caktimin e afateve standarde kohore minimale për gjykimin e çështjeve familjare që prekin fëmijët, duke respektuar parimin kushtetues të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, në mënyrë që të ulet kohëzgjatja e gjykimit të çështjeve të këtij lloji.
- 4) Të vlerësohet mundësia e krijimit të një Seksioni Familjar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, duke patur parasysh që ka një Seksion Familjar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në bashkëpunim dhe koordinim edhe me KLGJ.

²²⁴ Pyetesori i plotësuar nga Gjykata e Apelit

- 5) Marrjen e masave nga Këshillat e gjykatave, në bashkëpunim e koordinim edhe me KLGJ-në, për klasifikimin dhe menaxhimin e diferencuar të çështjeve, filtrimin dhe grupimin e tyre sipas prioritetit, duke përfshirë këtu si prioritare edhe çështjet familjare me të mitur dhe çështjet civile që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të të miturve, me qëllim dhënien e drejtësisë pa vonesa dhe përmirësimin e efikasitetit të gjykatave, në përputhje kjo edhe me Strategjinë Kombëtare të uljes së numrit të çështjeve të prapambetura në gjykata 2024-2027 të KLGJ-së.
- 6) Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë duhet të vlerësojnë me më shumë kujdes caktimin e datave sa më të shpejta të gjykimit për çështjet civile të mbrojtjes së fëmijëve, çështjet familjare që prekin fëmijët, si dhe paraqitjen e kërkesave për shtyrje nga palët, reduktimi i të cilave do të bënte të mundur lëvizjen më shpejt të çështjeve gjyqësore, duke ulur ngarkesën për secilin gjyqtar²²⁵.
- 7) Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë duhet të vlerësojnë me më shumë kujdes njoftimin e saktë dhe në kohë të palëve, udhëzimin e këtyre të fundit për të përditësuar cdo ndryshim të të dhënave të kontaktit, si dhe përdorimin e platformës online për komunikimet, kryesisht në adresat elektronike, në mënyrë që të evitohen sa më shumë shtyrjet e seancave gjyqësore, zvarritja e gjykimit dhe njoftimi i vendimeve të gjykatës, për çështjet civile të mbrojtjes së fëmijëve dhe çështjet familjare që prekin fëmijët.
- 8) Të vlerësohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor mundësia e uljes së ngarkesës së gjyqtarëve me shumë çështje gjyqësore në shqyrtim, si një nga shkaqet kryesore që çojnë në zgjatjen përtej afateve ligjore dhe përtej afatit të gjykimit të arsyeshëm të çështjeve të mbrojtjes së fëmijëve dhe çështjeve të tjera familjare që prekin ata.
- 9) Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, të vlerësojnë si ndjekjen në një kohë sa më të shpejtë të procedurave të inventarizimit dhe rishortimit të çështjeve të gjyqtarëve të larguar ose të shkarkuar nga vetting-u, ashtu edhe përfundimin në një kohë të arsyeshme të këtyre proceseve gjyqësore të filluara, me qëllim uljen e kohëzgjatjes së çështjeve të mbrojtjes së fëmijëve dhe çështjeve të tjera familjare që prekin ata.
- 10) Duhet të caktohet një punonjës i dedikuar i administratës së Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për njoftimin dhe trajtimin e dosjeve për çështjet e mbrojtjes së fëmijëve dhe çështjeve të tjera

²²⁵ Avokati i Popullit ka nxjerrë dy rekomandime në këtë drejtim për marrjen e masave për respektimin nga gjykata e apelit dhe gjykata e shkallës së parë të afateve të parashikuara në kodet procedurale për përfundimin e çështjeve dhe vecanërisht shqyrtimin me prioritet të çështjeve që lidhen me të drejtat e fëmijëve apo që kanë ndikim tek fëmijët e mitur, pavarësisht përfshirjes së gjyqatrëve në procesin e vettingut apo të lëvizjes brenda sistemit gjyqësor. Për më tepër shih rekomandimet e publikuara në faqen zyrtare elektronike të Avokatit të Popullit.

familjare që prekin ata, i cili do të jetë pikë kontakti (focal point) për secilën gjykatë edhe në marrëdhënie me gjykatat e tjera apo institucione që ofrojnë shërbime për fëmijë

- 11) Në lidhje me sistemin e menaxhimit të çështjeve, në kushtet kur Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ka aktualisht në përdorim sistemin ICMIS, ndërsa Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ka në përdorim sistemin ARK IT, të cilat nuk arrijnë të vetgjenorjnë të dhëna statistikore të detajuara për çështje specifike dhe sidomos për ato që lidhen me fëmijët, rekomandojmë implementimin e një sistemi të ri të menaxhimit të çështjeve gjyqësore, të unifikuar në të gjitha gjykatat, i cili të mund të gjenerojë të dhëna statistikore të vlefshme si për gjykatën, KLGJ-në, Ministrinë e Drejtësisë, ashtu edhe për aktorë të tjerë të interesuar, duke përfshirë edhe kohëzgjatjen apo afatet e përfundimit të gjykimit, ku të dhënat për çështjet civile të mbrojtjes së fëmijëve dhe çështjet familjare që prekin ata të evidentohen në mënyrë të vecantë.
- 12) Të vlerësohet nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor, mundësia e krijimit të një baze të integruar ligjore, ku gjyqtarët të kenë një akses të lehtësuar në jurisprudencë dhe ligjet e përditësuara, në kushtet kur mungon një kodifikim i këtyre ligjeve me përmbajtje të integruar, me qëllim që të ndihmojë gjyqtarët në punën e përditshme, kërkimin ligjor, shfrytëzimin me efikasitet të kohës, aksesin në legjislacion dhe jurisprudencë në mënyrën e duhur, etj.
- 13) Në lidhje me godinën dhe ambientet e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, është i nevojshëm sistemimi në një kohë sa më të shpejtë në një godinë të re, me numër më të madh të sallave të gjyqësore, për të krijuar një ambient të përshtatshëm dhe për të ndihmuar në evitimin e vonësive lidhur me gjykimin e çështjeve.
- 14) Të vlerësohen nevojat për vijimin me prioritet të investimeve në sistemin e drejtësisë, në drejtim të përmirësimit të kushteve të punës në gjykata, të trajnimit dhe plotësimit të nevojave të stafëve me infrastrukturën e nevojshme dhe moderne, për arritjen me efikasitet të rezultateve të punës.
- 15) Përmirësimin e nivelit të dhënies së shërbimeve në gjykata, duke u ofruar maksimalisht me të gjitha resurset njerëzore të mundshme dhe njëkohësisht shfrytëzimin e mjeteve teknologjike dhe lehtësive që ofron përdorimi i teknologjisë, për dhënien e informacionit dhe ofrimin të shërbimeve të tjera gjyqësore, kryesisht në çështjet e mbrojtjes së fëmijëve dhe çështjeve familjare që prekin fëmijët.
- 16) Zhvillimin e trajnimeve nga Shkolla e Magjistraturës, me tematika në fushën e mbrojtjes së fëmijës dhe çështjeve familjare që i prekin ata, me fokus të posacëm në kohëzgjatjen e gjykimit dhe ekzekutimit të këtyre çështjeve, për gjyqtarët e seksioneve familjare dhe administratën e gjykatës.

17) Parashikimin në legjislacion të marrjes së vendimit për caktim të detyrimit ushqimor që në fazën e kryerjes së veprimeve përgatitore nga ana e gjykatës me ekzekutim të menjëhershëm (të përkohshëm), pasi në këtë mënyrë mbrohet në shkallën më të lartë interesi i fëmijës, pavarësisht sa zgjasin procedurat e mëtejshme gjyqësore dhe plotësimi i vendeve vakante në sistemin gjyqësor.


18) Parashikimin në legjislacion të një mekanizmi për kompensimin e detyrimit ushqimor nga shteti dhe vendosjen e marrëdhënies debi-kredi midis prindit që detyrohet dhe shtetit, të paktën në rastet e fëmijëve deri në 14 vjeç, kur prindi debitor është i papunë ose nuk ka asnjë mundësi pagese.

ANEKS 1 - STATISTIKAT 2020 – 2023

I. Disa të dhëna krahasimore që tregojnë situatën në lidhje me efincencën dhe efikasitetin e shqyrtimit të çështjeve gjyqësore në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë gjatë periudhës 2020-2023, që vlerësohen me interes për këtë analizë, janë sipas tabelave dhe grafikëve si vijon:


1. Koha e përfundimit të çështjeve civile (DT), Rendimenti i punës çështje/ gjyqtar (ER) dhe Norma e likuidimit të çështjeve civile (CR), në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për vitet 2020 – 2023

Nr.	Treguesit mbi efincencën dhe efikasitetin	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023
1	Koha e nevojshme për përfundimin e çështjeve civile (ditë mesatarisht)	260,7	280,8	261	332
2	Rendimenti i punës për gjyqtar (treguesi ER): çështje /gjyqtar	443	547	563	601
3	Norma e likuidimit të çështjeve civile (CR)	84,8%	75,4%	95,6%	100%




2. Backlogu-u i çështjeve civile në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për vitet 2020 – 2023

Nr.	Backlog	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023
1	Stoku (backlog) i çështjeve civile (të mbartura nga viti i mëparshëm)	7.800	10.616	18.191	17.066
2	Çështje civile të përfunduara gjithsej	14.016	22.205	22.766	17.845
3	Çështje civile të përfunduara brenda afatit 0-2 muaj	8.052	11.080	7.165	5.997
4	Çështje civile të përfunduara brenda afatit 2-6 muaj	2.765	5.727	7.128	3.291
5	Çështje civile të përfunduara në afatin mbi 6 muaj	3.467	5.696	8.708	8.719
6	Çështje civile të papërfunduara në afatin mbi 2 vjet	834	1.613	2.377	Nuk ka info



3. Numri i gjyqtarëve sipas strukturës së miratuar, në detyrë dhe në seksionin familjar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për vitet 2020-2023

Nr.	Numri i gjyqtarëve në GJ.SH.P.J.P.Tiranë	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023
1	Numri i gjyqtarëve të miratuar sipas strukturës	76	76	76	80
2	Numri i gjyqtarëve në detyrë	64	44	37	52
3	Numri i gjyqtarëve në seksionin familjar	8	4	4	6





4. Kohëzgjatja e gjykimit të çështjeve civile dhe familjare (me dhe pa palë kundërshtare), referuar afateve kohore 0-2 muaj, 2-6 muaj dhe mbi 6 muaj, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për vitet 2020-2023.

4.1 Për vitin 2020, kohëzgjatja e përfundimit të çështjeve civile dhe familjare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ka qenë mesatarisht 260.7 ditë. Më konkretisht, referuar llojit të çështjes civile dhe familjare, kohëzgjatja e shqyrtimit gjyqësor ka qenë si vijon:

Viti 2020



Nr.	Lloji i çështjes në GJ.SH.P.J.P.Tiranë	0-2 muaj	2-6 muaj	mbi 6 muaj
1	Paditë me palë kundërshtare - civile në përgjithësi	549	603	1646
2	Paditë me palë kundërshtare - Çështje Familjare	1010	362	730
3	Paditë pa palë kundërshtare - civile në përgjithësi	5665	2053	659
4	Paditë pa palë kundërshtare - Çështje Familjare	56	145	85



4.2 Për vitin 2021, kohëzgjatja e përfundimit të çështjeve civile dhe familjare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ka qenë mesatarisht 280,8 ditë. Më konkretisht, referuar llojit të çështjes civile dhe familjare, kohëzgjatja e shqyrtimit gjyqësor ka qenë si vijon:

Viti 2021



Nr.	Lloji i çështjes në GJ.SH.P.J.P.Tiranë	0-2 muaj	2-6 muaj	mbi 6 muaj
1	Paditë me palë kundërshtare - civile në përgjithësi	486	640	2667
2	Paditë me palë kundërshtare - Çështje Familjare	1108	536	1223
3	Paditë pa palë kundërshtare - civile në përgjithësi	7981	4962	1082
4	Paditë pa palë kundërshtare - Çështje Familjare	60	177	189



4.3 Për vitin 2022, kohëzgjatja e përfundimit të çështjeve civile dhe familjare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ka qenë mesatarisht 261 ditë. Më konkretisht, referuar llojit të çështjes civile dhe familjare, kohëzgjatja e shqyrtimit gjyqësor ka qenë si vijon:

Viti 2022



Nr.	Lloji i çështjes në GJ.SH.P.J.P.Tiranë	0-2 muaj	2-6 muaj	mbi 6 muaj
1	Paditë me palë kundërshtare - civile në përgjithësi	588	395	2008
2	Paditë me palë kundërshtare - Çështje Familjare	1296	223	1038
3	Paditë pa palë kundërshtare - civile në përgjithësi	5154	6241	3901
4	Paditë pa palë kundërshtare - Çështje Familjare	93	130	212





4.4 Për vitin 2023, kohëzgjatja e përfundimit të çështjeve civile dhe familjare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ka qenë mesatarisht 332 ditë. Më konkretisht, referuar llojit të çështjes civile dhe familjare, kohëzgjatja e shqyrtimit gjyqësor ka qenë si vijon:

Viti 2023

Nr.	Lloji i çështjes në GJ.SH.P.J.P.Tiranë	0-2 muaj	2-6 muaj	mbi 6 muaj
1	Paditë me palë kundërshtare - civile në përgjithësi	554	371	2595
2	Paditë me palë kundërshtare - Çështje Familjare	1412	228	1245
3	Paditë pa palë kundërshtare - civile në përgjithësi	4018	2656	4108
4	Paditë pa palë kundërshtare - Çështje Familjare	91	116	253



4.5 Në mënyrë krahasimore për periudhën 2020-2023, kohëzgjatja e përfundimit të çështjeve civile dhe çështjeve familjare (me dhe pa palë kundërshtare) në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, referuar afateve kohore 0-2 muaj, 2-6 muaj dhe mbi 6 muaj, ka qenë si vijon në paraqitje grafike:




5. Kohëzgjatja e gjykimit të çështjeve të mbrojtjes së fëmijës (UM/UMM), referuar afateve kohore 0-2 muaj, 2-6 muaj dhe mbi 6 muaj, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për vitet 2020-2023.

5.1 Kohëzgjatja e gjykimit të masave të mbrojtjes për vitin 2020.

Viti 2020

Nr.	Masat e mbrojtjes në GJ.SH.P.J.P.Tiranë	0-2 Muaj	2- 6 Muaj	Mbi 6 Muaj	Çështje gjithsej
1	Kërkesa Civile për vazhdim, ndërprerje, heqje e Urdherit të Mbrojtjes	1	19	0	20
2	Kërkesa për lëshim Urdhëri të Menjëhershëm të Mbrojtjes (UMM)	1	804	0	805
3	Kërkesa për lëshim Urdhëri të Mbrojtjes (UM)	3	147	0	150




5.2 Kohëzgjatja e gjyqimit të masave të mbrojtjes për vitin 2021.

Viti 2021

Nr.	Masat e mbrojtjes në GJ.SH.P.J.P.Tiranë	0-2 Muaj	2- 6 Muaj	Mbi 6 Muaj	Çështje gjithsej
-----	---	----------	-----------	------------	------------------


1	Kërkesa Civile për vazhdim, ndërprerje, heqje e Urdherit të Mbrojtjes	0	9	0	9
2	Kërkesa për lëshim Urdhëri të Menjëhershëm të Mbrojtjes (UMM)	37	862	3	902
3	Kërkesa për lëshim Urdhëri të Mbrojtjes (UM)	3	157	0	160



5.3 Kohëzgjatja e gjyimit të masave të mbrojtjes për vitin 2022.

Nr.	Masat e mbrojtjes në GJ.SH.P.J.P.Tiranë	Viti 2022			Çështje gjithsej
		0-2 Muaj	2- 6 Muaj	Mbi 6 Muaj	


1	Kërkesa Civile për vazhdim, ndërprerje, heqje e Urdherit të Mbrojtjes	0	14	0	14
2	Kërkesa për lëshim Urdhëri të Menjëhershëm të Mbrojtjes (UMM)	6	1038	0	1044
3	Kërkesa për lëshim Urdhëri të Mbrojtjes (UM)	0	183	0	183



5.4 Kohëzgjatja e gjyimit të masave të mbrojtjes për vitin 2023.

					Viti 2023
Nr.	Masat e mbrojtjes në GJ.SH.P.J.P.Tiranë	0-2 Muaj	2- 6 Muaj	Mbi 6 Muaj	Çështje gjithsej

1	Kërkesa Civile për vazhdim, ndërprerje, heqje e Urdherit të Mbrojtjes	0	17	0	17
2	Kërkesa për lëshim Urdhëri të Menjëhershëm të Mbrojtjes (UMM)	3	1098	17	2018
3	Kërkesa për lëshim Urdhëri të Mbrojtjes (UM)	0	195	0	195




5.5 Në mënyrë krahasimore për periudhën 2020-2023, kohëzgjatja e përfundimit të çështjeve të mbrojtjes së fëmijës në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, referuar afateve kohore 0-2 muaj, 2-6 muaj dhe mbi 6 muaj, ka qenë si vijon në paraqitje grafike:

**CËSHTJE TË MBROJTJES SË FËMIJËS TË GJYKUARA NË GJ.SH.P.J.P.TIRANË,
GJITHSEJ PËR VITET 2020 - 2023**



5.6 Në mënyrë krahasimore për periudhën 2020-2023, çështjet që lidhen me masat e mbrojtjes së fëmijëve të cilat rezultojnë me një kohëzgjatje gjykimi mbi 2 muaj ose përtej afateve ligjore të shqyrtimit të tyre, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, rezultojnë sipas grafikut:




6. Kohëzgjatja e gjykimit të çështjeve familjare që prekin fëmijët, referuar afateve kohore 0-2 muaj, 2-6 muaj dhe mbi 6 muaj, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për vitet 2020-2023.

6.1 Kohëzgjatja e gjykimit të çështjeve familjare që prekin fëmijët për vitin 2020.

Viti 2020

Nr.	Lloji i çështjes në GJ.SH.P.J.P.Tiranë	0-2 Muaj	2- 6 Muaj	Mbi 6 Muaj	Çështje gjithsej
1	Padi zgjidhje martesë	379	80	635	1094
1/a	Zgjidhje martesë me marrëveshje	40	15	8	63
2	Padi pension ushqimor	3	1	7	11
3	Kërkesa civile marrje mase e përkohshme	6	153	2	161
4	Padi ushtrim i përgjegjësishë prindërore	7	7	13	27
5	Padi birësimi i fëmijës	6	9	2	17
6	Padi vendosja e kujdestarisë mbi fëmijën, heqja dhe zëvendësimi i kujdestarit	4	4	4	12
7	Padi vendosje në përkujdesje alternative	4	2	1	7




6.2 Kohëzgjatja e gjyqimit të çështjeve familjare që prekin fëmijët për vitin 2021.

Viti 2021

Nr.	Lloji i çështjes në GJ.SH.P.J.P.Tiranë	0-2 Muaj	2- 6 Muaj	Mbi 6 Muaj	Çështje gjithsej
-----	--	----------	-----------	------------	------------------


1	Padi zgjidhje martesë	476	106	998	1580
1/a	Zgjidhje martesë me marrëveshje	99	17	71	187
2	Padi pension ushqimor	4	1	15	20
3	Kërkesa civile marrje martesë e përkohshme	6	168	0	174
4	Padi ushtrim i përgjegjësishë prindërore	7	8	25	40
5	Padi birësimi i fëmijës	2	5	1	8
6	Padi vendosja e kujdestarisë mbi fëmijën, heqja dhe zëvendësimi i kujdestarit	12	5	13	30
7	Padi vendosje në përkujdesje alternative	8	6	5	19



6.3 Kohëzgjatja e gjyqimit të çështjeve familjare që prekin fëmijët për vitin 2022.

					Viti 2022
Nr.	Lloji i çështjes në GJ.SH.P.J.P.Tiranë	0-2 Muaj	2- 6 Muaj	Mbi 6 Muaj	Çështje gjithsej


1	Padi zgjidhje martesë	177	45	909	1131
1/a	Zgjidhje martesë me marrëveshje	38	7	114	159
2	Padi pension ushqimor	0	0	1	1
3	Kërkesa civile marrje mase e përkohshme	0	42	0	42
4	Padi ushtrim i përgjegjësishë prindërore	10	3	28	41
5	Padi birësimi i fëmijës	10	9	0	19
6	Padi vendosja e kujdestarisë mbi fëmijën, heqja dhe zëvendësimi i kujdestarit	2	0	20	22
7	Padi vendosje në përkujdesje alternative	4	3	8	15



6.4 Kohëzgjatja e gjyqimit të çështjeve familjare që prekin fëmijët për vitin 2023.


Viti 2023

Nr.	Lloji i çështjes në GJ.SH.P.J.P.Tiranë	0-2 Muaj	2- 6 Muaj	Mbi 6 Muaj	Çështje gjithsej
1	Padi zgjidhje martese	189	101	1024	1314
1/a	Zgjidhje martese me marrëveshje	35	12	111	158
2	Padi pension ushqimor	2	0	2	4
3	Kërkesa civile marrje mase e përkohshme	1	0	1	2
4	Padi ushtrim i përgjegjesisë prindërore	3	3	40	46
5	Padi birësimi i fëmijës	3	6	0	9
6	Padi vendosja e kujdestarisë mbi fëmijën, heqja dhe zëvendësimi i kujdestarit	6	2	22	30
7	Padi vendosje në përkuqdesje alternative	2	6	9	17




6.5 Në mënyrë krahasimore për periudhën 2020-2023, kohëzgjatja e përfundimit të çështjeve familjare që prekin fëmijët në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm

Tiranë, referuar afateve kohore 0-2 muaj, 2-6 muaj dhe mbi 6 muaj, ka qenë si vijon në paraqitje grafike:



6.6 Në mënyrë krahasimore, çështjet familjare që prekin fëmijët të cilat rezultojnë me një kohëzgjatje gjykimi mbi 6 muaj, rezultojnë sipas grafikut:



ANEKS 2 - REFERENCA

Referenca kombëtare:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (parashikimet kushtetuese për organet e drejtësisë ndryshuar me ligjin nr.76/2016, datë 22.7.2016)
- Kodi i Procedurës Civile (Ligji Nr. 8116, datë 29.3.1996, i ndryshuar)
- Ligji nr.9062, datë 8.5.2003 “Kodi i Familjes”, i ndryshuar
- Ligji nr. 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”
- Ligji nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar
- Ligji nr.9695, datë 19.3.2007 “Për procedurat e birësimit dhe komitetin shqiptar të birësimit”, i ndryshuar
- Paketa e Ligjeve të Reformës në Drejtësi:
 - *Ligj nr. 84/2016 datë 6.10.2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*
 - *Ligj nr. 95/2016 datë 6.10.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”*
 - *Ligj nr. 96/2016 datë 6.10.2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (shfuqizuar nene me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 34, datë 10.4.2017)*
 - *Ligj nr. 97/2016 datë 6.10.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”*
 - *Ligj nr. 98/2016 datë 6.10.2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” si dhe Relacion shpjegues i përmbajtjes së ligjit (datë 21 06 2016)*
 - *Ligj nr. 115/2016 datë 3.11.2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” (shfuqizuar nene me vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 41, datë 10.4.2017 dhe nr. 78, datë 12.12.2017)*
 - *Ligj nr. 8577 datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” (ndryshuar me ligjin nr. 99/2016, datë 6.10.2016).*
- Ligji nr. 111/2017 datë 14.12.2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”
- Ligji nr. 10 385, datë 24.2.2011 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 10 221, datë 4.2.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar;
- Dekreti nr. 7818, datë 16.11.2012, “Për caktimin e numrit të gjyqtarëve për çdo gjykatë të shkallës së parë, të apelit dhe të gjykatave administrative, si dhe caktimin e kompetencave tokësore dhe selisë qendrore të gjykatave administrative”, i ndryshuar.
- VKM Nr. 495, datë 21.7.2022 “Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave” si dhe relacioni përcjellës.
- VKM Nr. 892, datë 27.12.2022 “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale të drejtësisë për të mitur 2022–2026, planit të veprimit dhe të pasaportës së indikatorëve”
- VKM Nr. 409, datë 19.6.2019 “Për miratimin e planit të veprimit 2019–2021 të strategjisë ndërsektoriale të drejtësisë”
- VKM Nr. 773, datë 2.11.2016 “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale të drejtësisë 2017–2020 dhe të planit të saj të veprimit”.

- Vendimi nr. 211, datë 10.06.2022 i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për miratimin e raportit vlerësues dhe propozimit të grupit ndërinstitucional të punës mbi riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave”
- Vendim nr. 505, datë 21.11.2022 i “Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm”
- VKM nr.110, datë 6.3.2019 “Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre”;
- VKM nr.55, datë 6.2.2019 “Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit për autorizimin e organizatave jofitimprurëse, që ofrojnë ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti”. Strategjia e Reformës në Sistemin e Drejtësisë – Projekt 24 korrik 2015 – Kuvendi, Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë, Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë.
- Vendimi nr. 78/2019 i KLGJ-së.
- Analizë e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri - Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë - Qershor 2015
- Monitorimi i Zbatimit të Reformës në Drejtësi 2019, mbështetur nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë
- Raportet mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitet 2020, 2021, 2022 dhe 2023
- Raport Auditimi Performance i Kontrollit të Lartë të Shtetit, v.2023, me objekt “Shërbimi përmbartimor shtetëror në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore” , për vitet 2019 – 2022.
- Strategjia kombëtare e uljes së numrit të çështjeve të prapambetura në gjykata (2024-2027) e KLGJ.

Referenca ndërkombëtare:

- Konventa për të drejtat e fëmijëve e OKB-së, ratifikuar atë me Ligjin nr. 7531, datë 11.12.1991 “Për ratifikimin e Konventës për të Drejtat e Fëmijës (OKB)”
- Protokolli Opsional i KDF-së “Mbi procedurën e komunikimit” (OPIC) i Kombeve të Bashkuara të vitit 2011 (hyrë në fuqi nga muaji Prill 2014), ratifikuar me ligjin nr. 86/2013, datë 14.02.2013
- Committee on the Rights of the Child - Concept Note: General Comment on Children’s Rights to Access to Justice and Effective Remedies, on 95th session in January 2024.
- Konventa e Hagës mbi “Juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen, zbatimin dhe bashkëpunimin në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve” aderuar me ligjin nr. 9443, datë 16.11.2005, hyrë në fuqi më 1.4.2007
- Konventa e Hagës nr.23, date 2 tetor 1973 “Mbi njohjen dhe zbatimin e vendimeve në lidhje me detyrimet ushqimore” aderuar me ligjin nr. 10398, datë 17.3.2011, hyrë në fuqi më 1.12.2012

- Konventa e Hagës nr.24 “Për ligjin e zbatueshëm për detyrimet ushqimore”, 2 tetor 1973 aderuar me ligjin nr. 10397, datë 17.3.2011, hyrë në fuqi me 1.11.2011
- Konventa e Hagës nr.38, date 23 nëntor 2007 “Për rivendosjen ndërkombëtare të detyrimit ushqimor ndaj fëmijëve dhe formave të tjera të mbështetjes për anëtarët e tjerë të familjes”, ratifikuar me Ligjin nr.63/2012 datë 15.06.2012.
- Konventa e Hagës, nr.33 “Për mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin për birësimet jashtë vendit”, 29 maj 1993, ratifikuar me ligjin nr. 8624, datë 15.6.2000
- Konventa e Hagës “Për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës”, 25.10.1980, aderuar në këtë Konventë me ligjin nr. 9446, datë 24.11.2005 (me rezervat dhe deklaratimet e parashikuara në këtë ligj)
- Konventa e Hagës “Për marrëveshjet për zgjedhjen e gjykatës”, bërë në Hagë më 30 qershor 2005, ratifikuar me ligjin nr.42/2024, datë 02.05.2024
- Protokollin “Për ligjin e zbatueshëm për detyrimet ushqimore”, bërë në Hagë më 23 nëntor 2007, aderuar në Protokoll me ligjin nr.43/2024, datë 02.05.2024
- Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ratifikuar me Ligjin Nr.8137, datë 31.7.1996 “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, si dhe Protokollit Shtesë Nr.1, Nr.2, Nr.4, Nr.7 dhe Nr.11 të Konventës”. KEDNJ hyri në fuqi në Shqipëri në vitin 1996.
- Konventa Evropiane “Mbi ushtrimin e të drejtave të fëmijëve” e Këshillit të Evropës, ratifikuar me ligjin nr. 10425, datë 2.6.2011, hyrë në fuqi më 1 Shkurt 2012.
- Konventa Evropiane “Për marrëdhëniet me fëmijët” e Këshillit të Evropës, Bruksel me 15 maj 2003, ratifikuar me Ligjin Nr.9359, datë 24.3.2005 “Për ratifikimin e “Konventës Evropiane “Për marrëdhëniet me fëmijët””
- Konventa “Mbi njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve në lidhje me kujdestarinë e fëmijëve dhe rivendosjen e kujdestarisë mbi fëmijët” e Këshillit të Evropës, 20 maj 1980 (ETS No.105)
- Konventa e Këshillit të Europës “Për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje” - Stamboll, 11.V.2011.
- Rekomandimi Nr. R (91) 9, “Për masat emergjente në çështjet familjare” i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, miratuar nga Komiteti i Ministrave më 9 shtator 1991 në mbledhjen e 461-të të Zëvendës Ministrave.
- Opinioni Nr.6 (2004) i Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropiane (CCJE/ KKGJE) “Për gjykimin e drejtë brenda një kohë të arsyeshme, mjetet alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve” Strasburg, me 22-24 nëntor 2004
- Traktati për Bashkimin Evropian, nënshkruar në Maastricht, me 7 Shkurt 1992.
- Karta e të drejtave themelore e Bashkimit Evropian, shpallur solemnisht më 7 Dhjetor 2000 si dhe me 12 Dhjetor 2007 në Strasburg
- Rregullorja e Këshillit (BE) 2019/1111- Rregullorja e Brukselit Iib, 25 qershor 2019.
- Rregullorja e Këshillit (BE) 4/2009, 18 dhjetor 2008
- Commission Staff Working Document Albania 2014 - Progress Report, Brussels, 8.10.2014,
- Raporti i posaçëm i Komisionerit të Këshillit të Europës për të Drejtat e Njeriut për Shqipërinë, CommDH (2014)1, 16 janar 2015.

- Komisioni i Venecies, Opinioni nr.754/2014, për projekt ndryshimet penale.
- European Commission for the Efficiency of Justice (CEPEJ) HFII: Towards a better evaluation of the results of judicial reform efforts in the Western Balkans “DASHBOARD Western Balkans” Data collection: 2021 - Report prepared by the CEPEJ for the attention of the European Commission.
- Commission Staff Working Document Albania 2020 - Report Accompanying the Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions 2020 Communication on EU Enlargement Policy, Brussels, 6.10.2020
- Commission Staff Working Document Albania 2021 - Report Accompanying the document Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions 2021 Communication on EU Enlargement Policy, Strasbourg, 19.10.2021
- Commission Staff Working Document Albania 2022 - Report Accompanying the document Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions 2022 Communication on EU Enlargement policy - Brussels, 12.10.2022

Praktikë gjyqësore:

Vendime të Gjykatës Kushtetuese:

- Vendim nr.70, datë 29.12.2023
- Vendim nr.6, datë 16.02.2023,
- Vendim nr.25, datë 11.05.2023
- Vendim nr.2, datë 17.02.2022
- Vendim nr.3, datë 17.02.2022
- Vendim nr.17, datë 29.06.2022
- Vendim nr.75, datë 23.11.2017
- Vendim nr.4, datë 20.02.2013
- Vendim nr.1, datë 19.01.2009
- Vendim nr.6, datë 31.03.2006
- Vendim nr.18, datë 19.07.2005

Vendime të GJEDNJ-së:

- Bara dhe Kola kundër Shqipërisë (kërkesa nr. 43391/18 dhe 17766/19), 22 Shkurt 2022
- Gjonboçari dhe të tjerë kundër Shqipërisë
- Cështja POPADIĆ v. SERBIA, 20.09.2022 (app.no.7833/12)
- Stögmüller kundër Austrisë, nr. 1602/62, 10 nëntor 1969.
- H kundër Francës, 24 Tetor 1989,
- Paulsen-Medalen and Svensson kundër Suedisë, 19 Shkurt 1998,
- V.A.M kundër Serbisë, shkurt 1999

- Mikulić kundër Kroacisë
- Laino kundër Italisë
- Jansen kundër Norvegjisë.
- Popadic kundër Serbisë
- T.C. kundër Italisë,
- Süß kundër Gjermanisë,
- Strömblad kundër Suedisë,
- Ribić kundër Kroacisë.